



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime



LUFTIMI I TRAFIKIMIT TË MBETJEVE

UDHËZUES PËR PRAKTIKAT E MIRA LEGJISLATIVE

ZYRA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR DROGAT DHE KRIMIN

LUFTIMI I
TRAFIKIMIT TË MBETJEVE
UDHËZUES PËR PRAKTIKAT E MIRA LEGJISLATIVE



KOMBET E BASHKUARA
Vjenë, 2022

FALËNDERIME

Ky publikim është përgatitur nga Seksioni i Mbështetjes së Konferencave, Dega e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit të Paligjshëm, Divizioni për Çështjet e Traktateve pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) në kuadër të Programit Global për zbatimin e Konventës kundër Krimin të Organizuar: nga Teoria në Praktikë.

Kërkimi dhe hartimi: Colin Craig, Marion Crepet, Nancy Isarin, Roxana-Andreea Mastor, Chervine Oftadeh, Riikka Puttonen, Flavia Romiti dhe Felix Wegerle.

Kontributet: Në përgatitjen e këtij publikimi kontribuuan edhe shumë individë të tjerë. UNODC-ja u shpreh mirënjohje të gjithë atyre që kontribuuan përmes pjesëmarrjes së tyre në takimet e grupit të ekspertëve të mbajtura me qëllim të përgatitjes së publikimit dhe/ose përmes dorëzimit të komenteve me shkrim lidhur me draftet e mëparshme. UNODC-ja çmon kontributet e individëve të mëposhtëm:

Daniela Andreatta (Intellegjit/Universiteti i Trentos), David Azoulay (Qendra për të Drejtën Ndërkombëtare të Mjedisit), Matthew Baird (Instituti Kërkimor Aziatik për të Drejtën e Mjedisit), Michael Bejos (Organizata e Shteteve Amerikane), Vinati Bhola (Sekretariati i Konventave të Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit), Lieselot Bisschop (Universiteti Erasmus i Roterdamit), Anne Brosnan (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut), Amanda Cabrejo le Roux (eksperte ligjore e pavarur), Jonathan Clough (Universiteti Monash), Virginia Comolli (Iniciativa Globale kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar), Fabio de Rosa (Itali), Vincent Delbos (Francë), Leila Devia (Qendra Rajonale e Konventës së Bazelit për Amerikën e Jugut, Argjentinë), Serena Favarin (Transcrime, Universitë Cattolica del Sacro Cuore), Mauricio Fernández Montalbán (Kili), Tim Grabiell (Agjencia e Hetimit Mjedisor), Patricia Grollet (Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale), Yuyun Ismawati (Fondacioni Nexus3), Mengxing Lu (Universiteti Kinez i Shkencave Politike dhe Drejtësisë), Vittoria Luda di Cortemiglia (Instituti i Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Kërkim), Howard McCann (Mbretëria e Bashkuar), Katie Olley (Mbretëria e Bashkuar), LeRoy Paddock (Universiteti George Washington), Rodrigo Peña Sepúlveda (Kili), Joseph Poux (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), Roux Raath (Organizata Botërore e Doganës), Ieva Rucevska (GRID-Arendal), Henk Ruessink (Vendet e Ulëta), Antonio Segovia Arancibia (Kili), Aphrodite Smagadi (Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin), Tatiana Terekhova (Sekretariati i Konventave të Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit), Christian Tournié (Francë), William Wilson (Ekspert i Pavarur i Mbetjeve) dhe Fenny Wong Yuk Yin (Malajzi).

Personeli i mëposhtëm i UNODC-së gjithashtu kontribuoi në përgatitjen e këtij publikimi: Maria Adomeit, Agostina Baccino Uberti, Siri Bjune, Dimosthenis Chrysikos, Ioana Cotutiu, Shamini Jayanathan, Anne Linn Jensen, Olga Kuzmianok, Nicole Quijano-Evans, Louise Portas, Raha Sayadifar, Daniela Sota Valdivia, Edmund Landy Tei, Stephen Thurlow, Lejda Toci dhe Michiel van Dyk.

UNODC-ja dëshiron gjithashtu të falënderojë Qeverinë e Francës për kontributin bujar të financimit dhënë Programit Global për Zbatimin e Konventës për Krimin e Organizuar: nga Teoria në Praktikë, duke e bërë të mundur publikimin.

© Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2022. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara në mbarë botën.

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehje të kurrfarë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara lidhur me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, qyteti a zone ose të autoriteteve të tyre, apo lidhur me delimitimin e kufijve të tyre shtetërorë ose administrativë.

Lidhjet me uebsajtet që janë dhënë në këtë publikim ofrohen për lehtësinë e lexuesit dhe janë të sakta në momentin e botimit. Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk merr asnjë përgjegjësi për saktësinë e tyre në vijimësi pas botimit ose për përmbajtjen e ndonjë uebsajti të jashtëm.

Botimi: Anglisht, Seksioni i Botimeve dhe Bibliotekave, Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Vjenë.

PËRMBAJTJA

HYRJE	1
Konteksti për këtë udhëzues	1
Konceptimi i krimit të mbetjeve, shkeljeve të mbetjeve dhe trafikimit të mbetjeve...	2
Natyra, shkalla dhe ndikimet e krimit të mbetjeve dhe trafikimit të mbetjeve	2
Qëllimi, fushëveprimi dhe audienca e synuar e udhëzuesit	3
Si përdoret udhëzuesi	4
1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME	7
Kuatri ligjor ndërkombëtar	7
E drejta ndërkombëtare e mjedisit	8
Kuatri ligjor ndërkombëtar për luftimin e krimit të rëndë	16
E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut	18
Legjislacioni i brendshëm për menaxhimin e mbetjeve	21
Kuatri institucional kombëtar	21
Përgjegjësitë dhe kompetencat	22
Institucionet e përfshira në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve	23
Konsiderata të mëtejshme	25
2. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	27
Deklarimi i parimeve të së drejtës së mjedisit	27
Përkufizimet	29
Tabelat e mbetjeve	32
Juridiksioni	34
3. SHKELJET DHE PËRGJEGJËSIA	37
Elementet e figurës së veprave penale	38
Shkeljet e mbetjeve	40
Trafikimi i mbetjeve	40
Mashtrimi me dokumente në lidhje me menaxhimin e mbetjeve	44

Shkeljet plotësuese	45
Konspiracioni dhe bashkimi kriminal.....	46
Pastrimi i parave	48
Korrupsioni.....	49
Pengimi i drejtësisë	50
Përgjegjësia dytësore	51
Përgjegjësia për tentativën	53
Përgjegjësia e personave juridikë	53
Rëndësia e kujdesit të duhur	59
Sfidat për vërtetimin e përgjegjësisë së personave juridikë.....	59
Mbrojtjet	62
4. HETIMI	63
Kompetencat e përgjithshme hetimore	63
Teknikat e posaçme hetimore	64
Dorëzimi i kontrolluar	66
Hetimi nën mbulim	67
Identiteti i pretenduar	69
Vëzhgimi i personave	70
Vëzhgimi elektronik.....	71
Sekuestrimi dhe konfiskimi	73
Kthimi i mbetjeve të trafikuara përtej kufijve ndërkombëtarë.....	74
Provat.....	75
Marrja.....	76
Trajtimi	76
Pranueshmëria	77
5. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	79
Ndihma e ndërsjellë juridike.....	80
Ekstradimi	81
Bashkëpunimi i forcave ligj-zbatuese	82
Hetimet e përbashkëta.....	83
6. NDJEKJA PENALE DHE MASAT NDËSHKUESE	87
Ndjekja penale.....	87
Diskrecioni i prokurorisë dhe udhëzimet për ndjekjen penale dhe ekzekutimin	87

Paraburgimi	88
Alternativat e gjykimit	89
Afatet e parashkrimit	91
Masat ndëshkuese dhe caktimi i dënimit	92
Konsideratat në themel të dënimit	92
Llojet e sanksioneve	98
7. MBROJTJA DHE NDIHMA	107
Mbrojtja e dëshmitarëve, viktimave dhe personave që bashkëpunojnë me autoritetet ...	107
Mbrojtja e dëshmitarëve gjatë procedimeve gjyqësore	110
Mbrojtja e sinjalizuesve dhe personave të tjerë raportues	110
Ndihma për viktimat	113
Restitucioni dhe kompensimi	113
Aksesi dhe pjesëmarrja në procedimet penale dhe të tjera	116
Masat e tjera të ndihmës	116
8. BASHKËRENDIMI KOMBËTAR	117
FJALË PËRMBYLLËSE	121
BURIME TË TJERA	123
Burime në lidhje me trafikimin e mbetjeve	123
Publikime të UNODC-së	123

HYRJE

KONTEKSTI PËR KËTË UDHËZUES

Krimet që prekin mjedisin janë ndër llojet më fitimprurëse dhe me rritjen më të shpejtë të veprimtarisë kriminale ndërkombëtare.¹ Në rezolutën 10/6, të adoptuar në vitin 2020, Konferenca e Palëve në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar shprehu alarmin e saj lidhur me kërkimet që tregojnë se krimet që prekin mjedisin ishin bërë ndër aktivitetet kriminale ndërkombëtare më fitimprurëse dhe shpesh ishin të ndërlidhura ngushtë me forma të ndryshme të krimit dhe korrupsionit, dhe se pastrimi i parave dhe flukset e paligjshme financiare që përftoheshin prej tyre mund të kontribuojnë në financimin e krimeve të tjera të organizuara ndërkombëtare dhe terrorizmit. Konferenca konfirmoi se Konventa kundër Krimin të Organizuar

përbën një mjet efektiv dhe një pjesë thelbësore të kuadrit ligjor për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar që prek mjedisin dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë drejtim

dhe kërkoi nga

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, në varësi nga disponueshmëria e burimeve jashtëbuxhetore, dhe brenda mandatit të saj, të ofrojë asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh për Shtetet palë, sipas kërkesës, për qëllime të mbështetjes së përpjekjeve të tyre për të zbatuar në mënyrë efektive Konventën në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar që prek mjedisin.

Në vitin 2019, Konferenca e Shteteve Palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, në rezolutën e saj 8/12, vuri në dukje me shqetësim rolin që mund të luajë korrupsioni në krimet që kanë ndikim në mjedis dhe shprehu shqetësimin se pastrimi i parave mund të përdoret për të maskuar dhe/ose fshehur burimet e produkteve të përfutuara në mënyrë të kundërligjshme, si dhe për të lehtësuar krimet që kanë ndikim në mjedis.

Në vitin 2021, Kongresi i Katërmbëdhjetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimin dhe Drejtësinë Penale adoptoi Deklaratën e Kiotos për avancimin e parandalimit të krimit, drejtësisë penale dhe sundimit të ligjit: Drejtësinë e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në të cilën përsëritet zotimi i Kombeve të Bashkuara për të adoptuar masa efektive për të parandaluar dhe luftuar krimet që prekin mjedisin, duke përfshirë, ndër krime të tjera, trafikun e paligjshëm të mjetëve të rrezikshme dhe të tjera, me përdorimin më të mirë të mundshëm të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe duke forcuar legjislacionin, bashkëpunimin ndërkombëtar, ngritjen e kapaciteteve, reagimet e drejtësisë penale dhe përpjekjet ligj-zbatuese që synojnë, ndër të tjera, trajtimin e krimit të organizuar ndërkombëtar, korrupsionit dhe pastrimit të parave të lidhur me krime të tilla dhe flukset e paligjshme financiare të përfutuara nga krime të tilla, ndërsa njihet nevoja për t'i privuar kriminelët nga produktet e krimit.² Në të njëjtin vit, Asambleja e Përgjithshme, në rezolutën e saj 76/185, u kërkoi Shteteve Anëtare të merrnin të njëjtat masa.

¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), *The State of Knowledge of Crimes that have Serious Impacts on the Environment* (Nairobi, 2018), f. 1.

² Asambleja e Përgjithshme, Rezolutë 76/181, aneks, para. 87.

Konceptimi i krimit të mbetjeve, shkeljeve të mbetjeve dhe trafikimit të mbetjeve

Nuk ka një përkufizim të pranuar botërisht për krimin e mbetjeve. Në përgjithësi, krimi i mbetjeve mund të konsiderohet se i referohet veprimeve që lidhen me mbetjet dhe që janë të përcaktuara si vepra penale. Më saktësisht, krimi i mbetjeve në përgjithësi mund të kuptohet si tregtimi, trajtimi ose asgjësimi i mbetjeve në mënyra që shkelin legjislacionin ndërkombëtar ose të brendshëm mjedisor dhe shkaktojnë dëm ose rrezik për mjedisin dhe [ose] shëndetin e njeriut dhe veprimet që lidhen me to, siç janë veprimet mashtruese dhe mosveprimet.³

Kuptimi i “shkeljet e mbetjeve” mund të ndryshojë në varësi nga konteksti. Në disa kontekste, shkeljet e mbetjeve mund të përdoret si term ombrellë për t’iu referuar jo vetëm veprave penale që lidhen me mbetjet, por edhe shkeljeve civile dhe administrative. Në kontekste të tjera, kur diskutohen veçanërisht veprat penale, shkeljet e mbetjeve mund të konsiderohen se i referohen krimit të mbetjeve. Duke qenë se ky udhëzues ka të bëjë kryesisht me përgjegjësinë penale, është marrë qasja e fundit.

“Trafikimi i mbetjeve” është gjithashtu një term që mund të ketë përkufizime të ndryshme, duke filluar nga përkufizimet më të ngushta që fokusohen në lëvizjen e mbetjeve dhe, në veçanti, lëvizjen e mbetjeve që është ndërkufitare ose ndërkombëtare, deri në përkufizime më të gjera që përfshijnë një gamë më të gjerë të akteve dhe nuk kufizohen në lëvizjet ndërkufitare. Trafikimi i mbetjeve mund të kuptohet si një nëngrup i krimit të mbetjeve dhe shkeljeve të mbetjeve, megjithëse një nëngrup me gjerësi të ndryshme në varësi nga mënyra se si përdoret termi. Për qëllimin e këtij udhëzuesi, trafikimi i mbetjeve kuptohet gjerësisht dhe nënkupton importimin, eksportimin, transportimin, blerjen, shitjen, brokerimin, trajtimin, përpunimin, grumbullimin, klasifikimin, etiketimin, manipulimin, përdorimin, magazinimin, riciklimin, asgjësimin dhe djegien e mbetjeve nga tabelat në kundërshtim me ligjin e brendshëm.⁴ Një koncept i gjerë i trafikimit, i cili shkon përtej transportit të thjeshtë dhe synon të përfshijë akte që lidhen me transportin, është në përputhje me konceptet e trafikimit nga disa kontekste të tjera, siç është përkufizimi i trafikimit në Protokollin për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar,⁵ dhe nocioni i trafikimit që përdoret në disa publikime të tjera të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), si p.sh. Udhëzues për hartimin e legjislacionit për luftimin e krimit të faunës dhe florës së egër⁶ dhe *Lufta kundër krimit që lidhet me falsifikimin e produkteve mjekësore: Udhëzues për praktikën e mirë legjislative*.⁷

Ky udhëzues ka të bëjë me hartimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve. Prandaj, ai përdor kryesisht termin “trafikim i mbetjeve”. Aty ku udhëzuesi i referohet kategorisë më të gjerë të veprave penale në lidhje me mbetjet, përdoren termat “krim i mbetjeve” ose “shkelje të mbetjeve”.

Natyrë, shkallë dhe ndikimet e krimit të mbetjeve dhe trafikimit të mbetjeve

Kërkimet mbi natyrën dhe shkallën e krimit të mbetjeve mbeten të kufizuara, veçanërisht nga një këndvështrim empirik.⁸ Trafikimi i mbetjeve ndodh si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht. Në nivelin ndërkombëtar, mbetjet zakonisht trafikohen nga vendet e zhvilluara në vendet më pak të zhvilluara, me flukse tregtare nga veriu global (Bashkimi Evropian, Japonia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Australia)

³ Lieselot Bisschop dhe Wim Huisman, “Waste crime from three criminological perspectives: implications for crime control and harm prevention”, në *Green Crimes and Dirty Money*, Toine Spapens and other, eds. (London, Routledge, 2018), f. 150.

⁴ Shih “Trafikimi i mbetjeve” në kapitullin 3, më poshtë.

⁵ Neni 3. nënpara. (a).

⁶ Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), *Guide to Drafting Legislation to Combat Wildlife Crime* (Vjenë, 2018), f. 13.

⁷ UNODC, *Combating Falsified Medical Product-Related Crime: A Guide to Good Legislative Practices* (Vjenë, 2019), f. 11.

⁸ Daniela Andreatta dhe Serena Favarin, “Features of transnational illicit waste trafficking and crime prevention strategies to tackle it”, *Global Crime*, vol. 21, No. 2 (shkurt 2020), f. 2; dhe Serena Favarin dhe Alberto Aziani, “The global waste trafficking and its correlates”, *Journal of Contemporary Criminal Justice*, vol. 36, No. 3 (korrik 2020), f. 352.

drejt jugut global (Afrika, Azia dhe Amerika e Jugut).⁹ Trafikimi i mbetjeve ngërthen një sërë aktorësh, duke përfshirë kompanitë që operojnë në industrinë e ligjshme të mbetjeve dhe grupet e organizuara kriminale. Megjithëse shkalla e saktë e krimit të mbetjeve është e vështirë të vlerësohet,¹⁰ krimi i mbetjeve konsiderohet si një nga krimet më të ndjeshme që prek mjedisin.¹¹

Ajo që është e qartë është gama e ndikimeve të dëmshme të krimit të mbetjeve dhe trafikimit të mbetjeve në mjedis, habitate, jetën e njeriut dhe kafshëve, shëndetin publik, sigurinë e ushqimit, jetesën, ekonominë, zhvillimin dhe sundimin e ligjit. Megjithëse rikuperimi i materialeve nga lloje të caktuara mbetjesh ofron një mjet të rëndësishëm për të gjeneruar të ardhura, veçanërisht në sektorin informal,¹² vendet në zhvillim dhe popullsitë e cenueshme janë më të goditurat nga krimi i mbetjeve dhe trafikimi i mbetjeve, ku gratë, fëmijët, popullsia indigjene, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët,¹³ të varfrit, migrantët dhe pakicat përballen me ndikimet më të mëdha.¹⁴ Krimi i mbetjeve në përgjithësi pengon përparimin drejt zbatimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Si rezultat i ndikimeve të përmendura më lart, krimi i mbetjeve kërcënon, ndër të tjera, arritjen e Objektivit 3 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe), Objektivit 6 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujës-jellës-kanalizimeve për të gjithë), Objektivit 12 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit), Objektivit 8 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë), Objektivit 14 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm), Objektivit 15 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Mbrotjtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretëtirizimit, ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit) dhe Objektivit 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet).

Pikërisht në këtë kontekst UNODC ka përgatitur udhëzuesin aktual. Seksionet pasuese të hyrjes trajtojnë qëllimin, fushëveprimin dhe audiencën e synuar të udhëzuesit dhe mënyrën se si mund të përdoret udhëzuesi.

QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE AUDIENCA E SYNUAR E UDHËZUESIT

Ky udhëzues synon të mbështesë Shtetet në miratimin ose forcimin e legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Së këndejmi, udhëzuesi është menduar kryesisht për politikëbërësit, ligjvënësit dhe hartuesit e legjislacionit që i mbështesin ata për të miratuar dhe forcuar legjislacionin. Për më tepër, ai përmban diskutime dhe analiza të çështjeve që lidhen me zbatimin e kuadrit legjislativ që synon parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve nga hetuesit, prokurorët, gjyqtarët dhe aktorët e tjerë në sistemin e drejtësisë penale, veçanërisht kur këto çështje duhet të merren parasysh edhe nga politikëbërësit, ligjvënësit dhe

⁹ Favarin dhe Aziani, "The global waste trafficking and its correlates".

¹⁰ Lorraine Elliott, "Fighting transnational environmental crime", *Journal of International Affairs*, vol. 66, No. 1, (2012),

f. 92; dhe Jim Baird, Robin Curry dhe P. Cruz, "An overview of waste crime, its characteristics, and the vulnerability of the EU waste sector", *Waste Management and Research: Journal for Sustainable Circular Economy*, vol. 32, No. 2 (shkurt 2014), fq. 97–98

¹¹ UNEP, *The State of Knowledge of Crimes*, p. 1.

¹² UNEP/CHW/OEWG/6/INF/17, para. 12.

¹³ Për një ekzaminim të ndikimeve të krimit të mbetjeve nga këndvështrimi i punës dhe menaxhimit të shëndoshë të mbetjeve në punë, shih Karin Lundgren, *The Global Impact of e-Waste: Addressing the Challenge* (Gjenevë, Zyra Ndërkombëtare e Punës, Programi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Mjedisin, Departamenti i Aktiviteteve Sektoriale, 2012); dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës, "The sound management of chemicals and waste in the world of work" (Gjenevë, 2019).

¹⁴ Shih A/HRC/36/41, para. 24–44; A/75/290, para. 20–48; A/HRC.25/53, para. 69–78; A/HRC/33/41; dhe A/HRC/42/41.

hartuesit e legjislacionit. Përtej këtyre grupeve, udhëzuesi mund të jetë gjithashtu i dobishëm për aktorët e sistemit të drejtësisë penale, studiuesit akademikë, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara.

Përveç Konventës për Krimin e Organizuar, udhëzuesi gjithashtu merr parasysh dispozitat e instrumenteve të tjera relevante ndërkombëtare, duke përfshirë, veçanërisht, Konventën e Bazelit për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre.¹⁵ Konventa e Bazelit është paraqitur në kapitullin 1,¹⁶ por vlen të theksohet shkurtimisht, gjatë diskutimit të fushëveprimit të udhëzuesit, se ai shkon përtej fushëveprimit të Konventës së Bazelit në dy aspekte. Së pari, ndryshe nga Konventa e Bazelit, shkeljet që mbulohen nga ky udhëzues nuk kufizohen në lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve. Së dyti, udhëzuesi nuk kufizohet në kategoritë e mbetjeve që mbulohen nga Konventa e Bazelit.¹⁷ Arsyeja për këtë qasje është që të sigurohet se udhëzuesi është gjithëpërfshirës, trajton të gjitha format e trafikimit të mbetjeve dhe mbështet Shtetet për të shmangur dhe mbyllur boshllëqet në kuadrin legjislativ kombëtar.

Në fillim, vlen të theksohet se udhëzuesi i qaset trafikimit të mbetjeve dhe problemit të mbetjeve gjerësisht, nga këndvështrimi i politikës së drejtësisë penale. Ndonëse qasjet e drejtësisë penale janë komponent i domosdoshëm i një reagimi holistik të politikave ndaj trafikimit të mbetjeve, ato nuk janë – dhe nuk duhet të jenë – të vetmet qasje, pasi ato nuk janë, në vetvete, të mjaftueshme. Megjithatë, ndërsa qasjet më të gjera rregullatore për menaxhimin e mbetjeve janë kritike për trajtimin e trafikimit të mbetjeve, ato janë përtej fushëveprimit të këtij publikimi dhe nuk trajtohen këtu.

SI PËRDORET UDHËZUESI

Shtetet mund ta përdorin këtë udhëzues si një mjet ndërsa hartojnë, rishikojnë ose ndryshojnë legjislacionin përkatës kombëtar për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve. Për shkak se legjislacioni kombëtar duhet të përshtatet enkas me traditën ligjore të secilit Shtet dhe rrethanat shoqërore, ekonomike, kulturore dhe gjeografike, udhëzuesi nuk ofron dhe nuk duhet të shihet se ofron ligj model të tipit “një kallëp për të gjithë” që është i gatshëm për t’u futur në çdo dhe të gjitha sistemet ligjore të brendshme. Përkundrazi, Shtetet duhet të përshtatin modelet e dispozitave dhe udhëzimet e ofruara për t’i dalë ndesh kushteve vendore, parimeve kushtetuese, kulturës dhe strukturave ligjore dhe rregulimeve ekzistuese të ekzekutimit. Udhëzuesi rekomandon që Shtetet të konsultohen me të gjithë aktorët përkatës ndërsa angazhohen në procesin e hartimit, rishikimit ose ndryshimit të legjislacionit për trafikimin e mbetjeve.

Shtete të ndryshme kanë marrë qasje të ndryshme për përcaktimin e shkeljeve të trafikimit të mbetjeve. Disa Shtete i kanë trajtuar shkeljet e trafikimit të mbetjeve në legjislacionin e specializuar për mbetjet ose mjedisin, ndërsa të tjerët kanë përfshirë shkeljet e trafikimit të mbetjeve në kodet penale ekzistuese. Shtetet duhet të sigurojnë më tej që shkeljet e trafikimit të mbetjeve dhe dispozitat përkatëse të harmonizohen me sistemet ligjore ekzistuese të brendshme për të shmangur krijimin e paqëllimshëm të zbrazëtirave, mbivendosjeve ose kundërthënieve që pengojnë efektivitetin e legjislacionit.

Në të gjithë dispozitat legjislative model të përfshira në udhëzues, kllapat katrore përdoren për të treguar fjalë ose fraza të veçanta që do të duhet të përshtaten posaçërisht për Shtetin në fjalë. Për shembull, udhëzuesi përdor kllapa katrore kur modelet e dispozitave i referohen emrit të Shtetit, dispozitave të tjera të përfshira në udhëzues, ligjeve të tjera të brendshme dhe gjykatave, ministrive dhe autoriteteve kompetente të brendshme. Udhëzuesi përdor gjithashtu kllapa katrore për të theksuar situatat në të cilat hartuesve të legjislacionit u prezantohen formulime alternative për shqyrtim.

Ky udhëzues ndahet në tetë kapituj:

- Kapitulli 1: Konsiderata të përgjithshme
- Kapitulli 2: Dispozita të përgjithshme
- Kapitulli 3: Shkeljet dhe përgjegjësia
- Kapitulli 4: Hetimi

¹⁵ Për një diskutim të instrumenteve të tjera relevante ndërkombëtare, shih kap. 1, “Kuadri ligjor ndërkombëtar”.

¹⁶ Shih kap. 1, pika “E drejta ndërkombëtare e mjedisit”.

¹⁷ Konventa e Bazelit përkufizon “mbetjet”, gjerësisht, në nenin 2, para. 1, por shtrirja e mbetjeve që i nënshtrohen Konventës kufizohet nga neni 1, duke përfshirë përmes referimeve për kategoritë e mbetjeve të përcaktuara në anekset e Konventës.

- Kapitulli 5: Bashkëpunimi ndërkombëtar
- Kapitulli 6: Ndjekja penale dhe masat ndëshkuese
- Kapitulli 7: Mbrojtja dhe ndihma
- Kapitulli 8: Bashkërendimi kombëtar

Përpara se të prezantohen dispozitat e veçanta legjislativë për luftimin e trafikimit të mbetjeve, kapitulli 1 parashtrohet disa çështje paraprake që duhet të merren parasysh nga ligjvënësit përpara adoptimit ose ndryshimit të ligjeve përkatëse. Kapitujt 2 deri në 8 përfshijnë udhëzime legjislativë dhe dispozita legjislativë model. Dispozitat legjislativë model janë vendosur në kutitë blu. Përfshihen gjithashtu shembuj nga legjislacionet kombëtare për të treguar se si Shtetet kanë nxjerrë ligje për të luftuar trafikimin e mbetjeve dhe krimin e organizuar në praktikë. Është punuar me kujdes për të siguruar përfaqësim gjeografik me drejtëri në shembujt e prezantuar të ligjvënies së brendshme dhe për të pasqyruar diversitetin e traditave ligjore të Shteteve.



Kapitulli 1.

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Përpara se të përqendrohemi në dispozitat legislative model specifike për luftën kundër trafikimit të mbetjeve, kapitulli i parë i këtij udhëzuesi trajton disa konsiderata të përgjithshme që duhen marrë parasysh gjatë hartimit ose ndryshimit të legjislacionit për luftimin e trafikimit të mbetjeve. Këto konsiderata janë kuadri ligjor ndërkombëtar që është i zbatueshëm, legjislacioni i brendshëm për menaxhimin e mbetjeve dhe nevoja për një kuadër të përshtatshëm institucional kombëtar për të mbështetur zbatimin e legjislacionit.

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR

E drejta ndërkombëtare kërkon që Shtetet të ndërmarrin veprime të caktuara legislative, duke vendosur gjithashtu kufizime për veprimet legislative në dispozicion të Shteteve. Për shembull, neni 9, paragrafi 5 i Konventës së Bazelit kërkon që palët të krijojnë legjislacionin e përshtatshëm kombëtar për të parandaluar dhe ndëshkuar trafikun e kundërligjshëm të mbetjeve. Neni 5 i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të adoptojnë masa legislative për të cilësuar si vepër penale pjesëmarrjen në një grup kriminal të organizuar. Nga ana tjetër, e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut nuk i lejon Shtetet të adoptojnë masa legislative që nuk respektojnë të drejtat e njeriut të të pandehurve, viktimave dhe palëve të ndryshme të interesuara që mund të preken nga masat e drejtësisë penale.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, gjatë hartimit të legjislacionit për luftimin e trafikimit të mbetjeve, Shtetet duhet të marrin parasysh kuadrin ligjor ndërkombëtar që është i zbatueshëm, duke përfshirë konventat ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare zakonore dhe parimet e përgjithshme të së drejtës. Ky seksion ofron një përmbledhje të shkurtër të komponentëve kyç të kuadrit ligjor ndërkombëtar që zbatohet për trafikimin e mbetjeve dhe mbulon fushat e mëposhtme:

- E drejta ndërkombëtare e mjedisit
- Kuadri ligjor ndërkombëtar për luftimin e krimeve të rënda
- E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut

Detyrimet e secilit Shtet të veçantë sipas të drejtës ndërkombëtare medoemos do të ndryshojnë, në varësi nga, ndër të tjera, traktatet ndërkombëtare dhe rajonale në të cilat ai është palë. Së këndejmi, në vlerësimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar që është i zbatueshëm, Shtetet duhet të marrin parasysh traktatet specifike në të cilat janë palë, përveç udhëzimeve të përfshira në këtë kapitull.

E drejta ndërkombëtare e mjedisit

E drejta ndërkombëtare e mjedisit i referohet kuadrit ligjor dhe rregullator të krijuar nga komuniteti i Shteteve sovraane për të adresuar dëmet mjedisore në nivelin global.¹⁸ Kuadri i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit përfshin, ndër burime të tjera, një numër në rritje të traktateve ndërkombëtare, si dhe deklarata dhe rezoluta jodetyruese. Në këtë seksion, burimet relevante të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit janë diskutuar përpara se të merren parasysh parimet relevante të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.

Burimet relevante të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit

Burimet e së drejtës ndërkombëtare të mjedisit janë të ndryshme, dhe një përshkrim dhe taksonomi gjithëpërfshirëse e këtyre burimeve është përtej fushëveprimit të këtij publikimi.¹⁹ Megjithatë, ky seksion sjell në vëmendjen e lexuesve disa burime kyç të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, të rëndësishme për zhvillimin e legjislacionit për të luftuar trafikimin e mbetjeve. Këto burime përfshijnë edhe instrumentet që adresojnë në mënyrë specifike mbetjet edhe instrumentet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.

Marrëveshja kryesore ndërkombëtare me rëndësi për trafikimin e mbetjeve është Konventa e Bazelit për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre. Ajo u adoptua më 22 mars 1989 dhe hyri në fuqi më 5 maj 1992. Në kohën e hartimit të këtij udhëzuesi, Konventa e Bazelit kishte 189 palë, duke reflektuar aderimin pothuajse universal. Një publikim i vitit 2016 i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) vuri në dukje se “objektivi ombrellë i Konventës së Bazelit është të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin kundër efekteve të pafavorshme të menaxhimit të papërshtatshëm dhe lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme”²⁰

Konventa e Bazelit përcakton një procedurë të njohur si “pëlqimi i informuar paraprak”, sipas së cilës palëve u kërkohet të ndalojnë ose të përmbahen nga lejimi i eksportit të mbetjeve të rrezikshme dhe të tjera në një Shtet importues nëse Shteti importues nuk ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për një import specifik,²¹ kur Shteti i fundit nuk e ka ndaluar plotësisht importin e këtyre mbetjeve.²² Gjithashtu kërkohet pëlqimi nga çdo Shtet transit, përveç rastit kur Shteti transit ka hequr dorë nga kërkesa.²³ Konventa e Bazelit e konsideron trafikun e kundërligjshëm të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera si krim²⁴ dhe kërkon që palët të vendosin masat e duhura legjislative për të parandaluar dhe ndëshkuar trafikun e kundërligjshëm dhe të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për këtë qëllim.²⁵ Palët janë gjithashtu të detyruara të marrin masat e duhura për të siguruar që gjenerimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera në territorin e tyre është pakësuar në minimum²⁶ dhe për të siguruar disponueshmërinë e instalimeve adekuata të asgjësimit për menaxhimin e shëndoshë mjedisor²⁷ të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera.²⁸ Palët duhet të

¹⁸ Lavanya Rajamani dhe Jacqueline Peel, “International environmental law: changing context, emerging trends and expanding frontiers”, në *The Oxford Handbook of International Environmental Law*, 2nd ed., Lavanya Rajamani and Jacqueline Peel, eds. (Oxford, Oxford University Press, 2021), f. 2..

¹⁹ Për një hyrje në burimet e së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, shih Catherine Redgwell, “Sources of international environmental law: formality and informality in the dynamic evolution of international environmental law norms”, në *The Oxford Handbook of Sources of International Law*, Samantha Besson and Jean d’Aspremont, eds. (Oxford, Oxford University Press, 2017).

²⁰ Ieva Rucevska dhe të tjerë, *Waste Crime – Waste Risks: Gaps in Meeting the Global Waste Challenge – A Rapid Response Assessment*. (Nairobi, UNEP, 2015), f. 11.

²¹ Konventa e Bazelit, neni 4, para. 1 (c). Procedura e pëlqimit të informuar paraprak parashikohet me më shumë hollësi në nenin 6..

²² Po aty, neni 4, para. 1 (a)–(c)..

²³ Po aty, neni 6, para. 4..

²⁴ Po aty, neni 4, para. 3..

²⁵ Po aty, neni 9, para. 5. Shih gjithashtu nenin 4, para. 4. Për kuptimin e shprehjes “trafiku i kundërligjshëm” për qëllimet e Konventës së Bazelit, shih nenin 9, para. 1.

²⁶ Konventa e Bazelit, neni 4, para. 2 (a)..

²⁷ Neni 2, paragrafi 8, i Konventës së Bazelit e përkufizon menaxhimin e shëndoshë mjedisor si “marrja e të gjithë hapave praktikë për të siguruar që mbetjet e rrezikshme ose mbetjet e tjera menaxhohen në një mënyrë që do të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga efektet e pafavorshme që mund të rezultojnë nga këto mbetje”.

²⁸ Konventa e Bazelit, neni 4, para. 2 (b).

sigurojnë më tej që lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme dhe të tjera është pakësuar në minimum në përputhje me menaxhimin e shëndoshë dhe eficient mjedisor të mbetjeve të tilla,²⁹ dhe janë të detyruara të parandalojnë eksportin ose importin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera kur kanë arsye të besojnë se ato nuk do të menaxhohen në mënyrë të shëndoshë mjedisore.³⁰ Një amendament i Konventës (Amendamenti i Ndalimit), i cili fillimisht u adoptua më 22 shtator 1995 dhe hyri në fuqi më 5 dhjetor 2019, kërkon nga palët e renditura në aneksin VII (në kohën e hartimit të këtij udhëzuesi, vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Lihtenshtajni) të ndalojnë të gjitha lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme të destinuara për asgjësim në Shtetet që nuk renditen në aneksin VII, dhe gjithashtu të ndalojnë të gjitha lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme të mbuluara nga neni 1, paragrafi 1 (a) i Konventës³¹ dhe të destinuara për ripërdorim, riciklim ose operacione rikuperimi në Shtetet që nuk renditen në aneksin VII.³²

Përveç Konventës së Bazelit, Shtetet që krijojnë ligje për trajtimin e trafikimit të mbetjeve duhet të marrin parasysh dispozitat relevante të marrëveshjeve ndërkombëtare që rregullojnë forma specifike të mbetjeve, si dhe çdo instrument rajonal të zbatueshëm në lidhje me mbetjet. Në instrumentet rajonale përfshihen Konventa e Bamakos për ndalimin e importit në Afrikë dhe kontrollin e lëvizjes ndërkufitare dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme brenda Afrikës, e adoptuar nga Këshilli i Ministrave të Organizatës së Unitetit Afrikan (tani i njohur si Unioni Afrikan); Konventa për ndalimin e importimit të mbetjeve të rrezikshme dhe radioaktive në vendet ishullore të Forumit dhe për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme brenda Rajonit të Paqësorit Jugor (Konventa e Uaiganit), e adoptuar nga qeveritë në Paqësorin Jugor pas negociatave në Forumin e Ishujve të Paqësorit; dhe Direktiva 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 19 nëntor 2008, për mbetjet dhe që shfuqizon disa direktiva të caktuara, e adoptuar nga Bashkimi Evropian.

Në nivelin ndërkombëtar, ekzistojnë gjithashtu disa instrumente që rregullojnë forma specifike të mbetjeve që ligjvënësit duhet t'i marrin parasysh. Këtu përfshihen Konventa e Roterdamit për procedurën e pëlqimit të informuar paraprak për disa kimikate dhe pesticide të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare, Konventa e Stokholmit për ndotësit organikë të qëndrueshëm dhe Konventa e Minamatës për merkurin.

Këto instrumente ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me mbetjet duhet të merren parasysh kundrejt sfondit të një tërësie të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit. Këto parime janë zhvilluar nëpërmjet instrumenteve të tilla si Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin e Njeriut, e adoptuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin e Njeriut në Stokholm më 16 qershor 1972, dhe Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, e adoptuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin në Rio de Zhaneiro, Brazil, më 13 qershor 1992. Deklarata e Rios, megjithëse nuk është një deklaratë shteruese e parimeve të së drejtës ndërkombëtare të përfshira në Deklaratën e Stokholmit, megjithatë është e një rëndësie të veçantë sipas të drejtës ndërkombëtare të mjedisit si “i vetmi instrument ndërkombëtar i adoptuar me konsensus që bashkon, rreth një shtylle kurrizore të përbashkët, parimet më themelore të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit... duke i vendosur ato në një perspektivë zhvillimore... në tentativë për t'i pajtuar ato me zhvillimin socio-ekonomik”.³³ Në pjesën vijuese të këtij kapitulli, diskutohen disa nga parimet më të rëndësishme që lidhen me trafikimin e mbetjeve.

Parimet relevante të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit

Marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore si Konventa e Bazelit dhe e drejta ndërkombëtare e mjedisit më gjerësisht, në themelet e veta kanë një sërë parimesh të përgjithshme. Këto parime janë gjithashtu relevante për legjislacionin e brendshëm dhe duhet të merren parasysh në mënyrë të rregullt nga ligjvënësit gjatë

²⁹ Po aty, neni 4, para. 2 (d).

³⁰ Po aty, neni 4, para. 2 (e) dhe (g).

³¹ Kjo përfshin mbetjet e konsideruara si të rrezikshme nga Konventa e Bazelit, por nuk mbulon mbetjet që konsiderohen si të rrezikshme vetëm nga legjislacioni i brendshëm i Palës së eksportit, importit ose transitit, jo nga Konventa.

³² Konventa e Bazelit, neni 4A. Shih gjithashtu Sekretariat of the Basel Convention, Countries, Ban Amendment, “Amendment to the Basel Convention on the Control of Transboundary Movements of Hazardous Wastes and their Disposal”, në dispozicion këtu www.basel.int.

³³ Jorge E. Viñuales, “The Rio Declaration on Environment and Development: preliminary study”, në *The Rio Declaration on Environment and Development: A Commentary*, Jorge Viñuales, ed. (Oxford, Oxford University Press, 2015), f. 60.

zhvillimit dhe ndryshimit të legjislacionit për luftimin e trafikimit të mbetjeve. Ky seksion i udhëzuesit legjislativ shqyrton disa nga parimet që janë më të rëndësishme për legjislacionin e trafikimit të mbetjeve. Ato ndahen në parime të përgjithshme dhe parime që kanë të bëjnë veçanërisht me menaxhimin e mbetjeve.

Diskutimi i secilit prej këtyre parimeve nuk është menduar të sugjerojë se secili ka të njëjtin status sipas të drejtës ndërkombëtare. Përkundrazi, këto parime diskutohen krahas njëri-tjetrit pasi secili gëzon mbështetje të gjerë nga Shtetet nëpërmjet mishërimit të tyre në instrumentet përkatëse dhe pasqyrimin të tyre në praktikën shtetërore. Ato përfaqësojnë konsiderata të përgjithshme që Shtetet duhet t'i marrin parasysh, si minimum, kur zhvillojnë dhe ndryshojnë legjislacionin për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve. Kur parimet janë të mishëruara në detyrimet e traktateve ose pasqyrohen në të drejtën zakonore ndërkombëtare, Shtetet duhet t'i marrin parasysh ato.

Parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit

E drejta ndërkombëtare e mjedisit njih një sërë parimesh të përgjithshme. Ato janë të përgjithshme “në kuptimin që ato janë potencialisht të zbatueshme për të gjithë anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare në të gjithë gamën e aktiviteteve që ata kryejnë ose autorizojnë dhe për sa i përket të mbrojtjes së të gjitha aspekteve të mjedisit”.³⁴ Ky seksion diskuton disa parime që janë të një rëndësie të veçantë për zhvillimin dhe ndryshimin e legjislacionit për trafikimin e mbetjeve. Ato janë parimi i mos-dëmtimit, parimi i veprimtimit parandalues, parimi i kujdesit paraprak, parimi i ndotësi paguan, parimi i bashkëpunimit dhe parimet e aksesit në informacion, aksesit në drejtësi dhe pjesëmarrjes së publikut.

Parimi i mos-dëmtimit

Parimi 21 i Deklaratës së Stokholmit dhe parimi 2 i Deklaratës së Rios, të cilat përfaqësojnë një shprehje të parimit të mos-dëmtimit, theksojnë se Shtetet kanë “përgjegjësinë të sigurojnë që aktivitetet brenda juridiksionit ose kontrollit të tyre nuk shkaktojnë dëme në mjedisin e Shteteve të tjera ose të zonave përtej kufijve të juridiksionit kombëtar”. Parimi i mos-dëmtimit është referuar, mishëruar ose pasqyruar në një sërë traktatesh dhe rezolutash në lidhje me mjedisin dhe njihet sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare.³⁵ Në opinionin e saj këshillues mbi ligjshmërinë e kërcënimit ose përdorimit të armëve bërthamore, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë doli me qëndrimin se ekzistenca e detyrimit të përgjithshëm të Shteteve për të siguruar që aktivitetet brenda juridiksionit dhe kontrollit të tyre respektojnë mjedisin e Shteteve të tjera ose të zonave përtej kontrollit kombëtar tani është pjesë e korpusit të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me mjedisin.³⁶

Parimi i mos-dëmtimit qëndron në themelet e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale që rregullojnë menaxhimin e mbetjeve, siç është Konventa e Bazelit. Preambula e Konventës së Bazelit vë në dukje se palët e Konventës, ndër të tjera, ishin “të vetëdijshme për rrezikun e dëmtimit të shëndetit të njeriut dhe mjedisit të shkakuar nga mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera dhe lëvizja ndërkufitare e tyre” dhe “të vendosura për të mbrojtur, me kontroll të rreptë, shëndetin e njeriut dhe mjedisin kundër efekteve të pafavorshme që mund të rezultojnë nga gjenerimi dhe menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera”.

Parimi i parandalimit

Parimi i parandalimit është i lidhur ngushtë me parimin e mos-dëmtimit dhe kërkon që Shtetet të ndërmarin hapat e duhur për të parandaluar dëmin në mjedis dhe përndryshe “të pakësojnë, të kufizojnë ose të kontrollojnë aktivitetet që mund të shkaktojnë ose rrezikojnë shkaktimin e një dëmi të tillë”.³⁷ Në çështjen *Pulp Mills*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi se parimi i parandalimit, si rregull zakonore, e ka origjinën në kujdesin e duhur që i kërkohet një Shteti në territorin e tij.³⁸ Gjykata konstatoi tutje sa vijon:

³⁴ Philippe Sands dhe të tjerë, *Principles of International Environmental Law*, 4th ed. (Cambridge, Cambridge University Press, 2018), f. 198.

³⁵ Po aty, ff. 208–210.

³⁶ *Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons, Advisory Opinion, I.C.J. Reports 1996, f. 226, para. 29.*

³⁷ Sands dhe të tjerë, *Principles of International Environmental Law*, f. 211.

³⁸ *Pulp Mills on the River Uruguay (Argentina v. Uruguay), Judgment, I.C.J. Reports 2010, f. 14, para. 101.*

Është një detyrim që përfshin jo vetëm adoptimin e rregullave dhe masave të përshtatshme, por edhe një nivel të caktuar vigjilence në ekzekutimin e tyre dhe ushtrimin e kontrollit administrativ të zbatueshëm ndaj operatorëve publikë dhe privatë, si monitorimi i aktiviteteve të ndërmarra nga këta operatorë, për të mbrojtur të drejtat e palës tjetër.³⁹

Po kështu, neni 3 i projekt-neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare për parandalimin e dëmtimit ndërkufitar nga aktivitetet e rrezikshme thotë: “Shteti i origjinës merr të gjitha masat e përshtatshme për të parandaluar dëmtimin e ndjeshëm ndërkufitar ose në çdo rast për të minimizuar riskun përkatës.”

Parimi i parandalimit, ashtu si parimi i mos-dëmtimit, qëndron në themelet e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale që rregullojnë menaxhimin e mbetjeve, siç është Konventa e Bazelit. Të vetëdijshëm për riskun e dëmit ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit të shkaktuar nga mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera dhe lëvizja ndërkufitare e tyre,⁴⁰ neni 9, paragrafi 5, i Konventës së Bazelit kërkon që secila palë të krijojë legjisllacionin e brendshëm të përshtatshëm për të parandaluar dhe ndëshkuar trafikun e kundërligjshëm të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera. Parimi i parandalimit është gjithashtu i dukshëm në të gjitha dispozitat e tjera të Konventës së Bazelit, siç është detyrimi për të marrë masat e përshtatshme për të siguruar që gjenerimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera është pakësuar në minimum.⁴¹

Përtej që i kërkon Shteteve të ndërmarrin hapa për të parandaluar dëmtimin mjedisor ndërkufitar, parimi i parandalimit, argumentojnë disa komentues, përfshin gjithashtu një detyrim për Shtetet që të parandalojnë dëmtimin mjedisor brenda juridiksioneve të veta.⁴²

Parimi i kujdesit paraprak

Parimi i kujdesit paraprak synon të sigurojë që mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk përjashton marrjen e veprimeve efektive për të parandaluar dëmtimin mjedisor. Parimi 15 i Deklaratës së Rios, i cili pasqyron thelbin e parimit të kujdesit paraprak,⁴³ thekson sa vijon:

Për të mbrojtur mjedisin, qasja e kujdesit paraprak zbatohet gjerësisht nga Shtetet sipas kapaciteteve të tyre. Kur ka kërcënime për dëme serioze ose të pakthyeshme, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk përdoret si arsye për shtyrjen e masave me kosto efektive për të parandaluar degradimin e mjedisit.

Parimi i kujdesit paraprak “kërkon veprim në një fazë të hershme si reagim ndaj kërcënimeve të dëmtimit mjedisor, përfshirë në situata të pasigurisë shkencore. Zbatimi i parimit do të thotë që i besoni mjedisit”.⁴⁴

Parimi i kujdesit paraprak është mishëruar, qoftë shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, në marrëveshje të shumta ndërkombëtare dhe rajonale mjedisore. Preambula e Konventës së Stokholmit pranon se “kujdesi paraprak qëndron në themelet e shqetësimeve të të gjitha Palëve dhe është mishëruar brenda Konventës”. Neni 1 i Konventës së Stokholmit shpreh objektivin e Konventës në kontekstin e qasjes së kujdesit paraprak dhe i referohet shprehimisht parimit 15 të Deklaratës së Rios. Parimi i kujdesit paraprak përmendet shprehimisht edhe në Konventën e Bamakos. Neni 4, paragrafi 3 (f), i cili gjithashtu mishëron parimin e parandalimit, parashikon sa vijon:

Secila Palë përpiqet të adoptojë dhe të zbatojë qasjen parandaluese dhe të kujdesit paraprak ndaj problemeve të ndotjes, e cila përfshin, ndër të tjera, parandalimin e çlirimit në mjedis të substancave që mund të shkaktojnë dëm për njeriun ose mjedisin pa pritur prova shkencore në lidhje me një dëm të tillë. Palët bashkëpunojnë

³⁹ Po aty, para. 197.

⁴⁰ Konventa e Bazelit, neni. 4, para. 2 (a). Shih gjithashtu Cairo Guidelines and Principles for the Environmentally Sound Management of Hazardous Wastes (UNEP/GC.14/17, annex II, part II, para. 7).

⁴¹ Basel Convention, art. 4, para. 2 (a). See also Cairo Guidelines and Principles for the Environmentally Sound Management of Hazardous Wastes (UNEP/GC.14/17, annex II, part II, para. 7).

⁴² Sands dhe të tjerë, *Principles of International Environmental Law*, f. 212.

⁴³ Po aty, f. 230.

⁴⁴ Arie Trouwborst, “Prevention, precaution, logic and law: the relationship between the precautionary principle and the preventive principle in international law and associated questions”, *Erasmus Law Review*, vol. 2, No. 2 (Nëntor 2009), f. 108.

me njëra-tjetrën në marrjen e masave të përshtatshme për të zbatuar parimin e kujdesit paraprak për parandalimin e ndotjes përmes zbatimit të metodave të prodhimit të pastër [...]

Formulimi i parimit të kujdesit paraprak në Konventën e Bamakos është i rëndësishëm sepse, ndryshe nga parimi 15 i Deklaratës së Rios, ai nuk kërkon që të ketë një kërcënim për dëme “serioze” ose “të pakthyeshme” që parimi të zbatohet dhe kërkon një nivel më të ulët të sigurisë shkencore përpara se të kërkohet veprim.⁴⁵

Ndërsa statusi i parimit është i kontestuar, disa gjykata dhe komentues kanë argumentuar se parimi i kujdesit paraprak mbështetet mjaftueshëm nga praktika shtetërore për të arritur në përfundimin se ai ka status zakonor sipas të drejtës ndërkombëtare. Kështu, Sands dhe Peel shkruajnë sa vijon::

Statusi ligjor i parimit të kujdesit paraprak...vazhdon të evoluojë. Sigurisht që ka prova të mjaftueshme të praktikës shtetërore për të mbështetur përfundimin se parimi, siç është shtjelluar në Parimin 15 të Deklaratës së Rios dhe në konventa të ndryshme ndërkombëtare, tani ka marrë mbështetje mjaftueshëm të gjerë për të lejuar që të ngrihet një argument i fortë se ai pasqyron një parim të së drejtës zakonore, dhe se brenda kontekstit të Bashkimit Evropian ai tani ka arritur statusin zakonor, pa paragjykuar pasojat e përpikta të zbatimit të tij në çdo rast të caktuar. Edhe pse GJND-ja dhe një panel i OBT-së kanë refuzuar të deklarojnë se parimi ka një status të së drejtës ndërkombëtare zakonore, Dhoma për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me shtratin e detit pranë ITLOS, në fakt, ka arritur në atë përfundim.⁴⁶

Parimi ndotësi paguan

Parimi ndotësi paguan i referohet parimit se kostot e ndotjes duhet të barten nga personi fizik ose juridik përgjegjës për shkaktimin e ndotjes. Parimi ndotësi paguan shprehet në parimin 16 të Deklaratës së Rios me formulimin e mëposhtëm:

Autoritetet kombëtare duhet të përpiqen të nxisin përbrendësimin e kostove mjedisore dhe përdorimin e instrumenteve ekonomike, duke marrë parasysh qasjen që ndotësi, në parim, duhet të bartë kostot e ndotjes, duke pasur parasysh interesin publik dhe pa shtrembëruar tregtinë dhe investimet ndërkombëtare.

Parimi ndotësi paguan, ndonëse nuk përmendet shprehimisht në Konventën e Bazelit, është pjesë e sfondit të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit kundrejt të cilit duhet të lexohet Konventa e Bazelit dhe marrëveshjet e tjera relevante. Parimi ndotësi paguan, për më tepër, pasqyrohet në Protokollin për përgjegjësinë dhe kompensimin e dëmeve që rezultojnë nga lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimi i tyre (Protokolli i Bazelit) (ende nuk është në fuqi).

Parimi i bashkëpunimit

Parimi i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve është një tjetër parim themelor i së drejtës ndërkombëtare të mjedisit. Parimi 24 i Deklaratës së Stokholmit thotë sa vijon:

Çështjet ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit duhet të trajtohen në një frymë bashkëpunuese nga të gjitha vendet, të mëdha dhe të vogla, në baza të barabarta. Bashkëpunimi nëpërmjet marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe ose mjeteve të tjera të përshatshme është thelbësor për të kontrolluar, parandaluar, pakësuar dhe eliminuar në mënyrë të efektshme pasojat e pafavorshme mjedisore që rezultojnë nga aktivitetet e kryera në të gjitha sferat, ashtu që të merret parasysh në mënyrë të rregullt sovraniteti dhe interesat e të gjithë Shteteve.

Parimi 27 i Deklaratës së Rios thotë sa vijon:

Shtetet dhe njerëzit do të bashkëpunojnë me mirëbesim dhe në frymën e partneritetit në përbushjen e parimeve të mishëruara në këtë Deklaratë dhe në zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm.

⁴⁵ Sands and others, *Principles of International Environmental Law*, p. 232.

⁴⁶ Ibid., pp. 239–240.

Me rëndësi të veçantë për trajtimin e trafikimit të mbetjeve, parimi 14 i Deklaratës së Rios thekson më tej:

Shtetet duhet të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për të dekurajuar ose parandaluar zhvendosjen dhe transferimin në Shtete të tjera të çdo veprimtarie dhe substance që shkakton degradim të rëndë mjedisor ose që rezultojnë në jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut.

Parimi i bashkëpunimit qëndron në themelet e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me mbetjet, duke përfshirë Konventën e Bazelit. Neni 10 i Konventës së Bazelit parashikon që palët e Konventës bashkëpunojnë me njëra-tjetrën me qëllim që të përmirësojnë dhe arrijnë menaxhim të shëndoshë mjedisor të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dhe përcakton disa detyrime më specifike për këtë qëllim. Më tej, ky nen kërkon që palët të përdorin mjete të përshtatshme për të bashkëpunuar me qëllim që të ndihmojnë vendet në zhvillim në përmbushjen e detyrimeve të tyre të përgjithshme sipas Konventës.⁴⁷ Neni 9 përmban një detyrim specifik për palët që të bashkëpunojnë me qëllim parandalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të mbetjeve.⁴⁸ Parimi i bashkëpunimit është i lidhur ngushtë me procedurën e pëlqimit të informuar paraprak sipas Konventës dhe pasqyrohet në disa dispozita të tjera të Konventës,⁴⁹ duke përfshirë ato për ndarjen e informacionit.⁵⁰

Aksesi në informacion, pjesëmarrja e publikut dhe aksesit në drejtësi

Të paktën që nga vitet 1990, rëndësia e aksesit në informacion, pjesëmarrja e publikut dhe aksesit në drejtësi si parime të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit ka vazhduar të rritet. Këto tre parime të lidhura njihen në parimin 10 të Deklaratës së Rios, i cili thekson sa vijon:

Çështjet mjedisore trajtohen më së miri me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të interesuar, në nivelin përkatës. Në nivelin kombëtar, çdo individ ka akses në informacion lidhur me mjedisin në mënyrën e përshtatshme, që mbahet nga autoritetet publike, duke përfshirë informacionin mbi materialet dhe aktivitetet e rrezikshme në komunitetet e tyre, dhe mundësinë për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Shtetet lehtësojnë dhe inkurajojnë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut duke e bërë informacionin të disponueshëm në shkallë të gjerë. Ofrohet aksesit në procedurat gjyqësore dhe administrative në mënyrë efektive, duke përfshirë zhdëmtimin dhe mjetet juridike.⁵¹

Që nga adoptimi i Deklaratës së Rios, dispozitat për pjesëmarrjen e publikut janë përfshirë pothuajse në të gjitha traktatet ndërkombëtare mjedisore.⁵²

Parimet e aksesit në informacion, pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit në drejtësi (të drejtat e aksesit) janë zhvilluar më tej në instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale si Konventa “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin” (Konventa e Aarhusit), e adoptuar nën patronazhin e Komisionit Ekonomik për Evropën, dhe Marrëveshja Rajonale për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut dhe drejtësinë në çështjet mjedisore në Amerikën Latine dhe Karaibe (Marrëveshja e Eskazu), e adoptuar nën patronazhin e Komisionit Ekonomik për Amerikën Latine dhe Karaibet. Formulimi në Marrëveshjen e Eskazu, duke njohur aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi si të drejta të njeriut, nxjerr në pah lidhjen e ngushtë midis këtyre parimeve dhe të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

VLERËSIMET E NDIKIMIT NË MJEDIS DHE VLERËSIMET STRATEGJIKE MJEDISORE SI MJETE PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE TË AKSESIT

Parimet e aksesit në informacion, pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit në drejtësi janë gjithashtu të qenësishme në

⁴⁷ Konventa e Bazelit, neni 10, para. 3.

⁴⁸ Po aty, neni 9, para. 5.

⁴⁹ Shih, për shembull, Konventa e Bazelit, nenet 4, para. 2 (h), 5–6 dhe 11.

⁵⁰ Konventa e Bazelit, neni 13.

⁵¹ Theksi është shtuar.

⁵² Jonas Ebbesson, “Public participation”, në *The Oxford Handbook of International Environmental Law*, f. 354.

proceset e vlerësimit të ndikimit, të cilat janë mjete që lejojnë një vendimmarrje mjedisore të informuar dhe me pjesëmarrje. Parimi 17 i Deklaratës së Rios thotë: “Vlerësimi i ndikimit në mjedis, si instrument kombëtar, ndërmerret për aktivitetet e propozuara që ka gjasë të kenë një ndikim ndjeshëm të pafavorshëm në mjedis dhe janë subjekt vendimi

nga një autoritet kombëtar kompetent.”^a Në çështjen *Impiantet e pulpës në lumin Uruguay*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi se “tani mund të konsiderohet si një kërkesë sipas të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare ndërmarrja e një vlerësimi të ndikimit në mjedis kur ekziston risku që aktiviteti industrial i propozuar mund të ketë një ndikim ndjeshëm të pafavorshëm në një kontekstin ndërkufitar, në veçanti, në një burim të përbashkët”.^b Megjithëse Gjykata sugjeroi se kryerja e një vlerësimi të ndikimit në mjedis mund të përbëjë një kërkesë sipas të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, që duhet të përmbushet përpara se të kryhet aktiviteti, ajo konsideroi se fushëveprimi dhe përmbajtja e vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të përcaktohen nga ligjvënësi kombëtar.^c

Gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, proceset e vlerësimit të ndikimit në mjedis janë bërë gjithnjë e më të pranuar dhe më të përdorura si pjesë integrale e vendimmarrjes për aktivitete që mund të kenë pasoja në mjedis. Vlerësimet strategjike mjedisore janë një mjet më i ri që nxit një qasje të informuar dhe me pjesëmarrje për zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve, si dhe legjislacionit. Në shumë juridiksione,^d kryerja e tyre shihet si një hap i rëndësishëm për plotësimin e planeve, programeve dhe politikave, si dhe një hap që krijon bazën për aktivitetet e ardhshme që do t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit në mjedis. Protokollin për vlerësimin strategjik mjedisor i Konventës për vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkufitar, i adoptuar në Kiev më 21 maj 2003,^e është i vetmi instrument ndërkombëtar, ligjërish i detyrueshëm që ofron udhëzime specifike për palët se si të projektojnë procedurat strategjike të vlerësimit mjedisor.

^a Shih gjithashtu Konventën për diversitetin biologjik, neni 14.

^b *Pulp Mills on the River Uruguay (Argentina v. Uruguay)*, Judgment, I.C.J. Reports 2010, f. 14, para. 204.

^c Kështu ndodh edhe me Konventën për vlerësimin e ndikimit në mjedis në një kontekst ndërkufitar (Konventa e Espoo), e cila përcakton hapat proceduralë për konsultimet ndërkufitare mbi vlerësimet e ndikimit në mjedis, por specifikat i lë të vendosen sipas diskrecionit të legjislacionit të brendshëm.

^d Veçanërisht, në kontekstin e Bashkimit Evropian, shih Direktivën 2001/42/KE për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis (Fletorja Zyrtare e Komuniteteve Evropiane, L 197, 21 korrik 2001).

^e Megjithëse i negociuar në një kontekst rajonal nën Komisionin Ekonomik për Evropën, Protokollin është një instrument global.

Parimet e menaxhimit të mbetjeve sipas të drejtës ndërkombëtare të mjedisit

Në seksionin e mëparshëm, u diskutuan parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit të zbatueshme në një sërë aktivitetsesh, duke përfshirë por duke u shtrirë përtej menaxhimit të mbetjeve. Përveç këtyre parimeve të përgjithshme, parime të tjera në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në mënyrë specifike mund të shquhen përmes një ekzaminimi të instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë të së drejtës së mjedisit. Dy nga këto parime janë shqyrtuar në këtë seksion: koncepti i hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve dhe parimi i afërsisë.

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve

Konventa e Bazelit bazohet në parimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve.⁵³ Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve (nganjëherë e njohur si hierarkia e mbetjeve) përshkruan rendin e preferuar të praktikave për

⁵³ Tatiana Terekhova, “The Basel Convention: a tool for combating environmental crime and enhancing the management of hazardous and other wastes”, në *Handbook of Transnational Environmental Crime*, Lorraine Elliott and William H Schaedla, eds. (Cheltenham, United Kingdom, Edward Elgar Publishing, 2016), f. 424.

parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve për qëllimin e minimizimit të mbetjeve dhe, në fund të fundit, për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Hierarkia e mbetjeve ka prioritet parandalimin e mbetjeve. Nëse mbetjet nuk mund të parandalohen, ato duhet të minimizohen. Nëse nuk mund të minimizohen, ato duhet të ripërdoren. Nëse nuk mund të ripërdoren, ato duhet të riciklohen. Nëse nuk mund të riciklohen, ato duhet të rikuperohen (për shembull, përmes rikuperimit të energjisë). Në fund, nëse mbetjet nuk mund të rikuperohen, ato duhet të asgjësohen.

Konventa e Bazelit nuk i referohet shprehimisht hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, por parimi është mishëruar në dispozitat e saj, dhe preambula e Konventës vë në dukje se palët janë të vetëdijshme se mënyra më efektive për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga rreziqet që paraqesin këto mbetje janë pakësimi i gjenerimit të tyre në minimum për sa i përket sasisë dhe/ose potencialit të rrezikut. Kuadri strategjik për zbatimin e Konventës së Bazelit për 2012-2021, i adoptuar nga Konferenca e Palëve të Konventës së Bazelit në takimin e saj të dhjetë, njeh hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve si një parim udhëzues për zbatimin e Konventës dhe inkurajon opsionet e trajtimit që japin rezultatin më të mirë të përgjithshëm mjedisor, duke marrë parasysh aspektet e ciklit të jetës.⁵⁴ Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është mishëruar gjithashtu në Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008, për mbetjet dhe që shfuqizon disa direktiva të caktuara (Tekst me rëndësi për EEA), një ekstrakt i së cilës është dhënë më poshtë.

SHEMBULL: BASHKIMI EVROPIAN

Direktivë 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 19 nëntor 2008, për mbetjet dhe që shfuqizon disa direktiva të caktuara

Neni 4 – Hierarkia e mbetjeve

1. Hierarkia e mëposhtme e mbetjeve zbatohet si renditje sipas prioritetit në legjislacionin dhe politikën e parandalimit dhe menaxhimit të mbetjeve:

- (a) parandalimi;
- (b) përgatitja për ripërdorim;
- (c) riciklimi;
- (d) rikuperimi tjetër, p.sh. rikuperimi i energjisë; dhe
- (e) asgjësimi.

2. Kur zbatohet hierarkia e mbetjeve e referuar në paragrafin 1, Shtetet Anëtare marrin masa për të inkurajuar opsionet që japin rezultatin më të mirë të përgjithshëm mjedisor. Kjo mund të kërkojë që rryma specifike të mbetjeve të largohen nga hierarkia, kur kjo justifikohet nga aspektet e ciklit të jetës në raport me ndikimet e përgjithshme të gjenerimit dhe menaxhimit të këtyre mbetjeve.

[...]

⁵⁴ Decision BC-10/2, annex, para. 3 (a).

SHEMBULL: VENDET E ULËTA:**Akti për Mbrojtjen e Mjedisit, 1979****Neni 10.4**

1. Me rastin e adoptimit të planit të menaxhimit të mbetjeve dhe me rastin e marrjes së masave të tjera për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve, Ministri ynë zbaton sipas radhës prioritare hierarkinë e mëposhtme të mbetjeve:

- (a) parandalimi;
- (b) përgatitja për ripërdorim;
- (c) riciklimi;
- (d) përdorime të tjera të zbatueshme, duke përfshirë rikuperimin e energjisë;
- (e) largimi i sigurt.

2. Paragrafi 1 zbatohet përkatësisht në lidhje me marrjen e masave të referuara në atë paragraf nga ekzekutivi krahinor, kryetari i bashkisë dhe këshilltarët komunalë.

Parimi i afërsisë

Parimi i afërsisë i referohet idesë që, sa më shumë që të jetë e mundur, mbetjet duhet të menaxhohen dhe/ose të asgjësohen sa më afër që të jetë e mundur me vendndodhjen ku ato krijohen. Parimi i afërsisë pasqyrohet në preambulën e Konventës së Bazelit, e cila thotë se palët e Konventës janë të bindura se mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera duhet, për aq sa është në përputhje me menaxhimin e shëndoshë mjedisor dhe eficient, të asgjësohen në Shtetin ku ato u krijuan. Parimi i afërsisë synon të pakësojë ndikimin në mjedis që lind nga menaxhimi dhe asgjësimi i mbetjeve duke kufizuar transportin e tyre sa më shumë që të jetë e mundur. Kuadri strategjik për zbatimin e Konventës së Bazelit për 2012–2021 njeh parimin e afërsisë si një parim udhëzues për zbatimin e Konventës.⁵⁵

Kuadri ligjor ndërkombëtar për luftimin e krimit të rëndë

Shtetet që zhvillojnë ose ndryshojnë legjislacionin për të luftuar trafikimin e mbetjeve duhet të marrin parasysh gjithashtu kuadrin ligjor ndërkombëtar për shtypjen e krimeve të rënda. Dy instrumente janë me rëndësi të veçantë: Konventa kundër Krimit të Organizuar dhe Konventa kundër Korrupsionit.

Konventa kundër Krimit të Organizuar është i vetmi instrument ndërkombëtar ligjorisht detyrues kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Ajo u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme më 15 nëntor 2000 dhe që atëherë është bërë një nga traktatet më të ratifikuara në botë.⁵⁶ Neni 1 i Konventës thotë: “Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar në mënyrë më efektive”. Nenet e Konventës kërkojnë dhe inkurajojnë Shtetet palë që të vendosin një sërë masash për këtë qëllim. Këto përfshijnë masat që kërkojnë përcaktimin e veprimeve të caktuara si vepra penale, masat në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimit, masat për bashkëpunimin dhe ndihmën ndërkombëtare, masat për mbrojtjen dhe ndihmën dhënë dëshmitarëve dhe viktimave, si dhe masat parandaluese.

Fusha e zbatimit të Konventës përkufizohet në nenin 3 të saj. Sipas këtij neni, përveç rasteve kur Konventa parashikon ndryshe, masat e përfshira në Konventë zbatohen për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale

⁵⁵Po aty, annex, para. 3 (b) (viii).

⁵⁶Për thjeshtësi, termi “ratifikuar” përfshin aderimin, pranimin dhe miratimin në këtë kontekst. Për një listë të azhurnuar të palëve të Konventës kundër Krimit të Organizuar, shih United Nations Treaty Collection, Depository, Status of treaties, Multilateral treaties deposited with the Secretary-General, Chapter XVIII on penal matters, item No. 12, “United Nations Convention against Transnational Organized Crime”. Në dispozicion këtu <https://treaties.un.org>.

të shkeljeve të përcaktuara në përputhje me dispozitat e saj të sanksionimit penal dhe për “krimet e rënda”, kur shkeljet e tilla janë të natyrës ndërkombëtare dhe përfshijnë një grup kriminal të organizuar.⁵⁷ Konventa jep detaje të mëtejshme në lidhje me kuptimin e “grupit kriminal të organizuar” dhe “krimit të rëndë”, dhe lidhur me atë se kur një shkelje do të konsiderohet të jetë e natyrës ndërkombëtare. Një “grup kriminal i organizuar” përkufizohet si

një grup i strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose shkelje të rënda, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitim financiar ose përfitim tjetër material.⁵⁸

Konventa jep gjithashtu sqarime të mëtejshme për sa i përket kuptimit të një “grupi të strukturuar”⁵⁹ “Krimi i rëndë” është përkufizuar si “akt që përbën një shkelje të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.”⁶⁰ Neni 3, paragrafi 2, i Konventës parashikon kriteret për përcaktimin se kur një shkelje do të konsiderohet e natyrës ndërkombëtare, për qëllimet e zbatimit.⁶¹

Përdorimi i nocionit “krim i rëndë” për të përkufizuar fushëveprimin e Konventës duke iu referuar legjislacionit të brendshëm të Shteteve palë ofron fleksibilitet të mjaftueshëm që Konventa të zbatohet në një gamë të gjerë të manifestimeve të krimit të organizuar ndërkombëtar⁶² dhe mundëson që Konventa të zbatohet për trafikimin e mbetjeve kur ajo përfshin shkelje të dënueshme me një dënim maksimal prej katër ose më shumë vjet heqje lirie sipas ligjit të një Shteti palë që ka juridiksionin mbi shkeljen, dhe kur përmbushen dy kërkesat e tjera të natyrës ndërkombëtare dhe përfshirjes së një grupi kriminal të organizuar. Kur ky është rasti, një Shtet i caktuar palë mund të jetë subjekt i një sërë detyrimesh sipas Konventës, duke përfshirë detyrën për të siguruar që një veprim i veçantë në lidhje me trafikimin e mbetjeve të përcaktohet si vepër penale,⁶³ detyrimin për të mundësuar konfiskimin e produkteve të krimit dhe pasurisë tjetër që lidhet me shkeljen,⁶⁴ detyrimin për të bashkëpunuar me Shtetet e tjera palë në lidhje me shkeljet⁶⁵ dhe detyrën për të mbrojtur dëshmitarët dhe viktimat.⁶⁶

Duke qenë se trafikimi i mbetjeve shpesh lehtësohet nga korrupsioni, Konventa kundër Korrupsionit është gjithashtu relevante për zhvillimin dhe ndryshimin e legjislacionit për trafikimin e mbetjeve. Konventa kundër Korrupsionit, e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme më 31 tetor 2003, është instrumenti kryesor ndërkombëtar kundër korrupsionit.⁶⁷ Konventa mbulon shumë forma të ndryshme të korrupsionit, si rryshfeti, trafiku i influencës, abuzimi me funksionet dhe aktet e ndryshme të korrupsionit në sektorin privat dhe mbulon pesë fusha kryesore: masat parandaluese, penalizimi dhe zbatimi i ligjit, bashkëpunimi ndërkombëtar, rikuperimi i aseteve, dhe asistenca teknike dhe këmbimi i informacionit. Masat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit janë shqyrtuar më tej në kapitullin 3 të këtij udhëzuesi.

⁵⁷ Konventa kundër Krimit të organizuar, neni 3, para. 1.

⁵⁸ Po aty, neni 2 (a).

⁵⁹ Po aty, neni 2 (c).

⁶⁰ Po aty, neni 2 (b).

⁶¹ Po aty, neni 3, para. 2.

⁶² Shih Dimitri Vlassis, “Drafting the United Nations Convention against Transnational Organized Crime”, në *Combating Transnational Crime: Concepts, Activities and Responses*, Phil Williams and Dimitri Vlassis, eds. (London, Frank Cass, 2001), f. 373.

⁶³ Organized Crime Convention, art. 5 (Criminalization of participation in an organized criminal group); art. 6 (Criminalization of the laundering of proceeds of crime); and art. 23 (Criminalization of obstruction of justice). Art. 8 (Criminalization of corruption) requires that States parties criminalize acts of corruption independent of their connection to a serious crime.

⁶⁴ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 12 (Konfiskimi dhe sekuestrimi).

⁶⁵ Shih Konventën kundër Krimit të Organizuar, neni 13 (Bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit); neni 16 (Ekstradimi); neni 18 (Ndihma e ndërsjellë juridike); dhe neni 27 (Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit). Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar të trajtuara nga Konventa nuk përfshijnë detyra të detyrueshme, shih nenin 17 (Transferimi i personave të dënuar); neni 19 (Hetimet e përbashkëta); neni 20 (Teknikat e posaçme hetimore); dhe neni 21 (Transferimi i procedimeve penale).

⁶⁶ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 24 (Mbrojtja e dëshmitarëve) dhe neni 25 (Ndihma dhe mbrojtja e viktimave). Shih gjithashtu nenin 26 (Masa për rritjen e bashkëpunimit me autoritetet ligji-zbatuese).

⁶⁷ Një listë e azhurnuar e palëve të Konventës kundër Krimit të Organizuar është në dispozicion këtu <https://treaties.un.org/>.

E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut

E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut përbën një fushë të mëtejshme të kuadrit ligjor ndërkombëtar që Shtetet duhet të marrin parasysh dhe të respektojnë në zhvillimin dhe ndryshimin e legjislacionit për luftimin e trafikimit të mbetjeve. Ky seksion ofron një pasqyrë të shkurtër të aspekteve relevante të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në këtë kontekst. Ai fillon me një hyrje në burimet e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe komponentët e detyrimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Më pas, ai shqyrton se si trafikimi i mbetjeve ndikon si në ushtrimin e të drejtave të njeriut ashtu edhe në të drejtat që mund të implikohen nga reagimet e drejtësisë penale për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve. Në fund, ai ofron një pasqyrë të kuadrit të parashikuar nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut për trajtimin e çështjeve kur duhet të balancohen të drejtat konkurruese të njeriut.

Burimet e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Burimi i detyrimeve ndërkombëtare të Shteteve për të drejtat e njeriut mund të gjendet si brenda ashtu edhe jashtë traktateve të shumta ndërkombëtare dhe rajonale. Asambleja e Përgjithshme ka adoptuar një sërë traktatesh⁶⁸ dhe instrumente të tjera përkatëse, mes tyre nëntë instrumentet “kryesore” ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,⁶⁹ gjegjësisht, sipas radhës së adoptimit të tyre, këto si më poshtë:

- Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor;
- Pakti Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore
- Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese
- Konventa për të drejtat e fëmijës
- Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre
- Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë

Organizatrat rajonale shërbejnë gjithashtu si forume për adoptimin e instrumenteve detyruese dhe jodejtyruese të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ndër traktatet e rëndësishme rajonale të të drejtave të njeriut janë Karta Afrikane për të drejtat e njeriut dhe të popujve, Konventa Amerikane për të drejtat e njeriut dhe Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Detyrimet për të drejtat e njeriut mund të rrjedhin gjithashtu nga burime të së drejtës ndërkombëtare të ndryshme nga traktatet, siç është e drejta ndërkombëtare zakonore të të drejtave të njeriut. Për shembull, ndërsa Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut nuk është formalisht detyruese, sot ka një konsensus të gjerë që shumë nga dispozitat e saj pasqyrojnë të drejtën ndërkombëtare zakonore.⁷⁰

⁶⁸ Shih United Nations Treaty Collection, Depositary, Titles of Treaties, Multilateral Treaties Deposited with the Secretary-General, “Chapter IV: Human Rights”. Në dispozicion këtu <https://treaties.un.org>, duke renditur 16 traktate dhe protokollet plotësuese në këtë fushë. Kapitujt e tjerë të databazës përfshijnë gjithashtu traktate që mbrojnë të drejtat e njeriut të grupeve të cënueshme specifike (p.sh. Chapter V: Refugees and Stateless Persons, apo Chapter VII: Traffic in Persons).

⁶⁹ Shih gjithashtu Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, “The core international human rights instruments and their monitoring bodies”. Në dispozicion këtu www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/coreinstruments.aspx.

⁷⁰ Hurst Hannum, “The status of the Universal Declaration of Human Rights in national and international law”, *Georgia Journal of International and Comparative Law*, vol. 25, No. 1 (1996), f. 340.

Komponentët e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përfshijnë detyrime për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut.⁷¹ Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut në përgjithësi kuptohet si një detyrim negativ: një detyrim për të mos dëmtuar apo ndërhyrë në të drejtat e njeriut të të tjerëve. Detyrimi për të mbrojtur të drejtat e njeriut kërkon që Shtetet të mbrojnë individët dhe grupet kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut nga persona dhe subjekte private. Shtetet duhet të krijojnë dhe të mbajnë kuadrin legjislativ dhe kuadrin administrativ që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe ofrojnë mbrojtjen e përshtatshme për individët.⁷² Për më tepër, Shtetet duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të mbrojtur individët nga shkeljet, për të hetuar shkeljet, për të ndjekur penalisht dhe për të kërkuar llogaridhënie nga personat përgjegjës, për të eliminuar mosndëshkimin dhe zhdëmtimin duke u ofruar viktimave reparacion.⁷³ Komponenti i tretë i normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, detyrimi për përmbushjen e të drejtave të njeriut, kërkon që Shtetet të adoptojnë miratojnë masat e përshtatshme legislative, administrative, buxhetore, gjyqësore, nxitëse dhe të tjera në drejtim të realizimit të plotë të të drejtave të njeriut.⁷⁴ Detyrimet për përmbushjen e të drejtave të njeriut janë detyrime të realizimit progresiv – që do të thotë se gëzimi i plotë i së drejtës në përgjithësi nuk do të jetë i mundur menjëherë dhe mund të arrihet vetëm në mënyrë progresive, me kalimin e një periudhe kohore.⁷⁵

Detyrimet për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut duhet të merren parasysh në mënyrë të rregullt kur trajtohet trafikimi i mbetjeve, duke përfshirë zhvillimin dhe ndryshimin e legjislacionit përkatës. Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje të shkurtër të disa prej të drejtave të njeriut që preken nga trafikimi i mbetjeve dhe që implikohen në reagimet e drejtësisë penale, dhe përvijojnë kuadrin e parashikuar nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut për balancimin e këtyre të drejtave, aty ku është e nevojshme.

Të drejtat që preken nga trafikimi i mbetjeve

Trafikimi i mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera dëmtton mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Së këndejmi, ai përbën një kërcënim për ushtrimin e një sërë të drejtash të njeriut. Puna e Raportuesit të Posaçëm mbi implikimet për të drejtat e njeriut që ka menaxhimi i shëndoshë mjedisor dhe asgjësimi i substancave dhe mbetjeve të rrezikshme ka treguar se si aktivitete të tilla si trafikimi i mbetjeve kërcënojnë ushtrimin e të drejtës për jetë, të drejtës për shëndet, të drejtën për integritet fizik dhe mendor, të drejtës për ushqim të mjaftueshëm, të drejtës për ujë, të drejtës për kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune dhe të drejtës për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.⁷⁶ Ekspozimi ndaj mbetjeve të rrezikshme mund të përbëjë gjithashtu trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtëruës. Gratë, fëmijët, popujt indigjenë, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët, të varfrit, migrantët dhe pakicat janë veçanërisht të

⁷¹ UNODC, *The United Nations Convention against Transnational Organized Crime and International Human Rights Law* (publikim i radhës).

⁷² Shih, në përgjithësi, International Covenant on Civil and Political Rights, art. 2, para. 2; African Charter on Human and Peoples' Rights, art. 1; American Convention on Human Rights, art. 1, para. 2; dhe Inter-American Court of Human Rights, *Velásquez-Rodríguez v. Honduras (Merits)*, Series C No. 4, Judgment of 29 July 1988, paras. 166–167, 175.

⁷³ *Velásquez-Rodríguez v. Honduras*, paras. 166–167, 174; Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, General Comment No. 31 (2004) on the nature of the general legal obligation imposed on States parties to the Covenant, para. 8; European Court of Human Rights, *Ergi v. Turkey*, Application Nos 66/1997/850/1057, Judgment, 28 July 1998, para. 82; dhe African Court on Human and Peoples' Rights, *Norbert Zongo and Others v. Burkina Faso (Merits)*, Application No. 13/2011, Judgment of 28 March 2014, paras. 150–156. Shih gjithashtu rezolutën 65/228 të Asamblesë së Përgjithshme me titull "Strengthening crime prevention and criminal justice responses to violence against women", f. 2.

⁷⁴ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, General Comment No. 14 (2000) on the right to the highest attainable standard of health, para. 33; OHCHR, Principles and Guidelines for a Human Rights Approach to Poverty Reduction Strategies, para. 48.

⁷⁵ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, General Comment No. 3 (1990) on the nature of States parties' obligations (art. 2, para. 1, of the Covenant).

⁷⁶ Shih, për shembull, E/CN.4/2004/46, A/HRC/7/21, A/HRC/21/48, A/HRC/33/41, A/HRC/36/41, A/HRC/42/41, A/74/480 dhe A/75/290. E drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm është njohur si e drejtë e njeriut nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në rezolutën 48/13, të adoptuar më 8 tetor 2021. Për një shqyrtim të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe rolin e prokurorëve, shih Raoul Wallenberg Institute of Human Rights and Humanitarian Law, "The right to a healthy environment in Southeast Asia: National Prosecutors and Prosecuting Authorities", Discussion Brief Series, No. 6 (Tetor 2021).

prekur.⁷⁷ Ndikimi i pafavorshëm joproporcional i krimit të mbetjeve në përgjithësi mbi këto grupe ngre çështje të mosdiskriminimit në mbrojtjen e të drejtave sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.⁷⁸

Siç u përmend në seksionin e mëparshëm, Shtetet jo vetëm që duhet të respektojnë vetë të drejtat e njeriut, por gjithashtu duhet të mbrojnë individët dhe grupet nga shkeljet e këtyre të drejtave nga persona dhe subjekte private. Kjo përfshin një detyrim për të mbrojtur individët dhe grupet nga shkeljet e shkaktuara nga trafikimi i mbetjeve dhe aktivitetet e lidhura me to.⁷⁹ Shtetet kanë për detyrë të parandalojnë ekspozimin ndaj mbetjeve të rrezikshme, detyrë që rrjedh nga të drejtat e shumta të njeriut që kërcënohen nga ekspozimi i tillë.⁸⁰ Kjo përfshin një detyrë për të krijuar dhe mbajtur kuadër legjislativ dhe kuadër administrativ të përshtatshëm për të parandaluar dhe luftuar krimin e mbetjeve, duke përfshirë trafikimin e mbetjeve, dhe për të marrë hapa të arsyeshëm për parandalimin e shkeljeve, mbrojtjen e individëve, hetimin e shkeljeve, ndjekjen penale dhe llogaridhënien e personave përgjegjës, eliminimin e mosndëshkimit, garantimin e aksesit të viktimave në drejtësi dhe zhdëmtimin duke u ofruar viktimave reparacion. Dispozitat legjislative dhe masat, institucionet, proceset dhe praktikat përkatëse të parashikuara nga ky udhëzues mund të shihen, në këtë kontekst, si kontribuues në përmbushjen e detyrave të Shteteve për të mbrojtur individët dhe grupet nga shkeljet e të drejtave.

Të drejtat që implikohen në reagimet e drejtësisë penale ndaj trafikimit të mbetjeve

Seksioni i mëparshëm tregoi se si e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kërkon që Shtetet të marrin masat e përshtatshme për të trajtuar krimin e mbetjeve, duke përfshirë trafikimin e mbetjeve. Megjithatë, të drejtat e njeriut të atyre që preken ose janë të cenueshëm nga krimi i mbetjeve nuk janë të vetmet të drejta të njeriut që Shtetet duhet të marrin në konsideratë gjatë zhvillimit dhe ndryshimit të legjislacionit për të luftuar trafikimin e mbetjeve. Shtetet gjithashtu duhet të respektojnë, të mbrojnë dhe të përmbushin të drejtat e grupeve të tjera të njerëzve, duke përfshirë personat e dyshuar, të akuzuar ose të dënuar për trafikim të mbetjeve; personat e tjerë që mund të preken nga masat e adoptuara për shtypjen e trafikimit të mbetjeve; dhe dëshmitarët dhe personat që bashkëpunojnë me autoritetet.⁸¹ Masat e parashikuara nga ky udhëzues – penalizimi, hetimi (përfshirë përdorimin e teknikave të posaçme hetimore), bashkëpunimi ndërkombëtar, ndjekja penale, gjykimi, ndalimi, burgimi dhe dënimi, si dhe mbrojtja dhe ndihma dhënë dëshmitarëve dhe viktimave – secila ka kapacitetin për të prekur të drejtat e njeriut të këtyre grupeve. Të drejtat përfshijnë, ndër të tjera, parimin e ligjshmërisë, prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u mbrojtur nga privimi arbitrar i lirisë, të drejtën për një gjykim të drejtë, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për ndihmë juridike, ndalimin e torturës dhe trajtimit a dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, të drejtën për jetë private, të drejtën për shëndet, të drejtën e pronës, lirinë nga diskriminimi, të drejtën për një mjet juridik dhe të drejtën për të vërtetën. Shtetet duhet t'u kushtojnë vëmendjen e duhur këtyre të drejtave dhe të respektojnë të gjitha detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut sipas të drejtës ndërkombëtare kur zhvillojnë dhe ndryshojnë legjislacionin për të luftuar trafikimin e mbetjeve. Dokumenti tematik i UNODC-së me titull *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut* u ofron ndihmë Shteteve për identifikimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre në këtë drejtim.

Ndërsa secila nga të drejtat e sipërpërmendura, në zhvillimin e legjislacionit për trafikimin e mbetjeve dhe në ndryshimin e legjislacionit ekzistues, kërkon shqyrtim të plotë, kjo shkon përtej aspekteve që merren në konsideratë në këtë udhëzues. Në udhëzues do të përmendet shkurtimisht parimi i ligjshmërisë, pasi ai është pjesë përbërëse e procesit të hartimit dhe ndryshimit të legjislacionit penal. Parimi i ligjshmërisë, nullum crimen, nulla poena sine lege (“as krim, as dënim pa ligj”) ose askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim që nuk është paraparë në ligj si vepër penale,⁸² kërkon, ndër të tjera, që ligjet të cilat përcaktojnë vepra penale dhe dënime penale të jenë të qarta dhe të aksesueshme në mënyrë që pasojat e veprimeve

⁷⁷ Shih A/HRC/36/41, para. 24–44; A/75/290, para. 20–48; A/HRC.25/53, para. 69–78; A/HRC/33/41; dhe A/HRC/42/41.

⁷⁸ A/HRC/36/41, para. 15–16.

⁷⁹ Shih gjithashtu A/HRC/36/41, para. 4.

⁸⁰ A/74/480, paras. 6–7.

⁸¹ A/HRC/42/41, para. 21; UNODC, *The United Nations Convention against Transnational Organized Crime and International Human Rights Law* (publikim i radhës).

⁸² Kenneth S. Gallant, *The Principle of Legality in International and Comparative Criminal Law*, Cambridge Studies in International and Comparative Law Series, No. 65 (New York, Cambridge University Press, 2009) f. 12.

ose mosveprimeve të një individi të mund të parashikohen paraprakisht nga individi.⁸³ Prandaj, qartësia në hartim është e rëndësishme jo vetëm nga këndvështrimi i zhvillimit të legjislacionit efektiv, por edhe nga këndvështrimi i respektimit të të drejtave të njeriut. Gjatë hartimit ose ndryshimit të legjislacionit që lufton trafikimin e mbetjeve, Shtetet duhet të bëjnë kujdes të shmangin kërkesat ligjore të paqarta, jo të përpikta, të dykuptimta, të paqëndrueshme ose kontradiktore.

Kuadri për balancimin e të drejtave të njeriut

Seksionet e mëparshme vunë në dukje shumëllojshmërinë e grupeve që mund të preken nga trafikimi i mbetjeve dhe reagimet e drejtësisë penale ndaj këtyre veprimeve dhe shumëllojshmërinë e të drejtave të njeriut të zbatueshme për ato grupe të cilat mund të preken. Është detyrë e ligjvënësve të sigurojnë që legjislacioni për luftimin e trafikimit të mbetjeve respekton, mbron dhe përmbush të drejtat e të gjitha grupeve. Kur këto të drejta konkurrojnë me njëra-tjetrën, ligjvënësit (si dhe gjykatat, agjencitë ligj-zbatuese dhe organet e tjera shtetërore) duhet të arrijnë një ekuilibër të përshtatshëm. E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut ofron kuadrin që Shtetet duhet të zbatojnë për të arritur këtë ekuilibër.

Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut mund të shprehin garancitë e të drejtave të njeriut qoftë në mënyrë absolute ose në mënyrë të kualifikuar. Të drejtat absolute, të tilla si ndalimi i torturës dhe trajtimit a dënimit çnjerëzor ose poshtërues, nuk mund të kufizohen kurrë. Të drejtat e tjera mund të kufizohen nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Ndërsa gjuha që përdoret për të cilësuar të drejtat e njeriut mund të jetë e ndryshme ndërmjet dhe brenda instrumenteve, në përgjithësi, kufizimet e të drejtave të njeriut mund të bëhen kur ato përcaktohen me ligj të qartë dhe të aksesueshëm (parimi i ligjshmërisë),⁸⁴ i shërbejnë një qëllimi legjitim dhe janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimit legjitim dhe në proporcion me qëllimin legjitim.⁸⁵ Një qëllim legjitim mund të përfshijë respektimin ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve ose të interesave të caktuara publike, si rendi publik, shëndeti publik, siguria publike dhe siguria kombëtare.⁸⁶ Mbrojtja e shëndetit publik dhe mbrojtja e të drejtave të atyre që preken ose janë të cenusur ndaj viktimizimit nga trafikimi i mbetjeve mund të justifikojnë vendosjen e masave të drejtësisë penale për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve, me kusht që masat përcaktohen me ligj të qartë dhe të aksesueshëm dhe janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të tyre legjitim dhe proporcionale me qëllimin e tyre legjitim.

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE

Një konsideratë kyç për zhvillimin e legjislacionit për të luftuar trafikimin e mbetjeve në çdo vend duhet të jetë marrëdhënia midis këtij legjislacioni dhe legjislacionit që rregullon menaxhimin e mbetjeve në përgjithësi, duke përfshirë gjenerimin, mbledhjen/grumbullimin, ruajtjen/magazinimin, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin e tyre. Kjo është e nevojshme jo vetëm për të siguruar që të dy fushat e legjislacionit janë të harmonizuara, plotësuese dhe jo të paqëndrueshme apo kontradiktore, por edhe sepse dispozitat e trafikimit të mbetjeve shpesh mbështeten në dispozitat e menaxhimit të mbetjeve për të përcaktuar se çfarë veprimi përbën krim dhe çfarë nuk përbën krim. Në të vërtetë, në shumë vende, trafikimi i mbetjeve është përcaktuar si veprë penale nga dispozitat e përfshira në legjislacionin e menaxhimit të mbetjeve. Prandaj, është detyrë e ligjvënësve që të marrin në konsideratë marrëdhënien ndërmjet legjislacionit për të luftuar trafikimin e mbetjeve dhe legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve. Kjo çështje diskutohet më në detaje më poshtë në lidhje me dispozitën legjislativë model në lidhje me trafikimin e mbetjeve.

⁸³ Po aty, ff. 362–364.

⁸⁴ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, General Comment No. 34 (2011) on the freedoms of opinion and expression, para. 25; shih gjithashtu Oscar M. Garibaldi, "General limitations on human rights: the principle of legality", *Harvard International Law Journal*, vol. 17, No. 3 (1976), f. 503.

⁸⁵ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, General Comment No. 31 (2004), para. 6; General Comment No. 34 (2011), para. 22; dhe Human Rights Council resolution 15/21, para. 4.

⁸⁶ Shih Siracusa Principles on the Limitation and Derogation of Provisions in the International Covenant on Civil and Political Rights (E/CN.4/1985/4, annex).

KUADRI INSTITUCIONAL KOMBËTAR

Ky publikim është një udhëzues legjislativ dhe jo një udhëzues për ngritjen e institucioneve kombëtare. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se këto dy tema nuk mund të ndahen tërësisht nga njëra-tjetra. Legjislacioni është i nevojshëm në mënyrë që institucionet qeveritare të krijohen dhe të kryejnë funksionet e tyre në një mënyrë konsistente me shtetin e së drejtës, madje edhe ligjet e hartuara më së miri do të jenë të pafuqishme për të arritur qëllimet e tyre nëse nuk mbështeten nga një kuadër institucional kombëtar që është efektiv. Për arsye praktike, fushëveprimi i këtij publikimi është i kufizuar, me fokus në legjislacionin material për trajtimin e trafikimit të mbetjeve. Nuk është bërë asnjë përpjekje për të ofruar udhëzime gjithëpërfshirëse për ngritjen e institucioneve efektive kombëtare për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve. Megjithatë, për shkak se këto tema janë medoemos të ndërthurura, ky publikim nuk hesht për çështjen e ngritjes së institucioneve kombëtare. Ky seksion ofron një pasqyrë të llojeve të kompetencave dhe përgjegjësisive që do të duhet t'u ndahen institucioneve vendase. Ai gjithashtu ofron një pasqyrë të institucioneve tipike të cilave u besohen këto kompetenca dhe përgjegjësi. Kapitujt pasues ofrojnë modelet e dispozitave që përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, si kompetencat dhe përgjegjësitë në lidhje me hetimin, bashkëpunimin ndërkombëtar, ndjekjen penale dhe caktimin e dënimit. Në fund, në kapitullin 8 është dhënë një dispozitë legjislative model për krijimin e një trupi për të bashkërenduar institucionet kombëtare.

Përgjegjësitë dhe kompetencat

Ndarja e përshtatshme e përgjegjësisive dhe kompetencave është një aspekt i domosdoshëm i një kuadri institucional kombëtar që është efektiv. Ndarja e përgjegjësisive dhe kompetencave me legjislacion është gjithashtu e nevojshme në mënyrë që veprimi i qeverisë kundër trafikimit të mbetjeve të jetë legjitim dhe në përputhje me sundimin e ligjit. Autoriteteve kombëtare të përfshira në menaxhimin e mbetjeve dhe/ose në parandalimin, hetimin, ndjekjen penale ose gjykimin e shkeljeve të trafikimit të mbetjeve duhet t'u jepen përgjegjësi të qarta dhe kompetenca të përshtatshme për të përmbushur këto përgjegjësi. Më poshtë është dhënë një listë jo shteruese e përgjegjësisive dhe kompetencave në lidhje me parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve që duhet të përcaktohen qartë me legjislacion për departamentet, agjencitë dhe nëpunësit publikë përkatës:

- Shpallja dhe ndryshimi i legjislacionit sekondar ose akteve nënligjore (si rregulloret) në lidhje me menaxhimin e mbetjeve
- Dhënia e licencave, lejeve dhe/ose certifikatave në lidhje me menaxhimin e mbetjeve
- Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të mbetjeve
- Zbatimi dhe ekzekutimi i përdorimit të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave Bazë të Organizatës Botërore të Doganës për importet dhe eksportet e mbetjeve⁸⁷
- Mbledhja, raportimi dhe analizimi i të dhënave përkatëse
- Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i shkeljeve të ligjeve dhe rregulloreve të mbetjeve
- Vendosja e sanksioneve në rastet e shkeljes dhe monitorimi i zbatimit të sanksioneve
- Bashkëpunimi me agjencitë e huaja ligj-zbatuese dhe autoritete të tjera të huaja, si dhe organizatat relevante ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë agjencitë ndërkombëtare dhe rajonale të bashkëpunimit për zbatimin e ligjit
- Rritja e ndërgjegjësimit në sektorin e menaxhimit të mbetjeve dhe ofrimi i edukimit për publikun e gjerë

Këto përgjegjësi dhe kompetenca medoemos do t'u besohen departamenteve, agjencive dhe nëpunësve publikë të ndryshëm, duke u lejuar këtyre departamenteve, agjencive dhe nëpunësve publikë të zhvillojnë kompetenca dhe ekspertizë të specializuar dhe në këtë mënyrë të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë më efektive. Ndarja e kompetencave të caktuara (siç është ndarja e ushtrimit të kompetencave gjyqësore të gjykimin nga ushtrimi i kompetencave ekzekutive dhe administrative) mund të kërkohet edhe nga kushtetutat e vendeve.

⁸⁷ Shih gjithashtu World Customs Organization, Topics, Nomenclature and classification of goods, "Instruments and tools". Në dispozicion këtu www.wcoomd.org/.

Seksioni i mëposhtëm shqyrton organet, departamentet, agjencitë dhe agjencitë publike tipike të përfshira në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve.

Institucionet e përfshira në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve

Seksioni i mëparshëm kishte të bënte me përgjegjësitë dhe kompetencat që duhet të përcaktohen me legjislacion për të trajtuar në mënyrë efektive trafikimin e mbetjeve. Në këtë seksion, merren parasysh organet qeveritare, departamentet, agjencitë dhe nëpunësit publikë që në mënyrë tipike ka të ngjarë të përfshihen në trajtimin e trafikimit të mbetjeve. Këto organe mund të ekzistojnë në nivelet e qeverisjes vendore, kombëtare ose rajonale.

Mënyra se si Shtetet i ndajnë përgjegjësitë dhe kompetencat midis organeve, departamenteve, agjencive dhe nëpunësve publikë përkatës do të ndryshojë. Së këndejmi, ky seksion ofron vetëm një përshkrim të përgjithshëm të përgjegjësisë dhe kompetencave që ushtrojnë zakonisht këto organe, departamente, agjenci dhe nëpunës.

Legjislatura

Sipas ndarjes së pushteteve, legjislatura (e njohur si parlamenti në shumë Shtete) është përgjegjëse për miratimin e legjislacionit. Prandaj, legjislaturat e brendshme janë përgjegjëse për prezantimin dhe ndryshimin e legjislacionit në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe trafikimin e mbetjeve. Kompetencat për ligjëvendime përcaktohen në mënyrë tipike në kushtetutat e vendeve dhe zakonisht do të jenë mjaft të gjera për të përfshirë nxjerrjen e ligjeve për menaxhimin e mbetjeve dhe trafikimin e mbetjeve pa ndryshime të mëtejshme. Megjithatë, kur Shtetet janë të detyruara nga një marrëveshje ndërkombëtare në të cilën janë palë – siç është Konventa kundër Krimit të Organizuar ose Konventa e Bazelit – të krijojnë legjislacion që nuk është brenda kompetencave legjislative të parlamentit të tyre, është përgjegjësi e tyre të sigurojnë që parlamentit i jepen kompetencat e duhura për të lejuar Shtetin të përmbushë detyrimet sipas traktatit.⁸⁸

Departamentet dhe autoritetet e mjedisit

Departamentet, ministritë ose agjencitë përkatëse qeveritare, të tilla si departamentet e burimeve natyrore ose mjedisit, zakonisht do të kenë funksione dhe përgjegjësi të veçanta në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve dhe për trajtimin e shkeljeve të mbetjeve, përfshirë trafikimin e mbetjeve. Në disa Shtete këto detyra mund t'u delegohen autoriteteve rajonale ose vendore. Autoritetet mjedisore janë të përfshira në zhvillimin e politikave, azhurnimin e legjislacionit sekondar (për shembull, tabelat e mbetjeve) dhe marrjen e veprimeve ekzekutive. Autoritetet mjedisore mund të shqyrtojnë kërkesa dhe të japin licenca, leje ose certifikata në lidhje me mbetjet. Nëpunësit e autoriteteve mjedisore zakonisht përfshihen në monitorimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret e mbetjeve, kryerjen e inspektimeve dhe zbulimin ose identifikimin e trafikimit të mbetjeve dhe shkeljeve të tjera të mbetjeve. Në disa Shtete, disa përgjegjësi në lidhje me mbetjet, si dhënia e licencave, lejeve ose certifikatave, mund të trajtohen nga departamente të tjera, si departamentet e industrisë ose tregtisë.

Autoritetet ligj-zbatuese

Autoritetet ligj-zbatuese mund të përfshihen në zbulimin ose identifikimin e shkeljeve të mbetjeve ose mund të thirren për të përmbushur funksione të specializuara hetimore që janë përtej mandatit të inspektorëve ose nëpunësve të mbetjeve, të tilla si trajtimi i vendngjarjeve të krimit dhe hetimet kriminalistike, kryerja e hetimeve financiare (pasurore) dhe përdorimi i teknikave të posaçme hetimore. Autoritetet përkatëse ligj-zbatuese mund të përfshijnë, në varësi nga vendi në fjalë, policinë kombëtare, rajonale, portuale, hekurudhore dhe vendore, si dhe departamentet e policisë përgjegjëse për trajtimin e krimit të mbetjeve, krimit të organizuar, pastrimit të parave, korrupsionit dhe hetimeve financiare (pasurore). Në rastet komplekse të trafikimit të mbetjeve, përfshirja e autoriteteve ligj-zbatuese mund të bëhet thelbësore. Autoritetet ligj-zbatuese mund të ushtrojnë kompetenca për të hetuar trafikimin e mbetjeve sipas një sërë ligjesh dhe

⁸⁸ Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, neni 27.

rregulloresh kombëtare, duke përfshirë ligjet në lidhje me krimin e organizuar, pastrimin e parave dhe korrupsionin, si dhe sipas ligjeve të specializuara në lidhje me trafikimin e mbetjeve dhe ligjeve të përgjithshme që vendosin kompetencat e agjencive ligj-zbatuese.

Agjencitë doganore

Agjencitë doganore do të vijnë gjithashtu në kontakt me trafikun e mbetjeve, kryesisht në porte dhe kufij tokësorë. Agjencitë doganore përgjithësisht kanë mandatin për të zbuluar dhe identifikuar trafikimin e mbetjeve në këto lokacione në përputhje me legjislacionin doganor. Nëpunësit doganorë përgjithësisht janë të trajnuar dhe të autorizuar për të kryer hetime të përgjithshme, për të regjistruar çështje dhe për të mbledhur dhe sekuestruar prova. Nëpunësit doganorë shpesh luajnë role të rëndësishme në mbledhjen e informacionit, identifikimin e dërgesave me risk të lartë dhe kryerjen e hetimeve.

Autoritetet përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale

Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i çështjeve të trafikimit të mbetjeve mund të kërkojë bashkëpunim me Shtete të tjera. Ky mund të jetë rasti kur shkelja ndodh në rrethana ndërkufitare ose kur shkelësit, dëshmitarët ose viktimat ndodhen në juridiksione të tjera. Organizimi i përpjekjeve të një Shteti për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar është një detyrë komplekse. Mbajtja e shënimeve për të gjitha marrëveshjet, traktatet, memorandumet e mirëkuptimit, shërbimet e ndërlidhjes policore, regjimet ligjore, zhvillimet në të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare dhe shërbimet e ndryshme të ekzekutimit dhe hetimit që janë burimi i kërkesave për bashkëpunim, krahas me trajtimin e të gjitha kërkesave hyrëse dhe dalëse, kërkon ekspertizë dhe autoritet ligjor dhe administrativ. Një autoritet qendror i caktuar me përgjegjësinë për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale është një mjet kritik për ruajtjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi këto çështje dhe për sigurimin e bashkëpunimit efektiv ndërkombëtar.⁸⁹ Neni 18, paragrafi 13, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të caktojnë një autoritet qendror me përgjegjësinë dhe kompetencën për të marrë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe për t'i ekzekutuar ato ose për t'ua transmetuar ato autoriteteve kompetente për ekzekutim. Ky parakusht është pa paragjykim për bashkëpunimin përmes kanaleve diplomatike, Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) dhe bashkëpunimit informal ndërmjet autoriteteve.

Autoritetet e prokurorisë

Rolet e prokurorëve ndryshojnë nga vendi në vend. Në shumicën e sistemeve, funksionet kryesore të prokurorëve janë vendimi për ndjekjen penale dhe përfaqësimi i prokurorisë në gjykatë. Funksionet kryesore në disa juridiksione mund të përfshijnë gjithashtu hetimin e krimit, mbikëqyrjen e respektimit të rregullave të procedurës nga hetuesit, lirimimin e përkohshëm gjyqësor (lirimimin me garanci pasurore), marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe caktimit të dënimit, devijimin e autorëve në alternativa ndaj ndjekjes penale, mbështetjen e viktimave, rekomandimet në lidhje me caktimin e dënimit, mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve dhe trajtimin e personave në burgim⁹⁰

Autoritetet gjyqësore

Funksionet e autoriteteve gjyqësore – pra gjykatave dhe gjyqtarëve – gjithashtu ndryshojnë nga vendi në vend. Funksioni kryesor i gjyqtarëve është të vendosin mbi çështjet procedurale dhe ligjore në çështjet penale përpara, gjatë dhe pas gjykimit. Gjatë fazës së hetimit, gjyqtarët mund të shqyrtojnë dhe të vendosin për kërkesat për përdorimin e teknikave të posaçme hetimore ose urdhrat për të kryer kontrole. Nëse një person është arrestuar ose ndaluar nën dyshimin për veprimtari kriminale, gjyqtarët ose nëpunësit e tjerë

⁸⁹ Shih gjithashtu UNODC, *Manual on Mutual Legal Assistance and Extradition* (Vjenë, 2012), ff. 29–39.

⁹⁰ Shih gjithashtu UNODC, *The Status and Role of Prosecutors: A United Nations Office on Drugs and Crime and International Association of Prosecutors Guide*, Criminal Justice Handbook Series (Vjenë, 2014).

gjyqësorë mund të ngarkohen me shqyrtimin e kërkesave për paraburgim ose lirim me garanci pasurore. Ata gjithashtu mund të nxjerrin aktvendime në lidhje me menaxhimin e çështjeve, si caktimi i datave për procedurat paraprake dhe gjykimin, zbulimi i provave dhe pranueshmëria e provave të caktuara. Në gjykim, roli i gjyqtarit ndryshon në varësi nga fakti nëse gjyqtari është vendimmarrësi i vetëm ose nëse kompetencat vendimmarrëse u jepen edhe anëtarëve të jurisë apo gjyqtarëve porotë. Në sistemet e gjykimeve me juri, gjyqtari zakonisht është përgjegjës për mbikëqyrjen e gjykimit me juri sipas ligjit, duke udhëzuar anëtarët e jurisë mbi ligjin e zbatueshëm dhe duke nxjerrë aktvendime për çështjet ligjore. Në sisteme të tilla, përgjegjësia për përcaktimin e çështjeve faktike, duke përfshirë përcaktimin përfundimtar të fajësisë, përgjithësisht i lihet jurisë dhe jo gjyqtarit. Kur juria konstaton se i pandehuri është fajtor për një krim, në përgjithësi është gjyqtari ai që përcakton dënimin e duhur. Kur gjyqtarët nuk ndajnë kompetencat vendimmarrëse gjyqësore me anëtarët e jurisë, kompetencat e tyre do të jenë më të gjera dhe mund të përfshijnë përcaktimin edhe fajësisë edhe të dënimit. Autoritetet gjyqësore pas gjykimit mund të shqyrtojnë apelet, veçanërisht apelet kundër shpalljes së fajësisë dhe/ose caktimit të dënimit nga personi i dënuar, si dhe kërkesat në lidhje me ekzekutimin e ligjshëm të dënimeve. Në disa vende, gjykatat e specializuara mjedisore shqyrtojnë çështjet mjedisore.⁹¹

Agjencitë e tjera qeveritare

Disa agjenci të tjera qeveritare mund të përfshihen në hetimin e shkeljeve të trafikimit të mbetjeve. Përfshirja e tyre do të varet nga rregullimet e brendshme, por ato mund të përfshijnë agjenci të specializuara si nëpunësit anti-pastrim i parave, njësitë e hetimit financiar (pasuror), komisionet anti-korrupsion dhe autoritetet tatimore.

Konsiderata të mëtejshme

Vlen të përmenden shkurtimisht dy konsiderata të tjera në lidhje me kuadrin institucional kombëtar: burimet dhe bashkërendimi. Institucionet e ndryshme kombëtare nuk do të jenë në gjendje të kryejnë me efektivitet mandatat e tyre për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve nëse nuk u ofrohet financimi i duhur dhe burime të tjera për të ushtruar funksionet e tyre. Përveç kësaj, nuk mjafton që secilit institucion përkatës t'i jenë besuar përgjegjësitë dhe kompetencat e veta. Duhet gjithashtu të sigurohet që këto institucione bashkërendojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive me njëra-tjetrën. Shtetet duhet të jenë të kujdesshme, gjatë zhvillimit dhe përmirësimit të kuadrit institucional kombëtar për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve, që institucionet e ndryshme të mos zhvillojnë sisteme “silos” që funksionojnë në mënyrë të izoluar. Shtetet duhet gjithashtu të sigurojnë bashkërendim dhe bashkëpunim efektiv ndërmjet niveleve kombëtare, rajonale dhe vendore të qeverisjes, ku përgjegjësitë përndahen ndërmjet niveleve të qeverisjes. Për të ndihmuar me bashkërendimin, kapitulli 8 përfshin një dispozitë legjislative model për krijimin e një trupi bashkërendues kombëtar.

⁹¹ Shih, përgjithësisht, George Pring dhe Catherine Pring, *Environmental Courts and Tribunals: A Guide for Policy Makers* (Nairobi, Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, 2016).

Kapitulli 2.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kapitulli i dytë i këtij udhëzuesi ka të bëjë me dispozitat e përgjithshme për luftimin e trafikimit të mbetjeve. Këto dispozita trajtohen veçmas nga kapitujt pasues për shkak të rëndësisë së tyre të gjerë për të gjitha masat e diskutuara në udhëzues. Në kapitullin 2 trajtohen tri tema: deklaratimet legjislative të parimeve të ligjit mjedisor, përkufizimet dhe tabelat dhe juridiksioni i mbetjeve.

DEKLARIMI I PARIMEVE TË DREJTËS SË MJEDISIT

Në kapitullin 1 të këtij udhëzuesi, u shpjegua se marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si Konventa e Bazelit, dhe më gjerësisht, e drejta ndërkombëtare e mjedisit, njohin një sërë parimesh të përgjithshme që janë relevante për zhvillimin dhe ndryshimin e legjislacionit për të luftuar trafikimin e mbetjeve. Ndër këto parime të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit përfshihen parimi i mos-dëmtimit, parimi i parandalimit, parimi i kujdesit paraprak, parimi ndotësi paguan, parimi i bashkëpunimit dhe parimet e aksesit në informacion, pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit në drejtësi. U diskutuan gjithashtu dy parime të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare të mjedisit me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbetjeve: hierarkia e menaxhimit të mbetjeve dhe parimi i afërsisë.

Ndërsa e drejta ndërkombëtare e mjedisit në përgjithësi nuk kërkon që Shtetet t'i ritheksojnë këto parime sipas legjislacionit të brendshëm për sa kohë që Shtetet përmbushin thelbin e detyrimeve të tyre sipas parimeve detyruese të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit, deklarimi i parimeve relevante në legjislacionin kombëtar është një mjet i dobishëm për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit mjedisor, duke përfshirë legjislacionin për të luftuar trafikimin e mbetjeve. Deklarimi i parimeve ombrellë që qëndrojnë në themel të legjislacionit për luftimin e trafikimit të mbetjeve mund të ndihmojë në interpretimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni, jo vetëm nga gjyqësori por edhe nga palët përkatëse të interesit. Referimet ndaj parimeve relevante të së drejtës ndërkombëtare mund të përfshihen, sipas nevojës, në preambulën ose pjesën operative të legjislacionit përkatës.

SHEMBULL: LESOTO**Akti për Mjedisin, 2008****Seksioni 4 – E drejta për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm**

[...]

- (4) Gjykata, gjatë ushtrimit të juridiksionit të saj, udhëhiqet nga këto parime të zhvillimit të qëndrueshëm –
- (a) parimi ndotësi paguan;
 - (b) parimi i kujdesit paraprak;
 - (c) parimi i integritetit të ekosistemit;
 - (d) parimi i pjesëmarrjes së publikut në zhvillimin e politikave, planeve dhe proceseve për menaxhimin e mjedisit; dhe
 - (e) parimi i drejtërisë ndërmjet brezave dhe brenda brezave.

SHEMBULL: ZAMBIA**Akti për Menaxhimin e Mjedisit, 2011****Seksioni 6 – Parimet që rregullojnë menaxhimin e mjedisit**

Për arritjen e qëllimit të këtij ligji, zbatohen parimet e mëposhtme:

- (a) mjedisi është trashëgimia e përbashkët e brezave të tashëm dhe të ardhshëm;
- (b) efektet e pafavorshme parandalohen dhe minimizohen nëpërmjet planifikimit të integruar afatgjatë dhe bashkërendimit, integritetit dhe bashkëpunimit të përpjekjeve, të cilat marrin parasysh të gjithë mjedisin si një subjekt të tërë;
- (c) parimi i kujdesit paraprak;
- (d) parimi ndotësi paguan;
- (e) nxitet aksesit me drejtëri në burimet mjedisore dhe merret parasysh integriteti funksional i ekosistemeve për të garantuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve dhe për të parandaluar efektet e pafavorshme;
- (f) qytetarët përfshihen në zhvillimin e politikave, planeve dhe programeve për menaxhimin e mjedisit;
- (g) qytetari ka akses në informacionin mjedisor për t'i mundësuar qytetarit të zgjedhë në mënyrë të informuar, duke inkurajuar performancë të përmirësuar nga industria dhe qeveria;
- (h) gjenerimi i mbetjeve duhet të minimizohet, kudo që është e mundur, dhe mbetjet duhet, sipas radhës së prioritetit, të ripërdoren, të riciklohen, të rikuperohen dhe të asgjësohen në një mënyrë të sigurt që shmang krijimin e efekteve të pafavorshme;
- (i) mjedisi është jetik për jetesën e njeriut dhe përdoret në mënyrë të qëndrueshme për të arritur uljen e varfërisë dhe zhvillimin socio-ekonomik;
- (j) burimet natyrore të rinovueshme përdoren me maturi, duke marrë parasysh nevojat për brezat e tashëm dhe të ardhshëm;
- (k) burimet natyrore të rinovueshme përdoren në një mënyrë që është e qëndrueshme dhe nuk paragjykon realizueshmërinë dhe integritetin e tyre; dhe
- (l) nxitet dhe lehtësohet pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit në menaxhimin e burimeve natyrore dhe ndarja e përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve.

SHEMBULL: PERU

Dekret Legjislativ për miratimin e Ligjit për menaxhimin gjithëpërfshirës të mbetjeve të ngurta, 2016

Neni 2 – Qëllimi i menaxhimit gjithëpërfshirës të mbetjeve të ngurta

Qëllimi i parë dhe kryesor i menaxhimit gjithëpërfshirës të mbetjeve të ngurta në Peru është parandalimi ose minimizimi i gjenerimit të mbetjeve të ngurta në pikën e origjinës, si një prioritet mbi çdo opsion tjetër. Së dyti, për mbetjet që krijohen, përparësi i jepet rikuperimit ose konvertimit të materialeve përbërëse dhe potencialit energjetik nëpërmjet ripërdorimit, riciklimit, kompostimit dhe bashkë-përpunimit, ndër të tjera, me kusht që gjithmonë të mbrohen kushtet shëndetësore dhe mjedisi.

Asgjësimi përfundimtar i mbetjeve të ngurta në instalimet përkatëse është opsioni i fundit i menaxhimit të mbetjeve dhe duhet të bëhet në kushte të përshtatshme mjedisore siç përcaktohen në rregulloret zbatuese të këtij Dekreti Legjislativ të nxjerrë nga Ministria e Mjedisit.

PËRKUFIZIMET

Modeli i dispozitës 1 në këtë udhëzues parashtron përkufizime për disa terma kyç që përdoren dhe janë relevante në mënyrë të përgjithshme për dispozitat model të përfshira këtu. Përkufizime të mëtejshme që janë relevante për modelet e dispozitave specifike janë përfshirë në ato dispozita.⁹² Hartuesit e legjislacionit duhet të sigurojnë që terminologjia e përdorur në legjislacionin për luftimin e trafikimit të mbetjeve është e qartë, e përpiktë dhe e qëndrueshme. Duhet ushtruar kujdes për të shmangur dykuptimësitë që mund të pengojnë ekzekutimin ose ndjekjen penale efektive. Hartuesit e legjislacionit duhet të marrin parasysh gjithashtu legjislacionin tjetër përkatës të brendshëm për të shmangur boshllëqet dhe kontradiktat.

MODEL I DISPOZITËS 1: PËRKUFIZIMET

Për qëllime të këtij [Akti/Ligji/Kapitulli ...]:

- (a) “Mbetje” nënkupton një substancë ose objekt që asgjësohet, është menduar të asgjësohet ose është parashikuar me ligj të asgjësohet;
- (a) “Grup kriminal i organizuar” nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë shkelje për të cilat zbatohet ky [Akt/ Ligj/ Kapitull ...], me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitim financiar ose përfitim tjetër material;
- (c) “Krim i rëndë” nënkupton një shkelje të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë;
- (d) “Përfitim financiar ose përfitim tjetër material” përfshin çdo lloj nxitjeje financiare ose jo-financiare, pagesë, ryshfet, shpërblim ose avantazh tjetër, duke përfshirë shërbimet;
- (e) “[Konfiskim/humbje e pasurisë]” nënkupton privimin e përhershëm nga pasuria me urdhër të [shëno gjykatën përkatëse ose autoritetin tjetër kompetent];

⁹² Konkretisht, përkufizimet për “trafikim” në modelin e dispozitës 3, “person juridik” dhe “nëpunës i lartë” në modelin e dispozitës 11, “dorëzim i kontrolluar” në modelin e dispozitës 12, “hetim nën mbulim” në modelin e dispozitës 13, “identitet i pretenduar” në modelin e dispozitës 14, “vëzhgim i personave” në modelin e dispozitës 15, “vëzhgim elektronik” në modelin e dispozitës 16, “sekuëstrim” në modelin e dispozitës 17, “dëshmitar” dhe “person që bashkëpunon me autoritetet ligj-zbatuese” në modelin e dispozitës 25, “viktima” në modelin e dispozitës 26.

- (f) “[Ngrirje/sekuestrim]” nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së pasurisë ose marrjen e përkohshme të kujdesit ose kontrollit ndaj pasurisë në bazë të një urdhri të dhënë nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent;
- (g) “Produkt i krimit” nënkupton çdo pasuri të prejardhur, tërësisht ose pjesërisht, nga kryerja e një shkeljeje, ose të fituar, direkt ose indirekt, nëpërmjet kryerjes së një shkeljeje, qoftë e kryer brenda ose jashtë territorit të [shëno emrin e Shtetit];
- (h) “Person” nënkupton personin fizik ose juridik.

Përkufizimet (a) deri në (g) janë përshtatur nga Konventa e Bazelit dhe Konventa kundër Krimit të Organizuar. Asnjëra nga konventat nuk kërkon rreptësisht që Shtetet t'i vendosin këto përkufizime sipas ligjit të brendshëm. Megjithatë, duke qenë se këto përkufizime ofrojnë përmbajtje lidhur me detyrimet e Shteteve sipas secilës prej këtyre konventave, mund të jetë e dobishme që Shtetet t'i përfshijnë ato në legjislacionin e brendshëm.

Përkufizimi i mbetjeve i dhënë në paragrafin (a) është përshtatur nga përkufizimi i mbetjeve që përmban Konventa e Bazelit.⁹³ Elementet e këtij përkufizimi janë veçuese dhe jo kumulative. Kjo do të thotë, vetëm një nga elementet (që asgjësohet, është menduar të asgjësohet ose është parashikuar me ligj të asgjësohet) duhet të plotësohet në mënyrë që një substancë ose objekt të konsiderohet mbetje. Përkufizimi është menduar të jetë i gjerë dhe mund të përfshijë si mbetjet e rrezikshme ashtu edhe ato jo të rrezikshme dhe përfshijnë, ndër forma të tjera të mbetjeve, mbetjet plastike, mbetjet industriale dhe bujqësore, mbetjet e vajrave, mbetjet elektronike dhe elektrike, mbetjet mjekësore dhe mbetje të tjera të lëngëta dhe të ngurta. Aty ku është relevante për legjislacionin e propozuar, Shtetet mund të dëshirojnë gjithashtu të përkufizojnë terma të tjerë të lidhur, si p.sh. “mbetje të rrezikshme” dhe “mbetje të tjera”. Kur Shtetet dëshirojnë t'u referohen llojeve ose rrymave të veçanta të mbetjeve në dispozita të veçanta legjislative, ky udhëzues rekomandon përdorimin e tabelave të mbetjeve për ta bërë këtë. Përdorimi i tabelave të mbetjeve shpjegohet në seksionin vijues.

Përkufizimet e përcaktuara në paragrafët (b) deri (g) janë përshtatur nga Konventa kundër Krimit të Organizuar dhe *Modele të dispozitave legjislative kundër krimit të organizuar* (botimi i dytë, 2022). Në paragrafin (e), ofrohet një zgjedhje midis përdorimit të termave “konfiskim” dhe “humbje e pasurisë”. Në paragrafin (f), ofrohet një zgjedhje midis termave “ngrirje” dhe “konfiskim”. Këto zgjedhje pasqyrojnë faktin se terminologjia për këto koncepte ndryshon midis Shteteve. Neni 2, paragrafi (f), i Konventës kundër Krimit të Organizuar vendos përkufizime identike për termin “ngrirje” dhe “konfiskim”, dhe paragrafi (g), në përkufizimin e termit “konfiskim”, parashikon që përkufizimi i tij “përfshin humbjen e pasurisë aty ku është e zbatueshme”. Ky udhëzues përdor termat “konfiskim” dhe “sekuestrim”.

Për komente të mëtejshme relevante mbi përkufizimet e dhëna në modelin e dispozitës 1, shih nenin 3 të *Modele të dispozitave legjislative kundër krimit të organizuar* (Botim i dytë, 2022).

SHEMBULL: KINA

Ligji i Republikës Popullore të Kinës për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së mjedisit të shkaktuar nga mbetjet e ngurta, 1995

Neni 124

Për qëllimet e këtij Akti, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Mbetje të ngurta nënkupton artikujt dhe substancat e ngurta dhe gjysmë të ngurta, dhe artikujt dhe substancat e gazta në kontejnerë, që kanë humbur vlerën e tyre fillestare të përdorimit ose nuk e kanë humbur vlerën e tyre të përdorimit, por janë braktisur ose hedhur, si dhe artikujt dhe substancat që bien në kuadër të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve

⁹³ Konventa e Bazelit, neni 2, para. 1.

administrative për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Artikujt dhe substancat e tilla që janë bërë të padëmshme gjatë përpunimit dhe që janë në pajtim me standardet e detyrueshme kombëtare të cilësisë së produktit dhe që nuk do të rrezikojnë shëndetin publik dhe sigurinë ekologjike, ose që nuk konsiderohen si mbetje të ngurta sipas kriterëve dhe procedurave për identifikimin e mbetjeve të ngurta, përjashtohen.

2. Mbetje të ngurta industriale nënkupton mbetjet e ngurta që gjenerohen gjatë aktiviteteve të prodhimit industrial.
3. Mbetje shtëpiake nënkupton mbetjet e ngurta që gjenerohen në jetën e përditshme ose në aktivitete që ofrojnë shërbime për jetën e përditshme, si dhe mbetjet e ngurta që konsiderohen mbetje shtëpiake sipas dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve administrative.
4. Mbetje nga ndërtimi nënkupton tokën e hedhur, materialet mbeturina dhe mbetjet e tjera të ngurta të krijuara në procesin e ndërtimit të ri, ndryshimit, zgjerimit ose shkatërrimit të llojeve të ndryshme të ndërtesave, strukturave, rrjeteve të tubacioneve, etj., si dhe të dekorimit dhe rinovimit të banesave, nga ndërtesat dhe njësitë e ndërtimit.
5. Mbetje të ngurta bujqësore nënkupton mbetjet e ngurta që gjenerohen gjatë aktiviteteve të prodhimit bujqësor.
6. Mbetje të rrezikshme nënkupton mbetjet e ngurta me karakteristika të rrezikshme që renditen në regjistrin kombëtar të mbetjeve të rrezikshme ose që identifikohen sipas kriterëve dhe metodave të identifikimit të mbetjeve të rrezikshme të përcaktuara nga Shteti.
7. Magazinim nënkupton vendosjen e përkohshme të mbetjeve të ngurta në një instalim ose vend të caktuar.
8. Përdorim nënkupton nxjerrjen e substancave nga mbetjet e ngurta për t'u përdorur si lëndë të para ose lëndë djegëse.
9. Asgjësim nënkupton ndryshimin e karakteristikave fizike, kimike ose biologjike të mbetjeve të ngurta me djegie ose metoda të tjera për të arritur pakësimin e sasisë së gjeneruar të mbetjeve të ngurta, pakësimin e vëllimit të mbetjeve të ngurta, pakësimin ose eliminimin e përbërësve të rrezikshëm ose vendosjen përfundimtare të mbetjeve të ngurta në një vend-depozitim që plotëson kërkesat e rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit

SHEMBULL KOMBËTAR: ARGJENTINA

Akti nr. 24.051 për mbetjet e rrezikshme, 1992

Neni 2

Për qëllimet e këtij Akti, çdo mbetje që mund të shkaktojë dëm, në mënyrë direkte ose indirekte, për qeniet e gjalla ose të ndotë tokën, ujin, ajrin ose mjedisin në përgjithësi konsiderohet e rrezikshme.

Në veçanti, mbetjet e treguara në aneksin I të këtij Akti do të konsiderohen të rrezikshme, si dhe ato që kanë karakteristikat e renditura në aneksin II.

Dispozitat e këtij Akti zbatohen në mënyrë të ngjashme për çdo mbetje të rrezikshme që mund të përdoret si input për procese të tjera industriale.

Fushëveprimi i këtij Akti nuk përfshin mbetjet shtëpiake, mbetjet radioaktive ose mbetjet e gjeneruara nga operimet normale të anijeve, të cilat të gjitha rregullohen nga legjislati i veçantë dhe marrëveshjet relevante ndërkombëtare.

TABELAT E MBETJEVE

Trafikimi i mbetjeve mund të përfshijë një gamë të gjerë të rrymave të mbetjeve. Për të lehtësuar hartimin e legjislacionit të qartë, është e dobishme që këto rryma të klasifikohen në kategori të gjera, si mbetje të rrezikshme dhe mbetje të tjera. Për ta bërë këtë, ky udhëzues rekomandon përdorimin e tabelave të mbetjeve. Tabela e mbetjeve është një listë e rrymave të mbetjeve që i përkasin një kategorie të caktuar. Këto kategori të gjera më pas referohen në dispozitat përkatëse legjislative si një mënyrë stenografike për t'iu referuar rrymave të mbetjeve të renditura aty. Kjo e bën legjislacionin jo vetëm më të lehtë për t'u lexuar, por edhe më të thjeshtë për t'u ndryshuar. Për shembull, nëse dëshirohet që legjislacioni të mbulojë një rrymë të re të mbetjeve, vetëm tabela përkatëse (si p.sh. “Mbetjet e rrezikshme”) do të duhet të ndryshohet, dhe jo çdo dispozitë përkatëse.

Tabelat e mbetjeve mund të përfshihen në instrumentet legjislative primare, siç janë ligjet, ose në instrumentet legjislative dytësore ose aktet nënligjore, siç janë rregulloret. Përfshirja e tyre në legjislacionin sekondar ka avantazhin se një legjislacion i tillë ndryshohet më lehtë, gjë që ofron fleksibilitet shtesë. Forma e duhur ligjore e këtyre tabelave është një çështje që duhet të përcaktohet nga secili Shtet.

Kur vendosin për formën e instrumentit legjislativ për tabelat, Shtetet duhet të marrin parasysh gjithashtu proceset e zbatueshme për ndryshimin e këtij instrumenti. Kjo është e rëndësishme sepse teknologjitë në lidhje me gjenerimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve po ndryshojnë vazhdimisht. Metodatat që përdorin kriminelët për të kryer shkelje të trafikimit të mbetjeve do të vazhdojnë të evoluojnë. Shtetet duhet të azhurnojnë ligjet e tyre, duke përfshirë tabelat e zbatueshme, për të zënë hapin me këto ndryshime. Procesi i një Shteti për ndryshimin e rregulloreve ose akteve tjera nënligjore zakonisht do të jetë më i thjeshtë sesa procesi për ndryshimin e legjislacionit. Përcaktimi i tabelave përkatëse në rregullore ose instrumente të tjera të legjislacionit sekondar mund t'u mundësojë Shteteve të reagojnë më lehtë ndaj zhvillimeve. Për aq sa është në përputhje me kuadrin legjislativ të një Shteti, ky udhëzues gjithashtu rekomandon që autoriteteve kompetente t'u jepet një rol në procesin e miratimit ose nisjes së ndryshimeve të tabelave. Kompetencat e tilla në përgjithësi do të duhet të delegohen nga legjislatura përkatëse.

Gjatë zhvillimit të dispozitave të legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve, Shtetet duhet të sigurojnë që ata të respektojnë detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare. Kur legjislacioni i brendshëm përdor tabelat e mbetjeve për të përcaktuar përmbajtjen e dispozitave legjislative, Shtetet duhet të marrin parasysh anekset ose kategoritë ndërkombëtare të mbetjeve që përcaktojnë përmbajtjen e detyrimeve të tyre ndërkombëtare për të nxjerrë ligje. Për shembull, neni 9, paragrafi 5 i Konventës së Bazelit thotë që secila palë krijon legjislacionin e përshtatshëm kombëtar/të brendshëm për të parandaluar dhe ndëshkuar trafikun e kundërligjshëm. “Trafiku i kundërligjshëm” përkufizohet, për qëllimet e Konventës së Bazelit, në nenin 9, paragrafi 1, si “çdo lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera” kur plotësohen disa kushte të mëtejshme. “Mbetjet e rrezikshme” përkufizohen në nenin 1, paragrafi 1, të Konventës si më poshtë:

(a) Mbetjet që i përkasin kategorive që përmban Aneksi I, përveç rasteve kur ato nuk posedojnë asnjë nga karakteristikat e përfshira në Aneksin III; dhe

(b) Mbetjet që nuk mbulohen nga paragrafi (a), por përkufizohen si mbetje të rrezikshme ose konsiderohen si mbetje të rrezikshme nga legjislacioni i brendshëm i Palës së eksportit, importit ose transitit.

“Mbetjet e tjera” përkufizohen në nenin 1, paragrafi 2, si mbetje që i përkasin kategorive që përmban Aneksi II. Kështu, përmbajtja e detyrimit të Shteteve në nenin 9, paragrafi 5, të Konventës së Bazelit për të krijuar legjislacionin për parandalimin dhe ndëshkimin e trafikut të kundërligjshëm përcaktohet, pjesërisht,⁹⁴ të Konventës së Bazelit për të krijuar legjislacionin për parandalimin dhe ndëshkimin e trafikut të kundërligjshëm përcaktohet, pjesërisht, sipas asaj që shkruhet në anekset I, II dhe III të Konventës. Me miratimin e legjislacionit për parandalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të mbetjeve, Shtetet palë të Konventës së Bazelit duhet të sigurojnë që dispozitat e brendshme për trafikimin të mbulojnë llojet e mbetjeve që përmbajnë këto anekse. Anekset XIII dhe IX të Konventës së Bazelit mund të jenë gjithashtu të rëndësishme për këtë qëllim.

⁹⁴ Përfshirja e paragrafit (b) të këtij përkufizimi i lejon një Shteti palë të Konventës së Bazelit të përkufizojë, në legjislacionin e tij të brendshëm, rryma plotësuese të mbetjeve që do të konsiderohen si mbetje të rrezikshme dhe do t'i nënshtrohen regjimit të kontrollit sipas Konventës së Bazelit në lidhje me lëvizjet ndërkufitare që përfshijnë atë Shtet palë.

Anekset ose kategoritë e tjera ndërkombëtare të mbetjeve që Shteteve mund t'u kërkohej t'i kenë parasysh përfshijnë anekset e Konventës së Stokholmit për ndotësit organikë të qëndrueshëm, anekset e Konventës së Bamakos, anekset e Konventës së Uaiganit dhe shtojcat e Vendimit të Këshillit të OECD-së për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të destinuar për operacione rikuperimi.⁹⁵

Lidhur me çështjen e procesit të duhur për ndryshimin e tabelave të brendshme është çështja se si duhet të përfshihen anekset ose kategoritë ndërkombëtare të mbetjeve në legjislacionin e brendshëm. Në përgjithësi, kjo mund të arrihet qoftë duke i riprodhuar këto anekse ose kategori të mbetjeve në tabelat e brendshme ose duke i përfshirë ato me referim. Në rastin e fundit, teksti i anekseve ose kategorive ndërkombëtare nuk riprodhohet në tabelat e brendshme, por në vend të kësaj përfshihet një referim për ato anekse ose kategori në mënyrë të tillë që mbetjet e renditura atje të konsiderohen të përfshira në tabelat e brendshme përkatëse. Në disa vende, përfshirja me referim mund të lejojë që ndryshimet në anekset dhe kategoritë ndërkombëtare të përfshihen automatikisht në legjislacionin e brendshëm, pa pasur nevojë të ndryshohet legjislacioni ose rregulloret e brendshme sa herë që azhurnohen këto anekse ose kategori. Në vende të tjera, azhurnimi automatik i tabelave të brendshme mund të mos jetë i mundur nëpërmjet përfshirjes me referim për shkak të parimeve kushtetuese ose të tjera. Kur përcaktojnë procesin e duhur për ndryshimin e tabelave të brendshme, Shtetet duhet të vlerësojnë se cilat procese janë të lejueshme sipas sistemeve të tyre ligjore. Aty ku azhurnimi automatik nëpërmjet përfshirjes me referim është i lejueshëm, ky mekanizëm mund të jetë i dobishëm për Shtetet për të siguruar që tabelat e brendshme janë të azhurnuara.

Një shembull i përdorimit të tabelave nga Proklamata e Etiopisë për menaxhimin dhe kontrollin e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme është përfshirë më poshtë. Proklamata përfshin tre anekse (d.m.th., tabela): kategoritë e mbetjeve që do të kontrollohen, një listë të karakteristikave të rrezikshme dhe operacionet e asgjësimit. Anekset pastaj referohen në përkufizimet e përfshira në nenin 2 të Proklamatës. Për shkak të gjatësisë së tre anekseve, janë përfshirë vetëm fragmente të shkurtra nga secili.

SHEMBULL: ETIOPIA

Proklamata për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe kontrollin e asgjësimit, 2018

Neni 2 – Përkufizimet

Në këtë Proklamatë:

[...]

3/ "asgjësim" nënkupton çdo operacion të asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme të specifikuar në Aneksin Tre të kësaj Proklamate;

[...]

10/ "mbetje të rrezikshme" nënkupton mbetjet që i përkasin kategorive të përfshira në Aneksin Një të kësaj Proklamate dhe që posedojnë karakteristikat e përfshira në Aneksin Dy; duke përfshirë ato mbetje që mund të kategorizohen si mbetje të rrezikshme sipas direktivës që do të nxjerrë Ministria,

[...]

⁹⁵ Ligjvënësit mund të dëshirojnë gjithashtu të kenë parasysh klasifikimin e mbetjeve të përfshirë në Sistemin e Harmonizuar të përshkrimit dhe kodimit të mallrave bazë në aneksin e Konventës Ndërkombëtare për Sistemin e Harmonizuar të përshkrimit dhe kodimit të mallrave bazë. Në këtë drejtim, ligjvënësit mund të dëshirojnë të konsultojnë publikimin e Organizatës Botërore të Doganës, *Correlation Between the Product Coverage of Selected International Conventions and the Harmonized System* (tetor 2021), i cili identifikon korrelacionet midis kodeve të Sistemit të Harmonizuar dhe produkteve të kontrolluara sipas instrumenteve të përzgjedhura ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Bazelit, Vendimin e Këshillit të OECD-së për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të destinuar për operacione rikuperimi dhe Konventën e Stokholmit.

SHEMBULL: ETIOPIA**Aneksi I: Kategoritë e mbetjeve që do të kontrollohen**

Rrymat e mbetjeve

- Mbetjet nga kujdesi mjekësor në spitale, qendra mjekësore dhe klinika [...]
- Mbetjet nga prodhimi dhe përgatitja e produkteve farmaceutike

[...]

- Mbetjet nga vajrat/ujërat, hidrokarburet/përzierjet me ujëra, emulsionet

[...]

Mbetjet që kanë si përbërës

- Karbonile metalike
- Berilium; komponime të beriliumit
- Komponime të kromit gjashtëvalent
- Komponime të bakrit

[...]

Aneksi II: Lista e karakteristikave të rrezikshme

- Plasëse

[...]

- Lëngje të ndezshme

[...]

- Oksiduese

Aneksi III: Operacionet e asgjësimit

A. Operacione që nuk çojnë në mundësinë e rikuperimit, riciklimit, bonifikimit, ripërdorimit të drejtpërdrejtë ose përdorimeve alternative të burimeve

[...]

B. Operacione që mund të çojnë në rikuperimin, riciklimin, bonifikimin, ripërdorimin e drejtpërdrejtë ose përdorime alternative të burimeve

[...]

JURIDIKSIONI

Shtetet duhet të miratojnë dispozita që vendosin juridiksionin gjithëpërfshirës për ndjekjen penale dhe ndëshkimin e trafikimit të mbetjeve. Juridiksioni i referohet kompetencës së një Shteti, nëpërmjet prokurorëve, gjykatave dhe institucioneve të tjera të tij, për të ushtruar autoritet ligjor mbi një territor, person ose send. Vendosja e juridiksionit gjithëpërfshirës është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e trafikimit të mbetjeve, pasi kjo dukuri shpesh ndodh përtej kufijve shtetërorë.

Shkelësit gjithashtu mund të lëvizin ndërmjet Shteteve dhe të shfrytëzojnë boshllëqet e juridiksionit në ligjet e Shteteve për të shmangur kapjen dhe ndjekjen penale. Prandaj është e rëndësishme që të artikulohen qartë bazat e juridiksionit mbi të cilat gjykatat kombëtare mund të zhvillojnë procedime për shkeljet e trafikimit të mbetjeve. Është më se e qartë që Shtetet mund të ushtrojnë juridiksion mbi aktet e kryera brenda

territoreve të tyre, duke përfshirë ujërat e tyre territoriale (parimi i territorialitetit). E drejta ndërkombëtare njeh gjithashtu të drejtën e Shteteve për të ushtruar juridiksionin jashtë-territorial në disa rrethana. Ndërsa fushëveprimi i përpiktë i këtyre rrethanave mbetet i pacaktuar,⁹⁶ komuniteti ndërkombëtar në përgjithësi e ka njohur juridiksionin e një Shteti mbi shtetasit e tij, edhe kur janë jashtë territorit të tij (parimi i personalitetit aktiv); juridiksioni i një Shteti mbi aktet që dëmtojnë shtetasit e tij (parimi i personalitetit pasiv); dhe juridiksionin e një Shteti mbi aktet e kryera jashtë Shtetit, por që janë menduar të kenë një efekt substancial brenda territorit të Shtetit (parimi objektiv territorial).⁹⁷

Duke qenë se trafikimi i mbetjeve mund të ndodhë përtej kufijve, ky udhëzues propozon që Shtetet të miratojnë dispozita që vendosin juridiksionin mbi shkeljet e trafikimit të mbetjeve në bazë të parimit të territorialitetit dhe parimeve të njohura të juridiksionit jashtë-territorial. Modeli i dispozitës 2 më poshtë ofron një shembull se si një Shtet mund të vendosë këto baza të juridiksionit.

MODEL I DISPOZITËS 2: JURIDIKSIONI

1. [Shëno referimin për gjykatat përkatëse] kanë juridiksionin për të zhvilluar procedime për shkeljet për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] kur ato:
 - (a) Janë kryer [plotësisht ose pjesërisht] brenda territorit të [shëno emrin e Shtetit]; ose
 - (b) Janë kryer [plotësisht ose pjesërisht] në bordin e një mjeti lundrues që valon flamurin e [shëno emrin e Shtetit] ose një fluturakeje të regjistruar sipas ligjeve të [shëno emrin e Shtetit] në kohën kur është kryer shkelja; ose
 - (c) Janë kryer nga një shtetas i [shëno emrin e Shtetit] i pranishëm në territorin e [shëno emrin e Shtetit], ekstradimi i të cilit është refuzuar për shkak të shtetësisë; ose
 - (d) Janë kryer nga një person i pranishëm në [shëno emrin e Shtetit], ekstradimi i të cilit refuzohet për çfarëdo arsye.
2. [Shëno referimin për gjykatat përkatëse] kanë gjithashtu juridiksionin për të zhvilluar procedime për shkeljet e kryera jashtë territorit të [shëno emrin e Shtetit] për të cilin zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli] kur:
 - (a) [viktima/objekti i krimit] është shtetas [ose banor i përhershëm] [ose banor me vendqëndrim] i [shëno emrin e Shtetit];
 - (b) Shkelja është kryer nga një shtetas [ose banor i përhershëm] [ose banor me vendqëndrim] i [shëno emrin e Shtetit] [ose një prej personave juridikë të tij];
 - (c) Shkelja është kryer jashtë territorit të [shëno emrin e Shtetit] me qëllim kryerjen e një krimi të rëndë brenda territorit të [shëno emrin e Shtetit]; ose
 - (d) Ky juridiksion bazohet në një marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme për [shëno emrin e Shtetit].

⁹⁶ Cedric Ryngaert, *Jurisdiction in International Law*, 2nd ed., Oxford Monographs in International Law Series (Oxford, Oxford University Press, 2015) ff. 101, 110–113.

⁹⁷ Shih Konventën kundër Krimit të Organizuar, neni 15, para. 2; dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, neni 42, para. 2. Shih gjithashtu David McClean, *Transnational Organized Crime: A Commentary on the UN Convention and its Protocols*, Oxford Commentaries on International Law series (Oxford, Oxford University Press, 2007), f. 164.

Paragrafi 1 i modelit të dispozitës 2 përcakton juridiksionin territorial për vendosjen gjyqësore për shkeljet e trafikimit të mbetjeve. Paragrafi 1 (a) dhe (b) pasqyron detyrimet e Shteteve palë sipas nenit 15, paragrafi 1, të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Paragrafi 1 (c) pasqyron parimin *aut dedere aut judicare* (o ekstrado, o procedo)⁹⁸ të përfshirë në nenin 16, paragrafi 10, dhe nenin 15, paragrafi 3, të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Neni 16, paragrafi 10, parashikon që nëse një Shtet palë i Konventës nuk e ekstradon një person që gjendet në territorin e tij vetëm për arsye se ai ose ajo është shtetas i tij, ky Shtet palë është i detyruar, sipas kërkesës së Shtetit palë që kërkon ekstradimin, t'ia paraqesë çështjen pa vonesa të panevojshme organeve kompetente për ndjekje penale. Neni 15, paragrafi 3, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë, për qëllimet e nenit 16, paragrafi 10, të vendosin juridiksionin për shkeljet e mbuluara nga Konventa — pavarësisht se ku ka ndodhur shkelja — në situata kur i dyshuari është i pranishëm në territorin e tyre dhe ekstradimi refuzohet vetëm me arsyetimin se i dyshuari është shtetas. Paragrafi 1 (d) i modelit të dispozitës 2 pasqyron nenin 15, paragrafin 4, të Konventës kundër Krimit të Organizuar, i cili parashikon që Shtetet palë mund të vendosin juridiksionin edhe për shkeljet e mbuluara nga Konventa kur shkelësi i pretenduar është i pranishëm në territorin e tyre dhe Shteti nuk e ekstradon atë për çfarëdo arsye. Nëse paragrafi 1 (d) i këtyre modeleve të dispozitave legjislative përdoret në legjislacionin e brendshëm, nuk ka nevojë të përfshihet paragrafi 1 (c), sepse i pari mbulon situatat kur ekstradimi refuzohet për çfarëdo arsye, përfshirë shtetësinë.

Paragrafi 2 i modelit të dispozitës 2 parashtron katër baza për ushtrimin e juridiksionit jashtë-territorial për të vendosur në mënyrë gjyqësore për shkeljet e mbetjeve. Paragrafi 2 (a) përcakton juridiksionin për çështjet kur viktimat e një shkeljeje është shtetas i Shtetit. Paragrafi 2 (a) pasqyron parimin e personalitetit pasiv dhe nenin 15, paragrafi 2 (a), të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Shtetet mund të zgjedhin gjithashtu të shtrijnë bazën e juridiksionit nga paragrafi 2 (a) për banorët e përhershëm ose banorët me vendqëndrim në atë Shtet. Paragrafi 2 (b) i modelit të dispozitës 2 përcakton juridiksionin për shkeljet e kryera nga një shtetas (ose banor i përhershëm ose me vendqëndrim) i Shtetit, duke reflektuar parimin e personalitetit aktiv dhe nenin 15, paragrafi 2 (b), të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Paragrafi 2 (c) i modelit të dispozitës 2 parashikon juridiksionin për shkeljet e kryera jashtë territorit të Shtetit, por me qëllim kryerjen e një krimi të rëndë brenda territorit të Shtetit — pra parimin territorial objektiv, siç pasqyrohet në nenin 15, paragrafi 2 (c), të Konventës kundër Krimit të Organizuar.⁹⁹ Paragrafi 2 (d) i modelit të dispozitës 2 parashikon një bazë për vendosjen gjyqësore të çështjeve për të cilat juridiksioni është dhënë nga një marrëveshje ndërkombëtare e detyrueshme për Shtetin. Këtu mund të përfshihen edhe vendimet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

⁹⁸ UNODC, *Manual on Mutual Legal Assistance and Extradition*, paras. 108–110. Shih gjithashtu A/69/10, para. 57 ff.

⁹⁹ Shih gjithashtu UNODC, *Model Legislative Provisions against Organized Crime* (Vjenë, 2012), ff. 28–29.

Kapitulli 3.

SHKELJET DHE PËRGJEGJËSIA

Trafikimi i mbetjeve shpesh përfshin një zinxhir aktorësh që shtrihen nga gjeneruesit, grumbulluesit, transportuesit, brokerët dhe tregtarët e mbetjeve deri te kompanitë e riciklimit dhe asgjësimit. Në këtë zinxhir, aktorët mund të përfshihen në akte të ndryshme kriminale. Përveç trafikimit të mbetjeve, ata mund të përfshihen në mashtrime me dokumente në lidhje me mbetjet, pjesëmarrje në një grup kriminal të organizuar, pastrim të parave, korrupsion, pengim të drejtësisë dhe evazion fiskal.

Kapitulli 3 i këtij udhëzuesi ka të bëjë me penalizimin e këtyre veprimeve. Fillon me një diskutim të përgjithshëm të elementeve të figurës së veprave penale. Qëllimi i diskutimit në kapitullin 3 është të ndihmojë lexuesit e udhëzuesit për të shqyrtuar modelin e veprave penale të përfshira në këtë kapitull duke marrë parasysh elementet përbërëse të figurës së tyre dhe jo si formulim të paracaktuar që duhet të kopjohet dhe të ngjitet në legjislacionin e brendshëm. Siç u përmend në hyrje të udhëzuesit,¹⁰⁰ Shtetet duhet të përshtatin modelet e dispozitave të përfshira këtu për t'i dalë ndesh kushteve vendore, parimeve kushtetuese, kulturës dhe strukturave ligjore dhe rregullimeve ekzistuese të ekzekutimit.

Pas diskutimit të përgjithshëm të elementeve të figurës së veprave penale, shqyrtohen shkeljet që lidhen drejtpërdrejt me mbetjet përpara se të shqyrtohen shkeljet plotësuese — shkelje që lehtësojnë aktivitetet kryesore të trafikimit të mbetjeve. Më pas shqyrtohen çështjet e përgjegjësisë dytësore dhe përgjegjësisë për tentativën, përgjegjësisë së personave juridikë dhe mbrojtjet përkatëse.

Për të siguruar që aktivitetet e trafikimit të mbetjeve të ndëshkohen me vend, shkeljet e përkufizuara në udhëzues synojnë të penalizojnë dukurinë e trafikimit të mbetjeve nga këndvështrime të ndryshme. Në marrjen e një qasjeje të tillë, janë të pashmangshme disa mbivendosje midis shkeljeve. Mënyra se si Shtetet trajtojnë ndjekjen penale të shkelësve në rastin e shkeljeve të shumta që mbivendosen pjesërisht është një çështje e përcaktuar nga secili Shtet në përputhje me traditën e tij ligjore. Në disa Shtete, akuza të shumta që mbivendosen pjesërisht janë të mundshme për një akuzë penale. Në Shtete të tjera, përdorimi i kësaj qasjeje nuk do të ishte i mundur.

Modelet e dispozitave të përfshira në këtë kapitull nuk specifikojnë dënimin e zbatueshëm për secilën shkelje. Përcaktimi i masave ndëshkuese të përshtatshme i është lënë secilit Shtet, në përputhje me sistemin dhe kulturën e tij ligjore. Për shumicën e shkeljeve të përfshira në udhëzues, do të jetë e përshtatshme përgjegjësia penale. Në disa raste, Shtetet mund të dëshirojnë të parashikojnë përgjegjësinë civile ose administrative

¹⁰⁰ Shih “Si përdoret udhëzuesi”.

gjithashtu ose si një alternativë. Se çfarë duhet të jetë struktura e masave ndëshkuese brenda një ligji të caktuar vendos Shtetit individual. Disa Shtete mund të zgjedhin të përfshijnë dënimin e zbatueshëm për secilën shkelje në dispozitën që përcakton shkeljen. Shtete të tjera mund të vendosin të përcaktojnë masat ndëshkuese të zbatueshme për secilën shkelje brenda një dispozite të posaçme për masat ndëshkuese, të veçantë nga vetë shkeljet.

ELEMENTET E FIGURËS SË VEPRAVE PENALE

I gjithë legjislacioni që përcakton shkeljet – qofshin ato penale, civile apo administrative – përcakton disa kushte të zbatueshme përgjithësisht, përmbushja e të cilave do ta nënshtrojë një person ndaj një dënimi ose ndëshkimi të caktuar. Këto kushte, të cilat përbëjnë elementet ndërtuese të një shkeljeje, njihen si elementet e figurës së shkeljes. Në përgjithësi, ndërsa terminologjia e saktë mund të ndryshojë ndërmjet sistemeve ligjore, figura e shkeljes mund të kenë dy lloje elementesh: elementet fizike/objektive dhe elementet mendore.

Elementet fizike ose objektive të figurës së shkeljes (të njohura edhe si *actus reus*, në lidhje me veprat penale) kanë të bëjnë me veprimet që i akuzuari ka kryer në të vërtetë. Ato mund të përfshijnë sjellje (veprime ose mosveprime), rezultatet e sjelljes dhe rrethana të veçanta që lidhen me sjelljen. Përgjegjësia duhet të bazohet në sjelljen e një personi në mënyrë që ajo të mos jetë arbitrare.

Elementet mendore ose subjektive të figurës së shkeljes (të njohur edhe si *mens rea*, në lidhje me veprat penale) kanë të bëjnë me gjendjen shpirtërore të personit të akuzuar në kohën e kryerjes së shkeljes. Për veprat penale, në përgjithësi kërkohen prova të një elementi mendor përkatës në lidhje me secilin element fizik/objektiv të shkeljes. Llojet e gjendjeve mendore të njohura nga ligjet penale të Shteteve të ndryshme dhe termat që përdoren për të përshkruar ato gjendje mendore ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet juridiksioneve. Këto dallime në terminologji dhe parimet ligjore në themelin e tyre e bëjnë të vështirë bërjen e përgjithësimeve rreth elementeve mendore në të gjithë spektrin e traditave ligjore dhe sistemeve ligjore. Megjithatë, mund të thuhet se elementet mendore në përgjithësi ndryshojnë sipas shkallës së dashjes ose njohjes së fakteve, gjasave dhe rreziqeve nga ana e personit në fjalë ose, në disa rrethana, sipas asaj që duhet të dinte personi në fjalë. Elementet mendore mund të vendosen në një shkallë sipas nivelit të fajit që ato sjellin. Elementet mendore të dashjes dhe dijenisë janë në pjesën e sipërme të kësaj shkalle. Poshtë tyre janë elemente mendore të verbërisë së qëllimshme (mbyllja e syve me dëshirë), pamaturisë dhe pakujdesisë. Në pjesën e fundme të shkallës janë shkeljet e përgjegjësive së rreptë dhe përgjegjësive absolute, të cilat nuk kërkojnë prova të asnjë elementi mendor.

Elementet mendore për shkeljet e trafikimit të mbetjeve dhe mashtrimit me dokumente në lidhje me menaxhimin e mbetjeve janë lënë të hapura në këtë udhëzues. Në dispozitat përkatëse, fraza “me gjendjen e nevojshme mendore” është përfshirë në kllapa katrore për të theksuar se Shtetet duhet të marrin në konsideratë elementet e përshtatshme mendore, nëse ka, për shkeljen në fjalë. Kur Shtetet synojnë të përcaktojnë shkeljet me përgjegjësi të rreptë, është e rëndësishme që legjislacioni të parashikojë qartë se nuk kërkohet asnjë provë e elementeve mendore. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të siguruar që personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në industrinë e mbetjeve mund të konstatojnë se për çfarë mund të jenë përgjegjës penalisht (dhe së këndejmi të sigurohet respektimi i parimit të ligjshmërisë), por gjithashtu për të siguruar që shkelja mund të ndiqet penalisht siç është menduar. Sipas shumë sistemeve ligjore, gjykatat mund të zbatojnë prezumimin se një shkelje kërkon prova të *mens rea*, me një kërkesë për dashjen e qartë përkundrazi përpara se ky prezumim të mund të rrëzohet. Kjo dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e përgjegjësive së rreptë për shkeljet e mbetjeve shqyrtohen në shembullin e mëposhtëm nga Mbretëria e Bashkuar.

SHEMBULL: MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË TË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE

KV kundër Kurorës Mbretërore [2011] EWCA Crim 2342 (19 tetor 2011) dhe Ezeemo kundër Kurorës Mbretërore [2012] EWCA Crim 2064 (16 tetor 2012)

Këto çështje kishin të bënin me ndjekjet penale të personave fizikë dhe juridikë për transportimin e mbetjeve të destinuara për rikuperim në Nigeri ndesh me rregulloren 23 të Rregulloreve të Mbretërisë së Bashkuar për transportin ndërkufitar të mbetjeve të vitit 2007. Në kohën përkatëse, kjo dispozitë parashikonte se:

Një person kryen shkelje nëse, në kundërshtim me nenin 36(1) [të Rregullores nr. 1013/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 qershor 2006, për dërgesat e mbetjeve], ai transporton mbetje të specifikuar në atë nen të cilat janë të destinuara për rikuperim në një vend për të cilin nuk zbatohet Vendimi i OECD-së [Vendimi C(2001)107/Final i Këshillit të OECD-së lidhur me rishikimin e Vendimit C(92)39/Final për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të destinuara për operacione rikuperimi].

Në një seancë përgatitore për gjykimin, gjyqtari nxori një aktvendim për interpretimin e rregullores 23 të Rregulloreve të Mbretërisë së Bashkuar dhe nenit 36 të Rregullores së BE-së. Me këtë aktvendim u refuzuan parashtratat e bëra nga të pandehurit se Rregullorja 23 ishte joproporcionale dhe *ultra vires* (e bërë pa autoritet të ligjshëm).

Gjashtë të pandehur bënë apel të ndërmjetëm ndaj këtij aktvendimi, i cili u shqyrtua nga Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit. Në këtë apel, mes tjerash, të pandehurit ngrënë argumentin se gjyqtari gaboi kur konstatoi se Rregullorja 23 ishte proporcionale dhe së këndejmi brenda fushëveprimit të nenit 50 të Rregullores së BE-së, i cili kërkonte vendosjen e sanksioneve efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Të pandehurit ngrënë argumentin se krijimi i një shkeljeje të përgjegjësive së rreptë, të dënueshme me burgim deri në dy vjet dhe që mund të kryhet nga një gamë e gjerë individësh dhe organizatash, nuk ishte proporcionale.

Çështja u shqyrtua me supozimin se Rregullorja 23 vërtet krijoi një shkelje që përfshin përgjegjësi të rreptë. Ky kishte qenë supozimi i gjyqtarit në seancën përgatitore dhe në apelin e ndërmjetëm nuk ishin bërë parashtrata kundërshtuese. Gjykata e Apelit konstatoi se, edhe duke supozuar se shkelja përfshinte përgjegjësi të rreptë, ajo nuk ishte joproporcionale për këtë arsye. Gjykata kishte kompetencë të mjaftueshme për të shmangur caktimin e një dënimi me burgim ose një ndëshkim tjetër të rëndë nëse një i pandehur e kishte kryer vërtet shkeljen tërësisht pa faj.

Çështja procedoi në gjykim. Në mbyllje të çështjes së prokurorisë, gjyqtari gjykues nxori një aktvendim se kishte prova për t'iu drejtuar jurisë se secili nga të pandehurit ishte i përfshirë në transportimin e mbetjeve të destinuara për rikuperim në Nigeri dhe, për më tepër, se shkelja ishte një shkelje me përgjegjësi të rreptë kështu që prokurorisë nuk i kërkohet të provojë as se të pandehurit kishin dijeninë që produkti i transportuar ishte mbetje, as se ata kishin dijeninë ose dashjen që mbetjet të transportoheshin në Nigeri për rikuperim. Pas këtij aktvendimi, disa nga të pandehurit e ndryshuan deklarinimin e tyre të fajësisë në fajtor. Të pandehurit e tjerë u dënuan në përfundim të gjykimit, ndërsa një i pandehur u lirua nga disa akuza.

Shtatë të pandehur, katër persona fizikë dhe tre persona juridikë, e apeluan dënimin e tyre në Gjykatën e Apelit të Anglisë dhe Uellsit. Në apel, ata ngrënë argumentin, ndër të tjera, se gjyqtari gjykues kishte gabuar në aktvendimin se shkelja ishte një shkelje e përgjegjësive së rreptë.

Gjykata e Apelit vuri në dukje se është një prezumim i ligjit të Anglisë dhe Uellsit që një vepër penale kërkon një *mens rea* (dhe së këndejmi nuk është një shkelje e përgjegjësive së rreptë) përveç nëse *mens rea* përjashtohet nga implikimi i nevojshëm. Duke interpretuar rregulloret e Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata vendosi se ishte e qartë se Rregullorja 23 ishte menduar të jetë një shkelje e përgjegjësive së rreptë. Gjykata konstatoi se nëse do të ishte rasti kur shkelja kërkon që prokuroria të provojë *mens rea* të dijenisë,

shkelja nuk mund të provohej përveç nëse prokuroria do të mund të vërtetonte kundër cilitdo prej atyre që përkufizoheshin si transportues se ai kishte dijeni personale për dashjen e të tjerëve dhe/ose kishte inspektuar ngarkesat. Sipas gjykimit tonë, nëse kjo do të ishte kërkesa sipas Rregullores 23, rregullorja do të privohej në mënyrë thelbësore nga efekti i saj i menduar, që është pengimi i atyre që merren me biznesin e trajtimit të këtij materiali për eksport nga ndërmarrja e veprimeve me risk për mjedisin.

SHEMBULL: MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË TË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE

Gjykata u shpreh më tej:

Sipas mendimit tonë të respektueshëm, qëndrimi i përkohshëm i shprehur nga gjykata në çështjen *KV dhe të tjerë* është i saktë. Shkelja e krijuar nga Rregullorja 23 është shkelje e përgjegjësisë së rreptë. Ne e pranojmë, siç është parashtruar, se ky konstrukt ka efektin e kapjes së atyre që mund të mos kenë dijeni personale se një kontejner përmban mbetje ose që përmbajtja e kontejnerit ishte e destinuar për rikuperim në një vend jo anëtar të OECD-së. Një nga arsyet për vendosjen e përgjegjësisë së rreptë është ... nxitja e vigjilencës më të madhe mes atyre që ndërmarrin aktivitete që mund të shkaktojnë dëm për publikun. Detyrimi që rregulloret vendosin për transportuesit është të kujdesen për të marrë në dijeni njohuri për ngarkesat që transportojnë. Nëse nuk e bëjnë këtë, ata rrezikojnë të veprojnë ndesh me rregulloret.

Në fund, Gjykata citoi me miratim vendimin e *Hooper LJ në Jackson kundër Kurorës* [2006] EWCA Crim 2380 (17 tetor 2006), në të cilin gjyqtari i nderuar u shpreh se:

Ndërkohë që është gjithmonë e mundur të përvijohen situata të cilat duket se mbulohen nga një dispozitë ligjore dhe megjithatë mund të kenë rezultate haptazi të padrejta, duhet të mbështetemi në arsyen e shëndoshë të Autoriteteve të Prokurorisë dhe në rolin e përgjithshëm mbikëqyrës të gjykatave për të shmangur zhvillimin e një situate të tillë. Po kështu, sigurisht që dënimi i shqiptuar në të vërtetë në çdo çështje të veçantë mund të pasqyrojë shkallën aktuale të fajit të përfshirë në një çështje të caktuar.

Gjykata refuzoi këtë dhe arsyet e tjera për apel dhe vërtetoi dënimet e apeluesve.⁴

⁴ Për më shumë informacion, shih UNODC, "Sharing Electronic Resources and Laws on Crime (SHERLOC) knowledge management portal", Case law database, R v. Ezeemo and Ors. Në dispozicion këtu <https://sherloc.unodc.org>.

SHKELJET E MBETJEVE

Ky seksion i udhëzuesit ka të bëjë me shkeljet që lidhen drejtpërdrejt me trafikimin e mbetjeve. Në këtë seksion trajtohen dy shkelje: trafikimi i mbetjeve dhe mashtrimi me dokumente në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Trafikimi i mbetjeve

Për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive trafikimin e mbetjeve, është thelbësore që trafikimi i mbetjeve të penalizohet siç duhet sipas legjislacionit të brendshëm. Modeli i dispozitës 3 më poshtë ofron një shembull se si mund të arrihet kjo. Në këtë seksion, përpara se të parashtrohet teksti i kësaj dispozite model, diskutohet hartimi i shkeljeve të trafikimit të mbetjeve në përgjithësi, duke përfshirë elementet e tyre fizike/objektive dhe mendore, si dhe shpjegohet projektimi i modelit të dispozitës 3.

Në thelb, ekzistojnë tri elemente fizike/objektive të çdo shkeljeje të trafikimit të mbetjeve: aktet që mund të përbëjnë trafikim, mbetjet që mund të trafikohen (d.m.th., objekti i shkeljes) dhe rrethanat që përcaktojnë se kur aktet përkatëse do të konsiderohen si trafikim dhe së këndejmi vepër penale. Secili prej këtyre elementeve duhet të jetë i pranishëm në mënyrë që veprimet të konsiderohen trafikim i mbetjeve. Në këtë seksion, diskutimi përqendrohet rreth secilit prej këtyre elementeve, si ato parashikohen në modelin e dispozitës 3 dhe pse janë bërë zgjedhje të caktuara në lidhje me këto elemente gjatë hartimit të dispozitës model.

Elementi i parë janë aktet që mund të përbëjnë trafikim. Në sisteme të ndryshme ligjore dhe në kontekste të ndryshme, termi trafikim mund t'i referohet akteve të ndryshme. Për të siguruar që modeli i dispozitës 3 është sa më gjithëpërfshirës dhe për të shmangur lënien e boshllëqeve, ky udhëzues ka një qasje të gjerë ndaj akteve që përfshihen në shkeljen e trafikimit të mbetjeve. Nëpërmjet përkufizimit të termit "trafikon" në paragrafin 1, modeli i dispozitës 3 mbulon importimin, eksportimin, transportimin, blerjen, shitjen, brokerimin, trajtimin, përpunimin, grumbullimin, klasifikimin, etiketimin, manipulimin, përdorimin,

magazinimin, riciklimin, asgjësimin dhe djegien e mbetjeve. Për qëllimet e këtij udhëzuesi, importimi dhe eksportimi duhet të interpretohen se përfshijnë ri-importimin dhe ri-eksportimin, respektivisht. Aty ku kjo nuk do të ishte e qartë sipas legjislacionit të brendshëm, ligjvënësit mund të dëshirojnë të bëjnë referime specifike për ri-importimin dhe ri-eksportimin ndër aktet që mund të përbëjnë trafikim. Shtetet mund të dëshirojnë gjithashtu të përfshijnë, në formën e përshtatshme për legjislacionin e brendshëm, shembuj të disa ose të gjitha akteve që mund të përbëjnë trafikim.

Disa vende mund të kenë një këndvështrim më të ngushtë për sa i përket akteve që përfshihen në nocionin e trafikimit, duke preferuar të penalizojnë akte të caktuara nëpërmjet shkeljeve të dedikuara në vend që të krijojnë një shkelje të përgjithshme të trafikimit. Për shembull, ndërsa nocioni i trafikimit në modelin e dispozitës 3 përfshin asgjësimin e kundërligjshëm të mbetjeve, në disa vende ky veprim është i penalizuar si një shkelje specifike e asgjësimit të paligjshëm dhe jo nëpërmjet nocionit të trafikimit të mbetjeve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për akte të tjera të përfshira në nocionin e trafikimit të mbetjeve sipas modelit të dispozitës 3. Cilado qasje që të merret, ligjvënësit duhet të sigurojnë që të gjitha aktivitetet e paligjshme përkatëse të kryera përgjatë zinxhirit të aktorëve të përfshirë në trafikimin e mbetjeve penalizohen në mënyrë të përshtatshme.

Elementi i dytë është objekti i shkeljes. Me fjalë të tjera, çfarë është objekti që, kur trafikohet, përbën shkelje të trafikimit të mbetjeve? Kjo është gjithashtu një çështje në lidhje me të cilën Shtetet kanë marrë qasje të ndryshme. Në disa vende, shkeljet e trafikimit të mbetjeve mbulojnë vetëm mbetjet e rrezikshme ose kategori të tjera të specifikuar të mbetjeve. Në vende të tjera, shkelja e trafikimit të mbetjeve mund të kryhet duke trafikuar çdo lloj të mbetjeve.

Modeli i dispozitës 3 përdor dy mjete legjislative për përcaktimin e fushëveprimit të mbetjeve për të cilin mund të zbatohet. E para është se, duke përdorur termin “mbetje”, ai i referohet përkufizimit të mbetjeve që përmban modeli i dispozitës 1 në këtë udhëzues, përkatësisht, “një substancë ose objekt që asgjësohet, është menduar të asgjësohet ose është parashikuar me ligj të asgjësohet”. Së dyti, llojet e mbetjeve që përfshihen në shkeljen e trafikimit janë mbetjet “që i përkasin një kategorie të renditur në [shëno referimin ndaj tabelave relevante]”. Ky udhëzues nuk specifikon se cilat mbetje mund të jenë objekt i trafikimit. Megjithatë, rekomandimet e listave ndërkombëtare të mbetjeve për përfshirje në tabelat e brendshme janë përfshirë në kapitullin 2, së bashku me një shpjegim të përgjithshëm për përdorimin e tabelave të mbetjeve.

Elementi i tretë i shkeljes së trafikimit të mbetjeve janë rrethanat që i karakterizojnë aktet e veçanta që mbulohen nga kjo dispozitë si trafikim dhe së këndejmi i bëjnë këto akte vepra penale (“elementi i rrethanave”). Ky element është i domosdoshëm sepse jo të gjitha aktet e përfshira në këtë shkelje do të përbëjnë krime në të gjitha rrethanat. Në të njëjtën mënyrë që drejtimi i një makine nuk është vepër penale, por drejtimi i një makine pa leje drejtimi ose nën ndikimin e alkoolit në përgjithësi do të jetë vepër penale, aktet e ndryshme që lidhen me mbetjet në përgjithësi nuk do të përbëjnë sjellje kriminale, përveç nëse një ose më shumë kushte të tjera janë plotësuar. Për shembull, trajtimi ose asgjësimi i mbetjeve nuk do të përbëjë krim nëse kryhet nga mbajtësi i një licence ose lejeje të vlefshme në një mënyrë që është në përputhje me kushtet e asaj licence ose lejeje. Prandaj është e nevojshme që ligjvënësit të përcaktojnë se kur aktet e ndryshme që mbulohen nga një dispozitë e trafikimit të mbetjeve do të konsiderohen si krim i trafikimit, duke i dalluar këto raste nga rastet kur të njëjtat akte kryhen në mënyrë të ligjshme.

Elementet e rrethanave të shkeljeve të trafikimit të mbetjeve në përgjithësi u referohen detyrave ose detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve. Ka mënyra të ndryshme me të cilat mund të arrihet kjo. Për shembull, legjislacioni mund të përkufizojë trafikimin si akte të veçanta ndesh me “ligjin”, ndesh me një ligj apo rregullore të caktuar, ose ndesh me dispozitat specifike të një ligji apo rregulloreje të caktuar. Trafikimi mund të përkufizohet gjithashtu si akte të veçanta “pa autoritet të ligjshëm”, pa leje, licencë ose certifikatë, ose ndesh me kushtet e një licence, lejeje ose certifikate të tillë. Kërkesat për mbajtjen ose ushtrimin e autoritetit të ligjshëm dhe për dhënien e licencës, lejes ose certifikatës mund të përcaktohen në dispozita të tjera të të njëjtit ligj ose në një ligj tjetër. Shkeljet e trafikimit mund të përkufizojnë gjithashtu detyrat ose detyrimet që kanë të bëjnë me aktet brenda shkeljes. Për shembull, në përkufizimin e trafikimit, disa Shtete kanë ndjekur nga afër formulimet e Konventës së Bazelit, duke e përkufizuar trafikimin si akte të caktuara pa njoftimin e Shteteve të interesuara, pa pëlqimin e Shteteve të interesuara, ose me pëlqimin e

marrë nëpërmjet falsifikimit, keqparaqitjes ose mashtrimit apo në një mënyrë që nuk konfirmon pëlqimin në mënyrë materiale me dokumentet relevante.¹⁰¹

Detyrat dhe detyrimet që mund të zbatohen për secilin nga aktet e mbuluara nga modeli i dispozitës 3 – importimi, eksportimi, transportimi, blerja, shitja, brokerimi, trajtimi, përpunimi, grumbullimi, klasifikimi, etiketimi, manipulimi, përdorimi, magazinimi, riciklimi, asgjësimi ose djegia – medoemos do të ndryshojnë midis Shteteve dhe mund të jenë komplekse. Për këtë arsye, dhe në përputhje me fushëveprimin e këtij publikimi si një mjet i drejtësisë penale dhe jo një mjet më i gjerë i menaxhimit të mbetjeve, modeli i dispozitës 3 nuk përcakton detyrat dhe detyrimet që, kur shkelen, do t'i shndërrojnë këto akte në trafikim. Përkundrazi, modeli i dispozitës 3 ia lë specifikimin e këtyre detyrave dhe detyrimeve legjislatorit dhe rregullore për menaxhimin e mbetjeve, dhe në vend të kësaj, përcakton katër rrethana të përgjithshme që do të kapin situatat kur këto detyra ose detyrime shkelen, si më poshtë:

(a) Kur akti është kryer pa autoritetin e ligjshëm dhe kur autoriteti i tillë kërkohet me ligj për kryerjen e këtyre akteve;

(b) Kur akti është kryer pa një licencë, leje ose certifikatë përkatëse të dhënë nga një autoritet kompetent;

(c) Kur akti është kryer në kundërshtim me kushtet e një licence, lejeje ose certifikate të tillë; ose

(d) Kur akti është ndryshe në kundërshtim me legjislatorin për menaxhimin e mbetjeve.

Atëherë është kompetencë e ligjvënësve të sigurojnë që legjislatori për menaxhimin e mbetjeve mbulon në mënyrë adekuate rrethanat në të cilat aktet e importimit, eksportimit, transportimit, blerjes, shitjes, brokerimit, trajtimit, përpunimit, grumbullimit, klasifikimit, etiketimit, manipulimit, përdorimit, magazinimit, riciklimit, asgjësimit ose djegies së mbetjeve mund të kryhen nëpërmjet kërkesave për autoritetin e ligjshëm, kërkesave për të mbajtur dhe vepruar në përputhje me një licencë, leje ose certifikatë, ose nëpërmjet detyrave, detyrimeve ose ndalimeve të tjera të zbatueshme. Në disa vende, akte të caktuara, veçanërisht importimi i mbetjeve të rrezikshme, gjithmonë do të përbëjnë vepra penale. Në të vërtetë, Konventa e Bamakos kërkon që palët të penalizojnë importin e mbetjeve të rrezikshme në Afrikë nga vendet jo-palë.¹⁰²

Mirëpo, kjo medoemos do të thotë se ky model i dispozitës legjislativ – dhe ky udhëzues legjislativ – ofron vetëm një pjesë të mozaikut për trajtimin e trafikimit të mbetjeve në mënyrë efektive. Pjesa tjetër janë dispozitat e legjislatorit të brendshëm për menaxhimin e mbetjeve që përcaktojnë ligjshmërinë e veprimeve rreth menaxhimit të mbetjeve. Ky udhëzues më vete nuk mund të ofrojë qasje gjithëpërfshirëse për penalizimin e trafikimit të mbetjeve për Shtetet që nuk kanë një legjislator të tillë. Sugjerohet që, në raste të tilla, Shtetet të kërkojnë asistencë legjislativ për zhvillimin e legjislatorit për menaxhimin e mbetjeve së bashku me asistencën legjislativ për zhvillimin e legjislatorit për trafikimin e mbetjeve.

Së këndejmi, modeli i dispozitës 3 parashikon një shkelje të gjerë të trafikimit të mbetjeve, që mbulon akte të ndryshme, mbetje të ndryshme dhe rrethana të ndryshme që e bëjnë sjelljen të paligjshme. Kështu, modeli i dispozitës 3 mund të përfaqësojë një thjeshtësim të mënyrës se si ligjvënësit dëshirojnë të penalizojnë trafikimin e mbetjeve në të vërtetë. Në vend që t'i mbulojnë të gjitha këto në një vepër penale të vetme, ligjvënësit mund të dëshirojnë të përcaktojnë shkelje specifike për akte specifike, mbetje specifike dhe/ose lloje të veçanta të cenimit (d.m.th., rrethanat që e bëjnë sjelljen të paligjshme). Ka arsye të ndryshme pse ligjvënësit mund të dëshirojnë ta bëjnë këtë. Shtetet mund të dëshirojnë të përdorin elemente të ndryshme fizike/objektive dhe/ose mendore për lloje të ndryshme të trafikimit të mbetjeve. Ata gjithashtu mund të dëshirojnë të parashikojnë dënime maksimale të ndryshme në lidhje me lloje të ndryshme të trafikimit të mbetjeve. Siç diskutohet më tej më poshtë,¹⁰³ Shtetet duhet të marrin në konsideratë nevojën që masat ndëshkuese të jenë proporcionale. Shtetet gjithashtu mund të dëshirojnë të përcaktojnë shkelje të veçanta për të mundësuar përdorimin e kompetencave ose procedurave të ndryshme në lidhje me disa, por jo të gjitha shkeljet ose, sipas stilit të hartimit të legjislatorit në vend, thjesht mund të preferohet të penalizohen veprime të ndryshme në dispozita të veçanta.

¹⁰¹ Shih Konventa e Bazelit, neni 9, para. 1.

¹⁰² Konventa e Bamakos, neni 4, para. 1.

¹⁰³ Shih “Sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese” in kapitullin 6, më poshtë.

Dy vrojtme të mëtejshme mund të bëhen në lidhje me elementet fizike/objektive të shkeljes në modelin e dispozitës 3. Së pari, në përputhje me qasjen e marrë në këtë udhëzues, nuk ka asnjë kërkesë të mbivendosur që trafikimi të përfshijë një lëvizje ndërkufitare të mbetjeve. Ndërsa disa nga aktet që përbëjnë shkeljen mund të përfshijnë një lëvizje ndërkufitare (siç është importimi dhe eksportimi), nuk është e nevojshme që shkelja të përfshijë një lëvizje ndërkufitare në të gjitha rastet. Së dyti, për kryerjen e shkeljes së trafikimit nuk kërkohet shkaktimi i dëmtimit, qoftë për mjedisin, shëndetin e njeriut ose tjetër. Dëmi i shkaktuar realisht ose potencialisht nga trafikimi i mbetjeve mund të jetë i rëndësishëm në faza të tjera të procesit penal, si p.sh., në përcaktimin e dënimit të duhur,¹⁰⁴ por prokurorisë nuk i kërkohet të provojë dëmin në mënyrë që i pandehuri të shpallet fajtor.

Lidhur me elementet mendore të shkeljes, në pjesën e këtij kapitulli për elementet e figurës së veprave penale u theksua se në përgjithësi kërkohet vërtetimi i elementit mendor përkatës për secilin element fizik/objektiv të shkeljes. Kështu, hartuesit e legjislacionit duhet të marrin në konsideratë elementin e përshtatshëm mendor, nëse ka, në lidhje me secilin nga tri elementet fizike/objektive të sipërpërmendur: aktet, mbetjet dhe elementin e rrethanave. Kjo mund të jetë dashja, dijenia ose një element tjetër i përshtatshëm mendor. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme që ligjvënësit të vendosin përgjegjësi të rreptë (d.m.th., përgjegjësi pa prova të një elementi mendor) në lidhje me veprime të caktuara që çojnë në trafikimin e mbetjeve.

MODEL I DISPOZITËS 3: TRAFIKIMIT TË MBETJEVE

- (1) “Trafikon”, në lidhje me mbetjet, nënkupton importon, eksporton, transporton, blen, shet, brokeron, trajton, përpunon, grumbullon, klasifikon, etiketon, manipulon, përdor, magazinon, riciklon, asgjëson ose djeg:
- Pa autoritetin e ligjshëm kur një autoritet i tillë kërkohet me ligj;
 - Pa një [shëno terminologjinë përkatëse për licencat, lejet, certifikatat, etj.] të dhënë nga [shëno autoritetet kompetente];
 - Ndesh me kushtet e [shëno terminologjinë përkatëse për licencat, lejet, certifikatat, etj.] të përmendura; ose
 - Në një mënyrë që përndryshe bie ndesh me [shëno referimin ndaj legjislacionit përkatës për menaxhimin e mbetjeve].
- (2) Çdo person që [me gjendjen e nevojshme mendore] trafikon mbetje që i përkasin një kategorie të renditur në [shëno referimin ndaj tabelave relevante] kryen një shkelje.

SHEMBULL

Konventa e Bazelit për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, 1989

Neni 9 – Trafiku i kundërligjshëm

- Për qëllimet e kësaj Konvente, çdo lëvizje ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera:
 - pa njoftimin e të gjitha Shteteve të interesuara në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente; ose
 - pa pëlqimin e një Shteti të interesuar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente; ose
 - me pëlqimin e marrë nga Shtetet e interesuara nëpërmjet falsifikimit, keqparaqitjes ose mashtrimit; ose
 - që nuk përputhet në mënyrë materiale me dokumentet; ose
 - që rezulton në asgjësimin e qëllimshëm (p.sh. hedhjen) të mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera ndesh me këtë Konventë dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, konsiderohet si trafik i kundërligjshëm.

[...]

- Secila Palë krijon legjislacionin e përshtatshëm kombëtar/të brendshëm për të parandaluar dhe ndëshkuar trafikun e kundërligjshëm. Palët bashkëpunojnë me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë nen.

¹⁰⁴ See “Aggravating and mitigating factors” in chapter 6, below.

SHEMBULL: UNIONI AFRIKAN

Konventa e Bamakos për ndalimin e importit në Afrikë dhe kontrollin e lëvizjes ndërkufitare dhe menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme brenda Afrikës, 1991

Article 4 – General Obligations Neni 4 – Detyrimet e përgjithshme

1. Ndalimi i importit të mbetjeve të rrezikshme

Të gjitha Palët marrin masat e përshtatshme ligjore, administrative dhe masa të tjera brenda zonës nën juridiksionin e tyre për të ndaluar importin e të gjitha mbetjeve të rrezikshme, për çfarëdo arsye, në Afrikë nga Palët jo-Kontraktuese. Importi i tillë do të konsiderohet i kundërligjshëm dhe vepër penale. Të gjitha Palët:

- (a) Përcjellin sa më shpejt të jetë e mundur, të gjithë informacionin në lidhje me një aktivitet të tillë të importit të kundërligjshëm të mbetjeve të rrezikshme te Sekretariati, i cili do t'ua shpërndajë informacionin të gjitha Palëve Kontraktuese;
- (b) Bashkëpunojnë për të siguruar që asnjë import i mbetjeve të rrezikshme nga një vend jo-Palë nuk hyn në një vend Palë të kësaj Konvente. Për këtë qëllim, Palët shqyrtojnë, në Konferencën e Palëve Kontraktuese, mekanizma të tjerë të ekzekutimit.

[...]

SHEMBULL: RUANDA**Ligji N°48/2018 për Mjedisin****Neni 45 – Veprimet e ndaluara që lidhen me kimikatet dhe mbetjet**

Veprimet e mëposhtme në lidhje me kimikatet dhe mbetjet janë të ndaluara:

1. grumbullimi, asgjësimi dhe hedhja e mbetjeve në vende publike të paautorizuara ose në vende të tjera të papërshtatshme;
2. importimi i mbetjeve toksike dhe çdo produkti tjetër të dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
3. blerja, shitja, importimi, eksportimi, kalimi transit, magazinimi dhe grumbullimi i kimikateve, shumëllojshmërisë së kimikateve dhe substancave të tjera ndotëse ose të rrezikshme;

[...]

7. djegia e mbetjeve shtëpiake, mbeturinave, gomave dhe materialeve plastike.

Me urdhër të ministrit përcaktohet lista e kimikateve dhe substancave të tjera ndotëse që nuk lejohen.

Mashtrimi me dokumente në lidhje me menaxhimin e mbetjeve

Dokumentet në lidhje me aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve janë kritike për gjurmimin dhe evidentimin e mbetjeve dhe për të siguruar menaxhimin e shëndoshë mjedisor të mbetjeve. Licencat, lejet dhe certifikatat përdoren për të kryer ligjërisht aktivitetet e ndryshme të menaxhimit të mbetjeve. Kriminelët përdorin licenca, leje dhe certifikata të rreme për të maskuar aktivitetet e paligjshme me pamjen e ligjshmërisë. Mashtrimi me dokumente mund të kryhet në mënyra të ndryshme. Në disa raste, kriminelët falsifikojnë licencat, lejet ose certifikatat në tërësi. Në raste të tjera, licencat, lejet ose certifikatat e rreme prodhohen duke ndryshuar dokumente origjinale. Trafikimi i mbetjeve mund të lehtësohet gjithashtu nëpërmjet përdorimit të licencave, lejeve ose certifikatave origjinale të marra me keqparaqitje mashtruese që janë bërë në kërkesa dhe dokumente mbështetëse, të tilla si raportet e analizave, certifikatat, fletët e të dhënave, informacioni mbi përbërjen e mbetjeve, kontratat e trajtimit të mbetjeve, vërtetimi i pëlqimit, formularët e njoftimit, dokumentacioni doganor dhe dokumentacioni i lëvizjes së mbetjeve. Mashtrimi me dokumente mund të kryhet edhe kur licencat, lejet ose certifikatat origjinale përdoren nga persona të ndryshëm nga titullari i ligjshëm.

Shtetet duhet të trajtojnë secilën nga këto forma të mashtrimit me dokumente. Modelet e dispozitave 4 dhe 5 më poshtë përfshijnë shkelje që trajtojnë secilin nga këto aspekte të mashtrimit me dokumente. Modeli i dispozitës 4 penalizon prodhimin, ofrimin, shpërndarjen, prokurimin, tregtimin, shkëmbimin, dhënien, shitjen, përvetësimin, blerjen, përdorimin ose posedimin e një lejeje, certifikate ose një pjese të tyre që është e rreme. Ajo synon aktorët e përfshirë në të gjitha fazat e zinxhirit të furnizimit të lejeve dhe certifikatave të rreme, nga prodhuesit dhe ndërmjetësit e dokumenteve të tilla të rreme deri te përdoruesit ose poseduesit përfundimtarë. Dispozita mbulon si falsifikimin ashtu edhe ndryshimin e rremë të lejeve dhe certifikatave.

M MODEL I DISPOZITËS 4: [LICENCAT, LEJET, CERTIFIKATAT, ETJ.] E RREME NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E MBETJEVE

Çdo person që [me gjendjen e nevojshme mendore] prodhon, ofron, shpërndan, prokuron, tregton, shkëmben, jep, shet, përvetëson, blen, përdor ose posedon një [shëno terminologjinë përkatëse për licencat, lejet, certifikatat, etj.] ose një pjesë të tyre që është e rreme kryen një shkelje.

Falsifikimi i dokumenteve ose paraqitja e informacionit të rremë në lidhje me një kërkesë për licencë, leje ose certifikatë për menaxhimin e mbetjeve ose përdorimin e tyre duhet të konsiderohet shkelje. Keqparaqitja e mbetjeve të vërteta, për shembull, duke fshehur karakteristikat e tyre të rrezikshme, mund të ketë pasoja të mëdha si për mjedisin ashtu edhe për njerëzit që i trajtojnë ato mbetje. Modeli i dispozitës 5 përcakton një vepër penale për bërjen me dashje të një deklarami ose pohimi të rremë ose çorientues, paraqitjen e një dokumenti mashtrues, ose mospërfshirjen e informacionit ose dokumentacionit që kërkohet të ofrohet në një kërkesë për licencë, leje ose certifikatë ose në lidhje me kërkesën e tillë. Aty gjithashtu mbulohen veprimet mashtruese në lidhje me përdorimin e një licence, lejeje ose certifikate. Kjo mund të përfshijë, për shembull, një person që bën një keqparaqitje mashtruese se ai është titullari i ligjshëm i një dokumenti të tillë.

Në përcaktimin e një shkeljeje të tillë, Shtetet duhet të marrin në konsideratë se si legjislacioni duhet të trajtojë gabimet thjesht aksidentale të bëra në kërkesat për licenca, leje ose certifikata dhe përdorimin e tyre. Një mundësi është të vendoset elementi mendor i zbatueshëm i shkeljes që kërkon një masë faji – dashje, dijeni, pamaturia ose pakujdesi – për të përjashtuar keqparaqitjet që nuk janë bërë me dashje, me dijeni, nga pamaturia ose nga pakujdesia. Një mundësi tjetër është të përcaktohet shkelja si një shkelje me përgjegjësi të rreptë, por të lejohet një mbrojtje absolute e lajthimit në fakt që është i sinqertë dhe i arsyeshëm.

MODEL I DISPOZITËS 5: SJELLJA MASHTRUESE NË LIDHJE ME NJË KËRKESË PËR PËRDORIMIN E NJË [LICENCE, LEJEJE, CERTIFIKATE, ETJ.]

Çdo person që [me gjendjen e nevojshme mendore]:

- (a) bën një deklarami ose paraqitje të rreme ose çorientuese;
- (b) paraqet një dokument mashtrues; ose
- (c) nuk përfshin informacionin ose dokumentacionin që kërkohet të ofrohet;

për [shëno autoritetet kompetente] në, ose në lidhje me, kërkesën për një [shëno terminologjinë përkatëse për licencat, lejet, certifikatat, etj.] ose përdorimin e tyre, kryen shkelje.

SHKELJET PLOTËSUESE

Trafikimi i mbetjeve lehtësohet nga një sërë shkeljesh të tjera, si konspiracioni dhe bashkimi kriminal, pas-trimi i parave, korrupsioni dhe pengimi i drejtësisë. Këto shkelje mund të quhen “shkelje plotësuese” ose “shkelje të modus operandi” sepse kanë të bëjnë me veprimet plotësuese, modi operandi, të përdorur nga trafikantët e mbetjeve për të kryer aktivitetet e tyre kryesore kriminale. Është me rëndësi kritike që Shtetet

të adoptojnë masat e duhura legjislative dhe masa të tjera për të trajtuar këto shkelje plotësuese. Në të vërtetë, Konventa kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të penalizojnë pastrimin e parave, korrupsionin, pengimin e drejtësisë dhe qoftë konspiracionin ose bashkimin kriminal.¹⁰⁵ Ky seksion ofron udhëzime për penalizimin e këtyre formave të sjelljes në kontekstin e trafikimit të mbetjeve.

Duhet të theksohet gjithashtu se korporatat dhe grupet kriminale të organizuara që përfshihen në trafikimin e mbetjeve mund të kryejnë edhe shkelje të tjera, si evazioni fiskal. Ndërsa evazioni fiskal nuk trajtohet më tej nga ky udhëzues, Shtetet duhet të marrin masat e përshtatshme legjislative dhe masa të tjera për të parandaluar dhe luftuar evazionin fiskal nga ata që janë të përfshirë në menaxhimin e ligjshëm dhe të paligjshëm të mbetjeve.

Konspiracioni dhe bashkimi kriminal

Neni 5 i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të adoptojnë masa legjislative për të cilësuar si vepër penale pjesëmarrjen në një grup kriminal të organizuar. Neni 5, paragrafi 1 (a), u jep Shteteve palë mundësinë të zgjedhin njërin ose të dy modelet e ndryshme për ta arritur këtë.

Këto modele pasqyrojnë qasjet e ndryshme që merren tradicionalisht nga juridiksionet e së drejtës zakonore dhe juridiksionet e së drejtës civile për të penalizuar pjesëmarrjen në grupet kriminale të organizuara. Shkelja e llojit të marrëveshjes nga neni 5, paragrafi 1 (a) (i), pasqyron modelin e konspiracionit që merret tradicionalisht nga juridiksionet e së drejtës zakonore, ndërsa shkelja në paragrafin 1 (a) (ii) pasqyron modelin e bashkimit kriminal që merret tradicionalisht nga juridiksionet e së drejtës civile.

Modelet e dispozitave 6 dhe 7 më poshtë pasqyrojnë këto dy modele alternative të penalizimit të pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar. Dispozitat bazohen në formulimin e nenit 5, paragrafi 1 (a), të Konventës kundër Krimit të Organizuar, por janë përshtatur për t'u lidhur me shkeljet e trafikimit të mbetjeve të përfshira në këtë udhëzues.

Ashtu si me dy modelet e përfshira në Konventën kundër Krimit të Organizuar, Shtetet kanë mundësinë të zgjedhin nëse do të krijojnë njërin ose të dyja këto shkelje. Për të përcaktuar përgjegjësinë penale për shkeljen e komplotit në modelin e dispozitës 6, duhet të provohet se i akuzuari ka rënë dakord me një ose më shumë persona të tjerë për të kryer një krim të rëndë (elementi fizik/objektiv i shkeljes). Një paragraf 2 opsional është përfshirë për Shtetet që dëshirojnë të kërkojnë ose janë të detyruara nga ligji i brendshëm të kërkojnë elementin fizik/objektiv plotësues të një akti që ndërmerret nga një prej pjesëmarrësve për avancimin e marrëveshjes. Shtetet mund të zgjedhin gjithashtu të përfshijnë një element tjetër fizik/objektiv, gjegjësisht, që marrëveshja përfshinte një grup kriminal të organizuar.

Për këtë shkelje ekzistojnë dy elemente mendore:

- (a) Synimi për të rënë dakord me një ose më shumë persona të tjerë për të kryer veprën penale; dhe
- (b) Qëllimi i marrëveshjes është përfitimi financiar ose përfitimi tjetër material.

Modeli i dispozitës 6 nuk përfshin shprehimisht fjalën “synim”. Megjithatë, formulimi i shkeljes nënkupton një element mendor (a) të synimit. Akti i marrëveshjes për të kryer një shkelje mund të kryhet vetëm me dashje.

¹⁰⁵ Konventa kundër Krimit të organizuar, neni 5, 6, 8 dhe 23.

MODEL I DISPOZITËS 6: KONSPIRACIONI

1. Çdo person që merret vesh me një ose më shumë persona të tjerë për të kryer një krim të rëndë me qëllim që të sigurojë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitim financiar ose përfitim tjetër material, kryen një shkelje që ndëshkohet me [shëno dënimin].
2. Që një person të shpallet fajtor sipas këtij seksioni, një akt tjetër përveç lidhjes së marrëveshjes duhet të ndërmerret nga njëri prej pjesëmarrësve për avancimin e marrëveshjes.]

Modeli i dispozitës 7 përmban dy shkelje të bashkimit kriminal. E para nga këto shkelje ka të bëjë me pjesëmarrjen në aktivitete kriminale të një grupi kriminal të organizuar, ndërsa e dyta ka të bëjë me pjesëmarrjen në aktivitete të tjera të grupit kriminal të organizuar. Elementi fizik/objektiv i shkeljes në paragrafin 1 është i akuzuari që merr pjesë aktive në aktivitetet kriminale të grupit kriminal të organizuar. Elementet mendore të shkeljes në paragrafin 1 janë:

(a) Synimi për të marrë pjesë aktive; dhe

(b) Dijenia për njërin nga sa vijon:

(i) Qëllimi dhe aktivitetet e përgjithshme kriminale të grupit kriminal të organizuar; ose

(ii) Synimi i grupit kriminal të organizuar për të kryer një ose më shumë shkelje të përfshira në këtë udhëzues.

Elementi fizik/objektiv i shkeljes në paragrafin 2 është i akuzuari që merr pjesë aktive në aktivitete të tjera të grupit kriminal të organizuar. Elementet mendore të shkeljes në paragrafin 2 janë:

(a) Synimi për të marrë pjesë aktive;

(b) Dijenia për njërin nga sa vijon:

(i) Qëllimi dhe aktivitetet e përgjithshme kriminale të grupit kriminal të organizuar; ose

(ii) Synimi i tij për të kryer krimet në fjalë; dhe

(c) Dijenia se veprimet ose mosveprimet e të akuzuarit do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit kriminal të përshkruar më sipër.

Aktivitetet “e tjera” për qëllimet e shkeljes në paragrafin 2 nuk duhet të jenë të kundërligjshme në mënyrë që të përmbushen elementet e figurës së shkeljes. Shtetet mund të dëshirojnë ta sqarojnë këtë fakt në legjislacionin e tyre. Informacione të mëtejshme për secilin model të penalizimit të pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar mund të gjenden te *Udhëzuesi Legjislativ për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, botuar nga UNODC*.

MODEL I DISPOZITËS 7: PJESËMARRJA NË NJË GRUP KRIMINAL TË ORGANIZUAR

1. Çdo person i cili me dashje [ose me dijeni] merr pjesë aktive në aktivitetet kriminale të një grupi kriminal të organizuar, duke ditur qoftë qëllimin dhe veprimtarinë e përgjithshme të grupit kriminal të organizuar, ose synimin e tij për të kryer krimet në fjalë, kryen një shkelje të ndëshkueshme me [shëno dënimin].
2. Çdo person i cili me dashje [ose me dijeni] merr pjesë aktive në aktivitete [të tjera] të një grupi kriminal të organizuar:
 - (a) duke ditur qoftë qëllimin dhe aktivitetet e përgjithshme të grupit kriminal të organizuar, ose synimin e tij për të kryer krimet në fjalë; dhe
 - (b) duke ditur se sjellja e tij ose e saj do të kontribuojë në arritjen e qëllimit të grupit kriminal të organizuar ose synimit të tij për të kryer krimet në fjalë,
 kryen një shkelje të ndëshkueshme me [shëno dënimin].

Pastrimi Parave

Stimujt ekonomikë janë ndër shtytësit më të mëdhenj të trafikimit të mbetjeve.¹⁰⁶ Paratë e fituara nga trafikimi i mbetjeve mund të pastrohen për të fshehur origjinën e tyre të paligjshme. Shtetet duhet të sigurojnë marrjen e masave për të penalizuar pastrimin e parave të përftuara nga trafikimi i mbetjeve. Neni 6 i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të adoptojnë masa për të cilësuar si veprë penale pastrimin e parave. Një dispozitë të ngjashme përmban neni 23 i Konventës kundër Korrupsionit.

Neni 6, paragrafi 1, i Konventës kundër Krimit të Organizuar përmban një sërë nënseksionesh që u kërkojnë Shteteve palë të krijojnë vepra penale në lidhje me aspekte të ndryshme të pastrimit të parave. I pari nga këta, neni 6, paragrafi 1 (a) (i), kërkon që Shtetet palë të cilësojnë si veprë penale konvertimin ose transferimin e pasurisë, kur kryhet në mënyrë të qëllimshme, duke ditur se kjo pasuri është produkt i krimit, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë ose për të ndihmuar çdo person që është i përfshirë në kryerjen e veprës penale mëmë për t’iu shmangur pasojave ligjore të veprimit të tij ose saj. Lidhja ndërmjet kësaj shkeljeje dhe formave të tjera të krimit të organizuar parashikohet në termin “vepra penale mëmë”.

Koncepti i veprës penale mëmë është thelbësor për penalizimin në shumë juridiksione. Neni 2, paragrafi (h), i Konventës kundër Krimit të Organizuar e përkufizon “veprën penale mëmë” si “çdo veprë penale si rezultat i së cilës janë krijuar produkte që mund të bëhen subjekt i një veprë penale, siç përkufizohet në nenin 6 të kësaj Konvente”. Neni 6, paragrafi 2 (a), kërkon që çdo Shtet palë të synojë të zbatojë shkeljet nga paragrafi 1 i nenit 6 në “shtrirjen më të gjerë të veprave penale mëmë”. Neni 6, paragrafi 2 (b), kërkon në mënyrë specifike që Shtetet palë të përfshijnë si vepra penale mëmë të gjitha krimet e rënda, siç përkufizohen në nenin 2 të Konventës, dhe shkeljet e parashikuara në mënyrë specifike në Konventë.

Shtetet kanë marrë qasje të ndryshme ndaj përkufizimit të termit “veprë penale mëmë”. Disa Shtete kanë përkufizuar “veprën penale mëmë” duke iu referuar një liste shteruese të shkeljeve që përfshihen në legjislacion. Shtetet e tjera kanë përkufizuar gjerësisht “veprën penale mëmë”, duke përfshirë të gjitha krimet, të gjitha krimet e rënda ose të gjitha krimet që janë subjekt i një dënimi maksimal me një prag të caktuar ose mbi të. Qasja e përcaktimit të të gjitha krimeve si vepra penale mëmë është qasja më e gjerë dhe ajo që i shërben më së miri qëllimit të nenit 6 të Konventës kundër Krimit të Organizuar dhe dispozitës ekuivalente të Konventës kundër Korrupsionit.¹⁰⁷ Për Shtetet që përdorin një listë të veprave penale mëmë, neni 6, paragrafi 2 (b), i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që lista të përfshijë, së paku, “një gamë të plotë të veprave penale që lidhen me grupet e organizuara kriminale”.

Sipas dispozitave të nenit 6 të Konventës kundër Krimit të Organizuar, Shtetet palë përfshijnë si vepra penale mëmë, për qëllimet e legjislacionit për pastrimin e parave, të gjitha shkeljet e trafikimit të mbetjeve që konsiderohen si krime të rënda.

Aty ku kjo nuk do të parashikohej automatikisht sipas legjislacionit ekzistues, Shtetet mund të vendosin të deklarojnë shprehimisht në legjislacionin e menaxhimit të mbetjeve ose që shkeljet e trafikimit të mbetjeve janë vepra penale mëmë të pastrimit të parave ose që shkeljet e trafikimit të mbetjeve të cilat përbëjnë krime të rënda janë vepra penale mëmë. Jo të gjitha shkeljet e parashikuara për trafikimin e mbetjeve janë mjaft të rënda për t’u konsideruar krime të rënda. Një shembull i dispozitës që përcakton shkeljet e rënda të trafikimit të mbetjeve si vepra penale mëmë për pastrimin e parave është dhënë në modelin e dispozitës 8 më poshtë.

¹⁰⁶ Rucevska dhe të tjerë, *Waste Crime–Waste Risks*, f. 41.

¹⁰⁷ UNODC, *Status of Implementation of the United Nations Convention against Corruption: Criminalization, Law Enforcement and International Cooperation*, 2nd ed. (Vjenë, 2017), f. 73.

MODEL I DISPOZITËS 8: PËRCAKTIMI I VEPRAVE PENALE MËMË PER PASTRIMIN E PARAVE

Shkeljet e përfshira në këtë [Akti/Ligji/Kapitulli etj.] [të ndëshkueshme me një dënim maksimal prej [shëno dënimin maksimal] ose më të lartë] do të konsiderohen vepra penale mëmë për pastrim të parave sipas [shëno referimin ndaj shkeljeve të pastrimit të parave].

Pavarësisht nga mënyra në të cilën Shtetet palë zgjedhin të identifikojnë veprat penale mëmë, nuk duhet të jetë e nevojshme që një person të jetë shpallur fajtor për një vepër penale mëmë kur provohet se pasuria është produkt i krimit. Udhëzimet gjithëpërfshirëse lidhur me legjislacionin për pastrimin e parave janë përtej fushëveprimit të këtij udhëzuesi, por publikimet e tjera të UNODC ofrojnë udhëzime të mëtejshme për këtë çështje. UNODC ka publikuar më parë dy grupe të modeleve të dispozitave për pastrimin e parave. Në vitin 2005, UNODC dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar botuan publikimin *Model i legjislacionit për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, për përdorim nga hartuesit e legjislacionit në juridiksionet e së drejtës civile*. Në vitin 2016, UNODC, Sekretariati i Komonuelthit dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar botuan publikimin *Modele të dispozitave të legjislacionit për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, masat parandaluese dhe produktet e krimit në sistemet e së drejtës zakonore*, për përdorim nga hartuesit e legjislacionit në juridiksionet e së drejtës zakonore. Të dy dokumentet përmbajnë modele të detajuara të dispozitave të legjislacionit për pastrimin e parave, konfiskimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me produktet e krimit.

Korrupsioni

Grupet kriminale të organizuara, duke përfshirë ato të përfshira në trafikimin e mbetjeve, përdorin shpesh korrupsionin gjatë veprimtarisë së tyre. Ryshfeti dhe aktet e tjera të korrupsionit përdoren për të krijuar ose shfrytëzuar mundësi për operacione kriminale dhe për të mbrojtur operacione të tilla nga ndërhyrjet e sistemeve të drejtësisë penale dhe strukturave të tjera të kontrollit. Korrupsioni redukton risqet, rrit fitimet kriminale dhe ka më pak gjasa të tërheqë të njëjtën vëmendje dhe ndëshkim si tentativat për të ndikuar nëpunësit publikë nëpërmjet frikësimit ose dhunës së vërtetë.

Korrupsioni është njëkohësisht edhe forcë lëvizëse edhe produkt i krimit të organizuar. Efektet e korrupsionit shtrihen shumë përtej lehtësimit të krimit të rëndë. Fakti që nëpunësit publikë komprometohen dhe veprojnë kundër interesit publik minon stabilitetin e sistemeve qeveritare në përgjithësi dhe besimin e publikut tek ata. Kur korrupsioni arrin nivelet e larta në qeveri, ai prek marrëdhëniet midis Shteteve dhe minon cilësinë e jetës së njerëzve, pasi pengon përparimin ekonomik dhe social të shoqërive.

Ndërsa pasojat politike dhe ekonomike të korrupsionit janë të shumta, ai ka efekte shtesë që lidhen me luftën kundër krimit të rëndë ndërkombëtar. Korrupsioni nxit kërkesën për tregje të kundërligjshme. Për më tepër, nëpunësit e korruptuar lehtësojnë përpjekjet e grupeve kriminale të organizuara për të penguar drejtësinë, për të frikësuar dëshmitarët dhe viktimat dhe për të penguar ndryshe proceset ndërkombëtare të bashkëpunimit që synohet të nxiten nga Konventa kundër Krimit të Organizuar, duke përfshirë refuzimin e mundshëm të ekstradimit të kriminelëve të rëndë ndërkombëtarë.

Konventa kundër Korrupsionit është i vetmi instrument universal ligjërish i detyrueshëm kundër korrupsionit. Qasja me shtrirje të gjerë e Konventës dhe karakteri i detyrueshëm i shumë prej dispozitave të saj e bëjnë atë një mjet unik për zhvillimin e një reagimi gjithëpërfshirës ndaj një problemi global. Konventa mbulon pesë fusha kryesore: masat për parandalimin, penalizimin dhe zbatimin e ligjit, bashkëpunimi ndërkombëtar, rikuperimi i aseteve dhe asistencë teknike dhe shkëmbimi i informacionit. Konventa trajton shumë forma të ndryshme të korrupsionit, si ryshfeti, përvetësimi i paligjshëm, trafiku i influencës, abuzimi i pushtetit dhe akte të ndryshme korrupsioni në sektorin privat. Konventa ka gjithashtu një kapitull specifik që ka të bëjë me rikuperimin e aseteve, një shqetësim i madh për vendet që ndjekin pasuritë e ish-udhëheqësve dhe nëpunësve të tjerë të akuzuar ose të dënuar për përfshirje në korrupsion.

Konventa kundër Krimit të Organizuar mbulon gjithashtu tre lloje të veprave penale të korrupsionit në sektorin publik: ryshfeti aktiv (dhënia e ryshfetit), ryshfeti pasiv (marrja e ryshfetit) dhe pjesëmarrja si bashkë-fajtor në ryshfet. Përveç këtyre veprave të detyrueshme, Shteteve u kërkohet të marrin parasysh penalizimin e formave të tjera të korrupsionit, duke përfshirë ryshfetin e zyrtarëve të huaj. Konventa kundër Krimit të Organizuar kërkon gjithashtu futjen e masave legjislative dhe masave të tjera të projektuara për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar praktikat korruptive dhe për të rritur llogaridhënien.

Korrupsioni dëmton zbatimin dhe ekzekutimin e rregullt të kornizave për menaxhimin e mbetjeve. Në lidhje me menaxhimin e shëndoshë mjedisor të mbetjeve, korrupsioni mund të ndodhë në dhënien e lejeve dhe licencave, të tilla si licencimi i instalimeve të asgjësimit ose autorizimi i personave për të transportuar mbetje të rrezikshme. Në lidhje me lëvizjet ndërkuftare të mbetjeve, korrupsioni mund të ndodhë në të gjitha fazat, duke përfshirë situatat e mëposhtme:

- Kur Shteti i eksportit autorizon nisjen e procedurës së pëlqimit të informuar paraprak (e njohur zakonisht si procedura PIC, shkurt nga gjuha angleze *prior informed consent*)
- Kur Shteti i eksportit autorizon kryerjen e eksportit
- Kur Shteti i importit jep pëlqimin për dërgesën
- Në çdo kontroll kufitar¹⁰⁸

Korrupsioni mund të përfshijë palë të interesuara të ndryshme, duke përfshirë politikanët, autoritetet mjedisore ose kompetente, autoritetet portuale, punonjësit e policisë, doganierët, pronarët e tokave, tregtarët dhe brokerët, kompanitë e transportit detar, importuesit dhe eksportuesit.¹⁰⁹ Marrja e një përfitimi financiar ose përfitimi tjetër material, qoftë nëpërmjet uljes së kostove ose rritjes së të ardhurave, është një shtytës kyç i korrupsionit.

Parandalimi dhe luftimi i trafikimit të mbetjeve kërkon legjislacion për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive korrupsionin. Në këtë drejtim, Shtetet duhet të rishikojnë detyrimet e tyre sipas Konventës kundër Korrupsionit, Konventës kundër Krimit të Organizuar dhe publikimet e UNODC-së në lidhje me zbatimin e tyre.¹¹⁰

Pengimi i drejtësisë

Trafikimi i mbetjeve mund të jetë një burim i të ardhurave për grupet kriminale të organizuara. Për të ruajtur dhe zgjeruar operacionet e tyre kriminale, grupet kriminale të organizuara tentojnë të shtrembërojnë rrjedhën e drejtësisë duke përdorur kërcënime, shtrëngime dhe dhunë ndaj gjyqtarëve, prokurorëve, punonjësve ligj-zbatues dhe nëpunësve të tjerë, anëtarëve të jurisë dhe dëshmitarëve. Për të trajtuar në mënyrë efektive trafikimin e mbetjeve, Shtetet kanë nevojë për dispozita adekuate që penalizojnë pengimin e drejtësisë.

Shkelja e përfshirë në modelin e dispozitës 9 më poshtë cilëson si vepër penale tentativat për të penguar drejtësinë. Modeli i dispozitës 9 bazohet në kërkesat e nenit 23 të Konventës kundër Krimit të Organizuar për penalizimin e pengimit të drejtësisë.

Shtetet duhet të vlerësojnë nevojën për të përfshirë në legjislacionin e tyre të trafikimit të mbetjeve një dispozitë specifike që penalizon pengimin e drejtësisë duke iu referuar shkeljeve ekzistuese të pengimit të drejtësisë. Nëse tentativat për të penguar drejtësinë në lidhje me inspektorët, hetuesit, punonjësit ligj-zbatues dhe nëpunësit e tjerë të ngjashëm mbulojnë nga shkeljet ekzistuese është e një rëndësie të veçantë në këtë drejtim. Disa Shtete tashmë kanë dispozita gjithëpërfshirëse që parashikojnë mbrojtjen e këtyre nëpunësve dhe mbulojnë sjelljen e penalizuar sipas modelit të dispozitës 9. Shtetet që kanë zgjedhur në vend të kësaj të përfshijnë dispozita të specializuara për pengimin e drejtësisë në ligje të veçanta, mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë përfshirjen në legjislacionin e tyre për menaxhimin e mbetjeve një shkelje si

¹⁰⁸ Tatiana Terekhova, “Transboundary movements of hazardous wastes and corruption: the special case of e-waste in West Africa”, në UNODC, *Corruption, Environment and the United Nations Convention against Corruption* (2012), f. 14.

¹⁰⁹ Po aty.

¹¹⁰ Shih UNODC, *Legislative Guide for the Implementation of the United Nations Convention against Corruption*, 2nd rev. ed. (2012); UNODC, *Legislative Guide for the Implementation of the United Nations Convention against Transnational Organized Crime*, 2nd ed. (2017); dhe UNODC, *Status of Implementation of the United Nations Convention against Corruption*. Shih gjithashtu Terekhova, “Transboundary movements of hazardous wastes and Corruption”.

ajo që përmbahet në modelin e dispozitës 9. Në juridiksionet ku kompetencat e ekzekutimit ushtrohen nga autoritete kompetente të ndryshme nga policia, Shtetet duhet të sigurojnë që dispozitat e specializuara për pengimin e drejtësisë mbulojnë të gjithë nëpunësit përgjegjës për verifikimin e pajtueshmërisë dhe për veprimet e inspektimit dhe ekzekutimit në lidhje me dispozitat e menaxhimit të mbetjeve.

MODEL I DISPOZITËS 9: PENGIMI I DREJTËSISË

1. Çdo person i cili në lidhje me kryerjen e shkeljeve sipas këtij [Akti/Kapitulli/Ligji...] përdor forcën, kërcënimet ose frikësimin, apo premtën, ofron ose jep ndonjë avantazh të parregullt me qëllimin:

- (a) Për të nxitur dëshminë e rreme;
 - (b) Për të ndërhyrë në dhënien e dëshmisë ose në dorëzimin e provave;
- kryen një shkelje të ndëshkueshme me [shëno dënimin].

2. Çdo person i cili në lidhje me kryerjen e shkeljeve sipas këtij [Akti/Kapitulli/Ligji...] përdor forcën, kërcënimet ose frikësimin për të ndërhyrë në ushtrimin e detyrave të nëpunësve të zbatimit të ligjit, prokurorisë ose gjyqësorit, kryen një shkelje të dënueshme me [shëno dënimin].

SHEMBULL: ITALIA

Kodi Penal

Neni 452-septies – Parandalimi i kontrollit

Përveç rastit kur fakti përbën një shkelje më të rëndë, kushdo që parandalon, pengon ose anashkalon aktivitetet e vëzhgimit dhe kontrollit të mjedisit, si dhe praktikatat e sigurisë dhe higjienës në punë ose komprometon rezultatin e tyre duke mohuar hyrjen në vende, duke vendosur pengesa ose duke ndryshuar artificialisht gjendjen e tyre, ndëshkohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

PËRGJEGJËSIA DYTËSORE

Përveç shkelësve parësorë, ka një sërë aktorësh të përfshirë në trafikimin e mbetjeve, të cilët organizojnë, drejtojnë, japin ndihmë, nxisin, lehtësojnë ose japin këshilla për kryerjen e trafikimit të mbetjeve. Legjislacioni për luftimin e trafikimit të mbetjeve duhet të penalizojë veprimet e këtyre shkelësve. Termi “përgjegjësi dytësorë” i referohet situatave kur vërtetimi i përgjegjësisë kërkon të paktën prova prima facie për keqbërësi nga një palë e tretë.¹¹¹ Ajo duhet të dallohet nga përgjegjësia parësore, e cila mund të bazohet tërësisht në veprimet ose mosveprimet e një shkelësi të vetëm parësor.

Përgjegjësia dytësore në përgjithësi kërkon një shkallë më të lartë faji sesa ajo që kërkohet për shkeljen parësore. Kjo për shkak se, “ndërsa forma e përgjegjësisë penale largohet më shumë nga shkaktimi i vërtetë i dëmit, bazat e përgjegjësisë duhet të ngushtohen”.¹¹² Së këndejmi, dhënia e ndihmës, nxitja, dhënia e këshillave, prokurimi ose lehtësimi i kryerjes së një shkeljeje kërkon prova të dashjes — që personi kishte për qëllim aktin e ndihmës ose inkurajimit dhe e dinte se shkelësi kryesor kishte për qëllim ose kishte menduar të kryente veprime që përbëjnë shkeljen.¹¹³

¹¹¹ Shih gjithashtu Jaani Riordan, “A theoretical taxonomy of intermediary liability”, në The Oxford Handbook of Online Intermediary Liability, Giancarlo Frosio, ed. (Oxford, Oxford University Press, 2020), ff. 63–65.

¹¹² Andrew Ashworth dhe Jeremy Horder, Principles of Criminal Law, 7th ed. (Oxford, Oxford University Press, 2013), f. 432.

¹¹³ A.P. Simester dhe të tjerë, Simester and Sullivan’s Criminal Law: Theory and Doctrine, 6th ed. (London, Hart Publishing, 2016), ff. 228–229, 240; dhe Ashworth and Horder, Principles of Criminal Law, ff. 431–432.

Në shumë juridiksione, përgjegjësia dytësore përcaktohet për të gjitha veprat penale me dispozitat e ligjit të përgjithshëm penal. Në juridiksione të tilla, dispozitat specifike mbi përgjegjësinë dytësore në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve mund të mos jenë të nevojshme. Kur ky nuk është rasti, legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve duhet të përcaktojë shprehimisht përgjegjësinë dytësore.

Modeli i dispozitës 10 më poshtë përmban një shkëlqje që shtrin përgjegjësinë për përfshirjen në trafikimin e mbetjeve të shkelësit dytësorë. Këto dispozita bazohen në nenin 5, paragrafin 1 (b), të Konventës kundër Krimit të Organizuar, e cila kërkon që Shtetet palë të cilësojnë si vepra penale organizimin, drejtimin, dhënien e ndihmës, nxitjen, lehtësimin ose dhënien e këshillave për kryerjen e një krimi të rëndë që përfshin një grup kriminal të organizuar.

PËRMBLEDHJE E KËRKESAVE KRYESORE PËR PENALIZIM SIPAS NENIT 5, PARAGRAFI 1 (B), TË KONVENTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Neni 5, paragrafi 1 (b) i Konventës shtrin përgjegjësinë penale për personat që japin këshilla ose ndihmë në lidhje me kryerjen e krimeve të rënda që përfshijnë një grup kriminal të organizuar. Dispozita në mënyrë specifike i referohet personave që qëllimisht përfshihen në “organizimin, dhënien e ndihmës, nxitjen, lehtësimin ose dhënien e këshillave për kryerjen e një krimi të rëndë që përfshin një grup kriminal të organizuar. Paragrafi 1 (b) mundëson kështu ndjekjen penale të drejtuesve, bashkëpunëtorëve, organizatorëve dhe sekserëve, si dhe pjesëmarrësve të nivelit më të ulët, në kryerjen e krimeve të rënda.

“Dhënia e ndihmës, nxitja, lehtësimi ose dhënia e këshillave” mbulon palët dytësore dhe bashkëpunëtorët që nuk janë vetë shkelësit kryesorë.

“Organizimi” dhe “drejtimi”, nga ana tjetër, janë shtrirje që nuk gjenden (ose nuk përkufizohen) zakonisht në ligjet kombëtare. Për këtë qëllim, paragrafi 1 (b) është menduar të sigurojë përgjegjësinë e drejtuesve të grupeve kriminale të organizuara, të cilët japin urdhra në lidhje me kryerjen e krimeve, por nuk angazhohen vetë në kryerjen e krimeve në të vërtetë.

Modeli i dispozitës 10 përcakton përgjegjësinë dytësore për organizimin, drejtimin, dhënien e ndihmës, nxitjen, lehtësimin, dhënien e këshillave ose prokurimin e kryerjes së shkeljeve të trafikimit të mbetjeve. Kjo dispozitë mundëson ndjekjen penale të drejtuesve, organizatorëve dhe bashkëpunëtorëve, si dhe personave të përfshirë në trafikimin e mbetjeve në nivele më të ulëta. Shtetet mund të zgjedhin të përcaktojnë dënime më të larta për organizimin ose drejtimin sesa për dhënien e ndihmës, nxitjen, lehtësimin ose dhënien e këshillave për shkak të natyrës së nivelit më të lartë të këtyre veprimeve. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme që dënimet për organizatorët dhe drejtuesit të jenë më të larta sesa ato që u shqiptohen shkelësve kryesorë.

MODEL I DISPOZITËS 10: ORGANIZIMI, DREJTIMI, DHËNIA E NDIHMËS, ETJ., NË KRYERJEN E SHKELJES

1. Çdo person i cili me dashje organizon ose drejton kryerjen e shkeljes për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...], kryen një shkelje të ndëshkueshme me [shëno dënimin e përshtatshëm për marrjen e një roli drejtues në shkeljen e tillë].
2. Çdo person i cili me dashje jep ndihmë, nxit, lehtëson, jep këshilla ose prokuron kryerjen e shkeljes për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...], kryen një shkelje të ndëshkueshme me [shëno dënimin e përshtatshëm për marrjen e një roli mbështetës në shkeljen e tillë].

PËRGJEGJËSIA PËR TENTATIVËN

Shtetet duhet gjithashtu të sigurojnë që përgjegjësia për tentativën për shkeljet e shqyrtuara në këtë udhëzues të përcaktohet sipas ligjit të brendshëm. Ligji i përgjithshëm penal i shumë Shteteve parashikon përgjegjësinë për tentativën automatikisht. Kur ky nuk është rasti, Shtetet duhet të krijojnë dispozita specifike në legjislationin e mbetjeve për ta arritur këtë qëllim. Përveç përgjegjësisë për tentativën penale, Shtetet duhet të rishikojnë gjithashtu masën në të cilën ligji ekzistues parashikon përgjegjësinë për tentativën e shkeljeve administrative.

PËRGJEGJËSIA E PERSONAVE JURIDIKË

Termi “persona juridikë” u referohet organizatave që, për qëllimet e ligjeve të një juridiksioni të caktuar, konsiderohen si “persona” dhe që gëzojnë disa — por jo medoemos të gjitha — të drejtat dhe detyrimet e një personi fizik në atë juridiksion. Korporatat janë shembull klasik i një organizate me personalitet juridik, por personat juridikë mund të përfshijnë gjithashtu një sërë subjektesh të tjera, në varësi nga ligji i një Shteti të caktuar.

Personat juridikë luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe lehtësimin e trafikimit të mbetjeve. Trafikimi i mbetjeve dallohet nga format e tjera të krimit të organizuar, si trafikimi i drogave dhe kalimi kontrabandë i migrantëve, për shkak të lidhjeve të ngushta me industrinë e ligjshme, gjegjësisht industrinë e ligjshme të menaxhimit të mbetjeve.¹¹⁴ Me fjalë të tjera, shumë nga autorët e trafikimit të mbetjeve janë korporata që operojnë në industrinë e ligjshme të menaxhimit të mbetjeve. Ky lloj i shkeljes ndonjëherë nuk përfshihet në përshkrimet e përfshirjes së personave juridikë në krimin e organizuar, të cilat zakonisht përqendrohen në përdorimin e personave juridikë nga grupet kriminale të organizuara si një vello për të fshehur shkeljen e tyre. Përshkrimet e tilla flasin për ekzistencën e një grupi kriminal të organizuar që është i ndarë nga personi juridik dhe i paraprin personit juridik dhe i konceptojnë anëtarët e grupit kriminal të organizuar si autorë të shkeljeve, ku personi juridik shihet si një vello ose mburojë e thjeshtë — një mjet për të arritur qëllimet e grupit, pa zotësi vetjake për të vepruar. Ndonëse kjo është padyshim e vërtetë për disa persona juridikë të përfshirë në trafikimin e mbetjeve, ajo nuk përfaqëson saktë realitetin e përfshirjes së të gjithë personave juridikë. Në realitet, shumë korporata që kryejnë trafikim të mbetjeve nuk janë krijuar nga grupe kriminale të organizuara për të kryer veprime të kundërligjshme. Përkundrazi, ato janë krijuar për të marrë pjesë në industrinë e ligjshme të menaxhimit të mbetjeve dhe më pas marrin vendime — me ose pa dijeni — për të vepruar ndesh me detyrimet e tyre ligjore, në mënyrë që të reduktojnë kostot dhe të ndjekin fitime më të mëdha. Në këto raste, korporatat shihen më saktë si autorë të drejtpërdrejtë të trafikimit të mbetjeve, jo thjesht si mjete që përdoren në kryerjen e trafikimit të mbetjeve nga persona fizikë ose grupe kriminale të organizuara.

ROLI I NDËRMJETËSVE ONLINE NË ADRESIMIN E TRAFIKIMIT TË MBETJEVE

Në disa raste, trafikimi i mbetjeve kryhet ose lehtësohet nëpërmjet përdorimit të shërbimeve të personave juridikë që veprojnë si ndërmjetës online. Për një shqyrtim të çështjeve të politikave në lidhje me parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm online, shih publikimin e UNODC-së *Politikëbërja dhe roli i ndërmjetësve online në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm*.

Luftimi efektiv i trafikimit të mbetjeve kërkon që personat juridikë të mbajnë përgjegjësi kur kryejnë vepra penale. Neni 10, paragrafi 1, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të adoptojnë

¹¹⁴ Lieselot Bisschop, “Illegal trade in hazardous waste”, në *Handbook of Transnational Environmental Crime*, Lorraine Elliott and William H Schaedla, eds, (Cheltenham, United Kingdom, Edward Elgar, 2016), f. 196.

masat e nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë për pjesëmarrje në krime të rënda që përfshijnë një grup kriminal të organizuar dhe për shkeljet e përcaktuara në përputhje me Konventën.¹¹⁵

Konventa kundër Krimit të Organizuar ia lë çdo Shteti për të vendosur natyrën e përgjegjësisë së personave juridikë. Neni 10, paragrafi 2, i Konventës parashikon se përgjegjësia e personave juridikë mund të jetë penale, civile ose administrative. Disa Shtete gjithashtu mund të zgjedhin të përdorin dy, ose në të vërtetë, të gjitha këto forma të përgjegjësisë për personat juridikë brenda sistemit të tyre ligjor.

Përgjegjësia penale është forma më e rëndë e përgjegjësisë që një Shtet mund të vendosë ndaj personave juridikë. Kjo në përgjithësi lidhet me gjyqime në gjykatat penale, nivele të larta të sanksioneve të mundshme dhe mbrojtje relativisht më të mëdha procedurale për të pandehurit. Përgjegjësia penale e një personi juridik ka potencialin t'i shkaktojë dëm të kushtueshëm reputacionit të subjektit dhe gjithashtu mund të pengojë personat juridikë nga përfshirja në veprime të paligjshme.¹¹⁶

Përgjegjësia civile dhe administrative janë alternativa ndaj përgjegjësisë penale për personat juridikë. Kuptimet e këtyre termave janë teorikisht të dallueshme, por përdorimi i tyre mund të ndryshojë sipas sistemeve të ndryshme ligjore dhe termat ndonjëherë mund të përdoren edhe në mënyrë të ndërsjellë. Për qëllimet e këtij udhëzuesi, përgjegjësia civile u referohet masave ndëshkuese të shqiptuara në procedurë civile nga gjykatat ose organet e ngjashme. Përgjegjësia administrative në përgjithësi lidhet me përgjegjësinë që vendoset nga një organ rregullator, por në disa sisteme ligjore, organet gjyqësore mund të shqiptojnë edhe masa administrative me karakter ndëshkues. Ashtu si përgjegjësia civile, përgjegjësia administrative nuk rezulton me dënim penal. Përgjegjësia civile dhe administrative lidhen përgjithësisht me standarde më të ulëta të provës sesa përgjegjësia penale.

Aty ku përgjegjësia penale, civile ose administrative për personat juridikë të përfshirë në trafikimin e mbetjeve nuk parashikohet tashmë në legjislacionin e brendshëm, Shtetet duhet të përfshijnë dispozita specifike që e përcaktojnë këtë përgjegjësi. Zgjedhja nëse do të përcaktohet përgjegjësia penale, civile apo administrative duhet të bëhet nga secili Shtet, duke marrë parasysh traditën ligjore dhe nëse sistemi ligjor njeh zotësinë e personave juridikë për të kryer vepra penale. Cilado formë e përgjegjësisë të përcaktohet, Shtetet duhet të sigurojnë që gjykatat ose organet rregullatore mund të shqiptojnë sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese — në të vërtetë, kjo është një kërkesë e Konventës kundër Krimit të Organizuar.¹¹⁷ Sanksionet përkatëse për personat juridikë diskutohen në kapitullin 6, më poshtë.

Modeli i dispozitës 11 ofron një shembull bazë të një dispozite që përcakton përgjegjësinë penale për personat juridikë në lidhje me shkeljet e trafikimit të mbetjeve të mbuluara nga ky udhëzues. Paragrafi 1 parashikon që personat juridikë mund të jenë penalisht përgjegjës për shkeljet për të cilat zbatohet ky udhëzues (gjegjësisht, trafikimin e mbetjeve dhe shkeljet përkatëse). Paragrafi 3 (a) ofron një model të përkufizimit të personave juridikë për qëllimet e udhëzuesit. Lista e personave juridikë në paragrafin 3 (a) nuk është shteruese. Format e personalitetit juridik dhe statusi i tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis juridiksioneve dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e kujdesshme gamës së personave që mund të jenë subjekt i përgjegjësisë. Ndër çështjet që duhet të shqyrtohen nga hartuesit në këtë drejtim është masa në të cilën dispozitat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e personave juridikë duhet të mbulojnë organet publike, apo nëse nuk duhet fare.¹¹⁸ Organet publike mund të përfshijnë agjencitë qeveritare, korporatat shtetërore dhe autoritetet vendore.

Një pjesë e rëndësishme e vendosjes së përgjegjësisë penale të personave juridikë është të përcaktohet se vepimet e kujt mund t'i atribuohen personit juridik — me fjalë të tjera, për sjelljen e kujt mund të mbahet përgjegjës personi juridik. Siç shpjegohet më poshtë, paragrafi 4 i modelit të dispozitës 11 parashikon që një person juridik mund të jetë përgjegjës për sjelljen e një nëpunësi të lartë të atij personi juridik ose, sipas dëshirës, për sjelljen e personave nën mbikëqyrjen ose menaxhimin e një nëpunësi të lartë. Paragrafi 3 (b) e përkufizon “nëpunësin e lartë” si “një punonjës, agjent ose nëpunës i personit juridik me detyra të një përgjegjësie të tillë që sjellja e tij ose e saj mund të supozohet në mënyrë të drejtë se përfaqëson politikën e personit

¹¹⁵ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 10, para. 3. Për udhëzime për prokurorët mbi zgjedhjen e personave fizikë dhe/ose juridikë si të pandehur në procedimet për trafikimin e mbetjeve, shih WasteForce, *Guidance for Prosecutors of Waste Crime* (2020), ff. 32–36.

¹¹⁶ UNODC, *Udhëzuesi Legjislativ*.

¹¹⁷ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 10, para. 4.

¹¹⁸ UNODC, *Udhëzuesi Legjislativ*.

juridik”. Është e rëndësishme që hartuesit e legjislacionit të sigurojnë që dispozitat në lidhje me atribimin e sjelljes së personave të caktuar te një person juridik të përqendrohen në rolin e vërtetë të personit në organizatë dhe të mos kufizohen te personat që mbajnë tituj ose pozita të caktuara.

Paragrafi 4 përcakton rrethanat në të cilat një person juridik bëhet përgjegjës për shkeljet që lidhen me nëpunësit e lartë të atij personi juridik. Kjo pasqyron të ashtuquajturën doktrinë të atribimit ose identifikimit të përgjegjësisë së personave juridikë që mund të gjendet në një sërë juridiksionesh. Ai thekson tri mënyra të ndryshme si personi juridik mund të jetë përgjegjës për sjelljen e nëpunësve të lartë (ose, sipas dëshirës, personave nën mbikëqyrjen ose menaxhimin e një nëpunësi të lartë). Së pari, personi juridik mund të jetë përgjegjës kur nëpunësit e lartë (ose një person nën mbikëqyrjen ose menaxhimin e tyre) kryen një shkelje (nën-paragrafi (a)). Përveç kësaj, hartuesve të legjislacionit u ofrohen opsione për të shtrirë përgjegjësinë për rrethanat në të cilat persona të tillë autorizojnë ose lejojnë kryerjen e shkeljes (nën-paragrafi (b)) ose nuk marrin hapa të arsyeshëm për të parandaluar kryerjen e shkeljes (nën-paragrafi (c)). Ndërsa nën-paragrafët (a) dhe (b) kërkojnë disa hapa aktivë nga ana e nëpunësit të lartë, nën-paragrafi (c) përcakton përgjegjësinë kur nuk ka pasur mbikëqyrje. Paragrafi 5 sqaron se hapat e arsyeshëm për të parandaluar kryerjen e shkeljes përfshijnë adoptimin dhe zbatimin efektiv të një modeli të përshtatshëm organizativ dhe të menaxhimit. Gjendja mendore, nëse ka, e nevojshme për atribimin e sjelljes së nëpunësit të lartë te personi juridik në nën-paragrafët (b) dhe (c) lihet e hapur me përfshirjen e formulimit “me gjendjen e nevojshme mendore” në kllapa katrore. Vërtetimi i mens rea në çështjet e përgjegjësisë së personave juridikë diskutohet më tej, te “Sfidat për përcaktimin e përgjegjësisë së personave juridikë”.

Paragrafi 2 i modelit të dispozitës 11, që pasqyron nenin 10, paragrafin 3, të Konventës kundër Krimit të Organizuar, parashikon që Shtetet palë janë të detyruara të sigurojnë që përgjegjësia e personave juridikë nuk paragjykon përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer shkeljet.

MODEL I DISPOZITËS 11: PËRGJEGJËSIA E PERSONAVE JURIDIKË

1. Personat juridikë [përveç Shtetit] mund të jenë penalisht përgjegjës për shkeljet për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...].
2. Përgjegjësia e një personi juridik sipas këtij [neni/seksioni] nuk përjashton përgjegjësinë penale të asnjë personi fizik për të njëjtin veprim ose mosveprim.
3. Në këtë [Akti/Ligji/Kapitulli ...]:
 - (a) “Personat juridikë” përfshijnë [organet e korporatës, shoqërinë tregtare, firmën, shoqatat, shoqërinë, ortakëritë, pushtetin vendor, sindikatat, bashkitë dhe organet publike].
 - (b) “Nëpunës i lartë” nënkupton një punonjës, agjent ose nëpunës të personit juridik me detyra të një përgjegjësie të tillë që sjellja e tij ose e saj mund të supozohet në mënyrë të drejtë se përfaqëson politikën e personit juridik [, duke përfshirë personat që ushtrojnë de facto detyra të menaxhimit ose kontrollit].
4. Një person juridik është përgjegjës për një shkelje kur një nëpunës i lartë i personit juridik [, ose personat nën mbikëqyrjen ose menaxhimin e nëpunësit të lartë,] që veprojnë në emër ose në dobi të personit juridik:
 - (a) kryen shkeljen;
 - (b) [[me gjendjen e nevojshme mendore] autorizon ose lejon kryerjen e shkeljes;] ose
 - (c) [[me gjendjen e nevojshme mendore] nuk merr hapa të arsyeshëm për të parandaluar kryerjen e shkeljes].
5. Për qëllimin e paragrafit 4 (c), hapat e arsyeshëm përfshijnë adoptimin dhe zbatimin efektiv të një modeli të përshtatshëm organizativ dhe të menaxhimit.

SHEMBULL: SINGAPORI**Akti për krimin e organizuar 2015****Seksioni 76 – Shkeljet nga organet e korporatave, etj.**

(1) Kur një shkelje sipas këtij Akti e kryer nga një organ i korporatës provohet që—

- (a) është kryer me pëlqimin ose pajtimin e fshehtë të një nëpunësi të organit të korporatës; ose
- (b) i atribuohet pakujdesisë nga ana e tij ose saj,

nëpunësi si dhe organi i korporatës janë fajtorë për shkeljen dhe procedohen dhe ndëshkohen në përputhje me rrethanat.

(2) Kur punët e një organi të korporatës menaxhohen nga anëtarët e saj, nën-seksioni (1) zbatohet në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e një anëtari në lidhje me funksionet e tij ose të saj të menaxhimit sikur ai ose ajo të ishte drejtor i organit të korporatës.

(3) Kur një shkelje sipas këtij Akti e kryer nga një shoqatë e painkorporuar (përveç ortakërisë) provohet që—

- (a) është kryer me pëlqimin ose pajtimin e fshehtë të një ortaku; ose
- (b) i atribuohet pakujdesisë nga ana e tij ose saj,

ortaku si dhe ortakëria janë fajtorë për shkeljen dhe procedohen dhe ndëshkohen në përputhje me rrethanat.

(4) Kur një shkelje sipas këtij Akti e kryer nga një shoqatë e painkorporuar (përveç ortakërisë) provohet që —

- (a) është kryer me pëlqimin ose pajtimin e fshehtë të një nëpunësi të shoqatës së painkorporuar ose një anëtari të organit të saj drejtues; ose
- (b) i atribuohet pakujdesisë nga ana e këtij nëpunësi ose anëtari,

nëpunësi ose anëtari, si dhe shoqata e painkorporuar janë fajtorë për shkeljen dhe procedohen dhe ndëshkohen në përputhje me rrethanat.

(5) Në këtë seksion —

“organi i korporatës” përfshin një ortakëri me përgjegjësi të kufizuar që ka të njëjtin kuptim si në seksionin 2(1) të Aktit për Ortakëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (Kap. 163A);

“nëpunës” —

në lidhje me një organ të korporatës, nënkupton çdo drejtor, ortak, anëtar të komitetit të menaxhimit, shef ekzekutiv, menaxher, sekretar ose nëpunës tjetër të ngjashëm të organit të korporatës dhe përfshin çdo person që pretendon se vepron në cilësinë e tillë; ose

në lidhje me një shoqatë të painkorporuar (përveç ortakërisë), nënkupton presidentin, sekretarin ose çdo anëtar të komitetit të shoqatës së painkorporuar, ose çdo person që mban një pozitë të ngjashme me atë të presidentit, sekretarit ose anëtarit të një komiteti të tillë. dhe përfshin çdo person që pretendon se vepron në cilësinë e tillë;

“ortak” përfshin një person që pretendon se vepron si ortak.

(6) Ministri mund të nxjerrë rregullore për të parashikuar zbatimin e çdo dispozite të këtij seksioni, me modifikime të tilla që Ministri i konsideron të përshtatshme, për një organ të korporatës ose një shoqatë të painkorporuar të formuar ose të njohur sipas ligjit të një territori jashtë Singaporit.

SHEMBULL: ITALIA

Rregullore për përgjegjësinë administrative të personave juridikë, shoqërive tregtare dhe shoqatave, duke përfshirë edhe ata pa personalitet juridik (Dekreti Legjislativ 231/2001 i datës 8 qershor 2001)

Neni 5 – Përgjegjësia e agjencisë

1. Njësia ekonomike është përgjegjëse për krimet e kryera në interes të saj ose në dobi të saj:
 - (a) nga persona që kanë funksione të përfaqësimit, administrimit ose menaxhimit të njësisë ekonomike ose njëres prej njësive organizative të saj me autonomi financiare dhe funksionale, si dhe nga persona që ushtrojnë, qoftë edhe de facto, menaxhimin dhe kontrollin e tyre
 - (b) nga persona që janë subjekt i menaxhimit ose mbikëqyrjes nga njëri prej personave të përmendur në gurmën a).
2. Njësia ekonomike nuk është përgjegjëse nëse personat e treguar në paragrafin 1 kanë vepruar në interesin e vet ekskluziv ose atë të palëve të treta.

SHEMBULL – MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË TË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE**Akti për ryshfetin, 2010****Seksioni 7 – Mosparandalimi i ryshfetit nga organizatat tregtare**

- (1) Një organizatë tregtare përkatëse (“C”) është fajtorë për një shkelje sipas këtij seksioni nëse një person (“A”) i lidhur me C i jep ryshfet një personi tjetër me qëllimin—
 - (a) për të marrë ose ruajtur biznesin për C, ose
 - (b) për të marrë ose ruajtur një avantazh në kryerjen e biznesit për C.
- (2) Por një mbrojtje për C është të provuarit se C kishte në vend procedurat adekuate të projektuara për të parandaluar personat e lidhur me C nga ndërmarrja e veprimeve të tilla.
- (3) Për qëllimet e këtij seksioni, A i jep ryshfet një personi tjetër nëse, dhe vetëm nëse, A—
 - (a) është, ose do të ishte, fajtor për një shkelje sipas seksionit 1 ose 6 (pa marrë parasysh nëse A është ndjekur penalisht apo jo për një shkelje të tillë), ose
 - (b) do të ishte fajtor për një shkelje të tillë nëse seksioni 12(2)(c) dhe (4) nuk do të merreshin parasysh.
- (4) Shih seksionin 8 për kuptimin e një personi të lidhur me C dhe shih seksionin 9 për detyrën e Sekretarit të Shtetit për të publikuar udhëzime.

[...]

SHEMBULL: TUVALU

Akti kundër Terrorizmit dhe Krimit të Organizuar Ndërkombëtar 2009

Seksioni 85 – Përgjegjësia e një shoqërie tregtare

- (1) Ky Akt zbatohet për një shoqëri tregtare në të njëjtën mënyrë siç zbatohet për një individ dhe një shoqëri tregtare mund të shpallet fajtores për shkeljet e përcaktuara në këtë Akt, përveç përgjegjësisë së personave për të njëjtën shkelje.
- (2) Për një shkelje sipas këtij Akti, sjellja ose gjendja mendore e një punonjësi, agjenti ose nëpunësi të një shoqërie tregtare konsiderohet se i atribuohet shoqërisë tregtare nëse ai person vepron:
 - (a) brenda fushëveprimit të punësimit të personit; ose
 - (b) brenda fushëveprimit të autoritetit të vërtetë ose të dukshëm të personit; ose
 - (c) me pëlqimin ose pajtimin (të shprehur ose të nënkuptuar) të një drejtori, nëpunësi ose agjenti të shoqërisë tregtare, dhe dhënia e atij pëlqimi është brenda autoritetit të vërtetë ose të dukshëm të drejtorit, nëpunësit ose agjentit.
- (3) Një referim ndaj këtij seksioni për gjendjen mendore të një personi përfshin dijeninë, dashjen, opinionin, bindjen ose qëllimin e personit dhe arsyet e personit për atë dashje, opinion, bindje ose qëllim.

SHEMBULL: RUMANIA

Ligji nr. 286/2009 për Kodin Penal

Neni 135 – Kushtet për përgjegjësinë penale të personave juridikë

- (1) Personat juridikë, përveç organeve shtetërore dhe publike, janë penalisht përgjegjës për shkeljet e kryera gjatë zhvillimit të veprimtarisë së personave juridikë apo në emër të tyre ose në dobi të tyre.
- (2) Institucionet publike nuk përgjigjen penalisht për shkeljet e kryera gjatë zhvillimit të veprimtarive që nuk mund të jenë objekt i domenit privat.
- (3) Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk e përjashton përgjegjësinë penale të individit që merr pjesë në kryerjen e të njëjtit akt.

SHEMBULL: KINA

Ligji penal i Republikës Popullore të Kinës, 1979

Neni 30

Një shoqëri tregtare, sipërmarrje, institucion, organizatë ose grup që kryen një akt që rrezikon shoqërinë i cili konsiderohet krim sipas ligjit, mban përgjegjësi penale.

Rëndësia e kujdesit të duhur

Në kontekstin e përgjegjësisë së personave juridikë, kujdesi i duhur u referohet hapave të ndërmarrë nga një person juridik për të siguruar pajtueshmërinë me një ligj të caktuar. Kur prezantojnë ose ndryshojnë dispozitat për përgjegjësinë e personave juridikë, Shtetet duhet të marrin në konsideratë se si ligji duhet të trajtojë një situatë në të cilën një person juridik ka ushtruar kujdesin e duhur për të siguruar pajtueshmërinë me ligjin, por megjithatë ka kryer një shkelje. Ka mënyra të ndryshme se si kujdesi i duhur mund të merret parasysh në lidhje me përgjegjësinë e personave juridikë. Kujdesi i duhur nga ana e personit juridik mund të përjashtojë konstatimin e përgjegjësive. Për shembull, kur vërtetimi i një shkeljeje kërkon prova të mungesës së kujdesit të duhur (me fjalë të tjera, pakujdesisë), fakti që një person juridik ka ushtruar kujdesin e duhur do të nënkuptojë që nuk mund të konstatohet se personi juridik është përgjegjës. Në Shtete të tjera, vërtetimi i kujdesit të duhur mund të ofrojë një mbrojtje absolute ndaj përgjegjësive për personat juridikë. Në pjesën tjetër të Shteteve, kujdesi i duhur mund të jetë një faktor i rëndësishëm për ushtrimin e diskrecionit të prokurorisë në ngritjen e një çështjeje kundër një personi juridik ose mund të ofrojë një faktor lehtësues për caktimin e dënimit. Pala që mban barrën e provës për kujdesin e duhur (ose mungesën e tij) mund të ndryshojë gjithashtu midis Shteteve.

Çfarë përbën kujdes të duhur do të ndryshojë sipas sistemit ligjor në fjalë, akuzës, rrethanave të shkeljes së pretenduar dhe natyrës së të pandehurit. Në përgjithësi, ushtrimi i kujdesit të duhur do të përfshijë menaxhimin e riskut dhe sistemet e pajtueshmërisë për të parandaluar dhe zbuluar sjelljen e pahijshme. Një sistem adekuat për menaxhimin e riskut në përgjithësi do të përfshijë sisteme për aksesin në informacion, vlerësimin e riskut bazuar në atë informacion dhe zbutjen e riskut bazuar në atë vlerësim. Menaxhimi, kontrolli ose mbikëqyrja joadekuate e korporatës ose mosofrimi i sistemeve adekuate për përcjelljen e informacionit përkatës të personat përkatës mund të jetë provë e mungesës së kujdesit të duhur. Megjithatë, vetë ekzistenca e politikave, procedurave dhe sistemeve për të parandaluar dhe zbuluar sjelljen e pahijshme në përgjithësi nuk do të jetë e mjaftueshme për të liruar një person juridik nga përgjegjësia. Nëse një person juridik ka ushtruar kujdesin e duhur do të varet gjithmonë nga faktet dhe rrethanat e rastit individual.

Sfidat për vërtetimin e përgjegjësive së personave juridikë

Vërtetimi i përgjegjësive së personave juridikë për krime të tilla si trafikimi i mbetjeve mund të jetë sfidues për prokurorët. Në mënyrë që të sigurohet efektiviteti i legjislacionit, ligjvënësit duhet të konsultohen me prokurorët dhe të marrin në konsideratë sfidat e mundshme për vërtetimin e fajësisë për personat juridikë.

Ky seksion shqyrton shkurtimisht katër sfidat e përfshira në ndjekjen penale të personave juridikë. Kjo nuk duhet të konsiderohet si një listë shteruese e sfidave të ndjeshme për prokurorët. Sfidat e shqyrtuara në këtë seksion janë vërtetimi i fajit (*mens rea*), përcaktimi i “shtetësisë” së një personi juridik për qëllime të shpalljes së juridiksionit, ndjekja penale efektive e njësisë ekonomike më të përshtatshme kur personi juridik përdor struktura komplekse të korporatës dhe kërkesat e kriminalitetit të dyfishtë në çështjet që përfshijnë persona juridikë.

Një nga sfidat e mëdha për vendosjen e përgjegjësive penale ndaj personave juridikë është nevoja për t’ia atribuar përgjegjësinë një njësie ekonomike artificiale. Meqenëse një person juridik mund të veprojë vetëm përmes individëve, është e nevojshme të zhvillohen mekanizma përmes të cilëve përgjegjësia mund t’i atribuohet organizatës. Ndërsa atribuiimi i veprimeve fizike/objektive mund të jetë relativisht i thjeshtë, atribuiimi i gjendjeve mendore si “dashja” ose “dijenja” është më kompleks. Në përgjithësi, janë shfaqur dy modele të përgjegjësive për personat juridikë: përgjegjësia “nominale” ose “e prejardhur” dhe “faji organizativ”. Brenda këtyre modeleve, janë marrë qasje të ndryshme për të vërtetuar fajin (d.m.th., *mens rea*).

Modeli i dispozitës 11 nuk ofron një model të vetëm për vërtetimin e fajit. Gjendja mendore, nëse ka, e nevojshme për atribueimin e sjelljes së nëpunësit të lartë të personi juridik lihet e hapur me përfshirjen e formulimit “me gjendjen e nevojshme mendore” në kllapa katrore. Siç u përmend më lart,¹¹⁹ elementet mendore dhe terminologjia që përdoret për t’iu referuar atyre ndryshojnë midis juridiksioneve, por mund të përfshijnë aspekte të tilla si dashja, dijenia, verbëria e qëllimshme, pamaturia dhe pakujdesia. Në disa raste, përgjegjësia e rreptë — domethënë përgjegjësia që nuk kërkon vërtetimin e asnjë elementi mendor — mund të jetë e

¹¹⁹ Shih “Elementet e figurës së veprave penale”.

përshtatshme për shkeljet që lidhen me trafikimin e mbetjeve të kryera nga persona juridikë. Ky udhëzues ua lë këto zgjedhje ligjvënësve.

Një sfidë shtesë është ajo e përcaktimit të “shtetësisë” së një personi juridik për qëllime të shpalljes së juridiksionit. Duke qenë se një person juridik nuk mund të ekstradohet, mund të jetë një përgjegjësi e veçantë për juridiksionin vendas që të ndjekë penalisht një person juridik brenda juridiksionit të vet. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme kur një Shtet nuk do të shqyrtojë çështjen në procedurë gjyqësore pa “praninë” personale të të pandehurit. Një kriter i juridiksionit në raste të tilla bazohet në “shtetësinë” e personit juridik (parimi i personalitetit aktiv). Megjithëse nuk ka bazë universale për përcaktimin e shtetësisë së personave juridikë, dy baza të zakonshme janë vendi i themelimit dhe vendi kryesor i biznesit.

Një sfidë tjetër ka të bëjë me përdorimin e strukturave komplekse të korporatës nga personat juridikë. Në shumë raste, personat juridikë përdorin struktura komplekse të korporatës dhe veprojnë nëpërmjet filialeve dhe njërive ekonomike të tjera të lidhura, ku secili ka potencialisht personalitet juridik të vetin. Aty ku këto struktura komplekse përdoren për të kryer krime, mund të ketë sfida jo vetëm në hetimin e shkeljeve, por edhe në përcaktimin se cili person juridik do të ishte i pandehuri i duhur (ose cilët persona juridikë do të ishin të pandehurit e duhur). Sfidat shtohen kur strukturat e korporatave shtrihen në më shumë juridiksione. Jurisprudenca në lidhje me trafikimin e mbetjeve është përplot me çështje juridiksioni. Personat juridikë përfitojnë nga boshllëqet e juridiksionit, boshllëqet ligjore dhe kapacitetet e ndryshme ligj-zbatuese për t’iu shmangur ndjekjes penale për trafikimin e mbetjeve, shpesh duke hedhur mbetje në vende ku instalimet për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve janë më pak të zhvilluara dhe sanksionet për trafikimin e mbetjeve janë joefektive ose nuk ekzistojnë fare.

Ky udhëzues legjislativ është përqendruar në atribuimin e përgjegjësisë të personat juridikë bazuar në veprimet e personave fizikë. Megjithatë, ligjvënësit duhet të konsiderojnë gjithashtu se si personat juridikë mund të mbahen përgjegjës për rolin e tyre në shkeljet e kryera nga organizatat e lidhura. Për shembull, një hetim për trafikimin e mbetjeve mund të implikojë një shoqëri tregtare mëmë në akte kriminale të kryera nga filiali i saj. Në disa raste, mund të jetë e mundur të vendoset përgjegjësia mbi shoqërinë tregtare mëmë si bashkëfajtorë për shkeljen, ose për konspiracion për kryerjen e shkeljes ose si pjesë e bashkimit kriminal. Mirëpo, kjo mund të jetë e vështirë të vërtetohet. Një alternativë është vendosja e përgjegjësisë mbi shoqërinë tregtare mëmë në bazë të kontrollit të saj ndaj njësisë ekonomike tjetër. Kjo do të thotë, kur mund të tregohet se një person juridik ushtron kontroll mbi një njësi ekonomike tjetër, shoqëria tregtare mëmë mbahet përgjegjëse për shkeljen e kryer nga njësi ekonomike e kontrolluar. Përgjegjësia mund të vërtetohet gjithashtu në bazë të një personi juridik që ka dijeni se një shkelje do të kryhet në emër të tij ose në dobi të tij, ose kur ai nuk ka adoptuar dhe nuk ka zbatuar në mënyrë efektive modele të përshtatshme organizative dhe të menaxhimit për të parandaluar kryerjen e një shkeljeje nga një filial ose njësi ekonomike tjetër e lidhur. Legjislacioni i Francës, një fragment i të cilit është paraqitur më poshtë, ofron një shembull se si aktet e filialeve mund të përfshihen në dispozitat që përcaktojnë përgjegjësinë e personave juridikë.

Në fund, mosparashikimi në legjislacionin e përgjegjësisë së personave juridikë mund të përbëjë një sfidë për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet që përfshijnë trafikimin e mbetjeve. Ndërsa Konventa kundër Krimin të Organizuar kërkon që Shtetet palë t’i ofrojnë njëri-tjetrit “masën më të gjerë”¹²⁰ të ndihmës së ndërsjellë juridike në hetime, ndjekje penale dhe procedime gjyqësore, dhe parashikon që ndihma e ndërsjellë juridike “ofrohet në masën më të plotë të mundshme” në lidhje me shkeljet për të cilat një person juridik mund të mbahet përgjegjës në përputhje me nenin 10 të Konventës,¹²¹ Shtetet palë mund të refuzojnë gjithashtu dhënien e ndihmës së ndërsjellë juridike për shkak të mungesës së kriminalitetit të dyfishtë.¹²² Kjo mund të rezultojë në pengesa për bashkëpunimin kur personi juridik, për shkak të mosparashikimit në legjislacionin e përgjegjësisë së personave juridikë, nuk do të mund të kryente shkeljen përkatëse në Shtetin e kërkuar. Në një studim të Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, 32 për qind e Shteteve kërkuese dhe 21 për qind e Shteteve të kërkuara u shprehën se kanë pasur vështirësi në lidhje me ndihmën e ndërsjellë për shkak të mosnjohjes së përgjegjësisë penale të personave juridikë.¹²³

¹²⁰ Organized Crime Convention, art. 18, para. 1.

¹²¹ Ibid., art. 18, para. 2.

¹²² Ibid., art. 18, para. 9.

¹²³ Gert Vermeulen, Wendy De Bondt and Charlotte Ryckman, *Liability of Legal Persons for Offences in the EU*, vol. 44, International Research on Criminal Policy (IRCP) Series (Antwerpen, Belgium, Maklu Publishers, 2012).

SHEMBULL: FRANCË**Kodi Penal****Neni 121-2**

Personat juridikë, me përjashtim të Shtetit, janë penalisht përgjegjës për shkeljet e kryera në emër të tyre nga organet ose përfaqësuesit e tyre, sipas dallimeve të përcaktuara në nenet 121-4 dhe 121-7.

Mirëpo, autoritetet publike vendore dhe njësitë e lidhura me to mbajnë përgjegjësi penale vetëm për shkeljet e kryera gjatë aktiviteteve të tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet rregullave të delegimit të shërbimit publik.

Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk e përjashton atë të asnjë personi fizik që është autor apo bashkëpunëtor i së njëjtës shkelje, sipas përcaktimeve të paragrafit të katërt të nenit 121-3.

SHEMBULL: KANADAJA**Kodi Penal (R.S.C., 1985, c. C-46)****Neni 22.1 – Shkeljet nga pakujdesia — organizatat**

Në lidhje me një shkelje për të cilën kërkohet që prokuroria të provojë pakujdesinë, një organizatë është palë në kryerjen e shkeljes nëse

- (a) duke vepruar brenda kufijve të autoritetit të tyre
 - (i) një nga përfaqësuesit e saj është palë në shkelje, ose
 - (ii) dy ose më shumë nga përfaqësuesit e saj përfshihen në sjellje, qoftë me veprim apo mosveprim, të tilla që, nëse do të ishte sjellja e vetëm një përfaqësuesi, ai përfaqësues do të ishte palë në shkelje; dhe
- (b) nëpunësi i lartë i cili është përgjegjës për aspektin e aktiviteteve të organizatës që ka lidhje me shkeljen, devijon — ose nëpunësit e lartë, së bashku, devijojnë — dukshëm nga standardi i kujdesit që, në ato rrethana, në mënyrë të arsyeshme mund të pritej të parandalojë një përfaqësues të organizatës që të bëhet palë në shkelje.

Neni 22.2 – Shkelje të tjera — organizatat

Në lidhje me një shkelje për të cilën kërkohet që prokuroria të provojë fajin — përveç pakujdesisë — një organizatë është palë në kryerjen e shkeljes nëse, me dashjen për të përfituar organizata të paktën pjesërisht, një nga nëpunësit e saj të lartë

- (a) duke vepruar brenda kufijve të autoritetit të tyre, është palë në shkelje;
- (b) duke pasur gjendjen e nevojshme mendore për të qenë palë në shkelje dhe duke vepruar brenda kufijve të autoritetit të tyre, drejton punën e përfaqësuesve të tjerë të organizatës në mënyrë që ata të kryejnë veprimin ose të bëjnë mosveprimet e specifikuar në shkelje; oser
- (c) duke ditur se një përfaqësues i organizatës është ose do të bëhet palë në shkelje, nuk merr të gjitha masat e arsyeshme për t'i ndaluar ata të bëhen palë në shkelje.

MBROJTJET

Shtetet mund ta konsiderojnë të dëshirueshme që disa mbrojtje të pjesshme ose të plota të jenë të disponueshme për shkelje të veçanta. Mbrojtjet duhet të dallohen nga përjashtimet nga përgjegjësia penale. Ndërsa një mbrojtje fal ose justifikon sjelljen që përndryshe do të përbënte një shkelje, një përjashtim heq sjellje të caktuara nga vetë shkelja.

Shtetet mund të dëshirojnë të vënë në dispozicion disa mbrojtje për shkeljet që lidhen me trafikimin e mbetjeve ose menaxhimin e kundërligjshëm të mbetjeve. Këto përfshijnë, për shembull, veprimet që ndërmerren nga nevoja, forca madhore ose “emergjenca e papritur dhe e jashtëzakonshme” — për shembull, një derdhje ose zjarr në vendin e menaxhimit, ose veprimet sipas lajthimit në fakt që është i sinqertë dhe i arsyeshëm. Në shumë Shtete, këto mbrojtje do të ekzistojnë tashmë si mbrojtje të zbatimit të përgjithshëm sipas pjesës së përgjithshme të ligjit penal. Kur mbrojtje të tilla nuk ekzistojnë si mbrojtje të zbatimit të përgjithshëm, ose kur janë të dëshirueshme mbrojtje specifike, Shtetet mund të dëshirojnë t'i futin këto mbrojtje në legjislacionin e menaxhimit të mbetjeve. Siç u përmend më lart, kujdesi i duhur mund të vendoset gjithashtu si mbrojtje ndaj përgjegjësive të personave juridikë.

SHEMBULL: AUSTRALIA

Akti për Veprimtarinë e Mbrojtjes së Mjedisit, 1997 (NSW)

Seksioni 143 – Transportimi ose depozitimi i paligjshëm i mbetjeve

[...]

(3) Mbrojtja—pronar i mbetjeve

Është një mbrojtje në çdo procedim kundër një pronari të mbetjeve për një shkelje sipas këtij seksioni, nëse pronari nuk i ka transportuar mbetjet dhe vërteton—

(a) që kryerja e shkeljes ishte për shkaqe jashtë kontrollit të pronarit, dhe

(b) që pronari ka marrë masa paraprake dhe ka ushtruar kujdesin e duhur për të parandaluar kryerjen e shkeljes.

[...]

Kapitulli 4.

HETIMI

Shkeljet e trafikimit të mbetjeve nuk mund të shërbejnë si dekurajues efektiv nëse nuk ka ekzekutim. Për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive trafikimin e mbetjeve, është e nevojshme që Shtetet të vendosin një regjim efektiv për hetimin e shkeljeve të trafikimit të mbetjeve. Kjo përfshin, ndër të tjera, dhënien e kompetencave të nevojshme për hetuesit në mënyrë që ata të kryejnë funksionet e tyre. Ky kapitull trajton katër tema në lidhje me hetimin e shkeljeve të trafikimit të mbetjeve sa vijon: kompetencat e përgjithshme hetimore, teknikat e posaçme hetimore, sekuestrimi dhe konfiskimi, dhe marrja, trajtimi dhe pranueshmëria e provave.

KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME HETIMORE

Punonjësit e përfshirë në hetimin e trafikimit të mbetjeve dhe shkeljeve të lidhura me to mund të përfshijnë punonjës ligj-zbatues, punonjës të mjedisit, punonjës të doganave dhe punonjësit e njësisve të inteligjencës financiare dhe task-forcat me shumë agjenci (ndërinstitucionale). Kompetencat e duhura për secilin punonjës të tillë patjetër që do të jenë të ndryshme, por mund të përfshijnë kompetenca sa vijon:

- Për të ndaluar dhe kontrolluar persona, automjete, mjete lundruese ose mjete të tjera bartëse
- Për të hyrë dhe kontrolluar ambiente
- Për të marrë në pyetje dëshmitarë, shkelës të dyshuar dhe persona të tjerë me interes
- Për të urdhëruar inspektimin ose paraqitjen e dokumenteve
- Për të bërë fotografi ose regjistrime audiovizive të një gjëje ose vendi që dyshohet se është përfshirë në kryerjen e një shkeljeje
- Për të menaxhuar vendngjarjet e krimit
- Për të sekuestruar mbetje dhe objekte të tjera që dyshohet se janë përfshirë në kryerjen e një shkeljeje
- Për të sekuestruar çdo armë, pajisje ose mjet që dyshohet se është përfshirë në kryerjen e një shkeljeje të mbuluar nga ky udhëzues
- Për të sekuestruar dhe analizuar telefona, kompjuterë dhe pajisje të ngjashme që gjenden në posedim të autorëve të dyshuar
- Për të kërkuar informacion kriminalistik nga laboratorë të specializuar
- Aty ku është e përshtatshme, për të detyruar persona t'u përgjigjen pyetjeve dhe/ose të paraqesin dokumente të rëndësishme për hetimin e një shkeljeje
- Për të kërkuar akses në shënimet bankare dhe financiare

- Për të kërkuar akses në shënimet e telekomunikimit
- Për të kërkuar sekuestrimin ose ngrirjen e pasurive
- Për të kërkuar përdorimin e teknikave të posaçme hetimore, dorëzimin e kontrolluar, hetimet nën mbulim dhe vëzhgimin elektronik ose forma të tjera të vëzhgimit
- Për të kërkuar pezullimin, ndryshimin apo revokimin e lejeve ose certifikatave që mbajnë shkelësit e dyshuar
- Për të skualifikuar shkelësit e dyshuar nga mbajtja e lejeve ose certifikatave
- Për të shkëmbyer informacion me agjencitë e huaja ligj-zbatuese
- Për të marrë pjesë dhe/ose bashkërenduar hetimet e përbashkëta

Kompetencat hetuese duhet të parashikohen në mënyrë adekuate, me ligj, në mënyrë që veprimet e ekzekutimit të jenë legjitime dhe në përputhje me sundimin e ligjit. Procedurat për ushtrimin e kompetencave hetimore mund të ndryshojnë ndërmjet Shteteve. Mund të jetë e përshtatshme ose e nevojshme që Shtetet të kufizojnë disa kompetenca të tilla që të ushtrohen vetëm nën mbikëqyrjen e një gjyqtari ose magjistrati ose, në disa raste, një oficeri të lartë të ligj-zbatimit. Për shembull, një urdhër (mandat) ose një urdhër tjetër i dhënë nga gjyqtari ose magjistrati mund të jetë i nevojshëm për të ushtruar disa kompetenca të kontrollit, hyrjes dhe sekuestrimit, kompetencat për ngrirjen e pasurive dhe kompetencat për të përdorur teknika të posaçme hetimore, si përgjimet, dorëzimet e kontrolluara dhe hetimet nën mbulim.

SHEMBULL: NAMIBIA

Akti për Shëndetin Publik dhe Mjedisor, 2015

Seksioni 63 – Hetimi i ambienteve

Udhëheqësi i shërbimeve shëndetësore ose një punonjës i autorizuar prej tij me shkrim mund—

- në çdo kohë të arsyeshme, të hyjë në një ndërtesë ose në ambiente me qëllim hetimin e ekzistencës së një shqetësimi shëndetësor; dhe
- nëse është e nevojshme, të gërmojë tokën e ambienteve dhe të kërkojë testimin e kanalizimeve ose të kryhen punë të tjera që mund të jenë të nevojshme për hetimin efektiv të ambienteve,

por nëse nuk konstatohet se ka ndonjë shqetësim shëndetësor, autoriteti vendor duhet të restaurojë ambientet me shpenzimet e veta.

TEKNIKAT E POSAÇME HETIMORE

Neni 20, paragrafi 1, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon nga Shtetet palë, nëse lejohet nga parimet themelore të sistemeve ligjore të brendshme, të marrin masat e nevojshme për të lejuar përdorimin e përshtatshëm të teknikave të posaçme hetimore, siç është vëzhgimi elektronik ose forma të tjera të vëzhgimit dhe operacionet nën mbulim. Kur ka përputhje me parimet themelore të sistemeve të tyre ligjore dhe për aq sa është e mundur, Shtetet duhet të sigurojnë që teknikat e posaçme hetimore shtrihen për hetimet e rasteve të rënda të trafikimit të mbetjeve. Aty ku teknikat e posaçme hetimore nuk do të jenë të disponueshme për agjencitë ligj-zbatuese që hetojnë rastet e rënda të trafikimit të mbetjeve sipas ligjeve të brendshme ekzistuese, Shtetet duhet të marrin parasysh përfshirjen e dispozitave të tilla brenda legjisllacionit për luftimin e trafikimit të mbetjeve.

Ekzistojnë shumë lloje të ndryshme të teknikave të posaçme hetimore. Tre lloje janë shënuar në mënyrë specifike në nenin 20 të Konventës kundër Krimit të Organizuar: dorëzimet e kontrolluara, operacionet nën mbulim (që përfshijnë përdorimin e identiteteve të pretenduara) dhe vëzhgimi elektronik. *Udhëzuesi*

Legjislativ për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar shpjegon sa vijon:

Dorëzimi i kontrolluar është i dobishëm veçanërisht në rastet kur kontrabanda identifikohet ose kapet në transit dhe më pas dorëzohet nën vëzhgim për të identifikuar marrësit e synuar ose për të monitoruar shpërndarjen e saj të mëvonshme nëpër një organizatë kriminale. Shpesh kërkohen dispozita legjislative për të lejuar një kurs veprimi të tillë pasi dorëzimi i kontrabandës nga një agjent ligj-zbatues ose një person tjetër mund të jetë në vetvete një krim sipas ligjit të brendshëm.

Operacionet nën mbulim mund të përdoren kur është e mundur që një agjent ligj-zbatues ose një person tjetër të infiltrohet në një organizatë kriminale për të mbledhur prova.

Vëzhgimi elektronik në formën e pajisjeve dëgjuese ose përgjimi i komunikimeve kryen një funksion të ngjashëm dhe shpesh preferohet kur një person i jashtëm nuk mund të depërtojë në një grup të ngushtë ose kur infiltrimi fizik ose vëzhgimi fizik do të përfaqësonte një risk të papranueshëm për hetimin ose sigurinë e hetuesve. Duke pasur parasysh nivelin ndërhyrës, vëzhgimi elektronik në përgjithësi i nënshtrohet kontrollit të rreptë gjyqësor dhe masave të shumta mbrojtëse ligjore për të parandaluar abuzimin.¹²⁴

Ky seksion përmban modele të dispozitave legjislative për disa lloje të teknikave të posaçme hetimore: dorëzimi i kontrolluar, hetimi nën mbulim, përdorimi i identiteteve të pretenduara, vëzhgimi i personave dhe vëzhgimi elektronik. Secila prej tyre ka nivele të ndryshme të riskut dhe implikimeve. Disa nga teknikat mund të jenë veçanërisht ndërhyrëse, së këndejmi kërkojnë balancim të kujdesshëm të së drejtës së një të dyshuari për jetë private kundrejt nevojës për të hetuar kriminalitetin e rëndë. Teknikat e posaçme hetimore zakonisht kërkojnë një bazë legjislative, pa të cilën ato nuk mund të autorizohen me ligj. Teknikat e posaçme hetimore ngrenë gjithashtu shqetësime specifike për jetën private dhe të drejtat e njeriut. Dispozitat për teknikat e posaçme hetimore duhet të marrin parasysh plotësisht të drejtat e të dyshuarit dhe të palëve të treta. Vendimet e organeve dhe gjykatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për lejueshmërinë e teknikave të posaçme hetimore dhe parametrat e tyre duhet të merren parasysh gjatë hartimit të dispozitave përkatëse.

Si rezultat i këtyre shqetësimeve në lidhje me jetën private dhe të drejtat e njeriut, shumica e juridiksioneve kërkojnë një sërë masash mbrojtëse të rrepta kundër abuzimit, duke përfshirë kërkesa që shkelja të jetë e rëndë, që përdorimi i teknikës të jetë jetik për çështjen dhe që provat thelbësore nuk mund të sigurohen me mjete më pak ndërhyrëse. Modelet e dispozitave legjislative për teknikat e posaçme hetimore në këtë seksion përfshijnë parakushtin që autoriteti autorizues të bindet me shkaqe të arsyeshme që natyra dhe shtrirja e veprimtarisë kriminale justifikojnë përdorimin e teknikës së posaçme hetimore. Kjo kërkon që autoriteti autorizues të marrë parasysh domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e hetimit nën mbulim gjatë vlerësimit të kërkesës për zbatimin e teknikave.

Mbikëqyrja e përdorimit të teknikave të posaçme hetimore nga autoritetet gjyqësore ose autoritete të tjera të pavarura është praktikë e zakonshme në shumicën e juridiksioneve dhe kërkohet sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Masat mbrojtëse të përshtatshme për teknikat e posaçme hetimore mund të ndryshojnë në varësi nga teknika në fjalë. Mund të jetë e përshtatshme, për shembull, që dorëzimi i kontrolluar të autorizohet nga oficerë të lartë të ligj-zbatimit, ndërsa vëzhgimi elektronik zakonisht kërkon autorizim dhe mbikëqyrje gjyqësore. Prandaj, secili lloj i teknikave të posaçme hetimore trajtohet në nene të veçanta në këtë kapitull, në mënyrë që të vendoset një regjim i përshtatshëm për secilën.

Në përgjithësi, për secilën formë të teknikës së posaçme hetimore, hartuesit do të duhet të marrin në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- Mekanizmi i miratimit të teknikës
- Pragu për dhënien e miratimit
- Kushtet e vendosura për përdorimin e teknikës
- Masa në të cilën punonjësit që përdorin teknika të posaçme hetimore janë të mbrojtur nga përgjegjësia civile dhe penale

¹²⁴ UNODC, *Udhëzuesi Legjislativ*, para. 443–445.

- Përdorimi i provave që janë marrë nëpërmjet teknikës
- Masa në të cilën ai informacion mund të shpërndalet
- Mekanizmat e kontrollit, rishikimit dhe mbikëqyrjes
- Bashkëpunimi ndërkombëtar
- Ndikimi i mundshëm i përdorimit të teknikës te palët e treta

Në fund, dispozitat e parashtruara në këtë seksion janë menduar të funksionojnë si shtesë e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese në lidhje me kompetencat hetuese të organeve ligj-zbatuese dhe agjencive të tjera. Prandaj është jetike për hartuesit në nivelin kombëtar që të marrin në konsideratë funksionimin e këtyre dispozitave krahas ligjeve të tjera kombëtare, duke përfshirë ligjet që kanë të bëjnë me kompetencat e policisë në përgjithësi, ligjet e procedurës penale, ligjet për të drejtën e jetës private dhe ligjet për format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, në veçanti ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimin.

Seksioni aktual bazohet në kapitullin III të publikimit të UNODC-së *Modele të dispozitave legjislative kundër krimit të organizuar* (Botim i dytë, 2022). Për më shumë informacion, duke përfshirë komentime të mëtejshme mbi hartimin e modeleve të dispozitave legjislative për teknikat e posaçme hetimore dhe shembuj përkatës nga legjislacionet kombëtare, ju lutemi t'i referoheni atij publikimi.

Dorëzimi i kontrolluar

Sipas nenit 20, paragrafi 1, të Konventës kundër Krimit të Organizuar, në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemeve ligjore të brendshme, Shtetet palë lejojnë përdorimin e përshtatshëm të dorëzimit të kontrolluar për qëllime të luftimit të krimit të organizuar. Modeli i dispozitës 12 më poshtë krijon një model të dispozitës legjislative që rregullon përdorimin e dorëzimeve të kontrolluara.¹²⁵

MODEL I DISPOZITËS 12: DORËZIMI I KONTROLLUAR

1. Për qëllimin e këtij neni, “dorëzimi i kontrolluar” nënkupton teknikën e lejimit të dërgesave të paligjshme ose të dyshimta që të kalojnë në, brenda, përmes ose jashtë territorit të [shëno emrin e Shtetit] me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e [shëno autoritetin kompetent], me qëllim hetimin dhe identifikimin e personave të përfshirë në shkeljet për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...].
2. Një dorëzim i kontrolluar sipas paragrafit 1 është i ligjshëm vetëm nëse është autorizuar në përputhje me këtë nen.
3. Një dorëzim i kontrolluar mund të autorizohet nga [shëno titullarin ose zyrën e përcaktuar, si drejtori dhe zëvendës drejtori i agjencisë kompetente ligj-zbatuese, prokurori, gjyqtari hetues ose gjyqtari i hetimeve para-prake] (“autoriteti autorizues”) me kërkesë nga një punonjës ligj-zbatues [ose prokurori publik].
4. Një kërkesë për të kryer dorëzimin e kontrolluar mund të bëhet me [shëno mjetet e nevojshme për të paraqitur kërkesën]. Autoriteti autorizues duhet të mbajë një dosje me shkrim të kërkesës dhe vendimit pasues të marrë sipas paragrafit 6.
5. Një kërkesë për të kryer dorëzimin e kontrolluar duhet të tregojë:
 - (a) Të gjitha informacionet e disponueshme në lidhje me dërgesën dhe destinacionin e saj;
 - (b) Nëse çështja ka qenë subjekt i një kërkesë të mëparshme; dhe
 - (c) [Shëno parakushtet shtesë sipas nevojës/siç kërkohen].
6. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoriteti autorizues mund:
 - (a) Të autorizojë dorëzimin e kontrolluar pa kushte;

¹²⁵ This model provision is taken from chapter III of *Model Legislative Provisions against Organized Crime*, 2nd ed., published by UNODC in 2022. For further information, including further commentary on the design of the model provision and relevant national legislative examples, refer to that publication.

- (b) Të autorizojë dorëzimin e kontrolluar me kushte, duke përfshirë llojin dhe masën e zëvendësimit të dërgesës; ose
- (c) Të refuzojë kërkesën për të kryer dorëzimin e kontrolluar.
7. Autoriteti autorizues nuk duhet të miratojë kërkesën, përveç nëse bindet, me shkaqe të arsyeshme, se:
- (a) Një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet;
- (b) Natyra dhe masa e aktivitetit të dyshuar kriminal janë të tilla që justifikojnë kryerjen e dorëzimit të kontrolluar;
- (c) Çdo aktivitet i paligjshëm kufizohet në minimumin e nevojshëm për të arritur objektivat e dorëzimit të kontrolluar;
- (d) Dorëzimi i kontrolluar do të kryhet në një mënyrë që garanton se, në masën më të madhe të mundshme, çdo mall i paligjshëm i përfshirë në dorëzimin e kontrolluar do të jetë nën kontrollin e një punonjësi ligj-zbatues në fund të dorëzimit të kontrolluar;
- (e) Dorëzimi i kontrolluar nuk do të kryhet në mënyrë të tillë që një person ka të ngjarë të nxitet të kryejë një shkelje që personi përndryshe nuk do të kishte menduar ta kryente; dhe
- (f) Çdo sjellje e përfshirë në dorëzimin e kontrolluar nuk do të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë të asnjë personi dhe nuk do të rrezikojë rëndë jetën, shëndetin ose sigurinë e asnjë personi.
8. Autoriteti autorizues revokon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 nëse nuk është më i bindur, me shkaqe të arsyeshme, për çështjet e referuara në paragrafin 7.
9. Autoriteti autorizues anulon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 pas marrjes së një kërkesë për anulim nga kërkuesi.
10. Punonjësi ligj-zbatues ose personi tjetër i autorizuar i cili kryen veprime të autorizuara në përputhje me këtë nen nuk është subjekt i përgjegjësisë penale ose civile për ato veprime.
11. Autoriteti autorizues i raporton çdo vit [Parlamentit/Komisionit Parlamentar/publikut] numrin e kërkesave të pranuar sipas këtij neni dhe numrin përkatës të autorizimeve që janë miratuar, refuzuar, revokuar dhe anuluar sipas këtij neni.

Hetimi nën mbulim

Sipas nenit 20, paragrafi 1, të Konventës kundër Krimit të Organizuar, Shteteve palë u kërkohet, në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemeve ligjore të brendshme dhe kur është e përshtatshme, të lejojnë përdorimin e operacioneve nën mbulim në territorin e tyre për qëllime të luftimit të krimit të organizuar. Modeli i dispozitës 13 krijon një model të dispozitës legislative për përdorimin e operacioneve të kontrolluara.¹²⁶

Përveç procesit të bërjes së kërkesës dhe autorizimit të hetimeve nën mbulim të përcaktuar në këtë dispozitë, është jetike që hartuesit të shqyrtojnë çështjen nëse provat e marra nëpërmjet hetimeve nën mbulim mund të paraqiten si prova në gjykatë dhe, në qoftë se po, nëse hetuesi nën mbulim duhet të zbulojë identitetin e tij të vërtetë ose nëse hetuesi nën mbulim mund të dëshmojë me mjete të posaçme për të mbrojtur identitetin e vërtetë të tij apo saj.

¹²⁶ Po aty.

MODEL PROVISION 13: UNDERCOVER INVESTIGATION

1. Për qëllimin e këtij neni, “hetimi nën mbulim” nënkupton një hetim që përdor një ose më shumë punonjës ligj-zbatues [ose persona të tjerë të autorizuar nga [shëno agjencinë ligj-zbatuese]] të cilët për qëllimin e hetimit të një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] as shpalosin, as zbulojnë pozitën zyrtare ose mandatin e tyre.
2. Një hetim nën mbulim sipas paragrafit 1 është i ligjshëm vetëm nëse është autorizuar në përputhje me këtë nen.
3. Hetimet nën mbulim mund të autorizohen nga [shëno titullarin ose zyrën e përcaktuar, si drejtori dhe zëvendësdrejtori i agjencisë kompetente ligj-zbatuese, prokurori, gjyqtari hetues ose gjyqtari i hetimeve para-prake] (“autoriteti autorizues”) me kërkesë nga një punonjës ligj-zbatues [ose prokurori publik].
4. Një kërkesë për të kryer hetimin nën mbulim mund të bëhet me [shëno mjetet e nevojshme për të paraqitur kërkesën]. Autoriteti autorizues duhet të mbajë një dosje me shkrim të kërkesës dhe vendimit pasues të marrë sipas paragrafit 6.
5. Një kërkesë për të kryer hetimin nën mbulim duhet të tregojë:
 - (a) Kohëzgjatjen për të cilën kërkohet autorizimi;
 - (b) Nëse çështja ka qenë subjekt i një kërkesë të mëparshme; dhe
 - (c) [Shëno parakushtet shtesë sipas nevojës/siç kërkohen].
6. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoriteti autorizues mund:
 - (a) Të autorizojë hetimin nën mbulim pa kushte;
 - (b) Të autorizojë hetimin nën mbulim me kushte; ose
 - (c) Të refuzojë kërkesën për të kryer hetimin nën mbulim.
7. Autoriteti autorizues nuk duhet të miratojë kërkesën, përveç nëse bindet, me shkaqe të arsyeshme, se:
 - (a) Një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet;
 - (b) Natyra dhe masa e aktivitetit të dyshuar kriminal janë të tilla që justifikojnë kryerjen e hetimit nën mbulim;
 - (c) Çdo aktivitet i paligjshëm kufizohet në minimumin e nevojshëm për të arritur objektivat e hetimit nën mbulim;
 - (d) Hetimi nën mbulim nuk do të kryhet në mënyrë të tillë që një person ka të ngjarë të nxitet të kryejë një shkelje që personi përndryshe nuk do të kishte menduar ta kryente; dhe
 - (e) Çdo sjellje e përfshirë në hetimin nën mbulim nuk do të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë të asnjë personi dhe nuk do të rrezikojë rëndë jetën, shëndetin ose sigurinë e asnjë personi.
8. Autorizimi duhet të specifikojë periudhën kohore për të cilën autorizohet hetimi nën mbulim, e cila në çdo rast nuk është më e gjatë se [shëno periudhën e përshtatshme kohore]. Autorizimi mund të rinovohet me kërkesë.
9. Autoriteti autorizues revokon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 nëse nuk është më i bindur, me shkaqe të arsyeshme, për çështjet e referuara në paragrafin 7.
10. Autoriteti autorizues anulon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 pas marrjes së një kërkesë për anulim nga kërkuesi.
11. Punonjësi ligj-zbatues ose personi tjetër i autorizuar i cili kryen veprime të autorizuara në përputhje me këtë nen nuk është subjekt i përgjegjësisë penale ose civile për ato veprime.
12. Autoriteti autorizues i raporton çdo vit [Parlamentit/Komisionit Parlamentar/publikut] numrin e kërkesave të pranuar sipas këtij neni dhe numrin përkatës të autorizimeve që janë miratuar, refuzuar, revokuar dhe anuluar sipas këtij neni.

Identiteti i pretenduar

Sipas nenit 20, paragrafi 1, të Konventës kundër Krimin të Organizuar, Shteteve palë u kërkohet, në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemeve ligjore të brendshme dhe kur është e përshtatshme, të lejojnë përdorimin e teknikave të posaçme hetimore në territorin e tyre për qëllime të luftimit të krimit të organizuar. Përveç teknikave të përmendura shprehimisht, kjo mund të përfshijë përdorimin e identiteteve të pretenduara. Modeli i dispozitës 14 më poshtë krijon një model të dispozitës legislative që rregullon përdorimin e identiteteve të pretenduara.¹²⁷

Përveç çështjeve të trajtuara në nenin 12, ligjvënësit duhet të marrin parasysh gjithashtu se si punonjësit ligj-zbatues ose personat e tjerë të autorizuar që përdorin një identitet të pretenduar mund të japin dëshmi në gjykimet penale. Në veçanti, procedura për dhënien e dëshmisë duhet të sigurojë që dëshmia mund të jepet në një mënyrë që ofron mbrojtjen e duhur për identitetin e punonjësit ligj-zbatues ose personit tjetër të autorizuar dhe që nuk paragjykon kryerjen e ndonjë hetimi në vijim, duke respektuar të drejtat e mbrojtjes dhe në veçanti të drejtën për gjykim të drejtë.

MODEL I DISPOZITËS 14: IDENTITETET E PRETENDUARA

1. F Për qëllimin e këtij neni, “identiteti i pretenduar” nënkupton një identitet të rremë ose një identitet të ndryshuar që krijohet, përvetësohet dhe/ose përdoret nga punonjësit ligj-zbatues [ose persona të tjerë të autorizuar nga [shëno agjencinë ligj-zbatuese ose autoritetin gjyqësor]] në mënyrë që, për qëllimin e hetimit të një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...], të vendosin kontakte dhe të ndërtojnë një marrëdhënie besimi me një person tjetër ose të infiltrohen në një rrjet kriminal.
2. Krijimi, përvetësimi dhe përdorimi i një identiteti të pretenduar sipas paragrafit 1 është i ligjshëm vetëm nëse është autorizuar në përputhje me këtë nen.
3. T Krijimi, përvetësimi dhe përdorimi i një identiteti të pretenduar mund të autorizohet nga [shëno titullarin ose zyrën e përcaktuar, si drejtori dhe zëvendësdrejtori i agjencisë kompetente ligj-zbatuese, prokurori, gjyqtari hetues ose gjyqtari i hetimeve paraprake] (“autoriteti autorizues”) me kërkesë nga një punonjës ligj-zbatues [ose prokurori publik].
4. Një kërkesë për të krijuar, përvetësuar dhe përdorur identitetin e pretenduar mund të bëhet me [shëno mjetet e nevojshme për të paraqitur kërkesën]. Autoriteti autorizues duhet të mbajë një dosje me shkrim të kërkesës dhe vendimit pasues të marrë sipas paragrafit 6.
5. Një kërkesë për të krijuar, përvetësuar dhe përdorur një identitet të pretenduar duhet të tregojë:
 - (a) Detajet e identitetit të pretenduar që propozohet;
 - (b) Kohëzgjatjen për të cilën kërkohet autorizimi;
 - (c) Nëse çështja ka qenë subjekt i një kërkesë të mëparshme; dhe
 - (d) [Shëno parakushtet shtesë sipas nevojës/siç kërkohen].
6. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoriteti autorizues mund:
 - (a) Të autorizojë krijimin, përvetësimin dhe përdorimin e identitetit të pretenduar pa kushte;
 - (b) Të autorizojë krijimin, përvetësimin dhe përdorimin e identitetit të pretenduar me kushte; ose
 - (c) Të refuzojë kërkesën për të krijuar, përvetësuar dhe përdorur identitetin e pretenduar.
7. Autoriteti autorizues nuk duhet të miratojë kërkesën, përveç nëse bindet me shkaqe të arsyeshme se:
 - (a) Një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet;
 - (b) Natyra dhe masa e aktivitetit të dyshuar kriminal janë të tilla që justifikojnë përdorimin e identitetit të pretenduar;

¹²⁷ Po aty.

- (c) Identiteti i pretenduar nuk do të përdoret në mënyrë të tillë që një person ka të ngjarë të nxitet të kryejë një shkelje që personi përndryshe nuk do të kishte menduar ta kryente; dhe
- (c) Çdo sjellje e përfshirë në përdorimin e identitetit të pretenduar nuk do të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë të asnjë personi dhe nuk do të rrezikojë rëndë jetën, shëndetin ose sigurinë e asnjë personi.
8. Autorizimi duhet të specifikojë periudhën kohore për të cilën autorizohet krijimi, përvetësimi dhe përdorimi i identitetit të pretenduar, e cila në çdo rast nuk është më e gjatë se [shëno periudhën e përshtatshme kohore].
9. Autoriteti autorizues revokon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 nëse nuk është më i bindur, me shkaqe të arsyeshme, për çështjet e referuara në paragrafin 7.
10. Autoriteti autorizues anulon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 pas marrjes së një kërkesë për anulim nga kërkuesi.
11. Një person që vepron sipas një autorizimi për të krijuar, përvetësuar ose përdorur një identitet të pretenduar mund të kërkojë ndihmë nga punonjësit ligj-zbatues ose agjencitë përkatëse për të marrë prova të një identiteti të pretenduar, duke përfshirë identitetin dhe dokumente të tjera mbështetëse, të miratuara sipas këtij neni. Pavarësisht nga çdo ligj tjetër, një punonjës ligj-zbatues ose agjenci mund të krijojë ose të ofrojë prova të një identiteti të pretenduar në përgjigje ndaj një kërkesë sipas këtij neni.
12. Punonjësi ligj-zbatues ose personi tjetër i autorizuar i cili kryen veprime të autorizuar në përputhje me këtë nen nuk është subjekt i përgjegjësisë penale ose civile për ato veprime.
13. Autoriteti autorizues i raporton çdo vit [Parlamentit/Komisionit Parlamentar/publikut] numrin e kërkesave të pranuar sipas këtij neni dhe numrin përkatës të autorizimeve që janë miratuar, refuzuar, revokuar dhe anuluar sipas këtij neni.

Vëzhgimi i personave

Sipas nenit 20, paragrafi 1, të Konventës kundër Krimit të Organizuar, Shteteve palë u kërkohet, në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemeve ligjore të brendshme dhe kur është e përshtatshme, të lejojnë përdorimin e vëzhgimit të personave në territorin e tyre për qëllime të luftimit të krimit të organizuar. Modeli i dispozitës 15 më poshtë krijon një model të dispozitës legislative që rregullon përdorimin e vëzhgimit të personave.¹²⁸

MODEL I DISPOZITËS 15: VËZHGIMI I PERSONAVE

1. Për qëllimin e këtij neni, “vëzhgimi i personave” nënkupton vrojtimin e personave, nga punonjësit ligj-zbatues, për qëllime të hetimit të një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...], e cila është kryer, po kryhet, ose mund të kryhet.
2. Vëzhgimi i personave sipas paragrafit 1 është i ligjshëm vetëm nëse është autorizuar në përputhje me këtë nen.
3. Vëzhgimi i personave mund të autorizohet nga [shëno titullarin ose zyrën e përcaktuar, si drejtori dhe zëvendës drejtori i agjencisë kompetente ligj-zbatuese, prokurori, gjyqtari hetues ose gjyqtari i hetimeve para-prake] (“autoriteti autorizues”) me kërkesë nga një punonjës ligj-zbatues [ose prokurori publik].

¹²⁸ Po aty

4. Një kërkesë për të kryer vëzhgimin e personave mund të bëhet me [shëno mjetet e nevojshme për të paraqitur kërkesën]. Autoriteti autorizues duhet të mbajë një dosje me shkrim të kërkesës dhe vendimit pasues të marrë sipas paragrafit 6
5. Një kërkesë për autorizimin e vëzhgimit të personave duhet të tregojë:
 - (a) Kohëzgjatjen për të cilën kërkohet autorizimi;
 - (b) Nëse çështja ka qenë subjekt i një kërkesë të mëparshme; dhe
 - (c) [Shëno parakushtet shtesë sipas nevojës/siç kërkohen].
6. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoriteti autorizues mund:
 - (a) Të autorizojë vëzhgimin e personave pa kushte;
 - (b) Të autorizojë vëzhgimin e personave me kushte; ose
 - (c) Të refuzojë kërkesën për vëzhgimin e personave.
7. Autoriteti autorizues nuk duhet të autorizojë vëzhgimin e personave përveç nëse bindet me shkaqe të arsyeshme se:
 - (a) Një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet;
 - (b) Natyra dhe masa e aktivitetit të dyshuar kriminal janë të tilla që justifikojnë vëzhgimin e personave; dhe
 - (c) Çdo sjellje e përfshirë në vëzhgimin e personave nuk do të shkaktojë vdekjen ose lëndimin e rëndë të asnjë personi dhe nuk do të rrezikojë rëndë jetën, shëndetin ose sigurinë e asnjë personi
8. Autorizimi duhet të specifikojë periudhën kohore për të cilën autorizohet vëzhgimi i personave, e cila në çdo rast nuk është më e gjatë se [shëno periudhën e përshtatshme kohore]. Autorizimi mund të rinovohet me kërkesë.
9. Autoriteti autorizues revokon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 nëse nuk është më i bindur, me shkaqe të arsyeshme, për çështjet e referuara në paragrafin 7.
10. Autoriteti autorizues anulon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 pas marrjes së një kërkesë për anulim nga kërkuesi.
11. Punonjësi ligj-zbatues ose personi tjetër i autorizuar i cili kryen veprime të autorizuar në përputhje me këtë nen nuk është subjekt i përgjegjësisë penale ose civile për ato veprime.

Vëzhgimi elektronik

Sipas nenit 20, paragrafi 1, të Konventës kundër Krimit të Organizuar, Shteteve palë u kërkohet, në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemeve ligjore të brendshme dhe kur është e e përshtatshme, të lejojnë përdorimin e vëzhgimit elektronik në territorin e tyre për qëllime të luftimit të krimit të organizuar. Vëzhgimi elektronik mund të përfshijë sa vijon:

- Vëzhgimi me audio (përmes përdorimit të mjeteve si përgjimi i telefonit, protokollit i zërit përmes Internetit (VOIP) dhe pajisjet dëgjuese)
- Vëzhgimi me video dhe vizual (siç janë pajisjet e fshehura për vëzhgim me video, sistemet me video në makinë, pajisjet me video që mbahen në trup, imazhet termike/frontale me reze infra të kuqe (FLIR), CCTV, imazhet satelitore dhe sistemet automatike të njohjes së targave)
- Vëzhgimi me gjurmim (si sistemet e pozicionimit global (GPS)/transponderët, silent SMS (mesazhe lokalizuese për qëllime gjurmimi) dhe teknologjitë e tjera të gjurmimit të telefonave celularë, pajisjet e identifikimit të radiofrekuencave (RFID) dhe teknologjia e informacionit biometrik si skanimet e retinës)

- Vëzhgimi i të dhënave (duke përfshirë edhe përgjimin e përmbajtjes dhe të të dhënave të trafikut dhe përdorimin e mjeteve të tilla si spyware/cookies në kompjuter/Internet, telefonat celularë dhe monitorimin e rrahjeve të tastierës)

Vëzhgimi elektronik me përgjimin e komunikimeve është veçanërisht i dobishëm kur një person i jashtëm nuk mund të depërtojë në një grup kriminal të organizuar ose kur infiltrimi fizik ose vëzhgimi fizik do të përfaqësonte një risk të papranueshëm për hetimin ose sigurinë e hetuesve. Duke pasur parasysh nivelin ndërhyrës, vëzhgimi elektronik duhet t'i nënshtrohet kontrollit të rreptë gjyqësor dhe masave të shumta mbrojtëse ligjore për të parandaluar abuzimin.¹²⁹ Modeli i dispozitës 16 paraqet një model legjislativ për rregullimin e përdorimit të vëzhgimit elektronik.¹³⁰

MODEL I DISPOZITËS 16: VËZHGIMI ELEKTRONIK

1. Për qëllimin e këtij neni, “vëzhgimi elektronik” nënkupton:

- (a) Monitorimin, përgjimin, kopjimin ose manipulimin e mesazheve, të dhënave ose sinjaleve të transmetuara me mjete elektronike; ose
- (b) Monitorimin ose regjistrimin e aktiviteteve me mjete elektronike;

për qëllime të hetimit të një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...], e cila është kryer, po kryhet ose mund të kryhet.

2. Vëzhgimi elektronik sipas paragrafit 1 është i ligjshëm vetëm nëse është autorizuar në përputhje me këtë nen.

3. Vëzhgimi elektronik i personave mund të autorizohet nga [shëno titullarin ose zyrën e përcaktuar, si drejtuesi dhe zëvendësdrejtuesi i agjencisë kompetente ligj-zbatuese, prokurori, gjyqtari hetues ose gjyqtari i hetimeve paraprake] (“autoriteti autorizues”) me kërkesë nga një punonjës ligj-zbatues [ose prokurori publik].

4. Një kërkesë për të kryer vëzhgimin elektronik mund të bëhet me [shëno mjetet e nevojshme për të paraqitur kërkesën]. Autoriteti autorizues duhet të mbajë një dosje me shkrim të kërkesës dhe vendimit pasues të marrë sipas paragrafit 6.

5. Një kërkesë për autorizimin e vëzhgimit elektronik duhet të tregojë:

- (a) Llojin e vëzhgimit elektronik për të cilin kërkohet autorizimi;
- (b) Kohëzgjatjen për të cilën kërkohet autorizimi;
- (c) Natyrën e informacionit që pritet të merret;
- (d) Individët, vendndodhjet ose pajisjet që janë objektivi i vëzhgimit;
- (e) Masat që janë vendosur për të siguruar që jeta private dhe të drejtat e tjera të njeriut të individëve mbrohen sa më shumë që të jetë e mundur;
- (f) Nëse çështja ka qenë subjekt i një kërkesë të mëparshme; dhe
- (g) [Shëno parakushtet shtesë sipas nevojës/siç kërkohen].

6. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoriteti autorizues mund:

- (a) Të autorizojë vëzhgimin elektronik pa kushte;
- (b) Të autorizojë vëzhgimin elektronik me kushte; ose
- (c) Të refuzojë kërkesën për vëzhgimin elektronik.

¹²⁹ UNODC, *Udhëzuesi Legjislativ*, para. 445.

¹³⁰ Shih fusnotën 139. [[x-ref]]

7. Autoriteti autorizues nuk duhet të autorizojë vëzhgimin elektronik përveç nëse bindet me shkaqe të arsyeshme se:

(a) Një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] është kryer, po kryhet ose ka të ngjarë të kryhet; dhe

(b) Natyra dhe masa e aktivitetit të dyshuar kriminal janë të tilla që justifikojnë llojin e vëzhgimit elektronik për të cilin kërkohet autorizimi;

8. Autorizimi duhet të specifikojë periudhën kohore për të cilën autorizohet vëzhgimi elektronik, e cila në çdo rast nuk është më e gjatë se [shëno periudhën e përshtatshme kohore]. Autorizimi mund të rinovohet me kërkesë.

9. Autoriteti autorizues revokon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 nëse nuk është më i bindur, me shkaqe të arsyeshme, për çështjet e referuara në paragrafin 7.

10. Autoriteti autorizues anulon një autorizim të dhënë sipas paragrafit 6 pas marrjes së një kërkesë për anulim nga kërkuesi.

11. Punonjësi ligj-zbatues ose personi tjetër i autorizuar i cili kryen veprime të autorizuar në përputhje me këtë nen nuk është subjekt i përgjegjësisë penale ose civile për ato veprime.

12. Informacioni që merret nëpërmjet vëzhgimit elektronik nuk duhet të shpërndalet jashtë [agjencisë përkatëse ligj-zbatuese ose autoritetit tjetër kompetent] pa miratimin e [drejtuesit të agjencisë ligj-zbatuese ose autoritetit tjetër kompetent ose delegatit të tyre]. Ky miratim mund të jepet vetëm për qëllimet e sa vijon:

(a) Parandalimi ose ndjekja e një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...];

(b) Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin ose ndjekjen penale të krimeve [të rënda]; ose

(c) Sigurimi i mbikëqyrjes së duhur të aktiviteteve të agjencisë.

13. [Drejtuesi i agjencisë ligj-zbatuese] duhet të sigurojë që informacioni i cili është marrë nëpërmjet vëzhgimit elektronik të autorizuar sipas këtij neni por që nuk është i rëndësishëm për parandalimin ose ndjekjen penale të një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] shkatërrohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se [gjashtë] muaj pas skadimit të autorizimit.

14. Autoriteti autorizues i raporton çdo vit [Parlamentit/Komisionit Parlamentar/publikut] numrin e kërkesave të pranuar sipas këtij neni dhe numrin përkatës të autorizimeve që janë miratuar, refuzuar, revokuar dhe anuluar sipas këtij neni

SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI

Neni 12, paragrafi 1, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të adoptojnë, në masën më të madhe të mundshme brenda sistemeve ligjore të brendshme, masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e produkteve të krimit të përfutur nga shkeljet që mbulohen nga Konventa dhe të pasurisë, pajisjeve ose instrumenteve të tjera të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në shkeljet që mbulohen nga Konventa. Neni 12, paragrafi 2, kërkon që Shtetet palë të adoptojnë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar identifikimin, gjurmimin, ngrirjen ose sekuestrimin e çdo sendi të tillë me qëllim konfiskimin eventual.

Aty ku nuk parashikohet në mënyrë adekuate tashmë sipas ligjeve të tjera, legjislacioni për luftimin e trafikimit të mbetjeve duhet të parashikojë sekuestrimin dhe konfiskimin e këtyre pasurive dhe produkteve dhe provave të kryerjes së një shkeljeje.

Modeli i dispozitës 17 ofron një model se si mund të arrihet kjo. Ai bazohet, pjesërisht, në nenin 12 të Konventës kundër Krimit të Organizuar dhe përkufizimin e sekuestrimit të përfshirë në nenin 2, paragrafi (f), por shkon më tej se Konventa duke trajtuar gjithashtu sekuestrimin e provave që përndryshe nuk do të binin brenda

kategorive të cilat i nënshtrohen sekuestrimit sipas Konventës. Paragrafi 1 i modelit të dispozitës 17 parashtrohet një përkufizim të termit “sekuestrim” të përshtatur nga përkufizimi i Konventës për “sekuestrimin”. Paragrafi 2 më pas parashikon që një punonjës ligj-zbatues ose një punonjës tjetër përkatës mund të sekuestrojë një send të dyshuar në mënyrë të arsyeshme si provë e kryerjes së një shkeljeje që mbulohet nga ky udhëzues. Paragrafi 3 ka të bëjë me sekuestrimin e pasurisë, pajisjeve, instrumenteve dhe produkteve që mbulohen nga neni 12 i Konventës kundër Krimin të Organizuar. Formulimi fakultativ është përfshirë për të kufizuar përdorimin e kësaj kompetence për sekuestrim në situatat kur sekuestrimi është urdhëruar nga një gjykatë përkatëse ose është autorizuar nga një person zyrtar përkatës. Në bërjen e përcaktimit se kush mund të urdhërojë ose autorizojë sekuestrimin, ligjvënësit duhet të balancojnë nevojën për të mbrojtur të drejtat e të pandehurve dhe palëve të treta bona fide me nevojën për të kryer hetime efektive. Kur hetuesit nuk kanë kompetenca të mjaftueshme për sekuestrim, ata mund të mos jenë në gjendje të marrin prova për të hetuar dhe ndjekur penalisht trafikimin e mbetjeve në mënyrë efektive. Nga ana tjetër, nëse kompetencat e hetuesve për sekuestrim janë tejet të gjera dhe ushtrohen pa mbikëqyrje dhe llogaridhënie, ekziston risku që këto kompetenca të abuzohen.

Modeli i dispozitës 17 trajton vetëm sekuestrimin e provave, pasurisë, pajisjeve, instrumenteve dhe produkteve. Ai nuk trajton konfiskimin. Konfiskimi shqyrtohet më tej në kapitullin 6 si një urdhër plotësues për caktimin e dënimit.

MODEL I DISPOZITËS 17: SEKUESTRIMI

(1) Për qëllime të këtij [Akti/Ligji/Kapitulli...], “sekuestrimi” nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, konvertimit, disponimit ose lëvizjes së një sendi ose marrjen e përkohshme të kujdesit ose kontrollit ndaj sendit.

(2) Një [shëno referimin për punonjësit përkatës ligj-zbatues ose të tjerë] mund të sekuestrojë një send për të cilën punonjësi dyshon në mënyrë të arsyeshme se është provë e kryerjes së një shkeljeje sipas këtij [Akti/Ligji/Kapitulli ...].

(3) Një [shëno referimin për punonjësit përkatës ligj-zbatues ose të tjerë] në bazë të urdhrit të [shëno referimin për gjykatën përkatëse] ose me autorizimin e [shëno referimin për personin përkatës zyrtar]] mund të sekuestrojë:

(a) Pasurinë, pajisjet ose instrumentet e tjera të përdorura ose të destinuara për t’u përdorur në një shkelje sipas këtij [Akti/Ligji/Kapitulli ...];

(b) Produktet e krimin të përfuara nga një shkelje sipas këtij [Akti/Ligji/Kapitulli ...] ose pasurinë që rezultojnë nga transformimi ose konvertimi i këtyre produkteve, nëse këto produkte ose pasuri janë përzier me produkte ose pasuri të fituara nga një burim legjitim; ose

(c) Të ardhurat ose përfitimet e tjera të përfuara nga produkti ose pasuria e përmendur në paragrafin (b).

Duhet të kujtohet gjithashtu se, sipas të drejtës ndërkombëtare të mjedisit, duke përfshirë instrumente të tilla si Konventa e Bazelit, Shtetet kanë detyrime në lidhje me menaxhimin e shëndoshë mjedisor të mbetjeve të rrezikshme dhe të tjera, duke përfshirë mbetjet e sekuestruara. Sipas Konventës së Bazelit, Shtetet janë përfundimisht përgjegjëse për menaxhimin e shëndoshë mjedisor të mbetjeve të trafikuar, pavarësisht nëse shkelësit janë identifikuar ose kapur apo jo dhe pavarësisht nëse shkelësit mund të detyrohen apo jo në mënyrë efektive të paguajnë ose të kryejnë menaxhimin e shëndoshë mjedisor të mbetjeve të tilla.

Kthimi i mbetjeve të trafikuar përtej kufijve ndërkombëtarë

Neni 9, paragrafi 2, i Konventës së Bazelit parashikon se kur lëvizja ndërkufitare e mbetjeve të rrezikshme ose mbetjeve të tjera konsiderohet të jetë trafik i kundërligjshëm si rezultat i veprimeve nga ana e eksportuesit ose gjeneruesit, Shteti i eksportit siguron që mbetjet në fjalë kthehen mbrapsht nga eksportuesi ose gjeneruesi brenda 30 ditëve nga informimi për trafikun e kundërligjshëm. Kur është e nevojshme, mbetjet duhet të kthehen mbrapsht nga vetë Shteti eksportues. Nëse kthimi i mbetjeve në Shtetin eksportues është i pamundur, Shteti eksportues siguron që mbetjet asgjësohen në mënyrë tjetër në përputhje me dispozitat e

Konventës së Bazelit. Kërkesa për kthimin ose asgjësimin e mbetjeve brenda 30 ditëve mund të ndryshojë sipas marrëveshjes nga Shtetet e interesuara.

Vendimi nëse duhet të iniciohet procedura e kthimit mbrapsht kërkon përcaktimin nëse ka pasur një rast trafikimi të kundërligjshëm (siç përkufizohet në Konventën e Bazelit) që mund të çojë te kthimi mbrapsht i mbetjeve. Komiteti për Administrimin e Mekanizmit për nxitjen e implementimit dhe pajtueshmërisë me Konventën e Bazelit vëren se kjo kërkon një qasje me tre hapa për të përcaktuar nëse çështja bie brenda fushëveprimit të Konventës, nëse duket se ka një rast të trafikimit të kundërligjshëm dhe veprimet e kujt janë shkak i trafikimit të kundërligjshëm.¹³¹ Këto çështje mbivendosen në një masë të konsiderueshme me çështjet që duhet të hetohen për të identifikuar, kapur dhe ndjekur penalisht autorët për shkeljet përkatëse. Mirëpo, në praktikë, hetimet përkatëse kryhen shpesh nga agjenci të ndryshme brenda një Shteti. Aty ku është ky rasti, është me rëndësi kritike që këto agjenci të bashkërendojnë dhe bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe për të ndihmuar në vend që të ndërhyjnë në hetimet e njëra-tjetrës. Për shembull, Shtetet duhet të sigurojnë që kthimi ose asgjësimi i mbetjeve në përputhje me procedurën e marrjes mbrapsht sipas Konventës së Bazelit të mos vështirësojë, çrregullojë ose pengojë hetimin dhe ndjekjen efektive penale të shkeljeve që lidhen me trafikimin e kundërligjshëm. Kur një shkelje duke u hetuar ose ndjekur penalisht në Shtetin importues, mund të duhet të merren prova shtesë përpara kthimit ose asgjësimit të mbetjeve. Bashkëpunimi efektiv ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve importuese dhe eksportuese dhe çdo Shteti tjetër përkatës është përsëri vendimtar për të siguruar kthimin e mbetjeve në përputhje me Konventën e Bazelit dhe instrumentet e tjera, duke siguruar gjithashtu hetimin dhe ndjekjen penale efektive të trafikimit të mbetjeve në përputhje me frymën e këtyre instrumenteve¹³² dhe instrumenteve të tjera si Konventa kundër Krimit të Organizuar.

Ndonëse Konventa e Bazelit nuk trajton shprehimisht kthimin e mbetjeve të trafikuar, zakonisht palët bien dakord që kostot e lidhura me kthimin e mbetjeve (siç janë magazinimi, paketimi, etiketimi, transportimi dhe asgjësimi) duhet të përballohen nga pala përgjegjëse për trafikimin e kundërligjshëm — gjegjësisht eksportuesi ose gjeneruesi, sipas rastit.¹³³ Legjislacioni i brendshëm duhet të përfshijë dispozita për këtë qëllim dhe gjithashtu duhet të qartësojë përgjegjësinë për kostot e tjera që rezultojnë nga trafikimi, siç janë kostot e magazinimit përpara njoftimit për trafikimin e kundërligjshëm dhe kostot e hetimit.¹³⁴

PROVAT

Nga pikëpamja juridike, provat i referohen materialit që paraqitet përpara gjykatës gjatë një gjykimi me qëllim që t'i mundësojë përcaktuesit të fakteve (gjyqtarit ose jurisë) të marrë një vendim për çështjet në kontest. Provat mund të përfshijnë sa vijon:

- Prova gojore (dëshmi)
- Prova shkresore (si kopje të kontratave, faturave dhe deklaratave; këtu përfshihen gjithashtu fotografi dhe video)
- Prova materiale (objekte përkatëse, si kampionë të mbetjeve)

Rregullat e provës rregullojnë mënyrën se si provat merren, trajtohen dhe dorëzohen në gjykatë. Ligjvënësit duhet të sigurojnë që ligjet e brendshme të provave janë përshtatur siç duhet për të trajtuar marrjen, përdorimin dhe pranueshmërinë e formave përkatëse të provave. Një çështje që vlen të përmendet në këtë

¹³¹ UNEP/CHW.12/9/Add.2, para. 14.

¹³² Shih, për shembull, Konventa e Bazelit, neni 9, para. 11. Shih gjithashtu UNEP/CHW.12/9/Add.2, para. 77.

¹³³ UNEP/CHW.12/9/Add.2, para. 74..

¹³⁴ Po aty.

kontekst është marrja, trajtimi dhe pranueshmëria e provave elektronike, të cilat po luajnë një rol në rritje në hetimet dhe ndjekjet penale.¹³⁵

Nga këndvështrimi i hetuesve dhe prokurorëve, ndjekjet penale të suksesshme mund të zhvillohen vetëm në bazë të provave të pranueshme. Prandaj, provat duhet të merren dhe të trajtohen në përputhje me ligjet në fuqi.

Ndërsa ky udhëzues nuk ofron ndonjë model të dispozitës legislative për marrjen, trajtimin ose pranueshmërinë e provave (përveç marrjes së provave përmes teknikave të posaçme hetimore, të përvijuara më lart), ky seksion ofron disa udhëzime themelore për këto tema që mund të jenë të dobishme për lexuesit.

Marrja

Marrja e provave mund të jetë një ndërmarrje që kërkon kohë dhe para dhe është e rëndësishme që hetuesit dhe prokurorët të punojnë së bashku për të siguruar që kjo të kryhet në mënyrë efektive dhe efçiente.

Ndërsa në disa raste inspektimet vizuale mund të jenë të mjaftueshme për të identifikuar dhe përcaktuar karakteristikat e mbetjeve të sekuestruara, në raste të tjera mund të jetë e nevojshme marrja e kampionëve. Marrja e kampionëve duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat kombëtare, si dhe me praktikën më të mira ndërkombëtare. Konferenca e Palëve të Konventës së Bazelit ka dhënë udhëzime për marrjen e kampionëve dhe analizën si pjesë e dokumentit Elemente udhëzuese për zbulimin, parandalimin dhe kontrollin e trafikut të paligjshëm të mbetjeve të rrezikshme.¹³⁶ Shtojca 3 e atij dokumenti jep udhëzime për çështjet që lidhen me hetimet, marrjen e kampionëve dhe analizën, duke përfshirë trajtimin e kampionëve dhe zinxhirin e lëvizjes së provave. *Manuali i INTERPOL-it për Hetimin Kriminalistik të Krimeve të Ndotjes* është një burim tjetër i vlefshëm me udhëzime praktike për kryerjen e hetimeve dhe marrjen e provave, duke përfshirë marrjen e kampionëve të mbetjeve të rrezikshme.¹³⁷

Marrja e provave përmes përdorimit të teknikave të posaçme hetimore, si dorëzimi i kontrolluar, hetimi nën mbulim, identitetet e pretenduara, vëzhgimi i personave dhe vëzhgimi elektronik, u trajtuan më sipër. Për secilën nga këto forma të teknikave të posaçme hetimore janë ofruar edhe modele të dispozitave.¹³⁸

Trajtimi

Për të mbrojtur të drejtën e të pandehurve për një gjykim të drejtë, trajtimi i provave rregullohet me rregulla ligjore. Këto rregulla kanë për qëllim të parandalojnë dënimin e të pandehurve në bazë të provave të rreme ose të kontaminuara. Provat që nuk janë trajtuar në përputhje me këto rregulla mund të jenë të papranueshme në gjykatë. Prandaj, respektimi i këtyre rregullave ka rëndësi kritike, jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurve, por edhe për të siguruar që të pandehurit mund të ndiqen penalisht dhe të gjykohen në mënyrë efektive.

Shtetet duhet të sigurojnë që janë vendosur sisteme të përshtatshme për të mbrojtur provat dhe për të regjistruar trajtimin e tyre në mënyrë që të sigurohet mbajtja e zinxhirit të lëvizjes së provave. Mbetjet, kampionët dhe provat e tjera duhet të mbrohen nga manipulimet gjatë magazinimit. Vazhdimësia dhe integriteti duhet të sigurohet edhe për provat elektronike.

Për më tepër, Shtetet duhet të sigurojnë që mbetjet e sekuestruara magazinohen në një mënyrë të sigurt që nuk përbën kërcënim për shëndetin e njeriut ose mjedisin.

¹³⁵ Për informacion të mëtejshëm në lidhje me marrjen, trajtimin dhe pranueshmërinë e provave elektronike, shih publikimin nga UNODC, Drejtoria Ekzekutive e Komitetit Kundër Terrorizmit dhe Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve, *Practical Guide for Requesting Electronic Evidence Across Borders*, botim i dytë (Vjenë, 2021). Aksesi në këtë publikim është i kufizuar për përdoruesit e regjistruar të direktorisë së UNODC-së për autoritetet kombëtare kompetente. Për më shumë informacion, shih <https://sherloc.unodc.org/cld/en/st/evidence/practical-guide.html>.

¹³⁶ Miratuar me vendimin VI/16 të Konferencës së Palëve të Konventës së Bazelit.

¹³⁷ Shih INTERPOL, Environmental Security Sub-directorate, Pollution Crime Forensic Investigation Manual, vol. I (Lyon, France, 2014), ff. 50–66; dhe vol. II, ff. 143–156. Shih gjithashtu WasteForce, Guidance for Prosecutors of Waste Crime, ff. 24–30

¹³⁸ Shih “Teknikat e posaçme hetimore” në këtë kapitull, më sipër.

Pranueshmëria

Shtetet duhet të sigurojnë që ligjet e tyre në lidhje me pranueshmërinë e provave në gjykatë janë përshtatur siç duhet për të trajtuar çështjet lidhur me provat që mund të lindin në ndjekjen penale të trafikimit të mbetjeve. Këto çështje mund të përfshijnë transmetimin e provave të shërbimet kriminalistike të vendosura në juridiksione të huaja dhe pranueshmërinë e provave që janë marrë nga agjencitë ligj-zbatuese të huaja nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, provave që janë marrë në zbatim të hetimeve të përbashkëta dhe provave elektronike, duke përfshirë provat elektronike që janë marrë nga ofruesit e shërbimeve me bazë jashtë vendit.

Kapitulli 5

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Trafikimi ndërkombëtar i mbetjeve është një çështje shqetësuese globale. Bashkëpunimi efektiv ndërkombëtar ndërmjet agjencive shtetërore është thelbësor për parandalimin dhe luftimin e kësaj forme të krimit. Kjo njihet në instrumente të tilla si Konventa kundër Krimit të Organizuar dhe Konventa e Bazelit. Për më tepër, në kapitullin 1 të këtij udhëzuesi, është theksuar se parimi i bashkëpunimit ndërmjet Shteteve është një nga parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit.¹³⁹

Bashkëpunimi ndërkombëtar i referohet ndarjes së informacionit, burimeve dhe personelit dhe ofrimit të ndihmës për arritjen e synimeve të përbashkëta. Bashkëpunimi ndërmjet Shteteve mund të bëhet në mënyrë formale dhe joformale. Bashkëpunimi formal mund të bazohet në Konventën kundër Krimit të Organizuar, Konventën e Bazelit, traktate të tjera shumëpalëshe ose dypalëshe, ose parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, siç është parimi i reciprocitetit. Bashkëpunimi joformal në përgjithësi përfshin kontakt të drejtpërdrejtë punonjës ligj-zbatues me punonjës ligj-zbatues ose agjenci me agjenci përtej kufijve. Në përgjithësi nuk trajtohet me legjislacion, por ndonjëherë mund të bazohet në një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Shteteve bashkëpunuese ose agjencive të tyre. Bashkëpunimi joformal njihet shprehimisht në Konventën kundër Krimit të Organizuar.¹⁴⁰

Siç vërehet në kapitullin 1 të këtij udhëzuesi, Konventa e Bazelit përcakton një sërë detyrimesh për palët për të bashkëpunuar. Në veçanti, neni 10 parashikon që palët e Konventës bashkëpunojnë me njëra-tjetrën me qëllim që të përmirësojnë dhe arrijnë menaxhim të shëndoshë mjedisor të mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, dhe përcakton disa detyrime më specifike për këtë qëllim. Neni 9 i Konventës së Bazelit trajton në mënyrë specifike bashkëpunimin për të parandaluar dhe ndëshkuar trafikimin e mbetjeve,¹⁴¹ por Konventa nuk përmban dispozita të hollësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale. Në këtë drejtim, Konventa kundër Krimit të Organizuar mund të jetë një instrument i dobishëm për Shtetet, pasi ajo përcakton dispozita të hollësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar që mund të zbatohen për çështjet e trafikimit të mbetjeve.

Konventa kundër Krimit të Organizuar shërben si bazë për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet që i bien brenda fushëveprimit të saj. Ajo kërkon që Shtetet të ndërmarrin hapa ose të shqyrtojnë marrjen e hapave për të zbatuar një sërë masash për të mundësuar dhe lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar në çështje të tilla. Siç

¹³⁹ Shih "Parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit", më sipër.

¹⁴⁰ Shih Konventën kundër Krimit të Organizuar, neni 18, para. 4 dhe neni 27.

¹⁴¹ Konventa e Bazelit, neni 9, para. 5..

u përmend në kapitullin 1, rastet e trafikimit të mbetjeve bien brenda fushëveprimit të Konventës kundër Krimit të Organizuar kur ato përbëjnë “krim të rëndë” dhe kur shkelja është e natyrës ndërkombëtare dhe përfshin një grup kriminal të organizuar.¹⁴² Konventa kundër Krimit të Organizuar përfshin nene mbi masat e bashkëpunimit ndërkombëtar si bashkëpunimi në zbatimin e ligjit (neni 27), hetimet e përbashkëta (neni 19), ndihma e ndërsjellë juridike (neni 18), ekstradimi (neni 16), bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit (neni 13), transferimi i procedimeve penale (neni 21) dhe transferimi i personave të dënuar (neni 17). Dispozitat në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar janë përfshirë edhe në një sërë nenesh të tjerë të Konventës kundër Krimit të Organizuar.¹⁴³ Seksionet e mëposhtme ofrojnë udhëzime legjislative për vendosjen e dispozitave në lidhje me format e bashkëpunimit ndërkombëtar në kontekstin e trafikimit të mbetjeve si në vijim: ndihma e ndërsjellë juridike, ekstradimi, bashkëpunimi në zbatimin e ligjit dhe hetimet e përbashkëta. Ashtu si në kapitujt e tjerë, janë përfshirë modele të dispozitave për të ndihmuar në zbatimin e këtyre parimeve.

SHEMBULL: ENFORCE

Rrjeti Mjedisor për Optimizimin e Pajtueshmërisë Rregullatore për Trafikun e Kundërligjshëm (ENFORCE) u krijua nga Konferenca e Palëve të Konventës së Bazelit në takimin e saj të njëmbëdhjetë.^a Ai synon të nxisë pajtueshmërinë e palëve me dispozitat e Konventës së Bazelit në lidhje me parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve nëpërmjet zbatimit dhe ekzekutimit më të mirë të ligjit të brendshëm. ENFORCE bën bashkë burimet ekzistuese për të rritur dhe përmirësuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet subjekteve përkatëse që kanë mandatin për të ofruar aktivitete dhe mjete për ngritjen e kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të kundërligjshëm.^b

^a Decision BC-11/8.

^b Shih gjithashtu Basel Convention, Implementation, Enforcement, “Overview”. Në dispozicion këtu www.basel.int.

NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE

Ndihma e ndërsjellë juridike në çështjet penale është një proces me të cilin Shtetet kërkojnë dhe ofrojnë ndihmë në mbledhjen e provave për përdorim në çështjet penale.¹⁴⁴ Nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë juridike mund të merren në intervistë ose të marrin fletëthirrje dëshmitarët, të gjenden personat, të dorëzohen provat, të këqyren dhe të analizohen objektet dhe vendet, si dhe të jepen dhe të ekzekutohen urdhrat për kontroll dhe sekuestrim në juridiksione të huaja.¹⁴⁵ Ndihma e ndërsjellë juridike mund të përdoret, për shembull, për marrjen dhe analizimin e kampionëve të mbetjeve dhe që rezultatet e asaj analize të ndahen më pas me Shtetin kërkuar.

Ndihma e ndërsjellë juridike jepet zakonisht në bazë të traktateve dypalëshe ose shumëpalëshe, ndonëse disa Shtete ofrojnë ndihmë të tillë pa asnjë marrëveshje themelore, në bazë të legjislacionit të tyre të brendshëm dhe/ose parimit të reciprocitetit.¹⁴⁶ Neni 18 i Konventës kundër Krimit të Organizuar vendos një

¹⁴² Shih “Kuatro ligjor ndërkombëtar për luftimin e krimit të rëndë”, më sipër.

¹⁴³ Këto përfshijnë nene në lidhje me masat për të luftuar pastrimin e parave (neni 7, para. 1 (b) dhe para. 4), disponimi i produkteve të krimit ose pasurisë së konfiskuar (neni. 14, para. 2–3), juridiksioni (neni. 15, para. 5), teknikat e posaçme hetimore (neni 20, para. 2–4), mbrojtja e dëshmitarëve (neni 24, para. 3), masat për rritjen e bashkëpunimit me autoritetet ligj-zbatuese (neni 26, para. 5), marrja, shkëmbimi dhe analiza e informacionit mbi natyrën e krimit të organizuar (neni 28, para. 2), trajnimi dhe asistenca teknike (neni 29, para. 2 dhe 4), zbatimi i Konventës nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe asistencës teknike (neni 30) dhe parandalimi (neni 31, para. 7), të Konventës kundër Krimit të Organizuar.

¹⁴⁴ UNODC, *Manual on Mutual Legal Assistance and Extradition*.

¹⁴⁵ Shih gjithashtu UNODC, SHERLOC, Legislative Guide, chap. V, sect. B, “Mutual legal assistance in criminal matters”. Në dispozicion këtu www.unodc.org/cld/v3/sherloc/legislative-guide/index.html.

¹⁴⁶ Parimi i reciprocitetit ka qenë prej kohësh një parim i vendosur në marrëdhëniet ndërmjet Shteteve në lidhje me çështjet e së drejtës ndërkombëtare dhe diplomacisë. Në thelb ai është një premtim që Shteti kërkuar do t'i ofrojë Shtetit të kërkuar të njëjtin lloj ndihme në të ardhmen, nëse Shteti kërkuar do t'i kërkojë ndonjëherë ta bëjë këtë. Ky parim zakonisht mishërohet në traktate, memorandume mirëkuptimi dhe në legjislacionin e brendshëm.

kuadër për ndihmën e ndërsjellë juridike ndërmjet Shteteve palë në lidhje me krimet dhe shkeljet e rënda të përcaktuara sipas Konventës dhe Protokollit të saj. Ai inkurajon Shtetet palë të marrin në konsideratë, kur është e nevojshme, lidhjen e marrëveshjeve ose ujdive dypalëshe ose shumëpalëshe të cilat do t'i shërbenin përmirësimit ose do t'i jepnin efekt praktik dispozitave të nenit 18.¹⁴⁷

Shtetet palë duhet të sigurojnë që regjimet e brendshme të ndihmës së ndërsjellë juridike, qofshin të vendosura sipas traktatit dypalësh ose shumëpalësh ose që ofrojnë një bazë të pavarur për ndihmën e ndërsjellë juridike, të zbatohen për hetimet, ndjekjet penale dhe procedimet gjyqësore në lidhje me trafikimin e mbetjeve. Modeli i dispozitës 18 më poshtë ofron një shembull të një dispozite për këtë qëllim, të cilën një Shtet mund ta përfshijë në legjislacionin e mbetjeve të krijuar në përputhje me këtë udhëzues.

MODEL I DISPOZITËS 18: NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE

Dispozitat për ndihmën e ndërsjellë juridike të përfshira në [shëno legjislacionin kombëtar për ndihmën e ndërsjellë juridike] dhe në çdo traktat të zbatueshëm dypalësh ose shumëpalësh në të cilin [shëno emrin e Shtetit] është palë zbatohen për hetimet, ndjekjet penale dhe procedimet gjyqësore në lidhje me shkeljet e përcaktuara sipas këtij [Akti/Ligji/Kapitulli etj.].

Përpara se të hartohet dhe dorëzohet një kërkesë formale për ndihmë të ndërsjellë juridike, duhet marrë kohë për të shqyrtuar dhe pyetur nëse një kërkesë e tillë duhet të hartohet në atë kohë ose nëse i njëjti qëllim mund të arrihet përmes mekanizmave më pak formalë dhe përgjithësisht më të shpejtë të bashkëpunimit. Në veçanti, duhet të merret parasysh nëse ndihma mund të merret nëpërmjet bashkëpunimit polici-polici ose bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të tjera kompetente, siç janë prokurorët, ose nëse dokumentacioni i kërkuar është në domenin publik të Shtetit të kërkuar dhe për këtë arsye është një çështje që nuk kërkon ndihmë të ndërsjellë juridike. Në raste të tjera, bashkëpunimi joformal ndërmjet agjencive mund të ndihmojë në identifikimin se çfarë duhet të përfshihet në një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe të mundësojë që kërkesa të përgatitet dhe ekzekutohet më shpejt.

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike, si dhe sugjerime praktike hap pas hapi se si të nisni, si t'i përgjigjeni dhe si të ndiqni më mirë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike, ju lutemi t'i referoheni publikimit të UNODC-së *Manual për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike dhe Ekstradimin*.

EKSTRADIMI

Ekstradimi është procesi formal me të cilin një Shtet kërkon nga një Shtet tjetër kthimin e një personi të akuzuar ose të dënuar për një krim në mënyrë që ai person të dalë në gjyq ose të vuajë një dënim në Shtetin kërkues. Marrëveshjet për ekstradimin janë kritike për ndjekjen penale efektive të shkelësve të trafikimit të mbetjeve, duke pasur parasysh natyrën shpeshherë ndërkombëtare të krimit.

Ekstradimi përgjithësisht trajtohet sipas traktateve dypalëshe ose shumëpalëshe, megjithëse mund të kryhet edhe në bazë të parimit të reciprocitetit ose parimit të mirësjelljes ndërkombëtare. Ekstradimi trajtohet në nenin 16 të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Neni 16 ofron një bazë për ekstradimin e personave të kërkuar në lidhje me shkeljet e përcaktuara në përputhje me Konventën dhe ato që përfshijnë krime të rënda, kur shkeljet e tilla përfshijnë një grup kriminal të organizuar. Ai zbatohet për rastet kur shkelja për të cilën kërkohet ekstradimi është e ndëshkueshme sipas legjislacionit të brendshëm si të Shtetit kërkues ashtu edhe atij të kërkuar. Në këtë drejtim, ajo që ka rëndësi është se veprimet për të cilat kërkohet ekstradimi është janë të cilësuar si vepra penale sipas ligjeve të të dy Shteteve, pavarësisht nga emërtimi formal i shkeljeve të

¹⁴⁷ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 18, para. 30.

tilla.¹⁴⁸ Neni 16 është menduar të plotësojë traktatet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe të ekstradimit¹⁴⁹ dhe mund të ofrojë bazën për ekstradim për shkeljet që mbulohen nga neni 16 kur asnjë traktat ekstradimi nuk është në fuqi ndërmjet Shteteve në fjalë.¹⁵⁰

Ekstradimi është një fushë komplekse e së drejtës. Shumica e Shteteve kanë kuadër ekzistues për ekstradimin që mbështetet në traktate shumëpalëshe ose dypalëshe me Shtete të tjera. Duke njohur këto kompleksitete, ky udhëzues nuk orvatet të ofrojë një ekzaminim gjithëpërfshirës të çështjeve ligjore në lidhje me ekstradimin ose modele të dispozitave legjislative për krijimin e një kuadri të plotë ligjor për ekstradimin. Megjithatë, udhëzuesi trajton disa nga çështjet themelore ligjore në lidhje me ekstradimin që një Shtet duhet të marrë parasysh kur krijon legjislacionin për luftimin e trafikimit të mbetjeve.

Për qëllimet e këtij udhëzuesi, çështja kryesore ligjore në lidhje me ekstradimin është përcaktimi i shkeljeve të trafikimit të mbetjeve si shkelje që janë subjekt i ekstradimit. Disa nga shkeljet e përfshira në udhëzues mund të mos konsiderohen nga një Shtet si mjaft të rënda për të kërkuar ekstradimin. Kjo është një çështje që duhet ta përcaktojë secili Shtet në përputhje me sistemin dhe vlerat e tij ligjore. Për shkeljet për të cilat mund të kërkohej ekstradimi, Shtetet duhet të kujdesen të sigurojnë që ato konsiderohen si të tilla sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit dhe sipas traktateve të tij dypalëshe dhe shumëpalëshe të ekstradimit. Mënyra se si kjo mund të zbatohet do të varet nga metoda për përcaktimin e shkeljeve që janë subjekt i ekstradimit që përdoren nga Shteti në fjalë.

Dy qasje janë përdorur historikisht për përcaktimin e shkeljeve si shkelje që janë subjekt i ekstradimit: “qasja me listë” dhe “qasja e dënimit minimal”. Sipas metodës së listës, nëse një shkelje është subjekt i ekstradimit përcaktohet duke iu referuar një liste të shkeljeve që janë subjekt i ekstradimit që përfshihet në traktatin e ekstradimit dhe në legjislacionin zbatues. Sipas qasjes së dënimit minimal, nëse një shkelje është subjekt i ekstradimit përcaktohet duke iu referuar dënimit maksimal ose, në disa raste, dënimit minimal të zbatueshëm për shkeljen. Çdo shkelje me një dënim maksimal (ose, sipas rastit, minimal) në ose mbi një prag të caktuar mund të jetë një shkelje që është subjekt i ekstradimit.

Shtetet që përdorin qasjen e listës duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar që shkeljet të cilat kanë të bëjnë me trafikimin e mbetjeve dhe për të cilat kërkohej ekstradimi përfshihen në listat e shkeljeve që janë subjekt i ekstradimit në traktatet përkatëse dypalëshe dhe shumëpalëshe të ekstradimit dhe në çdo legjislacion përkatës zbatues. Shtetet që përdorin qasjen e dënimit minimal duhet të sigurojnë që shkeljet e trafikimit të mbetjeve të parashikuara në ligj sipas këtij udhëzuesi plotësojnë kërkesat minimale për ekstradim sipas traktateve të tyre dypalëshe dhe shumëpalëshe të ekstradimit.

Shtetet duhet gjithashtu të sigurojnë që legjislacioni i ekstradimit që zbatohet për shkelësit e trafikimit të mbetjeve është në përputhje me parimin “o ekstrado o procedo” të përvijuar në nenin 16, paragrafi 10, të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Paragrafi 10 parashikon që, në lidhje me një shkelje që mbulohet nga Konventa, një Shtet palë, me kërkesë të një Shteti palë që kërkon ekstradimin e një autori të pretenduar, ia paraqet çështjen autoriteteve të tij kompetente për qëllime të ndjekjes penale, kur Shteti palë i kërkuar refuzon të ekstradojë shkelësin e pretenduar vetëm mbi bazën se ai ose ajo është shtetas i atij Shteti.

BASHKËPUNIMI I FORCAVE LIGJ-ZBATUESE

Bashkëpunimi ndërkombëtar i agjencive të zbatimit të ligjit trajtohet në nenin 27 të Konventës për Krimin e Organizuar. Neni 27, paragrafi 1, kërkon nga Shtetet palë që të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin, në një mënyrë që është në përputhje me sistemet përkatëse të brendshme ligjore dhe administrative, për të rritur efektivitetin e veprimeve të zbatimit të ligjit në luftimin e krimit të rëndë që përfshin grupet kriminale të organizuara dhe shkeljeve të tjera që mbulohen nga Konventa. Masat e veçanta që kërkohej sipas nenit 27 përfshijnë vendosjen e kanaleve të komunikimit ndërmjet autoriteteve kompetente, agjencive dhe shërbimeve për shkëmbimin e sigurt dhe të shpejtë të informacionit në lidhje me krimin e organizuar;

¹⁴⁸ Shih gjithashtu UNODC, *Manual on Mutual Legal Assistance and Extradition*, para. 103..

¹⁴⁹ Përveç traktateve ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe për ekstradimin, Shtetet mund të konsiderojnë gjithashtu lidhjen e marrëveshjeve të reja duke zbatuar Modelin e Traktatit për Ekstradimin të adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/116 dhe të ndryshuar nga Asambleja me rezolutën 52/88.

¹⁵⁰ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 16, para. 4.

shkëmbimin e informacionit të tillë; bashkëpunimin me Shtetet e tjera palë në hetimin e personave, pasurisë dhe produkteve të përfshira në krimin e organizuar; ndarja e artikujve dhe substancave për qëllime analitike dhe hetimore; dhe emërimin e punonjësve ndërlidhës.

Një model për legjislacionin që rregullon forma të tilla të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ligj-zbatimit është dhënë në modelin e dispozitës 19 më poshtë. Dispozita është kryesisht relevante për ato Shtete në të cilat agjencitë hetuese duhet të kenë një mandat ligjor për të bashkëpunuar me homologët ndërkombëtarë. Në Shtete të tjera, një dispozitë e tillë mund të mos jetë e nevojshme, por mund të jetë e dëshirueshme për të qartësuar dhe përmirësuar mekanizmat ekzistues për bashkëpunimin e organeve ligj-zbatuese.

MODEL I DISPOZITËS 19: BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I FORCAVE LIGJ-ZBATUESE

1. [Pavarësisht ligjeve përkatëse për mbrojtjen e të dhënave dhe jetës private dhe dispozitave të tjera të konfidencialitetit të zbatueshme për të dhënat personale], [shëno agjencinë kombëtare ligj-zbatuese] mund t'i ofrojë një agjencie ligj-zbatuese të huaj ose një agjencie ligj-zbatuese ndërkombëtare ose rajonale informacion në lidhje me të gjitha aspektet e shkeljeve për të cilat ky zbatohet [Akti/Ligji/Kapitulli ...] [përfshirë lidhjet me aktivitetet të tjera kriminale].
2. [Shëno agjencinë ligj-zbatuese kombëtare] mund të bashkëpunojë me një agjenci ligj-zbatuese të huaj ose një agjenci ligj-zbatuese ndërkombëtare ose rajonale, në lidhje me:
 - (a) Kryerjen e hetimeve paraprake që kanë të bëjnë me:
 - (i) Identitetin, vendndodhjen dhe aktivitetet e personave të dyshuar për përfshirje në shkelje për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] ose vendndodhjen e personave të tjerë të implikuar;
 - (ii) Lëvizjen e produkteve të krimit ose pasurisë së përfutur nga kryerja e shkeljeve të tilla;
 - (iii) Lëvizjen e pasurisë, pajisjeve ose instrumenteve të tjera të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në kryerjen e shkeljeve të tilla;
 - (b) Ofrimin e sendeve, substancave, dokumenteve ose shënimeve për qëllime analitike ose hetimore;
 - (c) Atashimin ose shkëmbimin e personelit, duke përfshirë vendosjen e punonjësve ndërlidhës të zbatimit të ligjit ose magjistratëve ndërlidhës dhe duke vënë në dispozicion ekspertët;
 - (d) Shkëmbimin e informacionit mbi mjetet dhe metodat specifike që përdoren nga grupet kriminale të organizuara, duke përfshirë rrugët dhe mjetet bartëse dhe përdorimin e identiteteve të rreme, dokumenteve të ndryshuara ose të rreme ose mjete të tjera për fshehjen e aktiviteteve të tyre;
 - (e) [Hetimet e përbashkëta];
 - (f) Mbrojtjen e dëshmitarëve, duke përfshirë zhvendosjen e një dëshmitari të mbrojtur; dhe
 - (g) Asistencën tjetër administrative.
3. [Shëno emrin e agjencisë ligj-zbatuese kombëtare] mund të lidhë një marrëveshje me një agjenci ligj-zbatuese të huaj ose një organizatë ligj-zbatuese ndërkombëtare ose rajonale për të përmirësuar bashkëpunimin e organeve ligj-zbatuese për të parandaluar, identifikuar dhe luftuar shkeljet për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...].

Gjithashtu duhet pasur kujdes për t'u siguruar që legjislacioni kombëtar është përshtatur në mënyrë adekuate për të trajtuar çështjet lidhur me provat që mund të lindin nga bashkëpunimi ndërkombëtar në rastet e trafikimit të mbetjeve. Këto përfshijnë, ndër çështje të tjera të mundshme, pranueshmërinë e provave që janë marrë nga agjencitë ligj-zbatuese të huaja nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe transmetimin e provave të shërbimit kriminalistike që gjenden në juridiksione të huaja.

HETIMET E PËRBASHKËTA

Duke pasur parasysh që trafikimi i mbetjeve shpesh përfshin shkelje ndërkombëtare, hetimet e përbashkëta ndonjëherë mund të rezultojnë të jenë më efektive për shpartallimin e grupeve kriminale të organizuara sesa hetimet që kryhen nga vetëm një Shtet, veçanërisht në raste komplekse. Termi "hetim i përbashkët" përfshin një sërë përpjekjesh bashkëpunuese në hetimin e krimit. Përpjekjet e tilla në përgjithësi mund të klasifikohen si përpjekje që përfshijnë hetime të përbashkëta paralele, skuadra të përbashkëta hetimore ose organe të

përbashkëta hetimore. “Hetimet e përbashkëta paralele” u referohen hetimeve që nuk kryhen në të njëjtin vend, por janë të bashkërenduara ngushtë dhe ndërmerren në dy ose më shumë Shtete me një synim të përbashkët. “Skuadrat e përbashkëta hetimore” janë skuadra të autoriteteve ligj-zbatuese, prokurorëve, gjyqtarëve ose gjyqtarëve hetues që krijohen në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet autoriteteve kompetente të dy ose më shumë Shteteve për një kohëzgjatje të kufizuar dhe për qëllimin specifik të kryerjes së hetimeve penale në një ose më shumë nga Shtetet e përfshira.¹⁵¹ Skuadrat e përbashkëta hetimore mund të klasifikohen më tej në skuadra të integruara në mënyrë pasive ose aktive.¹⁵² Një skuadër e përbashkët hetimore e integruar në mënyrë pasive mund të jetë, për shembull, ajo ku një punonjës ligj-zbatues i huaj integrohet me punonjësit ligj-zbatues nga Shteti pritës në një rol të këshilltarit ose konsulentit apo në një rol mbështetës bazuar në ofrimin e asistencës teknike për Shtetin pritës. Një skuadër e përbashkët hetimore e integruar në mënyrë aktive do të përfshijë punonjës ligj-zbatues nga të paktën dy juridiksione me mundësinë për të ushtruar kompetenca ekuivalente operationale, ose të paktën disa kompetenca operationale, nën kontrollin e Shtetit pritës në territorin ose juridiksionin ku vepron skuadra.¹⁵³

Koncepti i organeve të përbashkëta hetimore është futur në Konventën kundër Krimit të Organizuar. Në bazë të nenit 19 të Konventës kundër Krimit të Organizuar, Shteteve palë u kërkohet të marrin në konsideratë lidhjen e marrëveshjeve ose ujdive për të krijuar organe të përbashkëta hetimore në lidhje me çështjet që janë subjekt i hetimeve, ndjekjeve penale ose procedimeve gjyqësore në një ose më shumë Shtete.¹⁵⁴ As teksti i Konventës, as *Travaux préparatoires* nuk përkufizojnë se çfarë duhet të kuptohet si trup i përbashkët hetimor.

Modeli i dispozitës 20 synon të ofrojë bazën ligjore për një autoritet kombëtar përkatës për të lidhur marrëveshje ose ujdive për të kryer hetime të përbashkëta, qoftë nëpërmjet krijimit të një trupi të përbashkët hetimor ose nëpërmjet ndërmarrjes së hetimeve të përbashkëta rast pas rasti. Ligjet e brendshme të shumicës së Shteteve tashmë lejojnë aktivitete të tilla të përbashkëta, dhe për ato pak Shtete ku ligjet nuk e lejojnë këtë, modeli i dispozitës 20 do të jetë një burim i mjaftueshëm i autoritetit ligjor për bashkëpunimin rast pas rasti të këtij lloji.

MODEL I DISPOZITËS 20: HETIMET E PËRBASHKËTA

1. Për qëllimin e hetimit të shkeljeve për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...], [shëno emrin e agjencisë përkatëse ligj-zbatuese kombëtare dhe/ose autoritetit të prokurorisë ose gjyqësorit sipas rastit] mund, në lidhje me çështjet që janë subjekt i hetimeve [ose ndjekjeve penale ose procedimeve gjyqësore] në një ose më shumë Shtete, të lidhë marrëveshje ose ujdive me një ose më shumë agjenci ligj-zbatuese [ose autoritete të prokurorisë ose gjyqësore] të huaja ose organizata përkatëse ndërkombëtare të zbatimit të ligjit ose bashkëpunimit gjyqësor në lidhje me njërin ose të dy qëllimet në vijim:

- (a) Krijimi i një trupi të përbashkët hetimor; dhe
- (b) Ndërmarrja e hetimeve të përbashkëta rast pas rasti.

2. Kur është lidhur një marrëveshje ose ujdive sipas paragrafit 1, [shëno emrin e agjencisë ligj-zbatuese ose prokurorisë publike ose autoritetit gjyqësor] mund të përfshihet në hetime të përbashkëta me Shtetin përkatës ose organizatat ndërkombëtare ose rajonale të zbatimit të ligjit ose bashkëpunimit gjyqësor.

3. Provat që janë marrë jashtë territorit të [shëno emrin e Shtetit] në zbatim të një hetimi të përbashkët sipas këtij neni janë të pranueshme në procedimet gjyqësore sikur provat e tilla të ishin marrë brenda territorit të [shëno emrin e Shtetit].

¹⁵¹ Shih gjithashtu Protokollin e Dytë Plotësues të Konventës Evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, neni 20; Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/465/DPB për skuadrat e përbashkëta hetimore; dhe rezolutën e Këshillit mbi një model të marrëveshjes për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore, aneksi.

¹⁵² CTOC/COP/WG.3/2020/2, paras. 6–8.

¹⁵³ Po aty., para. 51.

¹⁵⁴ Një dispozitë identike përmban neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Rezoluta 10/4 e Konferencës së Palëve të Konventës kundër Krimit të Organizuar ftoi më tej Shtetet palë që të konsiderojnë krijimin e “organeve të përbashkëta hetimore që përdorin teknologjitë moderne” (CTOC/COP/2020/10).

Puna e mëparshme e bërë nga UNODC ka identifikuar disa pengesa ligjore në lidhje me krijimin e hetimeve të përbashkëta. Këtu përfshihet mungesa e kuadrit të qartë ose legjislationit specifik që ka të bëjë me krijimin e hetimeve të përbashkëta, mungesa e qartësisë në lidhje me kontrollin e operacioneve dhe mungesa e qartësisë në lidhje me përgjegjësinë për kostot e hetimeve të përbashkëta. Këto çështje duhet të merren parasysh nga ligjvënësit gjatë hartimit të dispozitave që kanë të bëjnë me hetimet e përbashkëta.

Legjislationi që parashikon hetime të përbashkëta në kontekstin e trafikimit të mbetjeve duhet të sigurojë që secila prej këtyre çështjeve adresohet qartë në mënyrë që hetimet e përbashkëta të funksionojnë në mënyrë efektive.

Një kuadër i qartë ligjor është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e skuadrave të përbashkëta hetimore të integruara në mënyrë aktive dhe/ose organeve të përbashkëta hetimore, pasi këto mund të përfshijnë dislokimin operacional të punonjësve ligj-zbatues nga juridiksionet e huaja. Ndërsa skuadrat e përbashkëta hetimore dhe/ose organet e përbashkëta hetimore, në disa raste, janë krijuar në mungesë të legjislationit të brendshëm specifik në lidhje me këto skuadra ose organe, nëpërmjet përdorimit të konventave ndërkombëtare dhe rregullave të tjera të legjislationit të brendshëm, Shtetet duhet të shqyrtojnë nëse është i nevojshëm legjislationi që trajton çështjet e mëposhtme, ndër të tjera:

- Akordimi i kompetencave punonjësve ligj-zbatues të huaj ose, sipas rastit, prokurorëve publikë ose gjyqtarëve hetues të huaj
- Kush ka përgjegjësinë për kontrollin operacional
- Mbledhja e provave nga punonjësit ligj-zbatues të huaj dhe pranueshmëria e tyre në çdo procedim
- Mundësia që procedurat e ndihmës së ndërsjellë juridike të hiqen në lidhje me provat që merren në zbatim të hetimit të përbashkët
- Detyrimet civile dhe penale të punonjësve ligj-zbatues dhe personelit tjetër të huaj të përfshirë në hetimin e përbashkët

Modeli i dispozitës 21 trajton dy nga këto çështje: akordimin e kompetencave zyrtarëve të huaj dhe detyrimet e zyrtarëve të atashuar..

Ndër konsideratat shtesë përfshihen sa vijon:

- Sigurimi i qartësisë në lidhje me mbikëqyrjen dhe rolet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të atashuar
- Sigurimi i kufizimeve se në të cilat aktivitete mund të angazhohen zyrtarët e atashuar

Një çështje tjetër është nëse zyrtarët që angazhohen në veprime të autorizuara nga një hetim i përbashkët mbajnë përgjegjësi penale dhe civile për ato veprime. Paragrafi 2 i modelit të dispozitës 21 sugjeron marrjen parasysh të kësaj duke u akorduar disa mbrojtje zyrtarëve të huaj të atashuar, ekuivalente me ato që gëzojnë zyrtarët përkatës kombëtarë.

MODEL I DISPOZITËS 21: AKORDIMI I KOMPETENCAVE ZYRTARËVE TË HUAJ NË HETIMET E PËRBASHKËTA

1. Kur [shëno emrin e Shtetit] ka një marrëveshje që mbulon akordimin e kompetencave në hetimet e përbashkëta me një Shtet të huaj, [shëno autoritetin kompetent] mund t'u akordojë punonjësve ligj-zbatues [ose prokurorëve publikë ose gjyqtarëve hetues] të atij Shteti një ose më shumë nga kompetencat si në vijim, të cilat ata mund t'i ushtrojnë më pas në [shëno emrin e Shtetit], duke iu nënshtruar ligjit të [shëno emrin e Shtetit]:

(a) [Kompetenca për të marrë informacione dhe për të marrë deklarata, në përputhje me ligjin e Shtetit të huaj];

(b) [Kompetenca për të regjistruar akuza në dosjen zyrtare, duke përfshirë në një formë të kërkuar nga ligji i tyre kombëtar]; dhe

(c) [Autoriteti për të ndërmarrë vëzhgimin e personave dhe/ose operacione nën mbulim].

2. Një zyrtar, të cilit i janë akorduar kompetencat e specifikuar në paragrafin 1, gëzon të drejtën për të njëjtat mbrojtje si një zyrtar ekuivalent i [shëno emrin e Shtetit] sipas ligjit të [shëno emrin e Shtetit].

Kapitulli 6.

NDJEKJA PENALE DHE MASAT NDËSHKUESE

Hetimi i shkeljeve të trafikimit të mbetjeve është vetëm një hap i procesit të parandalimit dhe luftimit të trafikimit të mbetjeve; kërkohen gjithashtu procedura efektive penale. Ky kapitull trajton tema që lidhen me dy aspekte të procedurës penale: ndjekjen penale dhe masat ndëshkuese.

NDJEKJA PENALE

Siç u theksua në kapitullin 1, rolet e prokurorëve ndryshojnë midis vendeve. Në shumicën e sistemeve, funksionet kryesore të prokurorëve janë vendimi për ndjekjen penale dhe përfaqësimi i prokurorisë në gjykatë. Funksionet kryesore në disa juridiksione mund të përfshijnë gjithashtu hetimin e krimin, mbikëqyrjen e respektimit të rregullave të procedurës nga hetuesit, lirimimin e përkohshëm gjyqësor (“lirimimin me garanci pasurore”), marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe caktimit të dënimit, devijimin e autorëve në alternativa ndaj ndjekjes penale, mbështetjen e viktimave, rekomandimet në lidhje me caktimin e dënimit, mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve dhe trajtimin e personave në burgim.¹⁵⁵

Në këtë seksion, shqyrtohen disa çështje që lidhen me procedurën e prokurorisë: diskrecioni i prokurorisë dhe udhëzimet e ndjekjes dhe ekzekutimit, paraburgimi, alternativat ndaj gjyqimit dhe afatet e parashkrimit.¹⁵⁶

Diskrecioni i prokurorisë dhe udhëzimet për ndjekjen penale dhe ekzekutimin

Në disa Shtete, prokurorëve u jepet diskrecion për të vendosur nëse do të ndjekin penalisht shkeljet, qoftë me ligj ose nëpërmjet procedurave administrative. Kushtet për ushtrimin e këtij diskrecioni mund të përfshijnë interesin e komunitetit për ndjekjen penale ose jo të një shkeljeje dhe nevojën për të sjellë autorët para drejtësisë dhe për të penguar kryerjen e shkeljeve të ngjashme. Diskrecioni i prokurorisë mund të lidhet jo vetëm me vendimin për fillimin dhe vazhdimin e një ndjekjeje penale, por edhe me kërkesat për masa paraprake që

¹⁵⁵ Shih gjithashtu UNODC, *The Status and Role of Prosecutors*.

¹⁵⁶ Për udhëzime praktike për prokurorët, lexuesit mund të dëshirojnë gjithashtu të konsultojnë publikimin e WasteForce, *Guidance for Prosecutors of Waste Crime*.

kufizojnë lirinë personale, vendimet në lidhje me menaxhimin dhe prioritizimin e ngarkesës së çështjeve të prokurorëve dhe vendimet për të pranuar ujdite e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në disa Shtete, marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të jenë një mjet i dobishëm për prokurorët dhe mund t'u lejojnë prokurorëve të ngrenë çështje kundër shkelësve të nivelit të lartë duke siguruar dëshmi nga shkelësit e nivelit më të ulët. Në Shtete të tjera, prokurorët nuk ushtrojnë diskrecion të tillë.

Duke pasur parasysh dallimet në traditat ligjore në lidhje me diskrecionin e prokurorisë, ky udhëzues nuk përmban asnjë model të dispozitës përkitazi me atë temë. Për Shtetet që u japin prokurorëve diskrecionin nëse do të nisin dhe vazhdojnë ndjekjet penale, ekziston nevoja për të garantuar konsistencë në vendimmarrjen e prokurorisë se kur duhet të iniciohet, të vazhdohet ose të pushohet ndjekja penale dhe kur të pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë. Aty ku është e zbatueshme, Shtetet duhet të adoptojnë masat e duhura për të siguruar konsistencën, të tilla si udhëzime legislative ose jo-legislative për ushtrimin e diskrecionit.¹⁵⁷ Në përgjithësi, udhëzimet dhe politikat e ekzekutimit dhe ndjekjes penale të çështjeve mjedisore mund të jenë mjete të dobishme për informimin e palëve të interesuara në lidhje me mënyrat se si rregullatorët dhe autoritetet e prokurorisë i qasen funksioneve të tyre ligjore si dhe për përmirësimin e pajtueshmërisë.¹⁵⁸ Politika e ekzekutimit dhe e sanksioneve e Agjencisë së Mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar është një shembull i një dokumenti që informon palët e interesuara se si do të ushtrohen përgjegjësitë rregullatore.¹⁵⁹ Ajo përcakton rezultatet e dëshiruara të ekzekutimit dhe sanksioneve, parimet që zbatohen në veprimet rregullatore, qasjen e ndërmarrë ndaj ekzekutimit, kompetencat dhe procedurat e zbatueshme dhe mënyrën se si agjencia merr vendime për ekzekutim.

Paraburgimi

Trafikantët e mbetjeve nuk mund të sillen para drejtësisë nëse i shmangen juridiksionit të autoriteteve të ndjekjes penale dhe gjyqësorit. Trafikimi i mbetjeve nganjëherë kryhet nga shtetas të huaj ose nga persona që përndryshe mund të jenë me risk për arratisje. Është e domosdoshme që Shtetet, brenda kuadrit të tyre kushtetues dhe të drejtave të njeriut, të ndërmarrin hapa për të parandaluar që shkelësit të largohen nga vendi përpara gjykimit ose caktimit të dënimit. Në disa raste, risku i arratisjes së një shkelësi mund të kërkojë që shkelësi të mbahet në ndalim ndërsa pritet gjykimi. Në raste të tjera, masa të tilla si konfiskimi i pasaportës së një shkelësi mund të jenë të mjaftueshme për të zbutur riskun e arratisjes.

Neni 11, paragrafi 3, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që, në lidhje me shkeljet e përcaktuara sipas Konventës, secili Shtet palë të marrë masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe duke pasur parasysh të drejtat e mbrojtjes, për të siguruar që kushtet e vendosura në lidhje me vendimet për lirim në pritje të gjykimit ose apelit marrin parasysh nevojën për të siguruar praninë e të pandehurit në procedimet penale vijuese.

Operacionet e kundërligjshme në të cilat përfshihen grupet kriminale të organizuara mund të gjenerojnë fitime të konsiderueshme të tilla që shuma të mëdha parash mund të jenë në dispozicion të të dyshuarve dhe të akuzuarve, duke ua mundësuar atyre të paguajnë lirimin me garanci pasurore dhe të shmangin paraburgimin ndërsa pritet gjykimi ose apeli i tyre. Kështu, neni 11, paragrafi 3, i Konventës dhe modeli i dispozitës 22 inkurajojnë përdorimin e matur të paraburgimit duke kërkuar që Shtetet palë të marrin masat e nevojshme, në përputhje me ligjet e tyre përkatëse dhe me të drejtat e të dyshuarve dhe të akuzuarve, për të siguruar që ata nuk do të arratisen.

Ndërsa shqyrtimi i kësaj nuk kërkohet shprehimisht nga Konventa, mundësia që i dyshuari të ushtrojë ndikim mbi dëshmitarët, të manipulojë provat ose të ndërmarrë hapa të tjerë për të minuar administrimin e drejtësisë mund të duhet të merret parasysh në vendimmarrjen në lidhje me lirimin në procedurë paraprake ose paraburgimin. Prandaj, këta faktorë janë përmendur për t'u marrë parasysh në modelin e dispozitës legislative 22.

¹⁵⁷ Shih gjithashtu udhëzimin 17 të Udhëzimeve për Rolin e Prokurorëve, të adoptuara nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e krimit dhe trajtimin e shkelësve, i mbajtur në Havanë nga 27 gusht deri më 7 shtator 1990.

¹⁵⁸ Shih gjithashtu WasteForce, Guidance for Prosecutors of Waste Crime, ff. 18–19.

¹⁵⁹ Azhurnuar më 17 mars 2022. Në dispozicion këtu www.gov.uk

MODEL I DISPOZITËS 22: PARABURGIMI

1. Kur një person është akuzuar për një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli/...], gjykata mund të urdhërojë paraburgimin nëse ekziston një nga arsyet e renditura në paragrafin 2.
2. Gjukata mund të urdhërojë paraburgimin nëse bindet se ka indikacione serioze për fajësinë e të akuzuarit dhe se ekziston një risk i papranueshëm që personi, nëse nuk ndalohet, mund:
 - (a) Të mos paraqitet në procedimet penale vijuese;
 - (b) Të ushtrojë ndikim mbi një dëshmitar, të manipulojë provat ose të pengojë në ndonjë mënyrë tjetër rrjedhën e drejtësisë;
 - (c) Të kryejë një shkelje të mëtejshme; ose
 - (d) Të rrezikojë jetën, shëndetin ose sigurinë e një personi për të cilin pretendohet se është viktimë e shkeljes për të cilën personi akuzohet ose çdo personi tjetër.
3. Urdhri për paraburgimin e një personi sipas këtij neni nuk duhet të kalojë një periudhë prej [shëno afatin kohor]. Gjukata mund ta zgjasë afatin e paraburgimit nga paragrafi 2 i këtij neni me kërkesë të prokurorit. Periudha totale e paraburgimit nuk duhet të kalojë [shëno afatin kohor].
4. Paraburgimi nuk duhet të urdhërohet, të mbahet apo të zgjatet nëse objektivat e paraburgimit mund të arrihen me mjete më pak të ashpra. Në vend të paraburgimit, gjykata mund t'i vendosë kushte [personit/të akuzuarit] në pritje të gjykimit ose apelit për të siguruar praninë e tyre në procedimet penale vijuese dhe për të siguruar administrimin e drejtësisë, duke përfshirë sa vijon:
 - (a) [Sekuestrimi/konfiskimi] i dokumenteve të udhëtimit ose dokumenteve të tjera të identitetit të personit;
 - (b) Njoftimi i autoriteteve përkatëse në pikat e kontrollit kufitar;
 - (c) Mbajtja e një garancie pasurore;
 - (d) Kufizimet në lëvizjen e personit, të tilla si qëndrimi në shtëpi ose monitorimi elektronik i lëvizjeve;
 - (e) Masa të tjera që gjykata i konsideron të nevojshme dhe proporcionale për të parandaluar personin nga ushtrimi i ndikimit mbi dëshmitarët, manipulimi me provat ose pengimi i rrjedhës së drejtësisë në ndonjë mënyrë tjetër.

Alternativat ndaj gjykimit

Në disa juridiksione organet ligj-zbatuese, autoritetet mjedisore ose prokurorët mund të ushtrojnë diskrecion për të zgjidhur çështjet, kur është e përshtatshme, nëpërmjet alternativave ndaj gjykimit, të tilla si vërejtjet formale, njoftimet e ekzekutimit, programet e diversionit, pezullimi i dënimit dhe marrëveshjet për shtyrje të ndjekjes penale. Alternativat ndaj gjykimit mund të jenë veçanërisht të përshtatshme në rastet e shkeljeve të vogla dhe/ose për herë të parë dhe mund të jenë të papërshtatshme në lidhje me shkelje të rëndësishme ose të përsëritura. Faktorët që mund të jenë të rëndësishëm për të përcaktuar nëse duhet të ndiqet një alternativë ndaj gjykimit mund të përfshijnë dashjen dhe motivet e shkelësit, parashikueshmërinë e cenimit, ndikimet në mjedis dhe të tjera të shkeljes, nevojën për parandalim specifik ose të përgjithshëm, nëse shkelësi ka një histori të mosbindjes ose shkeljeve, qëndrimin e shkelësit ndaj shkeljes dhe masën në të cilën ai ka bashkëpunuar gjatë hetimit, veprimet e shkelësit për të ndrequr ndikimet e shkeljes dhe/ose kompensimin e viktimave, masat e vendosura nga shkelësi për të parandaluar shkeljet në të ardhmen dhe rrethanat personale të shkelësit.

Dy alternativa ndaj gjykimit, njoftimet e ekzekutimit dhe marrëveshjet për shtyrje të ndjekjes penale, diskutohen shkurtimisht në seksionet e mëposhtme. Shtetet mund të dëshirojnë gjithashtu të marrin në konsideratë alternativa të tjera, të tilla si ndërmjetësimi mjedisor dhe qasje të tjera të bazuara në drejtësinë restauruese.

Njoftimet e ekzekutimit

Njoftimet e ekzekutimit zakonisht lëshohen nga autoritetet kompetente mjedisore. Ato mund të lëshohen kur autoriteti beson se një person fizik ose juridik po shkel ose do të shkelë një ligj ose rregullore mjedisore

ose një kusht për një leje, licencë ose autorizim që ata zotërojnë. Njoftimet e ekzekutimit zakonisht specifikojnë hapat që duhet të ndërmerren për të ndrequr shkeljen e kryer ose të parashikuar. Duhet të përcaktohet dispozita që lejon marrësit të ushtrojnë apel për lëshimin e njoftimeve të ekzekutimit. Mosrespektimi i një njoftimi të ekzekutimit mund të përbëjë shkelje.

SHEMBULL KOMBËTAR: MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË TË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE

Akti për Mbrojtjen e Mjedisit, 1990

Seksioni 13 – Njoftimet e ekzekutimit

(1) Nëse autoriteti ekzekutues është i mendimit se personi që kryen një proces të përcaktuar sipas një autorizimi është në kundërvajtje me kushtet e autorizimit, ose ka të ngjarë të jetë në kundërvajtje me kushtet e tilla, autoriteti mund t'i dorëzojë atij një njoftim (“njoftim ekzekutimi”).

(2) Njoftimi i ekzekutimit—

(a) Thotë se autoriteti është i mendimit të përmendur;

(b) Specifikon çështjet që përbëjnë kundërvajtjen ose çështjet që e bëjnë të mundur që kundërvajtja të lindë, sipas rastit;

(c) Përcakton hapat që duhet të ndërmerren për të ndrequr kundërvajtjen ose për të ndrequr çështjet që e bëjnë të mundur që kundërvajtja të lindë, sipas rastit; dhe

(d) Përcakton periudhën brenda së cilës duhet të ndërmerren këta hapa.

(3) Sekretari i Shtetit, nëse e sheh të arsyeshme në lidhje me zhvillimin e një procesi të përcaktuar nga çdo person, mund t'i japë autoritetit ekzekutues udhëzime nëse autoriteti duhet të ushtrojë kompetencat e tij sipas këtij seksioni dhe për hapat të cilët duhet të merren sipas këtij seksioni.

(4) Autoriteti ekzekutues, në lidhje me çdo njoftim ekzekutimi që i ka lëshuar çdo personi, me anë të njoftimit me shkrim dorëzuar atij personi, mund ta tërheqë njoftimin.]

Seksioni 23 – Shkeljet ^a

(1) Është shkelje kur një person—

[...]

(c) nuk i bindet ose është në kundërvajtje ndaj një kërkesë ose ndalimi të vendosur sipas një njoftimi të ekzekutimit ose një njoftimi të ndalimit;

(2) Një person fajtor për një shkelje sipas paragrafit (a), (c) ose (l) të nën-seksionit (1) më sipër i nënshtrohet:

(a) dënimit në gjykim të drejtpërdrejtë, me gjobë ose me burgim për një afat jo më shumë se tre muaj, ose të dyja;

(b) dënimit në gjykim sipas aktakuzës, me gjobë ose me burgim për një afat jo më të gjatë se dy vjet, ose për të dyja.

[...]

^a Fragmenti i kësaj dispozite legislative zbatohet në Angli dhe Uells. Teksti i seksionit 23, para. 2 (a), të Aktit për Mbrojtjen e Mjedisit të vitit 1990 është i ndryshëm për aq sa zbatohet në Skoci. Shih gjithashtu www.legislation.gov.uk/ukpga/1990/43/section/23.

Marrëveshjet për shtyrjen e ndjekjes penale

Në lidhje me trafikimin e mbetjeve, marrëveshjet për shtyrje të ndjekjes penale mund t'u ofrohen të pandehurve që pranojnë të plotësojnë kushte të caktuara, si pagesa e kompensimit për dëmin mjedisor dhe riparimi i tij. Në sisteme të tjera ligjore, marrëveshjet për shtyrje të ndjekjes penale ose gjykimet e tjera alternative nuk janë të lejueshme.

Shtetet që përdorin mundësinë e marrëveshjeve për shtyrje të ndjekjes penale për shkeljet e trafikimit të mbetjeve duhet të sigurojnë që ligjet ose udhëzimet që rregullojnë përdorimin e tyre ndalojnë ose dekurajojnë marrëveshjet për mbylljen e çështjeve vetëm në bazë të pagesës monetare nga shkelësi. Pagesat monetare nga anëtarë të grupeve kriminale të organizuara ose persona juridikë të përfshirë në trafikimin e mbetjeve janë me risk të lartë për të pasur origjinë të paligjshme. Ekziston gjithashtu rreziku që grupet kriminale të organizuara thjesht të përfshijnë pagesat sipas marrëveshjeve për shtyrje të ndjekjes penale si një kosto operative të përfshirjes në trafikimin e mbetjeve, pa pasur ndonjë efekt parandalues në veprimet e tyre kriminale.

SHEMBULL: FRANCË

Kodi i Procedurës Penale

Neni 41-1-3

Me kusht që ndjekja publike të mos ketë nisur, prokurori publik mund t'i ofrojë një personi juridik të akuzuar për një ose më shumë shkelje të zakonshme të parashikuara në rregulloret mjedisore ose shkelje të ndërlidhura, duke përjashtuar krimet e rënda dhe shkeljet e zakonshme kundër personit, siç përcaktohet në Librin II të Kodi Penal, mundësinë e lidhjes së një marrëveshjeje gjyqësore me interes publik që vendos një ose më shumë nga detyrimet e mëposhtme:

- (1) Të paguajë një gjobë me interes publik në thesar. Shuma e një gjobe të tillë përcaktohet në mënyrë proporcionale dhe, sipas rastit, duke marrë parasysh përfitimet që rrjedhin nga shkeljet e konstatuara se janë kryer, deri në një kufi prej 30 për qind të xhiros mesatare vjetore të llogaritur në bazë të tre xhirove vjetore më të fundit të njohura në datën e konstatimit të shkeljeve. Pagesa mund të bëhet me këste, sipas programit të përcaktuar nga prokurori publik, për një periudhë të specifikuar në marrëveshje dhe jo më të gjatë se një vit;
- (2) Të normalizojë situatën e tij në raport me ligjin ose rregulloret brenda kuadrit të një programi të pajtueshmërisë që zgjat maksimumi tre vjet, nën mbikëqyrjen e organeve kompetente të Ministrisë së Mjedisit dhe enteve të Agjencisë Franceze të Biodiversitetit;
- (3) Të sigurojë, brenda periudhës maksimale prej tre vjetësh dhe nën mbikëqyrjen e të njëjtave ente, ndreqjen e dëmit mjedisor si pasojë e shkeljeve të kryera.

Kostot e pësura nga entet kompetente të Ministrisë së Mjedisit ose entet e Agjencisë Franceze të Biodiversitetit për thirrjen e ekspertëve ose personave a autoriteteve të kualifikuara për t'i ndihmuar ata në kryerjen e vlerësimeve teknike të nevojshme për veprimtaritë e tyre mbikëqyrëse barten nga personi juridik në fjalë, deri në një kufi të përcaktuar sipas marrëveshjes. Këto shpenzime nuk rimbursohen nëse ekzekutimi i marrëveshjes pezullohet.

Kur pala e dëmtuar është identifikuar, përveç rastit kur personi juridik i akuzuar mund të provojë se e ka riparuar dëmin e shkaktuar, marrëveshja parashikon gjithashtu shumën dhe kushtet e kompensimit për dëmin e shkaktuar nga shkelja, që duhet të paguhet brenda një afati që nuk është më i gjatë se një vit.

Procedura e zbatueshme është parashikuar në nenin 41-1-2 dhe në tekstet e adoptuara për qëllime të zbatimit të atij neni. Urdhri i vlefshmërisë, shuma e gjobës me interes publik dhe marrëveshja publikohen në uebsajtet e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mjedisit dhe komunës në të cilën është kryer shkelja ose, nëse komuna nuk ka uebsajt, atë të shoqatës publike të bashkëpunimit ndërkomunal të cilës i përket komuna.

Afatet e parashkrimit

Në disa juridiksione, fillimi i një ndjekjeje penale kufizohet me periudha kohore të njohura si “afate të parashkrimit” sipas ligjeve të njohura si “ligjet e parashkrimit”. Në juridiksione të tjera, afatet e parashkrimit nuk zbatohen për veprat penale. Neni 11, paragrafi 5, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon nga Shtetet palë të vendosin periudha kufizimi për ndjekjen penale të veprave penale për të siguruar që afatet e parashkrimit që zbatohen për shkeljet e mbuluara nga Konventa janë mjaftueshëm të gjata, veçanërisht kur

autori i pretenduar qëllimisht i shmanget organeve të drejtësisë. Shtetet duhet të sigurojnë që dispozitat legjislative që zbatohen në këto detyrim sipas Konventës kundër Krimit të Organizuar shtrihen edhe për shkeljet që mbulojnë nga ky udhëzues. Legjislacioni duhet të jetë gjithashtu i qartë për sa i përket kohës kur fillon të ecë afati i parashkrimit (për shembull, nëse kjo bazohet në kohën e kryerjes ose në kohën e zbulimit) dhe rrethanat në të cilat afati i parashkrimit mund të pezullohet, si për shembull kur shkelësi qëllimisht i shmanget organeve të drejtësisë.

Në disa Shtete, ecja e afatit të parashkrimit mund të pezullohet ndërsa provat mbledhen jashtë vendit. Shtetet duhet të konsiderojnë nëse një dispozitë e tillë do të ishte e dëshirueshme në sistemin e tyre ligjor, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çdo afati të parashkrimit të zbatueshëm për shkeljet e trafikimit të mbetjeve dhe vështirësitë e mundshme në mbledhjen e provave jashtë vendit. Çfarëdo qoftë qasja ndaj afateve të parashkrimit që ndërmerret nga një Shtet, Shteti duhet të sigurojë që procesi në prokurori është mjaftueshëm i racionalizuar për t'i sjellë ndjekjet penale në gjykim me kohë.

Modeli i dispozitës 23 ofron një shembull të një dispozite që përcakton afatin e parashkrimit të zbatueshëm për shkeljet e trafikimit të mbetjeve. Paragrafi 2 i kësaj dispozite parashikon pezullimin e ecjes së një afati parashkrimi kur i dyshuari qëllimisht i shmanget organeve të drejtësisë.

MODEL I DISPOZITËS 23: AFATI I PARASHKRIMIT

1. Në varësi nga paragrafi 2, afati i parashkrimit për procedimet penale të shkeljeve për të cilat zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] është [shëno numrin e viteve] pas kryerjes së shkeljes.
2. Kur një person i dyshuar për një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] synon t'i shmanget administrimit të drejtësisë, afati i parashkrimit nga paragrafi 1 nuk ec për sa kohë që zgjat shmangia e tillë.

MASAT NDËSHKUESE DHE ÇAKTIMI I DËNIMIT

Legjislacioni që përcakton shkeljet e mbuluara nga ky udhëzues duhet të parashikojë masa ndëshkuese të përshtatshme dhe duhet të synojë të sigurojë që personat e shpallur fajtorë për shkelje të trafikimit të mbetjeve marrin dënimet e përshtatshme. Duke marrë parasysh se qasjet ndaj përcaktimit të masave ndëshkuese dhe çaktimit të dënimit për shkelësit ndryshojnë shumë midis Shteteve sipas traditës së tyre ligjore, udhëzuesi nuk ofron asnjë model të dispozitës për masat ndëshkuese dhe çaktimin e dënimit. Përkundrazi, ky seksion parashtron disa çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë nga Shtetet gjatë hartimit të dispozitave legjislative në lidhje me masat ndëshkuese dhe çaktimin e dënimit. Në këtë seksion, disa nga konsideratat më të rëndësishme që qëndrojnë në themel të çaktimit të dënimit për trafikimin e mbetjeve shqyrtohen përpara se të merren në konsideratë llojet e veçanta të sanksioneve.

Konsideratat në themel të dënimit

Sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese

Konsideratat mbisunduese në përcaktimin e masave ndëshkuese të përshtatshme për shkeljet e përfshira në këtë udhëzues janë se masat ndëshkuese duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Këto parime janë pasqyruar në tekstin e Konventës kundër Krimit të Organizuar. Neni 11, paragrafi 1, i Konventës kërkon që secili Shtet palë që kryerjen e një shkeljeje të përcaktuar në përputhje me Konventën, t'ia nënshtrojë sanksioneve që marrin parasysh peshën e shkeljes. Neni 11, paragrafi 2, i referohet nevojës për të penguar kryerjen e këtyre shkeljeve. Neni 10, paragrafi 4, kërkon nga Shtetet palë të sigurojnë që personat juridikë që

mbahen përgjegjës në përputhje me nenin 10 i nënshtrohen “sanksioneve penale ose jo-penale efektive, proporcionale dhe dekurajuese”.

Kërkesat për sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese për trafikimin e mbetjeve përfshihen gjithashtu në instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë mbetjet. Neni 4, paragrafi 4, i Konventës së Bazelit parashikon gjithashtu sa vijon:

Secila Palë merr masa të përshtatshme ligjore, administrative dhe të tjera për zbatimin dhe ekzekutimin e dispozitave të kësaj Konvente, duke përfshirë masat për parandalimin dhe ndëshkimin e veprimeve në kundërshtim me Konventën.

Neni 9, paragrafi 2, i Konventës së Bamakos parashikon sa vijon:

Secila Palë vendos legjislacionin e përshtatshëm kombëtar për caktimin e masave ndëshkuese në procedurë penale për të gjithë personat që kanë planifikuar, kryer ose ndihmuar importet e tilla të kundërligjshme. Këto masa ndëshkuese duhet të jenë mjaftueshëm të larta për të ndëshkuar dhe parandaluar veprimet e tilla.

Në Bashkimin Evropian, kërkesat për Shtetet anëtare për të vendosur masa ndëshkuese “efektive, proporcionale dhe dekurajuese” për trafikimin e mbetjeve janë përcaktuar në Direktivën për Krimin Mjedisor,¹⁶⁰ Direktivën Kuadër për Mbetjet¹⁶¹ dhe Rregulloren për Dërgesat e Mbetjeve¹⁶²

Parimi i proporcionalitetit të dënimit është një parim i përgjithshëm i së drejtës penale i përbashkët për sistemet ligjore kombëtare. Për më tepër, ai mbrohet nga e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut dhe është mishëruar në instrumente të tilla si Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit)¹⁶³ dhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për masat pa heqje lirie (Rregullat e Tokios).¹⁶⁴

Shumë nga shkeljet e mbuluara nga ky udhëzues janë krime të rënda. Është e rëndësishme që masat ndëshkuese për këto shkelje të pasqyrojnë natyrën e tyre të rëndë dhe të jenë të krahasueshme me sanksionet për krime të tjera të rënda. Ato duhet të pasqyrojnë dënimin e komunitetit për trafikimin e mbetjeve dhe të luajnë rol parandalues efektiv. Në të njëjtën kohë, jo të gjitha shkeljet e përfshira në udhëzues kanë të njëjtën peshë. Masa ndëshkuese për secilën shkelje duhet të jetë proporcionale me peshën e saj. Për më tepër, rrethanat e secilës shkelje dhe të secilit shkelës janë pafundësisht të ndryshme. Dënimet në dispozicion të gjyqtarëve duhet të jenë mjaft fleksibël për të marrë parasysh rrethanat individuale të secilit rast.

Faktorët rëndues dhe lehtësues

Një rrjedhim i kërkesës që dënimet të jenë proporcionale me peshën e shkeljes është kërkesa që dënimet duhet të marrin parasysh rrethanat përkatëse të kryerjes së shkeljes. Rrethanat që kanë tendencë të rritin peshën e shkeljes ose fajësinë e shkelësit, ose të kërkojnë dënime më të larta për arsye të tjera, njihen si faktorë rëndues. Rrethanat që kanë tendencë të ulin peshën e shkeljes ose fajësinë e shkelësit, ose të kërkojnë dënime më të ulëta për arsye të tjera, njihen si faktorë lehtësues.

Në juridiksione të ndryshme janë marrë qasje të ndryshme ndaj faktorëve rëndues dhe lehtësues. Në disa juridiksione, dispozitat legjislative kërkojnë dënime më të ashpra, të tilla si dënime minimale dhe/ose maksimale më të larta, kur ekzistojnë faktorë të veçantë rëndues. Në juridiksione të tjera, dispozitat ligjore përcaktojnë faktorët përkatës që duhet të merren parasysh nga gjyqtarët që caktojnë dënimin ndërsa vendosin për dënimin e përshtatshëm. Në disa raste, lista specifike të faktorëve rëndues dhe lehtësues do të

¹⁶⁰ Direktivë nr. 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal, neni 5.

¹⁶¹ Direktivë nr. 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për mbetjet dhe që shfuqizon disa direktiva të caktuara, neni 36, para. 2.

¹⁶² Rregullore (KE) nr. 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për dërgesat e mbetjeve, neni 50, para. 1.

¹⁶³ Asambleja e Përgjithshme, rezolutë 40/33, aneks, rregullat 5.1 dhe 17.1.

¹⁶⁴ Asambleja e Përgjithshme, rezolutë 45/110, aneks, rregullat 2.3 dhe 3.2.

përcaktohen me ligj për shkelje të veçanta. Në juridiksione të tjera, gjyqtarët që caktojnë dënimin do të mbështeten në listat e përgjithshme të faktorëve të rëndësishëm për caktimin e dënimit për të gjitha veprat penale. Disa juridiksione përdorin një kombinim të këtyre qasjeve, në varësi nga legjislacioni dhe shkelja në fjalë. Secili Shtet duhet të përcaktojë se si faktorët rëndues dhe lehtësues merren parasysh në caktimin e dënimit të shkelësve për trafikimin e mbetjeve dhe shkeljet e lidhura me të, duke marrë parasysh detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga qasja e ndërmarrë, një sërë faktorësh rëndues dhe lehtësues që sugjerohen të merren parasysh janë paraqitur më poshtë.

Pasi gjyqtari që cakton dënimin të ketë marrë në konsideratë të gjithë faktorët rëndues dhe lehtësues përkatës, gjyqtari që cakton dënimin duhet të bëjë një “hap prapa” për të shqyrtuar nëse dënimi i propozuar, në tërësi, i përmbush objektivat e dënimit — domethënë, nëse dënimi është efektiv, proporcional dhe dekurajues.

Faktorët rëndues

Rrethanat që mund të konsiderohen si faktorë rëndues, të cilat kërkojnë dënime më të larta për një shkelje të mbuluar nga ky udhëzues, mund të përfshijnë sa vijon:

- (a) Çdo dëm i shkaktuar ose që ka gjasa të shkaktohet nga shkelja;
- (b) Vendi ku ka ndodhur shkelja, tërësisht ose pjesërisht, duke përfshirë nëse shkelja është kryer pranë banesave, shkollave, bagëtimeve ose zonave të ndjeshme mjedisore (p.sh. një zonë e caktuar si e mbrojtur ose me rëndësi të madhe për biodiversitetin);
- (c) Lloji dhe karakteristikat e mbetjeve me të cilat ka të bëjë shkelja, duke përfshirë çdo karakteristikë të rrezikshme;
- (d) Sasia ose vëllimi i mbetjeve me të cilat ka të bëjë shkelja;
- (e) Kur sjellja e të pandehurit përfshin riskun e dëmtimit ose vdekjes, nëse dëmtimi ose vdekja e tillë ka ndodhur realisht;
- (f) Madhësia e çdo përfitimi direkt ose indirekt financiar ose përfitimi material tjetër për shkelësin ose për çdo person tjetër si rezultat i shkeljes;
- (g) Madhësia e çdo humbjeje direkte ose indirekte financiare ose humbjeje materiale tjetër për një person tjetër që është shkaktuar nga shkelja, duke përfshirë kostot e pastrimit dhe ndreqjes së një mjedisi, habitati ose vendndodhjeje;
- (h) Kur shkelja është kryer si pjesë e veprimtarisë së një grupi kriminal të organizuar;
- (i) Kur shkelësi ka ushtruar rol të drejtimit ose të menaxhimit në grupin kriminal të organizuar;
- (j) Nëse shkelja ishte pjesë e një modeli të veprimtarisë kriminale në vijimësi;
- (k) Nëse shkelësi kishte kryer më parë shkelje të lidhur ose të ngjashme, pavarësisht nëse shkelësi ishte akuzuar ose shpallur fajtor në lidhje me shkeljen e tillë;
- (l) Nëse shkelësi ka tentuar të pengojë administrimin e drejtësisë gjatë hetimit, ndjekjes penale ose caktimit të dënimit të shkeljes;
- (m) Kur shkelja është kryer nga një nëpunës qeveritar;
- (n) Kur shkelja është kryer nga një person në një pozitë besimi ose autoriteti, duke përfshirë titullarin e një lejeje ose certifikate relevante.

Kur një faktor rëndues është tashmë element i shkeljes, ose element i një shkeljeje tjetër për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor që rrjedh nga e njëjta shkelje, ky faktor nuk duhet të konsiderohet gjithashtu si një faktor rëndues për shkeljen në fjalë. Disa nga faktorët rëndues të lartpërmendur janë elementë të shkeljeve të përcaktuara në këtë udhëzues, dhe për këtë arsye nuk do të ishte me vend të përdoren për të rritur dënimin e shkelësit në rrethanat kur një shkelësi i është caktuar dënimi ose po i caktohet dënimi për një shkelje të tillë. Për shembull, faktori rëndues i kryerjes si pjesë e veprimtarisë së një grupi kriminal të organizuar nuk duhet të zbatohet kur shkelësi është shpallur fajtor edhe për veprën penale të pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar. Një shembull i dytë do të ishte që një shkelës nuk mund të jetë përgjegjës për organizimin ose drejtimin e kryerjes së një vepre penale dhe gjithashtu t'i jepet një dënim edhe më i lartë për shkak të një roli të drejtimit ose të menaxhimit brenda një grupi kriminal të organizuar.

SHEMBULL: AUSTRALIA***Akti për Veprimtarinë e Mbrojtjes së Mjedisit, 1997 (NSW)*****Seksioni 241 – Çështjet që duhen marrë parasysh në caktimin e masës ndëshkuese**

(1) Në caktimin e një mase ndëshkuese për një shkelje sipas këtij Akti ose të rregulloreve, gjykata duhet të marrë parasysh sa vijon (për aq sa janë relevante)—

- (a) masën e dëmit të shkaktuar ose që ka gjasë t'i shkaktohet mjedisit nga kryerja e shkeljes,
 - (b) masat praktike që mund të merren për të parandaluar, kontrolluar, pakësuar ose zbutur atë dëm,
 - (c) masën në të cilën personi që ka kryer shkeljen mund të ketë parashikuar në mënyrë të arsyeshme dëmin e shkaktuar ose që ka gjasë t'i shkaktohet mjedisit nga kryerja e shkeljes,
 - (d) masën në të cilën personi që ka kryer shkeljen ka pasur kontroll mbi shkaqet nga të cilat ka lindur shkelja,
 - (e) nëse, gjatë kryerjes së shkeljes, personi ishte duke iu bindur urdhrave të një punëdhënësi ose punonjësi mbikëqyrës,
 - (f) praninë e asbestit në mjedis.
- (2) Gjykata mund të marrë parasysh edhe çështje të tjera që i konsideron relevante.

Faktorët lehtësues

Rrethanat që mund të konsiderohen si faktorë lehtësues, të cilat kërkojnë dënime më të ulëta për një shkelje të mbuluar nga ky udhëzues mund të përfshijnë sa vijon:

- (a) Lloji dhe karakteristikat e mbetjeve me të cilat ka të bëjë shkelja, duke përfshirë mungesën e ndonjë karakteristike të rrezikshme;
- (b) Sasia ose vëllimi i mbetjeve të përfshira në shkelje;
- (c) Kur shkelja nuk ka shkaktuar ose rrezikuar ndonjë dëm të dallueshëm;
- (d) Kur shkelja nuk është kryer për përfitime financiare ose përfitime materiale të tjera;
- (e) Kur shkelësi nuk ka marrë asnjë ose ka marrë pak përfitim financiar ose përfitim material tjetër nga shkelja;
- (f) Kur shkelësi kishte një rol të nivelit më të ulët ose rol minor në shkelje;
- (g) Kur shkelësi ka pasur njohuri ose kuptim të kufizuar rreth shkeljes;
- (h) Kur shkelësi ka kryer shkeljen nën ndikimin e shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit;
- (i) Nëse shkelësi ka vuajtur ose vuan nga aftësia e zvogëluar mendore në kohën e shkeljes ose në kohën e caktimit të dënimit;
- (j) Hapat e ndërmarrë nga shkelësi për të korrigjuar ose zbutur ndikimet e shkeljes;
- (k) Kur shkelësi ka treguar pendim për shkeljen;
- (l) Kur shkelësi ka bashkëpunuar vullnetarisht duke ofruar informacion ose duke ndihmuar ndryshe autoritetet kompetente, duke përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të mbetjeve ose shkeljeve të lidhura me të;
- (m) Kur shkelësi është deklaruar fajtor, veçanërisht kur i pandehuri pranoi fajësinë në fazë të hershme;

- (n) Kur shkelësi nuk ka pasur asnjë precedent të mëparshëm penal ose nuk ka pasur precedentë të mëparshëm penalë përkatës ose nuk ka dënime të kohëve të fundit;
- (o) Kur shkelësi përndryshe kishte një karakter të mirë paraprak;
- (p) Moshë e shkelësit në kohën e shkeljes ose në kohën e caktimit të dënimit;
- (q) Nëse shkelësi është kujdestari i vetëm ose kryesor për të afërmit në ngarkim;
- (r) Çdo aftësi e kufizuar fizike ose gjendje e rëndë mjekësore që kërkon trajtim urgjent, intensiv ose afatgjatë;
- (s) Çdo çrregullim mendor, çrregullim zhvillimor ose dëmtim neurologjik përkatës.

SHEMBULL: ITALIA

Kodi Penal

Neni 452-decies – Pendimi aktiv

Masat ndëshkuese të parashikuara për shkeljet e përmendura në këtë titull, për konspiracionin kriminal nga neni 416 në formë të rënduar sipas nenit 452-octies, si dhe për shkeljen nga neni 260 i dekretit legjislativ Nr. 152 të 3 prillit 2006 dhe ndryshimeve vijuese, reduktohen nga përgjysmë deri në dy të tretat për këdo që përpiqet të parandalojë që veprimtaria kriminale të çojë në pasoja të mëtejshme ose për këdo që, përpara hapjes së seancës në shkallën e parë, siguron konkretisht sigurinë, ndreqjen dhe, kur është e mundur, rivendosjen e gjendjes së vendeve, dhe reduktohen nga një e treta deri në përgjysmë për këdo që ndihmon konkretisht autoritetet policore ose gjyqësore në rikonstruktimin e fakteve, identifikimin e autorëve dhe heqjen e burimeve që kanë të bëjnë me kryerjen e shkeljeve të sipërpërmendura.

Afati i parashkrimit pezullohet kur gjyqtari, me kërkesën e të pandehurit dhe përpara hapjes së seancës në shkallën e parë, urdhëron pezullimin e procedimit për një periudhë të arsyeshme kohore, në çdo rast jo më shumë se dy vjet dhe që mund të zgjatet maksimum për një vit tjetër, me qëllim që të mundësohet kryerja e aktiviteteve në vijim të përmendura në paragrafin e mëparshëm.

Udhëzimet për caktimin e dënimit

Disa vende kanë adoptuar udhëzime për përdorim nga gjyqtarët gjatë caktimit të dënimit për shkelësit, duke përfshirë shkeljet mjedisore siç janë shkeljet e mbetjeve. Qëllimi kryesor i udhëzimeve për caktimin e dënimit është shpesh promovimi i konsistencës në caktimin e dënimeve, por ato gjithashtu mund të nxisin besimin e publikut në raport me caktimin e dënimeve dhe në raport me sistemin e drejtësisë penale më gjerësisht ¹⁶⁵

Secili Shtet duhet të vendosë nëse përdorimi i udhëzimeve për caktimin e dënimit do të ishte i dobishëm sipas sistemit të tij ligjor. Futja e një sistemi për nxjerrjen dhe përdorimin e udhëzimeve për caktimin e dënimit është një reformë që ka të ngjarë të jetë përtej fushëveprimit të legjislacionit që synon drejtpërdrejt parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve. Megjithatë, për Shtetet që janë të interesuara të vendosin udhëzime për caktimin e dënimeve ose të rishikojnë sistemet ekzistuese për nxjerrjen dhe përdorimin e udhëzimeve për caktimin e dënimit, ky seksion ofron disa udhëzime bazë. Diskutimi i konsideratave në këtë seksion nuk duhet të konsiderohet si shterues.

¹⁶⁵ Julian V. Roberts dhe Andrew Ashworth, "The evolution of sentencing policy and practice in England and Wales, 2003–2015", *Crime and Justice*, vol. 45 (2016), ff. 344–345.

Kompetenca për të regjistruar një shpallje të fajit penal dhe për të caktuar dënimin penal është një ushtrim i pushtetit gjyqësor. Ligjvënësit dhe politikëbërësit që shqyrtojnë futjen e udhëzimeve për caktimin e dënimit, në radhë të parë duhet të kujtojnë se qëllimi i udhëzimeve për caktimin e dënimit është të drejtohet ushtrimi i pushtetit gjyqësor dhe jo të uzurpohet ai. Ligjvënësit nuk duhet të kufizojnë procesin e përcaktimit gjyqësor të dënimit deri në atë masë sa të pengojnë gjykatat të cilat caktojnë dënimin që të ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore. Megjithatë, ligjvënësit mund të luajnë një rol në nxitjen e ushtrimit të rregullt të kompetencave gjyqësore duke vendosur procedura për nxjerrjen dhe përdorimin e udhëzimeve.

Një çështje paraprake në zhvillimin e një sistemi për nxjerrjen dhe përdorimin e udhëzimeve për caktimin e dënimit është të qartësohet qëllimi i tyre. Më sipër, u sugjerua që qëllimi kryesor i udhëzimeve për caktimin e dënimit shpesh mendohet të jetë promovimi i konsistencës në caktimin e dënimeve, por ofrimi i udhëzimeve të tilla gjithashtu mund të nxisë besimin e publikut në raport me caktimin e dënimeve dhe në raport me sistemin e drejtësisë penale. Në konstatimin e qëllimeve të udhëzimeve të tilla, ia vlen të sqarohet se çfarë nënkuptohet me “konsistencë”. Në këtë drejtim, literatura në lidhje me caktimin e dënimit ka bërë dallimin midis konsistencës së qasjes, konsistencës së rezultatit dhe njëtrajtshmërisë së rezultatit. Konsistenca e qasjes ka të bëjë me zbatimin e një metode konsistente në procesin e caktimit të dënimit, ndërsa konsistenca në rezultat përqendrohet në rezultatit e procesit të caktimit të dënimit.¹⁶⁶ Njëtrajtshmëria e rezultatit zbatohet kur shkelës të ndryshëm që kryejnë shkelje në rrethana të ndryshme marrin të njëjtin dënim. Përqendrimi në konsistencën e qasjes ofron mundësi më të mëdha për gjyqtarët që të marrin parasysh dallimet në rrethana duke nxitur gjithashtu konsistencë, por jo njëtrajtshmëri, në rezultate.¹⁶⁷ Njëtrajtshmëria e rezultatit është e padëshirueshme sepse është në kundërshtim me një nga konsideratat kryesore që qëndron në themel të caktimit të dënimit që u diskutua në këtë kapitull, parimin e proporcionalitetit.¹⁶⁸

Qartësia rreth qëllimit të udhëzimeve për caktimin e dënimit dhe për çështje të tilla si kuptimi i “konsistencës” është e rëndësishme sepse nënvizon rëndësinë e projektimit të çdo sistemi të udhëzimeve për caktimin e dënimit dhe metodave me të cilat sistemi synon të arrijë qëllimet e tij. Për shembull, një sistem që përqendrohet në konsistencën e qasjes mund të theksojë përshkrimin e një sekuence të hapave që gjykatat duhet të ndjekin kur vendosin për një dënim të përshtatshëm, në vend që të specifikojnë kufijtë e dënimit dhe të dekurajojnë ose kufizojnë gjyqtarët që të japin dënime jashtë atyre kufijve.¹⁶⁹

Një pyetje tjetër për ligjvënësit dhe politikëbërësit është organi i duhur për të nxjerrë udhëzimet për caktimin e dënimit dhe përbërja e atij organi. Një organ i pavarur i përbërë nga anëtarë aktualë ose të mëparshëm të gjyqësorit dhe persona nga profesione të tjera përkatëse, si profesionistë dhe studiues akademikë të drejtësisë penale, mund të jetë organi i duhur për nxjerrjen e udhëzimeve.

Në fund, ligjvënësit dhe politikëbërësit duhet të kenë parasysh vështirësitë e parashikimit të të gjitha konfigurimeve të mundshme të rrethanave që gjyqtarëve do t'u kërkohet t'i marrin parasysh për të caktuar dënimin. Udhëzimet për caktimin e dënimit ofrojnë drejtim për përcaktimin e dënimit të përshtatshëm të zbatueshëm për shumicën e rasteve, por ato mund të mos jenë të përshtatshme për rastet që bien në skajet ekstreme të shkeljes – pra, në çështjet me rrethana të skajshme rënduese ose lehtësuese.¹⁷⁰ Duhet të sigurohet që legjislacioni që parashikon përdorimin e udhëzimeve për caktimin e dënimit u mundëson gjykatave të devijojnë nga kufijtë e përfshirë në udhëzimet për caktimin e dënimit, ku një gjë e tillë do të ishte në interes të drejtësisë.

¹⁶⁶ Sarah Poppleton dhe të tjerë, “A review of consistency in sentencing” (London, Sentencing Council, 2021), f. 10.

¹⁶⁷ Po aty; dhe Julian V. Roberts, “Sentencing guidelines in England and Wales: recent developments and emerging issues”, vol. 76, *Law and Contemporary Problems*, (2013), f. 21..

¹⁶⁸ Shih “Sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese”, më sipër.

¹⁶⁹ Roberts, “Sentencing guidelines in England and Wales”, f. 5.

¹⁷⁰ Po aty., f. 13.

SHEMBULL: MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË TË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE**Udhëzimet për caktimin e dënimit për shkeljet mjedisore**

Në Mbretërinë e Bashkuar, Akti për Magjistratët Mjeko-Ligjorë dhe Drejtësinë i vitit 2009 themeloi Këshillin për Çështje të Dënimeve për Anglinë dhe Uellsin (“Këshilli për Çështje të Dënimeve”).^a Këshilli për Çështje të Dënimeve është i autorizuar të përgatisë dhe, pas konsultimeve, të nxjerrë udhëzime për caktimin e dënimit, qofshin ato të natyrës së përgjithshme ose të kufizuara për një shkelje të caktuar, kategori të veçantë të shkeljeve ose kategori të veçantë të shkelësve.^b Kur përgatit udhëzimet për caktimin e dënimit, Këshilli për Çështje të Dënimeve duhet të ketë parasysh që udhëzimet për caktimin e dënimit në lidhje me një shkelje të caktuar të jenë të strukturuar sipas një skeme me kufij të dënimit dhe pikënisje të përcaktuara sipas Aktit.^c Kur caktojnë dënimin për një shkelje, gjykatave u kërkohet të ndjekin çdo udhëzim për caktimin e dënimit që është relevant për çështjen e shkelësit, përveç nëse binden se kjo do të ishte në kundërshtim me interesat e drejtësisë.^d

Këshilli për Çështje të Dënimeve ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për caktimin e dënimit, duke përfshirë një udhëzues të përgjithshëm mbi parimet kryesore për caktimin e dënimit^e dhe udhëzimet për caktimin e dënimit për shkelje mjedisore. Udhëzimet për caktimin e dënimit për shkelje mjedisore përfshijnë, në momentin e hartimit të këtij udhëzuesi, udhëzime për caktimin e dënimit të shkeljeve të “depozitimit, trajtimit ose asgjësimit etj., të paautorizuar ose të dëmshëm të mbetjeve” dhe “shkarkimit të kundërligjshëm në ajër, tokë dhe ujë”, me udhëzime të veçanta për personat fizikë dhe juridikë^f dhe udhëzime të përgjithshme për shkelje të tjera mjedisore.^g

Udhëzimet në lidhje me shkeljet specifike mjedisore përcaktojnë një proces me 12 hapa që duhet ndjekur në caktimin e dënimit të shkelësve për shkelje të tilla. Për personat fizikë dhe juridikë janë përcaktuar hapa të ndryshëm. Procesi për caktimin e dënimit i përcaktuar në udhëzime përfshin, ndër hapa të tjerë, përcaktimin e kategorisë së përshtatshme të shkeljes duke iu referuar fajësisë së shkelësit, identifikimin e pikënisjes së zbatueshme dhe kufijve të kategorisë, identifikimin dhe marrjen parasysh të faktorëve përkatës rëndues dhe lehtësues, dhe shqyrtimin nëse dënimi, në tërësi, është proporcional dhe përmbush, në mënyrë të drejtë, objektivat e ndëshkimit, parandalimit dhe heqjes së përfitimit që rrjedh nga kryerja e shkeljes. Udhëzimet përfshijnë lista jo-shteruese të faktorëve përkatës rëndues dhe lehtësues. Udhëzimet trajtojnë gjithashtu dhënien e urdhrave plotësues, duke përfshirë urdhrat e ndreqjes, urdhrat e konfiskimit dhe urdhrat e skualifikimit.^h

^a Coroners and Justice Act 2009, seksioni 118.

^b Po aty, seksioni 120.

^c Po aty, seksioni 121.

^d Sentencing Code, seksioni 59.

^e Shih United Kingdom, Sentencing Council, “General guideline: overarching principles” (në fuqi nga data 1 tetor 2019). Në dispozicion këtu www.sentencing-council.org.uk.

^f Shih United Kingdom, Sentencing Council, “Organisations: unauthorised or harmful deposit, treatment or disposal etc of waste/Illegal discharges to air, land and water” (në fuqi nga data 1 korrik 2014), dhe “Individuals: unauthorised or harmful deposit, treatment or disposal etc of waste/Illegal discharges to air, land and water”. Në dispozicion këtu www.sentencingcouncil.org.uk.

^g Shih United Kingdom, Sentencing Council, “Organisations: unauthorised or harmful deposit, treatment or disposal etc of waste/Illegal discharges to air, land and water” (në fuqi nga data 1 korrik 2014), dhe “Individuals: unauthorised or harmful deposit, treatment or disposal etc of waste/Illegal discharges to air, land and water”. Në dispozicion këtu www.sentencingcouncil.org.uk.

^h Për një diskutim të mëtejshëm të urdhrave të tillë, shih “Urdhrrat plotësues” më poshtë

Llojet e sanksioneve

Seksioni i mëparshëm përvijoi disa nga konsideratat më të rëndësishme që qëndrojnë në themel të caktimit të dënimit për trafikimin e mbetjeve. Në këtë seksion, shqyrtimi tani kalon te llojet specifike të sanksioneve që mund të urdhërohen kur sintetizohen këto dhe konsiderata të tjera përkatëse. Përpara se të kalohet në të ashtuquajturit urdhra plotësues, shqyrtohen burgimi dhe masat ndëshkuese pa heqje lirie. Në fund, është përfshirë një seksion specifik mbi sanksionet për personat juridikë, i cili përfshin një model të dispozitës legjislative.

Burgimi

Shkeljet më të rënda të përfshira në këtë udhëzues duhet t’i nënshtrohen dënimeve maksimale me burgim që janë proporcionale me peshën e shkeljes dhe mjaftueshëm të larta për të shërbyer si masa efektive

parandaluese. Nevoja për dënime efektive, proporcionale dhe dekurajuese u diskutua më lart si një konsideratë e përgjithshme që qëndron në themel të caktimit të dënimit për shkeljet e trafikimit të mbetjeve.¹⁷¹ Përveç këtyre konsideratave të përgjithshme, ka edhe disa konsiderata të tjera që Shtetet duhet të marrin parasysh në përcaktimin e dënimeve maksimale me burgim për shkeljet e trafikimit të mbetjeve.

Së pari, siç u theksua në kapitullin 1,¹⁷² në mënyrë që Konventa kundër Krimit të Organizuar të zbatohet për një shkelje, shkelja duhet të jetë qoftë një shkelje e përcaktuar në përputhje me Konventën ose një “krim i rëndë”. “Krimi i rëndë” është përkufizuar si “akt që përbën një shkelje të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.”¹⁷³ Ndërsa disa shkelje që lidhen me trafikimin e mbetjeve — pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar, korrupsioni, pastrimi i parave dhe pengimi i drejtësisë — trajtohen shprehimisht në Konventë, trafikimi i mbetjeve nuk është trajtuar në këtë mënyrë. Së këndejmi, në mënyrë që Konventa kundër Krimit të Organizuar të zbatohet për shkeljet më të rënda që lidhen me trafikimin e mbetjeve të përcaktuara në këtë udhëzues, duhet të parashikohen dënime maksimale prej të paktën katër vjet burgim për secilën nga këto shkelje të rënda.

Së dyti, në disa Shtete, përcaktimi i veprave penale mëmë për qëllime të legjislacionit për pastrimin e parave vendoset duke iu referuar dënimit maksimal për shkeljen në fjalë. Në këto Shtete, ligjvënësit duhet të sigurojnë që dënimet maksimale për shkeljet e menduara për përcaktim si vepra penale mëmë janë mjaftueshëm të larta për të përmbushur prapenësit të dënimit me të paktën katër vjet burgim.¹⁷⁴

Në fund, në disa Shtete, pranueshmëria e shkeljes për të shërbyer si bazë për ekstradimin vendoset duke iu referuar dënimit maksimal për shkeljen në fjalë. Në këto raste, hartuesit e dispozitave legjislative duhet të sigurojnë që dënimet maksimale për shkeljet që janë mjaftueshëm të rënda për të justifikuar ekstradimin janë aq të larta sa ekstradimi të jetë i mundur sipas traktateve të Shtetit për ekstradimin dhe legjislacionit të brendshëm.¹⁷⁵ Disa nga shkeljet e mbuluara nga ky udhëzues janë të një peshe aq të rëndë sa të justifikojnë ekstradimin. Shkelje të tjera mund të konsiderohen nga një Shtet si jo mjaft të rënda për të justifikuar ekstradimin.

Masat ndëshkuese pa heqje lirie

Legjislacioni që përcakton ose ndryshon shkeljet e trafikimit të mbetjeve duhet të marrë në konsideratë alternativat ndaj dënimeve me heqje lirie në rrethana të caktuara. Llojet e dënimeve pa heqje lirie që mund t'u caktohen shkelësve dhe disponueshmëria e secilit lloj dënimi pa heqje lirie mund të ndryshojnë midis Shteteve dhe janë çështje që secili Shtet duhet t'i përcaktojë në përputhje me kuadrin e tij ligjor për caktimin e dënimit. Udhëzimet për alternativat ndaj burgimit mund të gjenden në Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për masat pa heqje lirie (Rregullat e Tokios)¹⁷⁶ dhe në rregullat 57 deri në 66 të Rregullave të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e grave të burgosura dhe masat pa heqje lirie për gratë shkelëse (Rregullat e Bangkokut),¹⁷⁷ si dhe në manualin e UNODC-së mbi parimet bazë dhe praktikën premtuese për alternativat ndaj burgimit dhe mbi strategjitë për të reduktuar mbipopullimin në burgje.¹⁷⁸

Sipas Rregullave të Tokios, ligji i brendshëm duhet të parashikojë një gamë të gjerë të masave pa heqje lirie për personat e dënuar, nga dispozitat për procedurën paraprake deri në dispozitat pas caktimit të dënimit.¹⁷⁹ Në veçanti, autoritetet që hetojnë ose ndjekin çështjet penale duhet të autorizohen që të pezullojnë dënimin e shkelësit në rrethana të përshtatshme dhe të caktojnë masa pa heqje lirie për çështjet minore.¹⁸⁰ Masat ndëshkuese pa heqje lirie mund të përfshijnë sanksione verbale, si vërejtja, qortimi ose paralajmërimi;

¹⁷¹ Shih “Konsideratat në themel të dënimit”.

¹⁷² Shih “Kuadri ligjor ndërkombëtar për të luftimin e krimit të rëndë”.

¹⁷³ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 2 (b).

¹⁷⁴ Shih gjithashtu diskutimin mbi pastrimin e parave në kapitullin 3, më sipër.

¹⁷⁵ Shih gjithashtu diskutimin mbi ekstradimin në kapitullin 5, më sipër.

¹⁷⁶ Asambleja e Përgjithshme, rezolutë 45/110, aneks.

¹⁷⁷ Asambleja e Përgjithshme, rezolutë 65/229, aneks.

¹⁷⁸ Në dispozicion këtu: <https://www.unodc.org/unodc/justice-and-prison-reform/index.html>.

¹⁷⁹ Rregullat 2.3 dhe 3.1.

¹⁸⁰ Rregulla 5.1.

pezullim të kushtëzuar të dënimit; masa ndëshkuese të statusit; sanksione ekonomike dhe masa ndëshkuese monetare, si gjobat dhe gjobat ditore; urdhra për konfiskim ose shpronësim; kompensim për viktimën ose urdhra kompensimi; dënime me kusht dhe të shtyra; vënie në provë dhe mbikëqyrje gjyqësore; urdhra pune në interes publik; referim në një qendër frekuentimi; arrest shtëpie; çdo mënyrë tjetër trajtimi jointitucional; dhe çdo kombinim i masave të tilla.¹⁸¹

Gjobat

Ashtu si masat ndëshkuese të tjera për trafikimin e mbetjeve, gjobat maksimale duhet të pasqyrojnë në mënyrë adekuate peshën e shkeljeve dhe të jenë mjaftueshëm të larta për të vepruar si masë efektive parandaluese. Në disa rrethana, gjobat mund të caktohen krahas dënimit me burgim. Kur bëjnë përcaktimin e vlerës së përshtatshme për gjobat maksimale për shkeljet e mbuluara në këtë udhëzues, ligjvënësit duhet të kenë parasysh se trafikimi i mbetjeve mund të jetë një biznes jashtëzakonisht fitimprurës për shkelësit. Nëse gjobat nuk janë mjaftueshëm të larta, ekziston rreziku që ato thjesht të përfshihen në kostot operative të grupeve kriminale të organizuara pa penguar kryerjen e shkeljeve. Gjendja financiare dhe kapacitetet e shkelësit duhet të merren parasysh në përcaktimin e shumës së përshtatshme të çdo gjobe. Në lidhje me personat juridikë, gjykata ose një autoritet tjetër kompetent mund të kërkojë akses në llogaritë dhe dokumente të tjera financiare të personave juridikë dhe, sipas rastit, të subjekteve të lidhura, për të vlerësuar gjendjen financiare të shkelësit.

Në disa raste, vetëm një gjobë nuk do të shërbejë si një masë efektive parandaluese pa konfiskimin e produkteve të krimit. Konfiskimi i produkteve të krimit dhe i pasurisë, pajisjeve dhe instrumenteve të tjera të përdorura ose të destinuara për përdorim në vepra penale trajtohet në nenin 12 të Konventës kundër Krimit të Organizuar.

Legjislacioni duhet të parashikojë që, në caktimin e dënimit të një shkelësi për trafikim mbetjesh ose për një shkelje tjetër të mbuluar nga ky udhëzues, prioritet duhet t'i jepet restitucionit ose kompensimit të viktimave të shkeljes. Nuk duhet të caktohen gjoba të një shume që do të minonte aftësinë e të pandehurit për restitucionin ose kompensimin e viktimave.

Shtetet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë zbatimin e masave për të parandaluar uljen e vlerës reale të gjobave me kalimin e kohës nga inflacioni. Një qasje mund të jetë lidhja e vlerave të gjobës në raport me njësi të masave ndëshkuese, të cilat më pas mund të përshtaten në hap me inflacionin.

Urdhrat për punë në interes publik

Në disa raste, urdhrat për punë në interes publik mund të jenë një opsion i përshtatshëm dënimi. Urdhrat për punë në interes publik tradicionalisht u janë dhënë personave fizikë të shpallur fajtorë për krime, por ato mund të përdoren edhe për dënimin e personave juridikë. Urdhrat për punë në interes publik për personat juridikë mund të jenë veçanërisht të përshtatshëm kur organizata e dënuar “posedon njohuri, instalime ose aftësi që e kualifikojnë atë në mënyrë unike” për të riparuar dëmet,¹⁸² megjithëse këta urdhra mund të jenë të përshtatshëm edhe në rrethana të tjera.

Urdhrat për punë në interes publik kanë disa ngjashmëri me restitucionin dhe kompensimin. Sipas disa sistemeve ligjore, urdhrat për punë në interes publik mund të dallojnë nga urdhrat për restitucion dhe kompensim ngaqë këto të fundit mund të urdhërohen vetëm për viktimat e krimit për të cilin është caktuar dënimi, ndërsa urdhrat për punë në interes publik nuk kanë një kufizim të tillë.¹⁸³ Në juridiksione të tjera, dallimi midis këtyre llojeve të urdhrave mund të jetë më pak i qartë.

Një urdhër për punë në interes publik mund të jetë i papërshtatshëm kur të pandehurit nuk mund t'i besohet zbatimi i kushteve të urdhratit. Për shembull, kur një i pandehur ka një histori shkeljesh të përsëritura të ligjeve ose rregulloreve mjedisore, ose përndryshe shfaq shpërfillje për respektimin e ligjeve dhe rregulloreve mjedisore, mund të ketë dyshime në lidhje me efektivitetin e një urdhri për punë në interes publik. Në përgjithësi, për të siguruar që sanksionet janë

¹⁸¹ Rregulla 8.2.

¹⁸² United States Sentencing Commission, *Guidelines Manual 2021* (Nëntor 2021) §8B1.3.

¹⁸³ Kris Dighe, “Organization community service in environmental crimes cases”, *United States Attorneys’ Bulletin*, vol. 60, No. 4 (Korrik 2012), f. 100.

efektive, proporcionale dhe dekurajuese, mund të jetë gjithashtu e përshtatshme që urdhrat për punë në interes publik të jepen vetëm krahas sanksioneve të tjera penale, si gjobat dhe burgimi (duke përfshirë dënimet me burgim me kusht).

SHEMBULL: SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Puna në interes publik për personat juridikë

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, puna në interes publik mund të urdhërohet si kusht diskrecionar i një dënimi me vënie në provë.^a Një memorandum i vitit 2009 i Divizionit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara ofron udhëzime për prokurorët në lidhje me përfshirjen e urdhrave për punë në interes publik në marrëveshjet për pranimin e fajësisë.^b Ky udhëzim përfshin sa vijon:

- Gjatë zhvillimit të një kushti për punë në interes publik duhet të merret asistencë e duhur rregullatore dhe teknike
- Duhet të ketë një lidhje të qartë midis punës në interes publik dhe shkeljes për të cilën është caktuar, duke përfshirë një lidhje gjeografike dhe një “lidhje të mediumit mjedisor”;
 - Lidhja gjeografike kërkon që të ketë një lidhje të qartë midis vendit ku është kryer shkelja ose është shkaktuar dëm dhe ku propozohet puna në interes publik
 - Lidhja e mediumit mjedisor kërkon që të ketë një lidhje të qartë ndërmjet mediumit me të cilin ka të bëjë shkelja (si ajri, uji ose gjallesat e egra) dhe punës në interes publik që propozohet
- Puna në interes publik nuk duhet të përbëjë më shumë se 25 për qind të vlerës totale të gjithë paketës së sanksioneve në përputhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, përveç në rrethana të jashtëzakonshme
- Puna në interes publik nuk duhet të shtojë burimet për një aktivitet që kërkohet përndryshe nga një agjenci federale
- Prokurorët dhe agjencitë e qeverisë federale nuk duhet të përfshihen në menaxhimin ose kontrollimin e projekteve të punës në interes publik, por duhet të parashikohet mbikëqyrja e rregullt për të siguruar që puna në interes publik kryhet siç duhet; dhe
- Prokurorët duhet të sigurojnë që i pandehuri të mos nxjerrë përfitime të padëshiruara si rezultat i urdhrat për punë në interes publik. Në veçanti, një i pandehur nuk duhet:
 - Të marrë kreditim për përmirësime kapitale ose ndryshime të tjera të planifikuara ose të kërkuara tashmë për të përmbushur lejet ose rregulloret përkatëse;
 - Të mbështetet në punën që kryhet në përputhje me urdhrin për të marrë kredite tatimore ose përfitime; ose
 - Të reklamojë aktivitetet e kryera në zbatim të urdhrat për të fituar publicitet të favorshëm.

Një urdhër për punë në interes publik ishte pjesë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në çështjen Shtetet e Bashkuara kundër Princess Cruise Lines, Ltd. Në këtë çështje, kompania e pandehur u deklarua fajtorë për akuzat, duke përfshirë konspiracionin për shkarkimin dhe hedhjen me dijeni të ujërave me vaj nga ulluku i anijes në ujërat e lundrueshme të Shteteve të Bashkuara, për mos mbajtjen me dijeni të evidencave të sakta të vajit dhe për pengimin e hetimit nga Roja Bregdetare të Shteteve të Bashkuara. Kompania e pandehur lidhi një marrëveshje për pranimin e fajësisë për një masë ndëshkuese monetare prej 40 milionë dollarësh, duke përfshirë një gjobë prej 30 milionë dollarësh dhe pagesën prej 10 milionë dollarësh si punë në interes publik nga organizata. Puna në interes publik nga organizata përfshinte një pagesë prej 7 milionë dollarësh për Fondacionin Kombëtar të Peshkut dhe Faunës dhe Florës së Egër, një organizatë jofitimprurëse e themeluar nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara, qëllimet e së cilës përfshinin administrimin e pasurisë për të avancuar konservimin dhe menaxhimin e peshkut, kafshëve të egra, bimëve dhe burimeve të tjera natyrore, si dhe 3 milionë dollarë për Trustin Kombëtar të Parqeve të Floridës së Jugut, një organizatë jofitimprurëse e themeluar për të mbështetur katër parqe kombëtare në Florida të Jugut. Kushtet e vënies në provë përfshinin gjithashtu që i pandehuri të zhvillojë, adoptojë, vendosë, zbatojë dhe financojë masa për ndreqjen e mjedisit të përcaktuara në një Plan të Pajtuashmërisë Mjedisore.^c

^a United States Code, Title 18, seksioni 3563 (b) (12).

^b Memorandum për Prokurorët e Seksionit të Krimeve Mjedisore nga Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm, Ronald J. Tenpas, mbi udhëzimet për restitucionin, punën në interes publik dhe masa ndëshkuese të tjera që caktohen në çështje të krimeve mjedisore, datë 16 janar 2009. Shih gjithashtu Kris Dighe, “Organization community service in environmental crimes cases”, United States Attorneys’ Bulletin, vol. 60, No. 4 (Korrik 2012), f. 100.

^c Për më shumë informacion, shih UNODC, “SHERLOC”, Case law database, United States of America v. Princess Cruise Lines, Ltd. Në dispozicion këtu <https://sherloc.unodc.org>.

Urdhrat plotësues

Në varësi nga rrethanat e rastit, vetëm dënimi me burgim ose një masë ndëshkuese alternative pa heqje lirie mund të jetë e pamjaftueshme. Mund të jetë e nevojshme që një gjykatë të nxjerrë urdhra shtesë, ndonjëherë të njohur si “urdhra plotësues”. Termi “urdhër plotësues” i referohet, në disa juridiksione, urdhrave që janë në dispozicion të gjyqtarëve me rastin e shpalljes së fajësisë, por që nuk janë ndëshkimi kryesor për shkelësin (siç është dënimi me burgim, një gjobë ose një masë ndëshkuese tjetër pa heqje lirie).¹⁸⁴ Në këtë kuptim, urdhrat janë “plotësues” (ose shtesë) ndaj masës ndëshkuese kryesore. Kjo nuk do të thotë se këta urdhra janë disi të parëndësishme ose mund të mos kenë pasoja serioze për shkelësin. Përkundrazi, urdhrave për restitucion ose kompensim, për shembull – që diskutohen në këtë seksion – duhet t’u jepet prioritet në raport me gjobat, të cilat u diskutuan më lart. Për më tepër, urdhrat e skualifikimit të një personi fizik ose juridik nga ushtrimi i një profesioni, ushtrimi i një veprimtarie ose mbajtja e një lejeje ose licence mund të jenë masa ndëshkuese të konsiderueshme për shkelësin në fjalë.

Në këtë seksion diskutohen disa urdhra që zakonisht klasifikohen si urdhra plotësues sipas legjislacionit të brendshëm, që duhet të merren parasysh në hartimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve. Këtu përfshihen urdhrat e restitucionit dhe konfiskimit, urdhrat e konfiskimit dhe asgjësimit, dhe urdhrat e skualifikimit.

Lexuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se diskutimi i urdhrave në këtë seksion është pa paragjykim ndaj klasifikimit të këtyre urdhrave sipas legjislacionit të brendshëm. Çfarë konsiderohet një urdhër plotësues dhe, nga ana tjetër, çfarë mund të urdhërohet si një opsion i pavarur për caktimin e dënimit, do të ndryshojë midis juridiksioneve. Për shembull, në disa juridiksione, urdhrat e restitucionit ose kompensimit ose urdhrat e skualifikimit mund të konsiderohen si opsione të pavarura për caktimin e dënimit sipas legjislacionit të brendshëm.

Për më tepër, ndërsa masat e përfshira në këtë seksion diskutohen në kontekstin e masave ndëshkuese dhe caktimit të dënimit, lexuesit duhet të jenë gjithashtu të vetëdijshëm se në disa juridiksione, nuk është i nevojshëm dënimi penal për të dhënë një urdhër për disa nga masat e diskutuara në këtë seksion. Për shembull, në disa juridiksione, janë të mundshme procedurat për konfiskim dhe/ose humbje të pasurisë pa dënim penal (të njohura edhe si “konfiskimi në procedurë civile” ose “konfiskimi in rem”).¹⁸⁵ Urdhrat e restitucionit dhe kompensimit mund të jepen gjithashtu në disa juridiksione pavarësisht nga dënimi penal. Shtetet mund të marrin në konsideratë, kur është e përshtatshme, vendosjen e procedurave që masat e tilla të urdhërohen në mungesë të një dënimi penal.

Restitucioni dhe kompensimi

Siç diskutohet më poshtë, neni 25, paragrafi 2, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të vendosin procedura të përshtatshme për të ofruar akses në restitucion dhe kompensim për viktimat e shkeljeve që mbulohen nga Konventa. Ndërsa Konventa nuk përmban asnjë hollësi të mëtejshme mbi llojet e procedurave që mund të jenë të përshtatshme për ofrimin e restitucionit dhe kompensimit, procedurat që lejojnë dhënien e urdhrave të restitucionit dhe kompensimit si urdhra plotësues të caktimit të dënimit duhet të konsiderohen nga Shtetet si një mjet për të ofruar restitucion dhe kompensim për viktimat e trafikimit të mbetjeve.

Restitucioni dhe kompensimi shqyrtohen më tej në kapitullin 7 më poshtë, në lidhje me mbrojtjen dhe ndihmën dhënë dëshmitarëve dhe viktimave. Kapitulli 7 përmban një model të dispozitës që mundëson përdorimin e restitucionit dhe kompensimit si urdhra plotësues të caktimit të dënimit.

¹⁸⁴ Andrew Ashworth dhe Rory Kelly, *Sentencing and Criminal Justice*, 7th ed. (London, Bloomsbury Publishing, 2021), f. 348.

¹⁸⁵ Për më shumë informacion mbi konfiskimin pa dënim penal, shih Theodore S. Greenberg dhe të tjerë, *Stolen Asset Recovery: A Good Practices Guide for Non-Conviction Based Asset Forfeiture* (Uashington, Distrikti i Kolumbisë, Banka Botërore, 2009).

Urdhrat e konfiskimit

Në kapitullin 4 të këtij udhëzuesi, u shqyrtua çështja e sekuestrimit dhe konfiskimit sipas Konventës kundër Krimit të Organizuar. U theksua se neni 12, paragrafi 1, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të adoptojnë, në masën më të madhe të mundshme brenda sistemeve ligjore të brendshme, masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e produkteve të krimit të përfutur nga shkeljet që mbulohen nga Konventa dhe të pasurisë, pajisjeve ose instrumenteve të tjera të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në shkeljet që mbulohen nga Konventa.

Shtetet duhet të sigurojnë që urdhrat për konfiskimin e këtyre produkteve, pasurisë, pajisjeve dhe instrumenteve të tjera mund të jepen si urdhra plotësues gjatë caktimit të dënimit për shkeljet e mbuluara nga ky udhëzues. Aty ku kjo nuk parashikohet tashmë në mënyrë adekuate sipas ligjeve të tjera, çështja duhet të trajtohet në legjislacionin për luftimin e trafikimit të mbetjeve.

Shtetet palë në Konventën kundër Krimit të Organizuar duhet gjithashtu të jenë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim konfiskimin dhe disponimin e produkteve të konfiskuara të krimit ose pasurisë në përputhje me nenet 13 dhe 14 të Konventës.

Urdhrat e skualifikimit, anulimi i lejeve dhe licencave dhe masa të ngjashme

Ndër urdhrat plotësues që mund të jenë të përshtatshëm për t'u dhënë nga gjykata janë ata që ndalojnë një person fizik ose juridik të ushtrijë një profesion ose pozitë të caktuar ose të kryejë aktivitete të caktuara. Për shembull, mund të jetë e përshtatshme që një gjykatë të skualifikojë një person fizik nga veprimi si drejtor i kompanisë për një periudhë kohore të caktuar. Mund të jetë gjithashtu e përshtatshme që një gjykatë të urdhërojë që leja ose licenca e një personi fizik ose juridik për të kryer aktivitete të caktuara në lidhje me mbetjet të anulohet dhe/ose që atij personi t'i ndalohet të aplikojë për një leje ose licencë të tillë për një periudhë kohore të caktuar.

Ashtu si me urdhrat e tjerë të diskutuar në këtë seksion, mund të jetë e përshtatshme që gjykatat ose autoritetet kompetente të japin urdhra skualifikimi, të anulojnë lejet ose licencat dhe të ndalojnë një person nga aplikimi për një leje ose licencë, pavarësisht nga çdo procedim penal kundër atij personi. Urdhrra të tillë mund të bëhen, për shembull, për shkak të shkeljes së detyrave që i takojnë drejtorëve të kompanive ose shkeljes së kushteve që i bashkëngjiten një lejeje ose licence.

SHEMBULL: VENDET E ULËTA

Gjykata e Distriktit të Roterdamit, 15 mars 2018, ECLI:NL:RBROT:2018:2108 ("Çështja Seatrade")

Në këtë çështje, gjashtë kompani në grupin Seatrade dhe dy drejtorë të tyre u shpallën fajtorë për transferimin e kundërligjshëm të katër anijeve nga Bashkimi Evropian në vende të tjera për skrap. Përveç caktimit të gjobave nga 50,000 euro deri në 750,000 euro për të pandehurit, dy drejtorëve iu ndalua ushtrimi i profesionit të drejtorit, drejtorit mbikëqyrës, këshilltarit ose punonjësit të një kompanie të dërgesave detare për një periudhë prej një viti.^a

^a Për më shumë informacion, shih UNODC, "SHERLOC", Case law database, Netherlands, Crimes that affect the environment, case No. NLDx007. Në dispozicion këtu <https://sherloc.unodc.org>.

SHEMBULL: VENDET E ULËTA**Kodi Penal****Neni 28**

1. Të drejtat nga të cilat shkelësi mund të skualifikohet me vendim gjyqësor në rastet e përcaktuara me ligj, janë:
 1. mbajtja e pozitave ose e pozitave të caktuara;
 2. shërbimi në shërbimet e armatosura;
 3. zgjedhja e anëtarëve të organeve të përgjithshme përfaqësuese dhe të qenët kandidat për zgjedhje në këto organe;
 4. shërbimi si avokat mbrojtës ose administrator i caktuar nga gjykata;
 5. ushtrimi i profesioneve të caktuara.
2. Anëtarët e gjyqësorit që janë emëruar qoftë me mandat të përhershëm ose me mandat të kufizuar, apo nëpunës të tjerë civilë që janë emëruar me mandat të përhershëm, skualifikohen nga mbajtja e pozitës në të cilën janë emëruar, vetëm në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj.
3. Skualifikimi nga e drejta e përmendur në nënparagrafin (1) (3^o) mund të caktohet vetëm në rast të dënimit me të paktën një vit burgim.
4. Gjykata mund të urdhërojë një institucion të provës që është emëruar me dekret qeveritar të monitorojë respektimin e skualifikimit nga mbajtja e pozitës ose nga ushtrimi i profesioneve të caktuara nga ana e të dënuarit.

Sanksionet për personat juridikë

Në seksionet e mëparshme të këtij udhëzuesi, u shqyrtuan masat ndëshkuese me heqje lirie dhe pa heqje lirie, si dhe urdhrat plotësues. Disa nga sanksionet e diskutuara në këto seksione, si gjobat dhe urdhrat plotësues, zbatohen si për personat fizikë ashtu edhe për ata juridikë. Sanksionet e tjera, si burgimi, janë të mundshme vetëm në lidhje me personat fizikë. Ndryshe nga një person fizik, një shoqëri tregtare nuk mund të burgoset. Ekzistojnë gjithashtu sanksione që mund të urdhërohen vetëm në lidhje me një person juridik, siç është urdhri për shpërbërjen ose shuarjen e personit juridik.

Modeli i dispozitës 24 përcakton një listë jo-shteruese të sanksioneve që mund të caktohen, individualisht ose në kombinim, ndaj personave juridikë të shpallur fajtorë për një shkelje. Llojet e sanksioneve të renditura në nënparagrafët (a) deri (n) shkojnë nga masat ndëshkuese monetare, konfiskimi i produkteve të krimin, publiciteti i pafavorshëm, sanksionet e stilit të vënies në provë dhe skualifikimet deri te shpërbërja e personit juridik.

MODEL I DISPOZITËS 24: SANKSIONET PËR PERSONAT JURIDIKË

Një person juridik i shpallur fajtor për një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli ...] i nënshtrohet njërit ose më shumë prej sanksioneve sa vijon:

- (a) Një gjobë që nuk kalon:
 - (i) [shuma maksimale]; ose
 - (ii) [x]fishi i vlerës totale të përfitimit të siguruar ose dëmit të shkaktuar që i atribuohet në mënyrë të arsyeshme shkeljes; ose
 - (iii) [Nëse gjykata nuk mund të përcaktojë vlerën totale të përfitimit ose dëmit] [x] për qind e xhiros vjetore të personit juridik gjatë periudhës 12 mujore përpara kryerjes së shkeljes;
- (b) Konfiskimi i produkteve të krimit;
- (c) Urdhërimi i personit juridik të publikojë vendimin e gjykatës, duke përfshirë, sipas rastit, veçantitë e shkeljes dhe natyrën e çdo mase ndëshkuese të caktuar;
- (d) Urdhërimi i personit juridik të bëjë gjërat e deklaruara ose të krijojë ose të kryejë një projekt të deklaruar për të mirën e publikut;
- (e) Urdhërimi i personit juridik të vendoset nën mbikëqyrje gjyqësore për një periudhë maksimale prej [x] vjetësh;
- (f) Nënshtrimi i personit juridik ndaj një shqyrtimi nga një vëzhgues i pavarur i emëruar nga gjykata me qëllim të raportimit në gjykatë mbi përpjekjet e personit juridik për të zbatuar një kulturë ligjshmërie;
- (g) Ndalimi i ushtrimit, qoftë direkt ose indirekt, të një ose më shumë aktiviteteve profesionale [në mënyrë të përhershme] [për një periudhë jo më shumë se [x] vjet];
- (h) Urdhërimi i anulimit të një [shëno terminologjinë përkatëse për lejet, licencat, etj.] që mban personi juridik;
- (i) Urdhërimi i skualifikimit [të përkohshëm] [të përhershëm] të personit juridik nga aplikimi për një [shëno terminologjinë përkatëse për lejet, licencat, etj.] për të kryer aktivitete të caktuara;
- (j) Urdhërimi i mbylljes [së përkohshme] [së përhershme] të instalimit, ose të një ose më shumë instalimeve, të personit juridik që është përdorur për kryerjen e shkeljeve në fjalë;
- (k) Urdhërimi i skualifikimit [të përkohshëm] [të përhershëm] të personit juridik nga tenderimi publik, nga e drejta për përfitime ose ndihmë publike, [dhe/ose] nga pjesëmarrja në prokurimin publik;
- (l) Skualifikimi [i përkohshëm] [i përhershëm] i personit juridik nga ushtrimi i aktiviteteve të tjera tregtare [dhe/ose] nga krijimi i një personi juridik tjetër;
- (m) Nëse veprimtaria e personit juridik është përdorur tërësisht ose kryesisht për kryerjen e veprave penale ose nëse personi juridik është krijuar për të kryer një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli...], urdhërimi i shpërbërjes së personit; ose
- (n) Urdhra të mëtejshëm siç i konsideron të drejtë gjykata.

Kapitulli 7.

MBROJTJA DHE NDIHMA

Gjatë zhvillimit dhe ndryshimit të legjislacionit për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve, është me rëndësi kritike që ligjvënësit të trajtojnë jo vetëm penalizimin, hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të mbetjeve, por edhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe personave që bashkëpunojnë me autoritetet dhe ofrimin e ndihmës për viktimat.

MBROJTJA E DËSHMITARËVE, VIKTIMAVE DHE PERSONAVE QË BASHKËPUNOJNË ME AUTORITETET

Nenet 24 deri në 26 të Konventës kundër Krimit të Organizuar trajtojnë, ndër të tjera, mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave dhe personave që bashkëpunojnë me autoritetet. Neni 24, paragrafi 1, i Konventës kundër Krimit të Organizuar parashikon sa vijon:

Secili Shtet palë merr masat e nevojshme brenda mundësive të tij, për të ofruar mbrojtje efektive nga hakmarrja ose frikësimi i mundshëm për dëshmitarët në procedime penale të cilët japin dëshmi në lidhje me shkeljet e mbuluara nga Konventa dhe, nëse është e nevojshme, familjarët e tyre ose personat e afërt me ta.

Ky detyrim për të ofruar mbrojtje zbatohet edhe për viktimat, për aq kohë sa ato janë edhe dëshmitarë,¹⁸⁶ dhe personat që bashkëpunojnë me autoritetet.¹⁸⁷ Konventa kundër Krimit të Organizuar nuk e përkufizon termin “dëshmitar”, por sugjerohet që të zbatohet një nocion i gjerë për dëshmitarët kur vendosen masat për mbrojtjen e dëshmitarëve në mënyrë që të arrihen sa më mirë qëllimet mbrojtëse të nenit 24.¹⁸⁸ Në këtë drejtim, ligjvënësit mund të dëshirojnë të vënë në dispozicion masa mbrojtëse jo vetëm për personat që kanë dëshmuar në të vërtetë, por edhe për personat që bashkëpunojnë me autoritetet. Mbrojtja e dëshmitarëve duhet të përfshijë edhe mbrojtjen e dëshmitarëve ekspertë.¹⁸⁹

Neni 24, paragrafi 2, i Konventës kundër Krimit të Organizuar përcakton që masat e parashikuara në nenin 24, paragrafi 1, mund të përfshijnë, ndër të tjera, masa për mbrojtjen fizike të dëshmitarëve (siç janë

¹⁸⁶ Konventa kundër Krimit të Organizuar, neni 24, para. 4.

¹⁸⁷ Po aty, neni 26, para. 4.

¹⁸⁸ UNODC, *Udhëzuesi Legjislativ*, para. 409.

¹⁸⁹ Konventa kundër Korrupsionit, neni 32.

zhvendosja dhe masat që kufizojnë zbulimin e identitetit ose vendndodhjes së tyre) dhe rregulla të provave të cilat lejojnë që dëshmia e dëshmitarit të jepet në një mënyrë që garanton sigurinë e tyre (si p.sh., nëpërmjet përdorimit të teknologjisë me video). Qëllimi i masave të parashikuara në nenin 24 është sigurimi i mbrojtjes dhe sigurisë së dëshmitarëve. Për sa i përket viktimave që janë edhe dëshmitarë, masat mbrojtëse synojnë gjithashtu shmangien e viktimizimit dhe viktimizimit dytësor gjatë procedimit gjyqësor. Shtetet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë futjen e masave mbrojtëse të përshtatshme që nuk përmenden shprehimisht në Konventën kundër Krimit të Organizuar.

Për sa i përket viktimave, duhet theksuar se Shteteve palë u kërkohet gjithashtu të vendosin dhe të ofrojnë masa mbrojtëse për viktimat që nuk janë dëshmitarë. Neni 25, paragrafi 1, i Konventës parashikon se “[s] ecili Shtet Palë merr masat e nevojshme brenda mundësive të tij për të ofruar...mbrojtje për viktimat e shkeljeve të mbuluara nga kjo Konventë, veçanërisht në rastet e kërcënimit për hakmarrje ose frikësimit” . Konventa kundër Krimit të Organizuar nuk e përkufizon termin “viktima”, por sugjerohet që ky term të interpretohet duke marrë parasysh tërësinë e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e viktimave të krimit. Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit përkufizon “viktimat” si vijon:

Personat që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëme, përfshirë dëmtime fizike apo mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose cenim të rëndë të të drejtave themelore, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë shkelje të ligjeve penale që zbatohen në Shtetet Anëtare, duke përfshirë ligjet që ndalojnë abuzimin kriminal me pushtetin.

Një përkufizim i ngjashëm është përfshirë në Parimet dhe Udhëzimet Themelore për të drejtën për mjete juridike dhe reparacione për viktimat e shkeljeve flagrante të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.¹⁹⁰

Modeli i dispozitës 25 trajton mbrojtjen e dëshmitarëve dhe personave që bashkëpunojnë me autoritetet ligj-zbatuese. Ai gjithashtu mbulon viktimat për aq kohë sa janë dëshmitarë. Modeli i dispozitës 26 trajton mbrojtjen e viktimave, pavarësisht nëse ato janë gjithashtu dëshmitarë. Formulimet e këtyre modeleve të dispozitave janë të ngjashme me njëra-tjetrën, por ato janë hartuar si dispozita të veçanta duke njohur nevojat e posaçme të viktimave dhe masat dhe programet e posaçme të cilat mund të jenë në dispozicionin e tyre sipas legjislacionit të brendshëm.

Modeli i dispozitës 26 përmban një përkufizim të termit “viktima” për qëllimet e këtyre modeleve të dispozitave legjislative, të përshtatur nga përkufizimet e përfshira në instrumentet ndërkombëtare të përmendura më sipër. Përkufizimi në modelin e dispozitës 26 mbulon personat që kanë pësuar dëme nëpërmjet një shkeljeje për të cilën zbatohen këto modele të dispozitave legjislative. Shtetet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë masën në të cilën legjislacioni i brendshëm mbron në mënyrë adekuate të drejtat e viktimave të abuzimeve sipas ligjit të punës nga trafikantët e mbetjeve, pavarësisht nëse këta persona kanë pësuar apo jo dëme nëpërmjet një shkeljeje për të cilën zbatohen këto modele të dispozitave legjislative.

Për më shumë informacion në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, ju lutemi t'i referoheni publikimit të UNODC-së *Praktikat e mira për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedimet penale që përfshijnë krimin e organizuar*.

¹⁹⁰ Asambleja e Përgjithshme, rezolutë 60/147, aneks, para. 8–9.

MODEL I DISPOZITËS 25. MBROJTJA E DËSHMITARËVE, VIKTIMAVE DHE PERSONAVE QË BASHKËPUNOJNË ME AUTORITETET LIGJ-ZBATUESE

1. Ky nen zbatohet për një dëshmitar, duke përfshirë një viktimë për aq kohë sa është gjithashtu dëshmitar, dhe një person që bashkëpunon me autoritetet ligj-zbatuese.
2. Për qëllime të këtij [Akti/Ligji/Kapitulli ...]:
 - (a) “dëshmitar” përfshin çdo person që ka dhënë, ka rënë dakord të japë ose kërkohet të japë dëshmi ose të bëjë një deklaratë në hetimin, ndjekjen penale ose gjykimin e një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Kapitulli/Ligji...].
 - (b) “person që bashkëpunon me autoritetet ligj-zbatuese” përfshin një person që bashkëpunon me autoritetet ligj-zbatuese ose një autoritet tjetër të përfshirë në hetimin ose ndjekjen penale të një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli...] për:
 - (i) Dhënien e informacionit të dobishëm për qëllime hetimore dhe provuese për çështje të tilla si:
 - a. Identiteti, vendndodhja ose aktivitetet e një personi që ka kryer ose mund të kryejë një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli...];
 - b. Identiteti, natyra, përbërja, struktura, vendndodhja ose aktivitetet e një grupi kriminal të organizuar ose lidhjet e tyre me grupe kriminale të organizuara të tjera; ose
 - c. Shkeljet që një person ose një grup kriminal i organizuar ka kryer ose mund të kryejë; ose
 - (ii) Ofrimin e ndihmës faktike dhe konkrete që mund të kontribuojë në privimin e një grupi kriminal të organizuar nga burimet e tyre ose nga produktet e krimit.
3. [Shëno autoritetet përkatëse] marrin masat e përshtatshme për të siguruar që një personi për të cilin zbatohet ky nen i ofrohet mbrojtje adekuate nëse rrezikohet siguria e atij personi. Kjo përfshin masat për të mbrojtur atë person nga hakmarrja, frikësimi ose dëmtimi nga të dyshuarit, shkelësit dhe bashkëpunëtorët e tyre.
4. [Shëno autoritetet përkatëse], sipas rastit, marrin më tej masat e specifikuar në paragrafin 3 në lidhje me të afërmit e personit [dhe partnerin familjar ose de facto, ...].
5. Një person për të cilin zbatohet ky nen ka akses në çdo masë ose program mbrojtës ekzistues sipas [specifiko Aktin/dispozitat/... përkatëse].

MODEL I DISPOZITËS 26. MBROJTJA E VIKTIMAVE

1. Për qëllimet e këtij [Akti/Ligji/Kapitulli...], “viktima” nënkupton personat që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëme, përfshirë dëmtime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose cenim të rëndë të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet një shkeljeje për të cilën zbatohet ky [Akti/Ligji/Kapitulli...].
2. [Shëno autoritetet përkatëse] marrin masat e përshtatshme për të siguruar që viktimave u ofrohet mbrojtje adekuate nëse rrezikohet siguria e tyre. Kjo përfshin masat për të mbrojtur viktimat nga hakmarrja, frikësimi ose dëmtimi nga të dyshuarit, shkelësit dhe bashkëpunëtorët e tyre.
3. [Shëno autoritetet përkatëse], sipas rastit, marrin më tej masat e specifikuar në paragrafin 2 në lidhje me të afërmit e viktimës [dhe partnerin familjar ose de facto, ...].
4. Viktimat kanë akses në çdo masë ose program mbrojtës ekzistues sipas [specifiko Aktin/dispozitat/... përkatëse].

Mbrojtja e dëshmitarëve gjatë procedimeve gjyqësore

Pjesëmarrja si dëshmitar në procedimet gjyqësore mund të jetë frikësuese në çdo rast, por veçanërisht në procedimet kundër grupeve kriminale të organizuara, pjesëmarrësve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Rëndësia e mbrojtjes dhe mbështetjes së dëshmitarëve gjatë procesit të gjykimit njihet shprehimisht në nenin 24, paragrafi 2, të Konventës kundër Krimin të Organizuar. Kjo mund të arrihet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë dispozitat legjislative që u mundësojnë dëshmitarëve të marrin pjesë në procedime gjyqësore në një mënyrë që merr parasysh nevojat e tyre specifike, mbështet funksionin e gjykatave për kërkimin e së vërtetës dhe, më e rëndësishmja, nuk cenon të drejtat e të pandehurit, të cilat njihen shprehimisht në këtë dispozitë të Konventës. Çfarëdo masash procedurale që përdoren, duhet t'i kushtohet vëmendje balancimit të pritshmërisë legjitime të dëshmitarit për siguri fizike me të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë, gjë që, në disa juridiksione, përfshin garanci kushtetuese për të drejtën e ballafaqimit.

Modeli i dispozitës 27 identifikon një sërë fushash në të cilat mund të ndiqet ligjvënia; megjithatë, ka të ngjarë që për fusha të tilla të ketë nevojë për gjuhë legjislative më të detajuar dhe hartuesit e legjislacionit kombëtar duhet të marrin në konsideratë dhe të respektojnë çdo ligj të brendshëm para-ekzistues në lidhje me procedurën penale.

Mbrojtjet procedurale ose në gjykatë janë veprime që synojnë në radhë të parë pakësimin e drojës nga frikësimi, veçanërisht të dëshmitarëve viktimë, veprime këto që mund të ndërmerren nga gjykata sua sponte (kryesisht) ose me kërkesë të prokurorit ose hetuesve. Masat për të pakësuar frikën nëpërmjet shmangies së ballafaqimit ballë për ballë me të pandehurin ose publikun mund të përfshijnë përdorimin e deklaratave në procedurë paraprake në vend të dëshmisë në gjykatë; dhënien e dëshmisë nga dëshmitari prapa një ekranit jotransparent ose një pasqyre të dyanshme; dhe që i pandehuri të shohë dhënien e dëshmisë nga dëshmitari nëpërmjet një lidhjeje me video në një dhomë ngjitur ose që dëshmitari të japë dëshminë nëpërmjet lidhjeje audiovizive.

MODEL I DISPOZITËS 27: MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË PROCEDIME GJYQËSORE

Në një seancë gjyqësore për çështjet në lidhje me një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Kapitulli/Ligji...] mund, pa paragjykuar të drejtat e të pandehurit, të jepen urdhra për të mbrojtur një dëshmitar përpara, gjatë dhe pas procedimeve, duke përfshirë urdhrat për:

- (a) Kryerjen e procedimeve me dyer të mbyllura;
- (b) Lejimin e dhënies së dëshmisë nga prapa ekranit jotransparent ose pengesës tjetër;
- (c) Lejimin që dëshmia të jepet nëpërmjet lidhjes me video ose mjeteve të tjera nga distanca;
- (d) Fshehjen e identitetit të dëshmitarit;
- (e) Shtrembërimin e zërit ose maskimin e fytyrës së dëshmitarit;
- (f) Lejimin e përdorimit të përkthyesve dhe interpretuesve;
- (g) Lejimin e pjesëmarrjes së personave mbështetës të dëshmitarit;
- (h) Ofrimin e mbështetjes profesionale për dëshmitarin;
- (i) Mbylljen (vulosjen) e procesverbaleve të gjykimit; dhe
- (j) Çdo masë tjetër që gjykata e konsideron të përshtatshme sipas rrethanave për qëllime të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Mbrojtja e sinjalizuesve dhe personave të tjerë raportues

Përveç mbrojtjes së personave që marrin pjesë në procedimet gjyqësore ose bashkëpunojnë me organet ligj-zbatuese, Shtetet duhet të marrin në konsideratë edhe forma të tjera të mbrojtjes për personat raportues. Për qëllimet e këtij udhëzuesi, “persona raportues” nënkupton çdo person që raporton në mirëbesim dhe me shkaqe të arsyeshme tek autoritetet përkatëse çdo fakt në lidhje me shkeljet e mbuluara nga ky udhëzues.¹⁹¹

¹⁹¹ Përshtatur nga Konventa kundër Korrupsionit, neni. 33..

Këshilli i Evropës përkufizon termin “sinjalizues” si “çdo person i cili raporton ose zbulon informacion mbi një kërcënim apo dëm ndaj interesit publik në kontekstin e marrëdhënive të tij punës, qoftë në sektorin publik ose privat”.¹⁹²

Personat raportues shpesh marrin përsipër risqe të larta personale kur mbledhin, raportojnë ose zbulojnë në ndonjë mënyrë tjetër rastet e parregullsive ose krimet. Ata mund të pushohen nga puna, të paditen për shkelje të konfidencialitetit, të futen në listën e zezë, të kërcënohen, të sulmohen ose, në disa raste, të vriten. Prandaj, mbrojtja e personave raportues nga dëmtimi dhe hakmarrja është e rëndësishme për të nxitur dhe lehtësuar ekspozimin e trafikimit të mbetjeve, për të përmirësuar zbulimin e tij, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të pakësuar kapacitetin e keqbërësve për t'u mbështetur në heshtjen e atyre që i kanë përreth. Nga ana tjetër, mungesa e mbrojtjes efektive mund të nënkuptojë që personat raportues janë më të cenueshëm nga frikësimi dhe hakmarrja dhe së këndejmi gjasat janë më të vogla që ata t'u zbulojnë informacion subjekteve ose individëve që mund të ndërmarrin veprime.

Mbrojtja e personave raportues nuk trajtohet në mënyrë specifike nga Konventa kundër Krimit të Organizuar, por neni 33 i Konventës kundër Korrupsionit kërkon që secili Shtet palë të shqyrtojë përfshirjen e masave të përshtatshme për të ofruar mbrojtje kundër trajtimit të pajustificuar për çdo person që raporton në mirëbesim dhe me shkaqe të arsyeshme tek autoritetet kompetente çdo fakt në lidhje me shkeljet e përcaktuara në përputhje me Konventën. Sugjerohet që Shtetet të shqyrtojnë përcaktimin e masave të tilla në lidhje me të gjitha shkeljet e mbuluara nga ky udhëzues, pavarësisht nëse ato përfshijnë korrupsionin. Kjo është gjithashtu në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare për mjedisin në lidhje me aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore. Për shembull, neni 3, paragrafi 8, i Konventës së Aarhusit parashikon se “[s]ecila Palë siguron që personat të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, nuk penalizohen, persekutohen apo ngacmohen në asnjë mënyrë për përfshirjen e tyre”. Për më tepër, neni 9, paragrafi 3, i Marrëveshjes së Eskazu parashikon:

Secila Palë merr ... masa të përshtatshme, efektive dhe me kohë për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar sulmet, kërcënimet ose frikësimet që mund të pësojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut në çështjet mjedisore gjatë ushtrimit të të drejtave të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Përveç legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve, është gjithashtu e rëndësishme që organizatat e përfshira në industrinë e menaxhimit të mbetjeve të krijojnë kanale të brendshme raportimi që janë të hapura dhe gjithëpërfshirëse për raportimin e rasteve të dyshuara të trafikimit të mbetjeve.¹⁹³

Legjislacioni dhe politikat për mbrojtjen e sinjalizuesve shpesh përfshijnë një kërkesë për “mirëbesim”, “shkaqe të arsyeshme” ose një “bindje të arsyeshme për keqbërësi”, ashtu që zbulimet mbrohen nëse ato bëhen me një bindje të arsyeshme se informacioni është i vërtetë në kohën kur zbulohet.¹⁹⁴ Kjo gjithashtu do të thotë se zbulimet që dihet se janë të rreme nuk duhet të mbrohen.

Lloji i mbrojtjes që mund të jetë i nevojshëm për një person varet nga shumë faktorë, si lloji i informacionit të raportuar, pozita e personit dhe niveli i kërcënimit me të cilin përballet një person për shkak të raportimit. Masat mbrojtëse duhet të sigurojnë që personi raportues është i mbrojtur nga të gjitha format e hakmarrjes, kërcënimit, disavantazhit dhe diskriminimit të lidhura me zbulimin ose që rezultojnë nga zbulimi. Me rëndësi në këtë drejtim janë masat si mbrojtja e karrierës, ofrimi i mbështetjes psikologjike, njohja institucionale e raportimit, transferimi brenda organizatës dhe zhvendosja në një organizatë tjetër. Konfidencialiteti i personit raportues duhet të ruhet dhe identiteti i tij/saj mund të zbulohet vetëm me pëlqimin e shprehur të sinjalizuesit.

Informacione të mëtejshme mbi mbrojtjen e personave raportues mund të gjenden në publikimin e UNODC-së Udhëzues burimor mbi praktikatat e mira në mbrojtjen e raportimit.¹⁹⁵

¹⁹² Këshilli i Evropës, rekomandim CM/Rec (2014)7 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi mbrojtjen e sinjalizuesve, adoptuar nga Komitetit më 30 prill 2014.

¹⁹³ Shih gjithashtu UNODC, *Speak up for Health! Guidelines to Enable Whistle-Blower Protection in the Health-Care Sector* (Vjenë, 2021), ff. 17–23.

¹⁹⁴ Po aty, ff. 14–15.

¹⁹⁵ Shih gjithashtu UNODC, *Speak up for Health! dhe Marie Terracol, A Best Practice Guide for Whistleblowing Legislation* (Berlin, Transparency International, 2018).

SHEMBULL: REPUBLIKA E KORESË

Akti për parandalimin e korrupsionit dhe themelimin dhe menaxhimin e Komisionit Anti-Korrupsion dhe për të Drejtat Civile, 2008

Neni 64 – Konfidencialiteti i sinjalizuesve

(1) Asnjë person nuk informon, zbulon ose raporton te të tjerët informacione personale për një sinjalizues ose asnjë fakt nga i cili mund të nxirret identiteti i një sinjalizuesi, duke ditur se ai/ajo është sinjalizuesi i përcaktuar në këtë Akt:

Me kusht që, kjo nuk zbatohet kur sinjalizuesi sipas këtij Akti jep pëlqimin për këtë.

[...]

Neni 64-2 – Masat për mbrojtjen e sigurisë personale

(1) Një sinjalizues mund të kërkojë nga Komisioni që të marrë masa për mbrojtjen e sigurisë personale, nëse akti i tillë i sinjalizimit rrezikon sigurinë fizike të tij/saj ose të të afërmeve ose bashkëjetuesve të tij/saj. [...]

[...]

Neni 68 – Çmimet dhe shpërblimet monetare

(1) Nëse sinjalizimi për korrupsion i paraqitur te Komisioni ose një agjenci publike ka shkaktuar përfitime pasurore për institucionet publike, parandalon dëmtimin e pasurisë së tillë ose rrit interesin publik, Komisioni mund të rekomandojë që sinjalizuesit përkatës t'i jepet një çmim monetar sipas dispozitave të Ligjit për Çmimet dhe Dekoratat dhe mund t'i jepet një shpërblim monetar, siç përcaktohet me Dekretin Presidential: Me kusht që, nëse sinjalizimi i korrupsionit është paraqitur në një agjenci publike, kjo zbatohet vetëm kur agjencia publike përkatëse rekomandon ose kërkon dhënien e shpërblimit monetar.

(2) Nëse një sinjalizues për shkak të sinjalizimit ka kontribuar drejtpërdrejt në rikuperimin ose rritjen e të ardhurave ose në shkurtimin e kostove për një institucion publik, ose marrëdhënia juridike për këto konfirmohet, sinjalizuesi përkatës mund të bëjë kërkesë te Komisioni për pagesën e shpërblimeve monetare përkatëse.

[...]

SHEMBULL: BASHKIMI EVROPIAN

Direktivë (BE) 2019/1937 e Bashkimit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2019, për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit;

Neni 2 – Fushëveprimi material

1. Kjo Direktivë përcakton standardet minimale të përbashkëta për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit sa vijon:

(a) shkeljet brenda fushëveprimit të akteve të Bashkimit të përcaktuara në Aneks që kanë të bëjnë me fushat vijuese:

- (i) prokurimi publik;
- (ii) shërbimet financiare, produktet dhe tregjet, si dhe parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- (iii) siguria dhe pajtueshmëria e produkteve;
- (iv) siguria e transportit;

- (v) mbrojtja e mjedisit;
- (vi) mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- (vii) siguria e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve;
- (viii) shëndeti publik;
- (ix) mbrojtja e konsumatorit;
- (x) mbrojtja e jetës private dhe të dhënave personale, si dhe siguria e rrjetit dhe sistemeve të informacionit;

[...]

Neni 6 – Kushtet për mbrojtjen e personave raportues

1. Personat raportues kualifikohen për mbrojtje sipas kësaj Direktive me kusht që:
 - (a) ata kishin shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni mbi shkeljet e raportuara ishte i vërtetë në kohën e raportimit dhe se ky informacion ishte brenda fushëveprimit të kësaj Direktive; dhe
 - (b) ata raportuan qoftë brenda në përputhje me nenin 7 ose jashtë në përputhje me nenin 10, ose bënë një zbulim publik në përputhje me nenin 15.

[...]

ASSISTANCE TO VICTIMS

Përveç kërkesës për mbrojtjen e viktimave, neni 25 i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon gjithashtu që Shtetet të marrin masa të përshtatshme për t'u ofruar ndihmë viktimave të shkeljeve të mbuluar nga Konventa.¹⁹⁶ Neni 25, paragrafët 2 dhe 3, kërkon më tej nga Shtetet palë të vendosin procedura të përshtatshme për të ofruar akses në kompensim dhe restitucion për viktimat dhe për të mundësuar paraqitjen e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të viktimave gjatë procedimeve penale. Ky seksion trajton më tej secilën prej këtyre masave të ndihmës dhe masat e ndihmës që nuk përmenden shprehimisht në nenin 25.

Asnjë nga masat e ndihmës për viktimat të shqyrtuara në këtë seksion dhe asnjë masë tjetër e ndihmës nuk duhet të kushtëzohet nga bashkëpunimi i viktimave me organet ligj-zbatuese ose autoritete të tjera.

Restitucioni dhe kompensimi

Neni 25, paragrafi 2, i Konventës kundër Krimit të Organizuar kërkon që Shtetet palë të vendosin procedura të përshtatshme për të ofruar akses në kompensim dhe restitucion për viktimat e shkeljeve që mbulohen nga Konventa. Raportuesi Special për efektet e pafavorshme të lëvizjes dhe hedhjes së produkteve dhe mbetjeve toksike dhe të rrezikshme në gëzimin e të drejtave të njeriut ka rekomanduar gjithashtu që Shtetet të krijojnë fonde të brendshme kompensimi për të financuar “restaurimin e mjedisit dhe kompensimin e viktimave kur autorët e shkeljeve janë të panjohur, nuk mund të gjenden apo shpallin falimentimin”.¹⁹⁷

Ndërsa përshkrimet dhe përkufizimet e brendshme të restitucionit mund të jenë të ndryshme, për qëllimet e këtij udhëzuesi, restitucioni kuptohet se i referohet masave që synojnë të rivendosin viktimën ose viktimat në situatën në të cilën ndodheshin përpara se të ndodhte krimi, ndërsa kompensimi kuptohet se i referohet pagesës që i bëhet viktimave për dëme, dëmtime, lëndime ose humbje.

Modeli i dispozitës 28 është menduar të ofrojë udhëzime për çështjet që Shtetet mund të dëshirojnë të shqyrtojnë kur hartojnë ligje si për restitucionin ashtu edhe për kompensimin për viktimat e trafikimit të mbetjeve. Dispozitat për sigurimin e aksesit si në restitucion ashtu edhe në kompensim duhet të përfshihen

¹⁹⁶ Organized Crime Convention, art. 25, para. 1.

¹⁹⁷ E/CN.4/2004/46, para. 114.

vetëm nëse procedurat e nevojshme për sigurimin e kompensimit dhe restitucionit në procedimet e mbuluar nga ky udhëzues nuk janë tashmë të disponueshme sipas ligjeve të brendshme.

Paragrafi 1 i modelit të dispozitës 28 parashikon që gjykatat mund të japin urdhër për restitucion ose kompensim kur i caktojnë dënimin një personi të akuzuar, pavarësisht nga një kërkesë që bëhet nga prokurori. Ndërsa ky model i dispozitës nuk kërkon medoemos që gjykata të shqyrtojë ose të urdhërojë restitucionin ose kompensimin, qasje të tilla janë të mundshme. Qasja e propozuar në modelin e dispozitës 28 siguron që viktimave nuk u kërkohet medoemos të bëjnë kërkesë për kompensim përmes procedimeve ligjore të tjera, të tilla si procedurat civile, të cilat mund të jenë të përealizueshme për shumë viktima.

Paragrafët 2 dhe 3 të modelit të dispozitës 28 përcaktojnë qëllimet e ndryshme të restitucionit dhe kompensimit dhe ofrojnë lista jo-shteruese të përmbajtjes së urdhrave të gjykatës për restitucion dhe kompensim. Këto dispozita pasqyrojnë frymën dhe përmbajtjen e paragrafëve 8 deri 13 të Deklaratës së Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit me pushtetin.

Paragrafi 4 i modelit të dispozitës 28 synon të sigurojë që gjykatat u kushtojnë vëmendje mundësive dhe aftësive të personit të dënuar kur japin një urdhër restiticioni ose kompensimi. Kur mundësitë e shkelësit janë të kufizuara, duhet t'i jepet prioritet pagesës së kompensimit kundrejt pagesës së çdo mase ndëshkuese financiare tjetër. Nëse shkelësi nuk është në gjendje të paguajë, paragrafi 6 parashikon që viktima kualifikohet për kompensim të financuar nga Shteti.

Modeli i restitucionit dhe kompensimit i përcaktuar në modelin e dispozitës 28 zbatohet me kusht që shkelësi të jetë shpallur fajtor në procedim penal. Megjithatë, duhet theksuar se restiticioni dhe kompensimi i bazuar në dënim penal nuk është modeli i vetëm në dispozicion. Në disa Shtete, viktimat mund të marrin restitucion ose kompensim pavarësisht nga dënimi penal i shkelësit. Mund të kujtohet se detyrimi i parashikuar në nenin 25, paragrafi 2, të Konventës kundër Krimit të Organizuar është një detyrim i përgjithshëm për të vendosur procedura të përshtatshme për të ofruar akses në restitucion dhe kompensim për viktimat e shkeljeve që mbulohen nga Konventa. Në krijimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve, Shtetet duhet të shqyrtojnë nëse viktimave të trafikimit të mbetjeve u ofrohet akses efektiv në restitucion dhe kompensim në rastet kur shkelësit nuk mund të identifikohen, gjenden, ekstradohen apo ndiqen penalisht.

Një çështje e lidhur është marrëdhënia midis urdhrave të restitucionit dhe kompensimit për viktimat dhe urdhrave për pastrimin e mbetjeve dhe ndreqjen e dëmeve mjedisore. Ashtu si restiticioni, ndreqja synon rivendosjen e situatës përpara dëmit. Ndërsa përdorimi i terminologjisë mund të ndryshojë midis juridiksioneve, për qëllimet e këtij udhëzuesi, ndreqja kuptohet si veprime për të riparuar ose zbutur dëmin që i është shkaktuar, mund t'i shkaktohet ose do t'i shkaktohet një mjedisi, habitati ose vendndodhjeje, ndërsa restiticioni kuptohet si veprime për të riparuar dëmin shkaktuar viktimës. Është e rëndësishme që gjykatat kompetente ose autoritetet mjedisore të kenë kompetencën për të dhënë urdhra për pastrimin e mbetjeve dhe ndreqjen e dëmeve mjedisore, pavarësisht nëse një shkelës është shpallur fajtor apo jo dhe pavarësisht nëse është shkaktuar dëm apo akoma jo. Mund të jetë gjithashtu e përshtatshme që gjykatat të kenë kompetencën për të dhënë urdhra plotësues për pastrim ose ndreqje në kohën e caktimit të dënimin. Shtetet duhet gjithashtu të vendosin procedura të përshtatshme për të siguruar pastrimin e mbetjeve dhe ndreqjen e dëmit mjedisor në rastet kur një shkelës nuk mund të identifikohet ose nuk mund të urdhërohet në mënyrë efektive të pastrojë mbetjet dhe të ndreqë dëmin mjedisor, sepse shkelësi nuk ka aftësi paguese ose nuk ndodhet në juridiksion, ose për ndonjë arsye tjetër. Ndërsa pastrimi dhe ndreqja është një temë e rëndësishme për ligjvënësit, ajo nuk trajtohet më tej në këtë udhëzuesin legjislativ.

MODEL I DISPOZITËS 28: RESTITUCIONI DHE KOMPENSIMI I VIKTIMAVE

1. Kur një shkelës shpallet fajtor për një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Kapitulli/Ligji...], gjykata mund të urdhërojë shkelësin të paguajë restitucion ose kompensim për viktimat, krahas ose në vend të çdo dënimi tjetër të urdhëruar nga gjykata.
2. Qëllimi i urdhrit për restitucion është rivendosja e viktimës në gjendjen në të cilën ka qenë përpara kryerjes së shkeljes. Urdhri për restitucion mund të përfshijë një ose më shumë nga format e restitucionit sa vijon:
 - (a) Kthimi te viktimat i pasurisë që është marrë nga personi i dënuar;
 - (a) Kthimi te viktimat i vlerës së fitimit të padrejtë që është marrë nga personi i dënuar; apo
 - (c) Restaurimi i habitatit për dëmet e shkaktuara në mjedis.
3. Qëllimi i urdhrit për kompensim është kompensimi i viktimës për çdo dëmtim, humbje ose dëm të shkaktuar nga shkelësi. Kjo mund të përfshijë pagesën për ose kundrejt sa vijon:
 - (a) Kostot e trajtimit mjekësor, fizik, psikologjik ose psikiatrik të pësuar ose që do të pësohen nga viktimat;
 - (b) Kostot e terapisë fizike dhe të punës ose rehabilitimit të pësuar ose që do të pësohen nga viktimat;
 - (c) Kostot e transportit të nevojshëm, kujdesit të përkohshëm të fëmijëve, strehimit të përkohshëm ose lëvizjes së viktimës në një vendbanim të përkohshëm të sigurt;
 - (d) Humbja e të ardhurave dhe pagave të pësuar nga viktimat sipas ligjit dhe rregulloreve kombëtare në lidhje me pagat;
 - (e) Tarifat ligjore dhe kostot ose shpenzimet e tjera të pësuar nga viktimat, duke përfshirë kostot që lidhen me pjesëmarrjen e viktimës në procesin e hetimit dhe ndjekjes penale;
 - (f) Dëmtimi fizik ose psikologjik, shqetësimi emocional ose dhimbjet dhe vuajtjet e përjetuara nga viktimat si rezultat i krimit të kryer kundër tij ose saj; dhe
 - (g) Çdo kosto ose humbje tjetër e pësuar nga viktimat si rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të shkelësit dhe që gjykata i konsideron të arsyeshme brenda rrethanave.
4. Me rastin e dhënies së urdhrit për restitucion ose kompensim, gjykata merr parasysh mundësinë dhe aftësinë e personit të dënuar për të paguar restitucionin ose kompensimin dhe i jep prioritet urdhrit për restitucion ose kompensim kundrejt gjobës.
5. Statusi i imigracionit ose kthimi i viktimës në vendin e tij ose të saj të shtetësisë ose vendqëndrimit të zakonshëm ose mungesa tjetër e viktimës nga juridiksioni nuk parandalon pagesën e kompensimit dhe/ose restitucionit sipas këtij neni.
6. Nëse restitucioni ose kompensimi nuk mund të paguhet nga personi i dënuar, viktimat kualifikohet për kompensim nga [shëno emrin e fondit kombëtar të kompensimit].
7. Kur personi i dënuar është një nëpunës publik, veprimet e të cilit që përbëjnë një shkelje për të cilën zbatohet ky [Akti/Kapitulli/Ligji...] janë kryer nën autoritetin e vërtetë ose të dukshëm të Shtetit, gjykata mund të urdhërojë Shtetin që t'i paguajë restitucionin ose kompensimin viktimës [në përputhje me [shëno legjislacionin përkatës kombëtar]]. Një urdhër për kompensim nga Shteti sipas këtij neni mund të përfshijë pagesën për ose kundrejt ndonjë ose të gjithë pikave sipas paragrafit 3 nënparagrafët (a)–(g).

Aksesi dhe pjesëmarrja në procedimet penale dhe të tjera

Neni 25, paragrafi 3, i Konventës kundër Krimit të Organizuar parashikon sa vijon:

Secili Shtet Palë, në varësi nga legjislacioni i tij i brendshëm, mundëson paraqitjen dhe shqyrtimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të viktimave në fazat e përshtatshme të procedimit penal kundër shkelësve në një mënyrë që nuk paragjykon të drejtat e mbrojtjes.

Fazat e përshtatshme dhe mjetet për paraqitjen dhe shqyrtimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të viktimave mund të dallojnë midis sistemeve ligjore, por, në përgjithësi, mund të përfshijnë mundësinë e paraqitjes si dëshmitar gjatë gjykimit, dhënien e një deklaratë të ndikimit nga viktimat për t'u marrë në konsideratë gjatë caktimit të dënimit ose forma të tjera të pjesëmarrjes gjatë gjykimit, caktimit të dënimit ose fazave të tjera të procedimeve penale. Në prezantimin ose ndryshimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve, Shtetet duhet të sigurojnë që masat e përshtatshme për aksesin dhe pjesëmarrjen në procedimet përkatëse shtrihen edhe për viktimat e trafikimit të mbetjeve. Për informacion të mëtejshëm mbi të drejtat e viktimave për aksesin dhe pjesëmarrjen, shih publikimin tematik të UNODC-së me titull *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*.¹⁹⁸

Masat e tjera të ndihmës

Përveç masave të përmendura shprehimisht në nenin 25, Shtetet që vendosin dispozita ligjore për ofrimin e ndihmës për viktimat e trafikimit të mbetjeve duhet të kenë parasysh edhe tërësinë e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me ndihmën për viktimat. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimin me pushtetin parashikon masat e mëposhtme:

14. Viktimat duhet të marrin ndihmën e nevojshme materiale, mjekësore, psikologjike dhe sociale nëpërmjet mjeteve qeveritare, vullnetare, të bazuara në komunitet dhe indigjene.
15. Viktimat duhet të informohen për disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe ndihmës tjetër përkatëse dhe t'u mundësohet lehtësisht aksesin në këto shërbime.
16. Personeli i policisë, drejtësisë, shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe personeli tjetër i interesuar duhet të trajnohen për t'i sensibilizuar ata për nevojat e viktimave dhe për të marrë udhëzime për të siguruar ndihmën e duhur dhe të menjëhershme.

¹⁹⁸ Publikim i radhës.

Kapitulli 8.

BASHKËRENDIMI KOMBËTAR

Në kapitullin 1 të këtij udhëzuesi, kuadri institucional kombëtar u diskutua si një konsideratë e përgjithshme që Shtetet duhet të marrin parasysh kur hartojnë ose ndryshojnë legjislacionin për luftimin e trafikimit të mbetjeve.¹⁹⁹ Përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse u diskutuan gjithashtu në kapitullin 1, si dhe institucionet tipike të përfshira në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve. Një çështje e lidhur ngushtë, e lënë mënjanë për diskutim në këtë kapitull, është sigurimi efektiv që institucionet e ndryshme të cilat punojnë në këtë fushë bashkërendojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive me njëra-tjetrën.

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi efektiv është i nevojshëm për institucionet kombëtare në mënyrë që të shmangët dyfishimi i përpjekjeve, të shmangen mospërputhjet dhe kontradiktat në qasje dhe të sigurohet që të gjitha institucionet përfitojnë nga njohuritë, ekspertiza dhe burimet brenda secilit institucion. Për shembull, kur ka shumë agjenci që potencialisht mund të jenë përgjegjëse për hetimin e trafikimit të mbetjeve dhe shkeljeve të lidhura me to, Shtetet duhet të sigurojnë që të ketë një ndarje të qartë dhe të përshtatshme të përgjegjësisë ndërmjet tyre. Ndarja e përgjegjësisë mund të organizohet sipas fazës së hetimit, peshës së shkeljes ose përfshirjes së krimeve të tjera të caktuara.

Përcaktimi i kompetencave ndërmjet institucioneve përkatëse është një çështje që secili Shtet duhet ta vendosë vetë. Së këndejmi, ky udhëzues nuk ofron një model të dispozitës për mandatet e agjencive përkatëse. Në vend të kësaj, modeli i dispozitës 29 parashikon krijimin e një trupi përgjegjës për bashkërendimin kombëtar. Kjo dispozitë është menduar kryesisht për Shtetet që nuk kanë tashmë mekanizma të përshtatshëm për bashkërendimin kombëtar në lidhje me trafikimin e mbetjeve. Dispozita nuk është menduar të përdoret kur krijimi i një trupi bashkërendues kombëtar shtesë do të ishte i tepërt ose do të dyfishonte strukturat ekzistuese ose përpjekjet bashkërenduese.

Çfarëdo qoftë ndarja e kompetencave që adopton një Shtet, Shteti duhet të sigurojë që mandatet përkatëse të secilës agjenci të përfshirë në parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e shkeljeve të mbetjeve janë përcaktuar qartë në legjislacion. Kjo është e domosdoshme jo vetëm që secila agjenci të kryejë me efektivitet këto funksione, por edhe për të garantuar ligjshmërinë dhe pranueshmërinë e provave që janë marrë nga agjenci të tilla në ndjekjet penale të mëpasshme të trafikimit të mbetjeve.

¹⁹⁹ Shih “Kuadri institucional kombëtar”, më sipër.

MODEL I DISPOZITËS 29: TRUPI BASHKËRENDUES KOMBËTAR

(1) [Shëno Ministrin përkatës] themelon një komitet bashkërendues kombëtar që do të përbëhet nga nëpunës nga [shëno agjencitë përkatëse] dhe përfaqësues nga [shëno organizatat e tjera përkatëse dhe organizatat joqeveritare dhe/ose ofruesit e shërbimeve].

(2) Komiteti bashkërendues kombëtar zhvillon, bashkërendon, monitoron dhe vlerëson reagimin kombëtar për parandalimin e të gjitha formave të krimit të organizuar, duke përfshirë mbledhjen, analizën dhe shkëmbimin e të dhënave, zhvillimin e programeve parandaluese, trajnimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shumëdisiplinor ndërmjet agjencive të ndryshme qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave përkatëse joqeveritare.

(3) Komiteti bashkërendues kombëtar do t'i raportojë çdo vit [Ministrin përkatës/Parlamentit] për aktivitetet e tij.

Shtetet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë përdorimin e dispozitave legislative ose memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet autoriteteve përkatëse si mjete për të përvijuar në mënyrë efektive përgjegjësitë e autoriteteve të ndryshme dhe për të krijuar mekanizma për bashkëpunim efektiv. Memorandumet e mirëkuptimit mund të trajtojnë çështje që përfshijnë sa vijon:

- Qëllimi i memorandumit të mirëkuptimit
- Informacione në lidhje me palët e memorandumit të mirëkuptimit dhe personat ose agjencitë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të tij
- Funkcionet e secilit institucion në lidhje me kontrollet e transportit të mbetjeve
- Përgjegjësitë dhe kompetencat e zbatueshme për secilin institucion
- Një deklaratë se si secili institucion do t'i ushtrojë këto përgjegjësi dhe kompetenca
- Marrëdhëniet e rëna dakord për punën e përbashkët
- Procedurat për shkëmbimin e informacionit
- Pikat e kontaktit
- Një proces për rishikimin e memorandumit të mirëkuptimit, duke përfshirë takime të rregullta rishikimi në nivel të lartë
- Periudha e vlefshmërisë së memorandumit të mirëkuptimit²⁰⁰

²⁰⁰ Institute for European Environmental Policy, Bio Intelligence Service and Ecologic, *Study on Inspection Requirements for Waste Shipments* (2008), f. 118.

SHEMBULL: INTERPOL**Task forcat kombëtare të sigurisë mjedisore**

Nën-Drejtoria e Sigurisë Mjedisore e INTERPOL-it rekomandon që vendet anëtare të krijojnë task force kombëtare të sigurisë mjedisore. Task forcat kombëtare të sigurisë mjedisore janë të projektuara për të trajtuar krimin e organizuar mjedisor që ka natyrë ndërkombëtare përmes bashkëpunimit dhe bashkërendimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Task forcat kombëtare të sigurisë mjedisore bëjnë bashkë të gjitha agjencitë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit kombëtar të mjedisit, duke përfshirë policinë, doganën, agjencitë mjedisore, prokurorinë dhe gjyqësorin. Shtetet mund të dëshirojnë gjithashtu të përfshijnë përfaqësues të organizatave përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale, shoqërisë civile, institucioneve kërkimore dhe sektorit privat.

Një publikim nga Nën-Drejtoria e Sigurisë Mjedisore e INTERPOL-it ofron një udhëzues për themelimin e një task force kombëtare të sigurisë mjedisore dhe trajton çështje të tilla si kush duhet të marrë pjesë, si të organizohet një seminar kombëtar për sigurinë mjedisore, si të formohet një komitet drejtues kombëtar i sigurisë mjedisore dhe si të ngrihet dhe të strukturohet një task forcë kombëtare e sigurisë mjedisore.^a

^a INTERPOL, Environmental Security Sub-directorate, *National Environmental Security Task Force: Bringing Compliance and Enforcement Agencies Together to Maintain Environmental Security* (Lion, Francë, 2014).

SHEMBULL: FRANCË**Zyra Qendrore Kundër Krimeve të Mjedisit dhe të Shëndetit Publik (OCLAESP)**

Zyra ndërministrrore franceze OCLAESP, e krijuar në vitin 2004, është një nga zyrat qendrore të Nën-Drejtorisë së Policisë Gjyqësore në kuadër të Xhandarmërisë. Ajo është përgjegjëse për udhëheqjen dhe bashkërendimin e hetimeve në fushat e mjedisit dhe shëndetit publik nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e prokurorëve ose gjyqtarëve, duke ndihmuar hetuesit dhe nëpunësit e tjerë në kryerjen e hetimeve, monitorimin dhe analizimin e krimeve kundër mjedisit dhe shëndetit publik dhe të autorëve të tyre, duke marrë pjesë në trajnime dhe në ngritjen e kapaciteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe në trajtimin e kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar.^a

^a Për më shumë informacion, shih www.gendarmerie.interieur.gouv.fr.

of the study. The first author (S.J.G.) was the primary investigator and was responsible for the development of the study protocol, data collection, data analysis and the writing of the paper. The other authors (M.C., J.S., and M.C.) were involved in the development of the study protocol, data collection, data analysis and the writing of the paper.

2. Methods

2.1. Participants

Forty-one participants (20 males and 21 females) were recruited from a university in the south of England. The participants were aged between 18 and 30 years ($M = 22.5$, $SD = 3.1$). The participants were screened for any medical conditions that could affect their performance on the tasks. All participants gave their informed consent to participate in the study. The study was approved by the local research ethics committee. The participants were allocated to two groups: a control group ($n = 20$) and an experimental group ($n = 21$). The control group consisted of 10 males and 10 females, and the experimental group consisted of 10 males and 11 females.

2.2. Apparatus

The participants performed the tasks on a computer workstation. The workstation consisted of a personal computer (Pentium III, 100 MHz) and a monitor (15 in.). The participants were seated in front of the monitor and the computer keyboard. The distance between the participants and the monitor was approximately 50 cm. The participants were instructed to maintain a neutral posture throughout the study. The participants were seated in a chair and their feet were supported by a footrest. The participants were instructed to maintain a neutral posture throughout the study.

2.3. Procedure

The participants performed the tasks in a laboratory setting. The participants were instructed to maintain a neutral posture throughout the study. The participants were seated in a chair and their feet were supported by a footrest. The participants were instructed to maintain a neutral posture throughout the study. The participants performed the tasks in a laboratory setting.

2.4. Data analysis

The data were analysed using a two-way ANOVA with group (control and experimental) and gender (male and female) as the independent variables. The dependent variables were the mean and standard deviation of the variables. The results are presented in the following sections.

2.5. Results

The results of the study are presented in the following sections. The results are presented in the following sections.

FJALË PËRMBYLLËSE

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të mbështesë Shtetet në miratimin ose forcimin e legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të Konventës kundër Krimit të Organizuar. Për këtë qëllim, udhëzuesi përvijoi një sërë çështjesh që Shtetet do të duhet të marrin në konsideratë kur miratojnë ose forcojnë legjislacionin e tillë dhe ofroi modele të dispozitave legjislative dhe shembuj përkatës kombëtarë dhe rajonalë për shqyrtim gjatë atij procesi.

Në fillim, u përshkruan një sërë konsideratash të përgjithshme për Shtetet, duke përfshirë kuadrin ligjor ndërkombëtar, jo vetëm në lidhje me të drejtën ndërkombëtare të mjedisit dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar për të luftuar krimin e rëndë, por edhe duke iu referuar të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në kapitullin 1, u shqyrtua gjithashtu lidhja e legjislacionit të brendshëm për menaxhimin e mbetjeve në raport me legjislacionin që trajton trafikimin e mbetjeve dhe rëndësia e një kuadri institucional kombëtar efektiv për zbatimin e legjislacionit të parashikuar në udhëzues.

Në kapitujt pasues të udhëzuesit, u shqyrtuan temat, çështjet dhe dispozitat që duhet të trajtohen në legjislacionin e trafikimit të mbetjeve ose të merren parasysh në procesin e zhvillimit të tij. Në kapitullin 2, u përshkruan disa dispozita të përgjithshme që janë të dobishme për legjislacionin e trafikimit të mbetjeve: parimet e të drejtës së mjedisit, përkufizimet, tabelat e mbetjeve dhe dispozitat në lidhje me juridiksionin.

Në kapitullin 3, u shqyrtuan temat e rëndësishme të shkeljeve dhe përgjegjësisë, duke ofruar një hyrje në elementet e figurës së veprave penale, përpara se të kalohej në një diskutim mbi shkeljet specifike të mbetjeve, si trafikimi i mbetjeve dhe mashtrimi me dokumente në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, si dhe shkeljet plotësuese që mbështesin këto aktivitete kriminale. Një konsideratë e mëtejshme iu kushtua çështjeve të ndërlidhura si përgjegjësia dytësore, përgjegjësia për tentativën, përgjegjësia e personave juridikë dhe mbrojtja.

Në kapitullin 4, u ekzaminuan çështjet në lidhje me hetimin e trafikimit të mbetjeve, duke përfshirë modelet e dispozitave legjislative për sekuestrimin dhe disa teknika të posaçme hetimore, si dhe një diskutim të çështjeve në lidhje me marrjen, trajtimin dhe pranueshmërinë e provave. Kapitulli 5 iu kushtua adresimit të disa formave të bashkëpunimit ndërkombëtar që lidhen me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve të trafikimit të mbetjeve: ndihma e ndërsjellë juridike, ekstradimi, bashkëpunimi i forcave ligj-zbatuese dhe hetimet e përbashkëta.

Në kapitullin 6, shqyrtimi u kthye drejt çështjeve që lidhen me ndjekjen penale të shkeljeve të trafikimit të mbetjeve dhe masat ndëshkuese dhe caktimin e dënimit për shkelje të tilla. Në seksionin për ndjekjen

penale, u diskutua diskrecioni i prokurorisë dhe udhëzimet që përdoren në ndjekjen penale si dhe ekzekutimi, paraburgimi, alternativat ndaj gjyqimit dhe afatet e parashkrimit. Në seksionin mbi masat ndëshkuese dhe caktimin e dënimit, u trajtuan konsideratat që qëndrojnë në themel të caktimit të dënimit për shkeljet e trafikimit të mbetjeve, si dhe disa nga llojet e sanksioneve që mund të jenë të përshtatshme për personat fizikë dhe juridikë të shpallur fajtorë për shkelje që lidhen me trafikimin e mbetjeve, duke përfshirë disa lloje të urdhrave plotësues.

Në kapitullin 7, u trajtuan tema në lidhje me mbrojtjen dhe ndihmën dhënë dëshmitarëve, viktimave, personave që bashkëpunojnë me autoritetet dhe sinjalizuesve. Në fund, në kapitullin 8, u shqyrtua çështja e bashkërendimit kombëtar dhe u përfshi një model i dispozitës legislative për një trup bashkërendues kombëtar.

Si përmbledhje, në këtë udhëzues, u bë një përpjekje për t'u ofruar lexuesve një pasqyrë të gjerë (por jo shteruese) të çështjeve që lidhen me zhvillimin e legjislacionit për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e mbetjeve nga perspektiva e drejtësisë penale dhe mjetet bazë për ligjvënësit që të miratojnë ose forcojnë legjislacionin e tillë.

Duke përmbledhur çështjet që u mbuluan nga ky udhëzues, është gjithashtu e dobishme të identifikohen çështjet që nuk janë mbuluar. Në veçanti, duhet të kujtohet se audienca kryesore e synuar e udhëzuesit janë politikëbërësit, ligjvënësit dhe hartuesit e legjislacionit. Së këndejmi, ndërsa udhëzuesi ka prekur gjithashtu një sërë çështjesh që lidhen me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e shkeljeve të trafikimit të mbetjeve, përmbajtja e tij nuk ofron një shqyrtim gjithëpërfshirës të çështjeve të rëndësishme për hetuesit, prokurorët dhe gjyqtarët.

Përveç kësaj, duhet theksuar se qasja e marrë në këtë udhëzues për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve është nga këndvështrimi i drejtësisë penale, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të Konventës kundër Krimet të Organizuar. Megjithatë, është me rëndësi kritike që politikëbërësit dhe ligjvënësit të kuptojnë se trafikimi i mbetjeve nuk mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet qasjeve të drejtësisë penale. Përkundrazi, nevojitet një reagim holistik i politikave që kombinon qasjet e drejtësisë penale me qasje më të gjera rregullatore për menaxhimin e mbetjeve. Për më tepër, koncepti i trafikimit të mbetjeve, siç diskutohet në udhëzues, është i lidhur qenësisht me dispozitat legislative ose rregullatore që kanë të bëjnë me kuadrin e brendshëm për menaxhimin e mbetjeve. Një shembull është përcaktimi i rasteve kur akte të caktuara bien ndesh me një detyrë ligjore ose një kusht të një lejeje ose licence. Me fjalë të tjera, qasja e drejtësisë penale e ofruar nga udhëzuesi legjislativ varet gjithashtu nga kuadri efektiv për menaxhimin e mbetjeve.

Burime të tjera të rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të mbetjeve janë paraqitur më poshtë.

BURIME TË TJERA

Burime në lidhje me trafikimin e mbetjeve

- UNEP, *Guide for the Development of National Legal Frameworks to Implement the Basel Convention* (2019)
- UNEP, *Manual for the Implementation of the Basel Convention* (2016)
- UNEP, *Guidance on the Implementation of the Basel Convention Provisions Dealing with Illegal Traffic (paragraphs 2, 3 and 4 of article 9)* (2019)
- UNEP, *Instruction Manual on the Prosecution of Illegal Traffic of Hazardous Wastes or Other Wastes* (2012)
- UNEP, *Basel Convention Training Manual on Illegal Traffic for Customs and Enforcement Agencies* (2006)
- Conference of the Parties to the Basel Convention, decision VI/16, *Guidance Elements for Detection, Prevention and Control of Illegal Traffic in Hazardous Wastes*
- WasteForce, *Guidance for Prosecutors of Waste Crime* (2020)

Publikime të UNODC-së

- UNODC, *Legislative Guide for the Implementation of the United Nations Convention against Transnational Organized Crime*, 2nd ed. (2017)
- UNODC, *Model Legislative Provisions against Organized Crime*, 2nd ed. (2022)
- UNODC, *The United Nations Convention against Transnational Organized Crime and International Human Rights Law* (2022)
- UNODC, *Manual on Mutual Legal Assistance and Extradition* (2012)
- UNODC, *Manual on International Cooperation for the Purposes of Confiscation of Proceeds of Crime* (2012)



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime